

SFIDAT FINANCIARE TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE NË KOSOVË

Bahri Hyseni

Dorëzuar

Universitetit European të Tiranës


Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca
Ekonomike, me profil Financë, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof.Dr. Magdalena Bregasi

Numri i fjalëve: 51,709

Tiranë, Shtator 2018



DEKLARATA E AUTORSISË

Unë, i nënshkruari Bahri Hyseni deklaroj që ky punim është punë origjinale e imja.

BAHRI HYSENI

DATË: 03.09.2018

ABSTRAKTI

“Të sundosh është lehtë, të qeverisësh është vështirë”

Johann Wolfgang von Goethe, shkrimtar gjerman (1749-1832)

Ndërmarrjet Publike gjithnjë e më shumë po bëhen objekt i hulumtimit dhe trajtimit nga ana e studiuesve dhe hulumtuesve pasi që nga afarizmi i tyre varet niveli shërbimeve publike. Në Kosovë, Qeveria ka kompetencën ekskluzive të ushtrimit të drejtës së akcionarit të ndërmarrjeve publike prandaj edhe është i kuptueshëm interesimi për funksionim të mirëfilltë të tyre por edhe për faktin se shërbimet publike kanë ndikim të drejtëpërdrejtë në nivelin e standardit jetësor të qytetarëve.

Gjithnjë e më shumë përveç kryerjes së shërbimeve publike po kërkohet transparencë në përdorimin e fondeve publike dhe llogaridhënje. Me qenë se ndërmarrjet publike në Kosovë janë themeluar para disa vitesh, qëllimi i këtij kërkimi është të hulumtojë ndikimin e sfidave financiare në ofrimin e shërbimeve publike cilësore. Po ashtu synon të japë përgjigje se çfarë efekti do të ketë kalimi i sukseshëm i këtyre sfidave për qytetarët si shfrytëzues dhe përdorues të këtyre shërbimeve.

Ky punim është mbështetur në hulumtimin e kryer në ndërmarrjet publike në Kosovë edhe pse disa nga ndërmarrjet publike nuk kanë pasur sfida të natyrës së këtij punimi. Punimi bazohet në metodologjinë e gërshetimit të të dhënave parësore dhe dytësore i mbështetur në

të dhënat e publikuara nga ndërmarrjet publike, Njësia për Politika dhe Monitorim të NP, zyrat rregullatore, odat ekonomike, etj.

Përgjatë punimit do të elaborohen disa nga sfidat aktuale të cilat ndikojnë në cilësinë e shërbimeve publike ndërsa në fund të punimit do të japim analizën e rezultateve të hulumtimit dhe disa rekomandime për të gjithë pjesëmarrësit. Rezultatet e këtij punimi do të shërbejnë për analizën e mëtejshme të sfidave të ndërmarrjeve publike.

ABSTRACT

“To rule is easy, to govern difficult.”

Johann Wolfgang von Goethe, German writer (1749-1832)

Public Enterprises are becoming increasingly a subject of research by scholars and researchers as the levels of public services is dependent on their performance. In Kosovo, the Government has the exclusive authority to exercise the shareholder rights, therefore it is understandable the concern regarding their proper operation but also due to the fact that public services have a direct impact on the level of the living standard of citizens.

Besides providing public services it is also becoming increasingly required a transparency in the use of public funds and accountability. Since public enterprises in Kosovo were established just a few years ago, the goal of this research is to explore the impact of the financial challenges in providing quality public services. It also aims to provide answers about the effect it will have the successful overcoming of these challenges for the citizens as the end users of these services.

This research study is based on research conducted in public enterprises in Kosovo, although some public enterprises didn't have challenges of the nature of this study. Furthermore, this research study is based on the methodology of gathering primary and secondary data, based on data published by public enterprises, Policy and Monitoring unit of Public Enterprises, the Regulatory Office, and the Economic Chamber etc.

This research study will elaborate challenges that affect the quality of public services, analyse the results of the research, and we will provide recommendations for all relevant actors. Results derived from this research study will be used for further analysis of the challenges of public enterprises.

DEDIKIMI

Ky punim i dedikohet në rend të parë familjes time dhe njerëzve të cilët më vlerësojnë dhe më kanë përkrahur gjithmonë, Universitetit European të Tiranës i cili na mundësoi që të zhvillojmë punën kërkimore hulumtuese pa të cilën nuk do të ishte e mundur të realizohet ky punim. Konsideroj, se ky punim do të jetë i dobishëm për të gjithë vendimmarrësitë në ndërmarrjet publike-bordet e drejtorëve, komisionet e auditimit, zyrtarët e lartë, kryeshefat ekzekutivë, etj. Gjithashtu, do të shërbej si një nismë për vazhdimin e studimeve të mëtejshme për hulumtuesit dhe kërkuesit shkencor e në veçanti për studentët e ardhshëm.

FALËNDERIME

Falënderoj përzemërsisht Prof. Dr. Magdalena Bregasin për ndihmen e madhe dhe të vazhdueshme, për përkrahjen dhe motivimin gjatë gjithë punës së përbashkët deri në përfundimin e këtij punimi.

Gjithashtu falënderoj Prof. Dr. Adrian Civicin, Prof. Dr. Luljeta Minxhozin, profesorët Arjan Kadareja, Selami Xhepa, Engjëll Pere, Aranit Shkurti për ndihmesën dhe këshillimin e hapur dhe të sinqertë.

Falënderoj kolegët Fatmir Mehmetin dhe Skender Hasanin pa nxitjen e të cilëve nuk do të ishim sot këtu.

Falënderoj Isak Muratin, Bahri Halitin, Bedri Dërvarin që u interesuan dhe më motivuan vazhdimisht.

Një falënderim i veçantë për Axhen tim Hysenin, Hallen Fetijen, motrat Hidajeten dhe Nizafeten, vëllezëritë Fahriun dhe Avniun.

Falënderoj bashkshorten time Myrveten, djalin Valonin me nusen Teuten, dhe Virtuozin për përkrahjen morale të përhershme.

PËRMBAJTJA E LËNDËS

KAPITULLI I: HYRJE.....	1
1.1 Parathënie.....	1
1.2 Shtrimi i problemit.....	4
1.3 Pyetjet kërkimore dhe hipotezat bazë	9
1.4 Çfarë kuptohet me sfida financiare dhe si matet ajo?	10
1.5 Diskutimet, shkrimet aktuale për problematikën e këtij punimi	13
1.6 Përmbledhje e literatures, përparësitë dhe kufizimet	14
1.7 Metodologjia e punimit dhe metodat e hulumtimit.....	16
1.8 Shpjegim i strukturës së punimit.....	17
1.9 Përmbledhje e kapitullit	18
PJESA E PARË: ANALIZË E ZHVILLIMIT TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE NË KOSOVË...19	
KAPITULLI II: SPECIFIKAT E ORGANIZIMIT TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE NË KOSOVË	19
2.1 Historiku i zhvillimit të ndërmarrjeve publike nga ish ndërmarrjet shoqërore deri më sot .19	
2.2 NP gjatë administrimit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM-ës)	24
2.3 NP gjatë administrimit të AKP-ës.....	26
2.4 Disa karakteristika të përbashkëta dhe të veçanta të NP.....	28
2.5 Funksionimi i NP-ve sot	33
2.6 Organizimi i tyre sipas Ligjit për NP	43
2.7 Mbikëqyrja e ndërmarrjeve publike	50
2.8 Parimet e qeverisjes korporative	62
2.9 Mungesa e përvojes në qeverisjen korporative	69
2.10 Përmbledhje e kapitullit	70
KAPITULLI III: SFIDAT FINANCIARE TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE	71
3.1 Niveli i ultë i arkëtimit të të hyrave	72
3.2 Niveli i lartë i shpenzimeve (pagat dhe të punësuarit)	79
3.3 Investimet kapitale nga burimet e veta.....	94
3.4 Likuiditeti i ulët.....	99
3.5 Rrjedha e parasë.....	102

3.6 Borxhet e këqija	104
3.7 Kërkesat ambientale (KEK, Trepça, Sharrcem, dhe kualiteti i ujit)	111
3.8 Llogaridhënja dhe raportimi financiar	116
3.9 Politika e çmimeve.....	122
3.10 Krizat politike-vakuumi institucional	127
3.11 Perspektiva e NP-ve dhe e ardhmja e tyre	128
3.12 Përmbledhje e kapitullit	129
PJESA E DYTË: STUDIMI EMPIRIK	130
KAPITULLI IV: METODOLOGJIA E KËRKIMIT	130
4.1 Përdorimi i kuadrit teorik në funksion të studimit empirik.....	130
4.2 Burimet e informacionit	131
4.3 Popullata dhe kampioni (mostra)	131
4.4 Metodologjia, metodat dhe instrumentet bazë të hulumtimit.....	133
4.5 Mbledhja e të dhënave dhe përpunimi i tyre.....	134
4.6 Vështirësitë gjatë mbledhjes së të dhënave.....	138
4.7. Përmbledhje e kapitullit	139
KAPITULLI V: ANALIZA E TË DHËNAVE	140
5.1 Tabelat e kryqëzuara	170
5.2 Analiza e Regresionit	210
KAPITULLI VI: DISKUTIME, KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	220
6.1 Diskutime të gjetjeve kryesore dhe rekomandime	220
6.2 Kontributet e studimit, kufizimet dhe perspektiva e vazhdimit në të ardhmen.....	225
6.3 Konkluzione përfundimtare	229
BIBLIOGRAFIA	232
SHTOJCA.....	239

LISTA E TABELAVE, GRAFIKËVE, DHE FIGURAVE

LISTA E TABELAVE

Tabela Nr. 1 - Implementimi i kërkesave të qeverisjes korporative.	68
Tabela Nr. 2 - Shkallët e arkëtimit të të hyrave në disa sektore dhe ndërmarrje publike.	73
Tabela Nr. 3 - Shkalla e arkëtimit për periudhën 2011-2015.....	79
Tabela Nr. 4 - Niveli i shpenzimeve për paga dhe numri i të punësuarve në KEK.	82
Tabela Nr. 5 - Niveli i shpenzimeve për paga dhe numri i të punësuarve në NP Infrakos.	82
Tabela Nr. 6 - Niveli i shpenzimeve për paga dhe numri i të punësuarve në NP Trainkos.	83
Tabela Nr. 7 - Niveli i shpenzimeve për paga dhe numri i të punësuarve në KRU Mitrovica.	83
Tabela Nr. 8 - Kostoja e stafit në Ndërmarrjet Publike.....	90
Tabela Nr. 9 - Provizionet për borxhe të këqia dhe llogaritë e arkëtueshme në KEK	108
Tabela Nr. 10 - Provizionet për borxhe të këqia dhe llogaritë e arkëtueshme në Infrakos	109
Tabela Nr. 11 - Provizionet për borxhe të këqia dhe llogaritë e arkëtueshme në KRU Mitrovica ..	109
Tabela Nr. 12 - Opinioni i auditorit të jashtëm për KEK.....	120
Tabela Nr. 13 - Opinioni i auditorit të jashtëm për NP Trainkos.....	120
Tabela Nr. 14 - Opinioni i auditorit të jashtëm për NP Infrakos.....	121
Tabela Nr. 15 - Opinioni i auditorit të jashtëm për KRU "Mitrovica".....	121
Tabela Nr. 16 - Veprimtaria dhe pozita e juaj si operator i vetëm i këtij lloji shërbimi	170
Tabela Nr. 17 - Veprimtaria dhe tarifat e shërbimeve nga Zyra e Rregullatorit	172
Tabela Nr. 18 - Veprimtaria dhe cila formë e organizimit të NP-ve është më efektive	174
Tabela Nr. 19 - Veprimtaria dhe arkëtimi i të hyrave në NP në periudhën 2013-15	177
Tabela Nr. 20 - Veprimtaria dhe arkëtimi i të hyrave	180
Tabela Nr. 21 - Veprimtaria dhe flukset monetare të ndryshueshme.....	183
Tabela Nr. 22 - Veprimtaria dhe likuiditeti.....	186
Tabela Nr. 23 - Veprimtaria dhe borxhet e këqija	188
Tabela Nr. 24 - Veprimtaria dhe afatet e shkurtëra të pagesës së detyrimeve	191
Tabela Nr. 25 - Veprimtaria dhe shpenzimet e larta	193
Tabela Nr. 26 - Veprimtaria dhe infrastruktura e vjetëruar	195
Tabela Nr. 27 - Veprimtaria dhe tarifat/çmimet e larta.....	197
Tabela Nr. 28 - Veprimtaria dhe operatori i vetëm i këtij lloji	199
Tabela Nr. 29 - Veprimtaria dhe shfrytëzuesit e shërbimeve.....	201
Tabela Nr. 30 - Veprimtaria dhe situata politike/mospagesa e komunitetit pakicë	203
Tabela Nr. 31 - Veprimtaria dhe numri i madh i të punësuarve	206
Tabela Nr. 32 - Korelacioni i Variablave.....	209
Tabela Nr. 33 - Variablat e përfshira në model.....	212
Tabela Nr. 34 - Statistikat përshkruese të variablave.....	214
Tabela Nr. 35 - Koeficientët e korrelacionit të Pearsonit të variablave të pavarura dhe variablës së varur	216
Tabela Nr. 36 - Përmbledhje e modelit të regresionit linear	217
Tabela Nr. 37 - Koeficientët e regresionit linear	218

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku Nr. 1 - Pozita punës e të anketuarve ne ndërmarrjen ku punojnë	140
Grafiku Nr. 2 - Numri i të punësuarve ne ndërmarrjet publike.....	141
Grafiku Nr. 3 - Veprimtaria e ndërmarrjeve publike në Kosovë	142
Grafiku Nr. 4 - Shfrytëzuesit e shërbimeve publike	143
Grafiku Nr. 5 - Ndërmarrjet publike si ofrues të vetëm të shërbimit.....	144
Grafiku Nr. 6 - Tarifat e shërbimeve të NP-ve të caktuara nga Zyra Rregullatore	144
Grafiku Nr. 7 - Përvoja në qeverisjen korporative para se të themelohen NP	145
Grafiku Nr. 8 - Përvoja si anëtar i Bordit të Drejtorëve të NP-ve.....	146
Grafiku Nr. 9 - Njohuri për NP para emërimit si anëtarë i Bordit të Drejtorëve	146
Grafiku Nr. 10 - Ndryshimet ligjore për funksionim më të mirë të NP-ve	147
Grafiku Nr. 11 - Ndryshime ligjore për zgjedhjen e drejtorit ekzekutiv që të ruhet pavarësia e tij.....	148
Grafiku Nr. 12 - Format më efikase të organizimit të NP-ve në ofrimin e shërbimeve publike.....	148
Grafiku Nr. 13 - Arkëtimi i të hyrave në NP për periudhën 2013-2015	149
Grafiku Nr. 14 - Faktorët që ndikojnë ne rritjen e arkëtitimit të NP.....	150
Grafiku Nr. 15 - Afatet e pagesës së detyrimeve nga NP-të	152
Grafiku Nr. 16 - Flukset monetare (rrjedhat e parasë) në NP	153
Grafiku Nr. 17 - Ndikimi i partneritetit publiko-privat në NP në Kosovë.....	154
Grafiku Nr. 18 - Vështirësitë e ndërmarrjeve publike dhe ballafaqimi me këto vështirësi.....	155
Grafiku Nr. 19 - Niveli i borxheve të këqija te ndërmarrjet publike.....	157
Grafiku Nr. 20 - Shpenzimet e zhvlerësimit të NP-ve	158
Grafiku Nr. 21 - Likuiditeti te NP-të.....	159
Grafiku Nr. 22 - Kostot e shërbimeve të NP-ve.....	161
Grafiku Nr. 23 - Investimet kapitale te NP-të.....	163
Grafiku Nr. 24 - Planifikimi i investimeve kapitale.....	164
Grafiku Nr. 25 - Planifikimi i burimeve financiare të NP-të	166
Grafiku Nr. 26 - Kthimi në aktive gjatë periudhës 2013-2015 te NP-të	168
Grafiku Nr. 27 - Kthimi në kapitale të veta gjatë periudhës 2013-2015 te NP-të.....	169

LISTA E FIGURAVE

Figura Nr. 1 - Organogrami i Ndërmarrjes Publike "Ibër Lepenci".....	38
Figura Nr. 2 - Organogrami i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik	53
Figura Nr. 3 - Logaridhëna dhe raportimi nga NP te Komisionet parlamentare.....	119

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

AKM - Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit

AKP - Agjencioni Kosovar i Privatizimit

ASK - Agjencioni i Statistikave të Kosovës

ATK - Administrata Tatimore e Kosovës

BB - Banka Botërore

BE - Bashkësia Evropiane

BERZH - Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

BD - Bordi i Drejtorëve

BIE - Banka Investive Evropiane

BKK - Buxheti i Konsoliduar i Kosovës

BSNK - Bordi për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit

FMN - Fondi Monetar Ndërkombëtar

IÇK - Indikatori i Çmimeve të Konsumit

IFC - Korporata Ndërkombëtare Financiare

KA - Komisioni i Auditimit

KB - Kombet e Bashkuara

KEK - Korporata Energjetike e Kosovës

KKDF- Kompania Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike

KKRF - Këshilli Kosovar për Raportim Financiar

KESCO - Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike

KOSID - Konsorciumi Kosovar i Shoqërisë Civile për Zhvillim të Qëndrueshëm

KQP - Komisioni Qeveritar për Privatizim

MEF - Ministria e Ekonomisë dhe Financave
MPMS - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MZHE - Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NP - Ndërmarrje Publike
NSH - Ndërmarrje Shoqërore
NJPM të NP - Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike
OEK - Oda Ekonomike e Kosovës
OEA - Oda Ekonomike Amerikane
OECD - Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim
SKK - Standardet Kosovare të Kontabilitetit
SNK - Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit
SNA - Standardet Ndërkombëtare të Auditimit
SNRF - Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar
SHUKALB - Shoqata Ujësjetllës Kanalizime e Shqipërisë
SHUKOS - Shoqata Ujësjetllësve dhe Kanalizimit të Kosovës
TPV - Takimi i Përgjithshëm Vjetor
UNDP - Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNMIK - Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë
USAID - Agjencia Ndërkombëtare për Zhvillim e Shteteve të Bashkuara
ZAP - Zyra e Auditorit të Përgjithshëm
ZRRE - Zyra Rregullatore e Energjisë
ZRRUM - Zyra Rregullatore e Ujit dhe Mbeturinave
ZRRUK - Zyra Rregullatore e Ujit dhe Kanalizimit

KAPITULLI I: HYRJJE

1.1 Parathënie

Një nga sfidat e cila është parashtruar para shumë shoqërive njerëzore deri më sot ka qenë plotësimi i kërkesave të qytetarëve për shërbime publike të domosdoshme për mirëqenjen e tyre. Në varësi nga shkalla e zhvillimit ekonomik të tyre nëpër periudha kohore ato edhe kanë ofruar ato lloje të shërbimeve publike. Kështu sot vendet e botës varësishtë nga niveli i zhvillimit të tyre dallojnë për nga lloji i shërbimeve publike që ofrohen. Ofrimi i këtyre shërbimeve dallon nga mënyra dhe niveli i organizimit të ofruesve të shërbimeve. Prandaj, një nga faktorët me rëndësi në ofrimin e shërbimeve cilësore publike është ballafqimi me sukses i ndërmarrjeve publike me sfidat financiare.

Në shumë vende të botës për shkak se disa shërbime publike janë të përbashkëta për popullsinë dhe kanë karakterin e monopolit natyror të tyre janë themeluar ndërmarrje me pronësi shtetërore. Në vendet me ekonomi të zhvilluar, të orientuara drejt tregut, përmes riorganizimit të ndërmarrjeve këtë funksion e kryejnë ndërmarrjet e privatizuara ose të cilat janë në partneritet publiko-privat ose ato të cilat kanë marrëveshje koncesionimi. Edhe në vendet e Ballkanit si Kroacia, Serbia, Mali i Zi, Shqipëria dhe Maqedonia, organizimi i ofrimit të shërbimeve publike kryhet nga ndërmarrjet publike përveç rasteve kur ato shërbime u janë besuar ndërmarrjeve private ose janë dhënë me koncesion, etj.

Edhe në Kosovë sikurse në vendet tjera të Ballkanit, ndërmarrjet publike janë të organizuara si shoqëri aksionare, ku Qeveria e Kosovës ka kompetencën ekskluzive për

ushtrimin e të drejtave të akcionarit të Republikës së Kosovës në Ndërmarrjet Publike Qendrore.

Qëllimi kryesor i këtij punimi është që të hulumtohen dhe analizohen sfidat financiare të ndërmarrjeve publike me të cilat ato ballafaqohen gjatë ushtrimit të veprimtarisë dhe ndikimi i tyre në afarizmin e ndërmarrjeve publike dhe sa drejtimi financiar efikas ka influencuar në përmirësimin e cilësisë së shërbimeve të ofruara.

Qëllimi tjetër është të hulumtohet ndikimi i sfidave financiare në nivelin e cilësisë së shërbimeve publike. Furnizimi me energji elektrike 24 orë pandërprerje, furnizim i rregulltë me ujë, kualiteti i ujit të pijshëm, kohëzgjatja e nxemjes qendrore, mbledhja dhe deponimi i mbeturinave, transporti rrugor urban, etj. janë kërkesa me të cilat sfidohen çdo ditë ndërmarrjet publike. Ndërmarrjet publike kanë numër të madh të të punësuarve, gjenerojnë të hyra të larta por që për disa ndërmarrje janë të pamjaftueshme, disa prej tyre subvencionohen nga Buxheti i Konsoliduar, dhe për disa vite nuk kanë arritur të përmirësojnë kualitetin e shërbimeve publike për të cilat qytetarët janë të interesuar dhe paguajnë për ato.

Literatura që fokuson vëmendjen në studimin e ndërmarrjeve publike është e gjërë. Ajo përfshin studime të shumta të organizatave ndërkombëtare si Banka Botërore (BB), Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN), Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim (OECD), Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara (UNDP). Problemi qendror i teorisë ekonomike lidhet me nivelin e ndërhyrjes së shtetit për të korrigjuar

mosfunksionimin e tregut. Ndërmarrjet publike vendosin në plan të parë interesin publik, por kjo formë e organizimit përballlet me rezultatin ekonomik duke ngritur problemin e rëndësishëm të justifikimit të efikasitetit financiar të saj përkundrejt shërbimeve që ofrohen. E konsideruar shpesh si formë e organizimit që nuk ka justifikuar financat e saj, NP janë përballur me sfidat e organizimit të saj: ristrukturimit ose privatizimit. Teoria ekonomike mbështet rolin e padiskutueshëm të NP në zhvillimin ekonomik të një vendi.

Por edhe në nivelin e vendit si Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike, Oda Ekonomike e Kosovës, Oda Ekonomike Amerikane, Instituti “Riinvest”, Instituti “GAP”, etj. kanë publikuar raporte të cilat kryesisht janë të fokusuara në performancën dhe efektivitetin e ndërmarrjeve publike. Konsiderojmë se do të ishte me interes të veçantë një studim më i thellë i shkaqeve dhe faktorëve të cilët ndikojnë në funksionimin normal të ndërmarrjeve publike dhe rrjedhimisht në cilësinë e shërbimeve publike me theks të veçantë si të përmirësohen ato apo si të ngritet niveli i shërbimeve publike të lidhura ngushtë me ngritjen e performancës financiare të tyre. Prandaj, konsiderojmë se njohja e sfidave do të ndihmojë në ballafaqimin dhe tejkalimin e suksesshëm të tyre në të ardhmen.

Disa nga objektivat e këtij punimi janë: Së pari, ky punim synon të analizojë gjendjen aktuale të ndërmarrjeve publike në ofrimin e shërbimeve publike. Së dyti, duke përdorur metoda shkencore të hulumtimit synohet të identifikohen sfidat financiare në ndërmarrjet publike të cilat ndikojnë në nivelin e cilësisë së shërbimeve publike. Së treti, përmes këtij punimi synohet të përcjelllet te politikëbërësit dhe vendimmarrësitë informacioni që do të

shërbej për të ardhmen në riorganizimin më të mirë dhe që do të ketë ndikim në ngritjen e cilësisë së shërbimeve publike.

1.2 Shtrimi i problemit

Kur flasim për sfidat financiare të ndërmarrjeve zakonisht ju adresohemi vështirësive financiare të ndërmarrjeve të cilat shkaktojnë probleme në arritjen e synimeve të parashtruara. Vështirësitë financiare të ndërmarrjeve janë dukuri që hasen në pjesën më të madhe të tyre, por që tërheqin vëmendjen gjithnjë e më shumë aktualisht përballë krizës financiare globale, ndryshimeve politike, problemeve të globalizimit dhe kërkesës për një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik të tyre. Prandaj Joseph E. Stiglitz në librin e tij “The price of inequality” argumenton: *“Përgjatë çerekut të shekullit të kaluar politikat makroekonomike dhe monetare dhe institucionet kanë dështuar të prodhojnë stabilitet; ato kanë dështuar të prodhojnë rritje të qëndrueshme; dhe më e rëndësishmja, ato kanë dështuar të prodhojnë rritje në shoqërinë tonë nga e cila do të përfitonin shumica e qytetarëve”* (Stiglitz, 2012: 264).

Vështirësitë financiare për publikun e gjërë shpesh janë të padukshme. Raporti në mes të vështirësive financiare dhe zhvillimit të qëndrueshëm përcakton jovetëm drejtimin e organizimit të mëtejshëm të ndërmarrjeve por edhe nivelin e plotësimit të shërbimeve publike. Disa ndërmarrje publike gjatë zhvillimit të veprimtarisë së tyre ballafaqohen me vështirësi financiare të lehta të cilat janë më shumë të natyrës operationale, kurse disa të tjera kanë vështirësi aq të mëdha sa mezi arrijnë të shpëtojnë nga falimentimi.

Ndërkohë që disa të tjera në pamundësi të mënjanimit të këtyre vështirësive, krijimit të të hyrave të mjaftueshme, gjetjes së burimeve shtesë të financimit, subvencionimit të pamjaftueshëm nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës nuk mund të kryejnë në plotni veprimtarinë e tyre, nuk mund të ofrojnë shërbime as në sasi e as në cilësi dhe vazhdojnë ciklin e veprimtarisë së tyre deri sa të bëhet një riorganizim i tyre. Këto ndërmarrje publike ofrojnë shërbime publike të cilat ndikojnë në kushtet e jetesës së njerëzve, standardin jetësor të tyre, kur kemi parasysh se ofrohen shërbimet e furnizimit me rrymë, të furnizimit me ujë, shërbime të transportit rrugor, transportit hekurudhor, të mbledhjes dhe deponimit të mbeturinave, shërbime të postës dhe telekomunikimit, ngrohjes qendrore, etj.

Prandaj është në interesin e qytetarit që ndërmarrjet publike të ballafaqohen me sa më pak vështirësi financiare apo edhe kur ballafaqohen të i evitojnë ato me sa më pak pasoja sepse kjo do të ndikojë në cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike e pastaj edhe në kushtet e jetës së qytetarëve. Duke pasur parasysh ndikimin shumë të madh në mirëqenien e njerëzve mund të kuptohet interesimi i madh i ekonomistëve në radhë të parë por edhe hulumtuesve nga lami të tjera me qëllim të tejkalimit të këtyre sfidave. Ne sot në literaturë çdo ditë e më shumë hasim në tema, hulumtime, punime kërkimore, intervista, sondazhe, debate të cilat kanë objekt studimi disa prej faktorëve të ndryshëm që shkaktojnë vështirësi financiare dhe ndikojnë në nivelin e performances financiare deri te niveli i cilësisë së shërbimeve publike, kushtet e jetesës dhe standardit të qytetarëve.

Pra, vlerësojmë se dukuria e vështirësive financiare në ndërmarrjet publike është mjaft e përhapur prandaj sot me këto sfida ballafaqohen gati pothuajse të gjitha vendet e rajonit

(Kroaci, Shqipëri, Serbi, Maqedoni, Mal të Zi) ndonëse disa nga vendet e zhvilluara kanë arritur që të gjejnë zgjidhje të cilat deri më tani janë treguar më të suksesshme se sa zgjidhjet në disa vende të tjera.

Ne në këtë punim kërkimor do të përqëndrohemi vetëm në hulumtimin e sfidave financiare të ndërmarrjeve publike në Kosovë duke marrë parasysh faktin se veprimtaritë e tyre kryesisht janë shërbimet publike prandaj edhe ndikimi i vështirësive financiare reflektohet më gjërësisht se sa tek bizneset tjera ku megjithatë nuk kemi një shtresë kaq të gjërë të atyre që ndikohen nga vështirësitë financiare. Prandaj rëndësia e këtij punimi është më e madhe për shkak të reflektimit në përpjekjen për gjetjen e zgjidhjes ose të propozimit të një zgjidhje për një shtresë shumë të madhe të popullsisë. Ne të gjithë po thuaj se ndeshemi me këto shërbime publike qoftë si shfrytëzues i këtyre shërbimeve, si klientë të ndërmarrjeve publike apo edhe si ofrues të shërbimeve (nga ata të cilët janë të punësuar në NP).

Ne si shfrytëzues të shërbimeve publike jemi të interesuar që ato të plotësojnë kërkesat tona në mënyrë sa më cilësore, edhe Drejtimi i ndërmarrjeve ka për qëllim të ofroj sipas mundësive shërbime sa më të kënaqshme për publikun. Këto ndërmarrje në formën e tanishme të organizimit janë ndërmarrje publike të reja të formuara nga ish ndërmarrjet shoqërore të themeluara në një sistem tjetër të rregullimit shoqëror dhe me sistem apo mënyrë tjetër të qeverisjes së tyre.

Për kërkuesit, hulumtuesit dhe studiuesit e këtij problemi parashtrohen shumë pyetje, të cilat shprehin natyrën komplekse dhe gjithëpërfshirëse të fushave të ndryshme të veprimit

dhe ndikimit tij. Këto janë pyetjet për të cilat kërkojnë të gjejnë përgjegjje edhe drejtuesit e bizneseve, pronarët, aksionarët, bankierët, investitorët, etj., të cilët janë pjesëmarrës të drejtëpërdrejt ose ndikohen në mënyrë indirekte.

Në praktikë paraqiten raste të ndryshme të vështirësive ekonomike dhe financiare nga më të thjeshtat (kur p.sh. arkëtimi i të hyrave arrin deri në nivelin prej 85% të kërkesave nga llogaritë e arkëtueshme) deri te rastet shumë të ndërlikuara dhe shumë vështirë të identifikueshme (sikurse janë rastet e rënda të jolikuiditetit). Por si të arrihet kjo? Në këtë ndikojnë shumë faktorë prej mjedisit ku vepron biznesi, madhësisë së biznesit, formës së organizimit të biznesit, kornizës ligjore ku vepron, mënyres së qeverisjes, sistemit të llogaridhënjes, kontabilitetit, standardeve të raportimit financiar, etj.

Pasqyrat financiare të prezentuara sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF-ve) japin informata për përdoruesit e tyre të brendshëm dhe të jashtëm. Në rastet e ballafaqimit me vështirësi financiare këto informata kur pranohen në kohën e duhur dërgojnë sinjale alarmuese për përdoruesin, shfrytëzuesin dhe analistin e kujdesshëm. Këto informata së pari i marrin drejtuesit financiarë, por ato duhet të pëcjellen te Drejtimi i biznesit-vendimmarrësit me qëllim që pas njohjes së natyrës së vështirësive të bëhet planifikimi i masave që do të ndërmerren për eliminimin e shkaqeve që kanë mundësuar paraqitjen e tyre. Megjithë që në zhvillimin ciklik të ekonomisë ballafaqimi me vështirësitë është diçka e pritshme për Drejtimin e ndërmarrjes, mënjanimi sa më i shpejtë dhe efikas, zvogëlimi i ndikimit të tyre deri te rimëkëmbja e biznesit nga vështirësitë dhe zhvillimi i qëndrueshëm mbeten fusha interesante të studimit.

Problemi i identifikimit të hershëm të treguesve të vështirësive financiare ka qenë i shtruar në teorinë ekonomike, e po ashtu në literaturë ka shembuj të analizave të zhvillimeve (të ngritjes dhe rënjes) të kompanive si p.sh. “Enron”, “General Motors” apo “Parmalat” që janë përdorur si raste studimi në praktikë. Një kërkim shkencor për identifikimin e treguesve të vështirësive financiare të ndërmarrjeve është i nevojshëm në radhë të parë për të kuptuar llojet e tyre, ndikimin e tyre, efektin se cili është momenti i duhur i reagimit të drejtuesve financiarë me qëllim të mbrojtjes nga rrëshqitja drejt falimentimit si rezultat i mospranimit të informacioneve financiare në kohën e duhur apo në rastin më të keq të mospërfilljes të informacioneve që japin pasqyrat financiare apo shkaqeve tjera që mund të jenë të natyrave të ndryshme.

Objekt i interesimit tonë nuk do të jenë ndërmarrjet me vështirësi të lehta, por ndërmarrjet të cilat kanë hasur në vështirësi, të cilat për shkak të pamundësisë për zgjidhje, të mosreagimit me kohë bëhen të mëdha, më të ndërlikuara që shumë shpejt mund të gjenden në prag të falimentimit, prandaj kanë nevojë për ndërhyrje me qëllim të rimëkëmbjes apo riorganizimit të tyre.

Konsiderojmë se hulumtimi i mëtejshëm i këtij problemi kërkimor do të kontribuojë në thellimin e identifikimit të treguesve të vështirësive financiare në aspektin teorik dhe në sensibilizimin e drejtuesve financiarë që raportojnë informacionet financiare të nivelit drejtues, të aksionerëve që goditen nga këto vështirësi, vendimmarrësve në bordet

drejtuese, që duhet të marrin vendime dhe të studiuesve dhe hulumtuesve tjerë në të ardhmen.

Njësia e analizës do të jenë Ndërmarrjet Publike Qendrore dhe Ndërmarrjet Publike Rajonale të Ujitjes dhe Ujësjellësit, aspekti financiar i treguesve të vështirësive financiare, shkaqet brendshme, shkaqet e jashtme deri te informacioni dhe reagimi i drejtimit në procesin vendimmarrës si proces i vazhdueshëm në ciklin e jetës së një ndërmarrje.

Vlerësojmë se para së gjithash është e nevojshme të bëhet një studim me qëllim të dhënjes së kontributit teorik, të analizimit dhe zbërthimit të shkaqeve, të nënvizimit të rëndësisë së informimit të shpejtë dhe cilësor nga niveli drejtues deri te drejtimi i lartë (bordi i drejtorëve dhe bordi i aksionarëve) dhe marrja e vendimeve në kontekst të situatës me qëllim të kuptimit të rëndësisë dhe efektit që do të ketë marrja e vendimeve për të ardhmen e ndërmarrjes në nivel të ndërmarrjeve të mëdha dhe të mesme. Cila do të jetë faza e ardhshme e zhvillimit të këtyre ndërmarrjeve: riorganizimi, falimentimi, rimëkëmbja apo zhvillimi i qëndrueshëm i tyre do të varet nga këto vendime.

1.3 Pyetjet kërkimore dhe hipotezat bazë

Pyetjet bazë kërkimore të këtij punimi janë:

- Çfarë korrelacioni kanë sfidat financiare me cilësinë e shërbimeve të ofruara nga ndërmarrjet publike?
- Çfarë ndikimi kanë sfidat financiare në performancën operative dhe financiare të ndërmarrjeve publike?

Hipotezat e këtij punimi kërkimor janë:

- Sfidat financiare kanë korrelacion pozitiv me cilësinë e shërbimeve që ofrohen nga ndërmarrjet publike.
- Sfidat financiare kanë ndikim negativ në performancën operative dhe financiare të ndërmarrjeve publike.

1.4 Çfarë kuptohet me sfida financiare dhe si matet ajo?

Me nocionin sfidë në kuptimin e përgjithshëm nënkuptojnë situatën (që nuk ka ndodhë përpara pra diçka të re dhe të vështirë) me të cilën ballafaqohemi e cila kërkon përpjekje që të kryhet në mënyrë të suksesshme. Në këtë kuptim sfidat financiare të NP në Kosovë paraqesin situata të reja dhe të vështira me të cilat ballafaqohen gjatë kryerjes së aktivitetit të tyre Drejtimet e NP-ve dhe përpjekjet të cilat ndërmerren me qëllim të kërkimit të zgjidhjes për tejkalimin e suksesshëm të tyre.

Sfidat me të cilat ballafaqohen ato janë të ndryshme dhe ndryshojnë varësisht nga veprimtaria e NP, klientët, lloji i shërbimit që ofrohet, shtrirja gjeografike, ofrimi i shërbimeve për persona fizik, për komunitetet pakicë, etj. Pse shtrirja gjeografike? Për shembull, ofrimi i shërbimeve të furnizimit me rrymë dhe ujë në Veri dhe në Jug të Mitrovicës ka sfida të ndryshme. Deri sa për shërbimet e kryera në Jug të Mitrovicës NP arkëtojnë një pjesë të të hyrave, për shërbimet e kryera Mitrovicën e Veriut ato nuk mund të arkëtojnë fare të hyrat e tyre.

Gjithashtu sfidat financiare dallojnë për kah niveli i ndikimit që kanë në kryerjen e veprimtarisë së NP-ve. P.Sh. arkëtimi i të hyrave për disa NP është sfidë e vështirë, për pjesën e të hyrave ku klientë janë personat fizik me gjendje jo të mirë sociale dhe ekonomike ose arkëtimi i të hyrave për shërbimet e kryera për komunitetin joshumicë të cilët refuzojnë pagesën e shërbimeve për shkaqe të natyrës politike. Te shumica e NP-ve të cilat i kemi analizuar kemi gjetur një ndryshim shumë të vogël të të hyrave në krahasim me shpenzimet që jep një fitim të vogël operativ ose nuk jep fare dhe rrjedhimisht norma e kthimit në aktive të qëndrueshme dhe norma e kthimit në kapitalet e veta (ekuitet) është shumë e ulët. Në këto raste të pamjaftueshmërisë së të hyrave NP sfidohen në kërkimin e burimeve financiare plotësuese nga burimet jashtë ndërmarrjeve, fondeve subvencionuese nga qeveria për realizimin e investimeve kapitale të domosdoshme për mirëmbajtjen e mjeteve dhe pajisjeve për kryerjen e veprimtarisë. Edhe likuiditeti i ulët manifestohet në rritjen e obligimeve ndaj të tjerëve i përcjellur me vështirësi të kryerjes së pagesave sipas afateve të kontraktuara ose ligjore dhe në raste të vonesave të ngarkuara edhe me kamata ndëshkuese për mospagesë sipas afatit. Një nga sfidat financiare e cila haset pothuaj te të gjitha NP është niveli i lartë i shpenzimeve për paga për të punësuarit si pasojë e numrit të madh të të punësuarëve si dhe pagesave tjera jashtë pagës në formë të stimulimit të efektshmërisë.

Gjatë punës tonë kemi gjetur se për disa NP të cilat ofrojnë shërbime publike të furnizimit me ujë, të furnizimit me rrymë, të mbledhjes dhe largimit të mbeturinave, ku konsumatorët-shfrytëzuesit e shërbimeve janë personat fizik-bashkësitë familjare, NP për shkak të mosarkëtitimit të të hyrave e me qëllim të paraqitjes së drejtë dhe sipas SNRF në pasqyrat e

veta financiare, detyrohen të provizionojnë të hyrat dhe të rrisin shpenzimet e borxheve të këqija dhe kjo ndikon në performancën financiare të tyre.

Në anën tjetër nga sfidat financiare kushtëzohet niveli i cilësisë së shërbimeve publike të cilat ofrohen. Tejkalimi i suksesshëm i tyre do të ndikojë në rritjen e sasisë por edhe të cilësisë së shërbimeve publike dhe kjo do të ndikojë në mirëqenjen dhe standardin jetësor të qytetarit.

Sfidat financiare prezentohen nga Drejtimet e NP në pasqyrat financiare, në raporte periodike dhe vjetore në shuma financiare. Prezentimi i këtillë mundëson krahasimin e vetëm një zëri të vetëm të sfidave financiare me planin dhe me vitin e kaluar. Pastaj kjo mund të krahasohet me sfida tjera brenda vet një NP si p.sh. arkëtimi i ulët i të hyrave me të hyrat e përgjithshme, me llogaritë e arkëtueshme , etj. si dhe mund të krahasohet me sfida të njejta në mes të dy NP-ve ose me sfiden e njejtë në mes të NP-ve me veprimtari të njejtë. Pra, bazuar në shprehjen e tyre në tregues monetar duke i krahasuar zërat e pasqyrave financiare (të hyrat, shpenzimet, fitimi operativ, aktivet afatshkurtëra, aktivet e qëndrueshme, llogaritë e arkëtueshme, kapitali aksionar, detyrimet, llogaritë e pagueshme, shpenzimet për paga, borxhet e këqija), ne kemi mundur të masim nivelin e tyre, peshën që kanë, ndikimin e tyre dhe të krahasojmë ato me sfida tjera ose me zëra tjerë të pasqyrave financiare.

1.5 Diskutimet, shkrimet aktuale për problematikën e këtij punimi

Problematika e ndërmarrjeve publike gjithnjë e më shumë po bëhet më aktuale, ka zënë vend në literaturën e kohës dhe në diskutimet e studiuesve, hulumtuesve dhe analistëve nga pozita të ndryshme. Varësisht se kush kryen hulumtimin lidhur me ndonjë aspekt të ndërmarrjeve publike mund të gjenden vlerësime kritike, opinione të bazuara në hulumtime për funksionimin e qeverisjes korporative, mënyrën e formimit të Bordeve të Drejtorëve dhe vlerësimin të efektshmërisë dhe performancës së tyre, për nivelin e ofrimit dhe cilësisë së shërbimeve publike, për ndikimin e disa shërbimeve publike në bizneset private, për numrin e madh të të punësuarëve dhe rritjen e vazhdueshme, etj..

Kështu organizatat joqeveritare dhe shoqëria civile duke monitoruar performancën qeveritare më shumë trajtojnë nivelin e lartë të shpenzimeve për paga të ndërmarrjeve publike dhe stimulimet për efektshmëri për anëtarët e Bordeve të Drejtorëve se sa që janë marrë me trajtimin dhe hulumtimin e nivelit të cilësisë së shërbimeve publike të ofruara apo të japin ndonjë zgjidhje alternative.

Ngjashëm me vendin tonë, edhe në vendet tjera të rajonit, debatet dhe diskutimet pothuajse pak dallojnë përmbajtja ndërsa dallohen për specifikat e zhvillimit të tyre dhe për veprimet e ndërmarra qeveritare. Natyrisht, se në nivelin ndërkombëtar debatet dhe diskutimet për sfidat dhe problematiken e përgjithshme të ndërmarrjeve publike janë të shumta, më të avansuara dhe më cilësore. Ne gjatë këtij punimi kemi trajtuar edhe

literaturen e cila është e organizatave të mirënjohura ndërkombëtare sikurse janë OECD-ja, Banka Botërore, FMN-ja, BERZH-i, etj.

Megjithëse ndërmarrjet publike ishin themeluar që të përkrahin zhvillimin ekonomik, të zvogëlojnë papunësinë dhe të mbajnë nën kontroll drejtimit kryesore të ekonomisë sidomos në vendet e zhvilluara, kishin vazhduar këtë trend deri në vitet e 80-ta të shekullit të kaluar por pastaj përdorimi i tyre për krijimin e vendeve të punës pa kritere ekonomike, rritja e joefikasitetit të drejtimeve të tyre, rritja e korrupsionit, mbipunësimi kanë ndikuar në vënjen e kufizimeve për NP. Megjithë kufizimet ato kanë pjesëmarrje të madhe në ekonomitë nacionale të vendeve e cila dallon për vendet e zhvilluara pjesëmarrja në BPV me 8% dhe investime me 13%, në vendet në zhvillim 9% dhe 17% kurse në vendet më pak të zhvilluara 14% dhe 28% (Nations, 2008).

1.6 Përmbledhje e literatures, përparësitë dhe kufizimet

Literatura bashkëkohore aktuale në botë për dallim nga ajo vendore për sfidat e ndërmarrjeve publike është mjaft e pasur. Ajo përfshinë një periudhë kohore mjaft të gjatë dhe përmbajtje të ndryshme. Për qëllime të këtij punimi, ne kryesisht jemi bazuar dhe kemi shfrytëzuar literaturen e cila trajton sfidat financiare të ndërmarrjeve publike dhe cilësinë e shërbimeve publike në vende të ndryshme të zhvilluara por jemi fokusuar në vendet e Ballkanit si Kroaci, Serbi, Shqipëri. Problematika e Ndërmarrjeve Publike në Kosovë është e re. Ato nuk kanë ndonjë përvojë të gjatë në veprimtarinë e tyre në formën e re të organizmit.

Prandaj, edhe literatura në lidhje me problematikën e ndërmarrjeve publike ka qenë e varfër. Megjithatë, sidomos në dy vitet e fundit duke u rritur interesimi i shoqërisë për nivelin e shërbimeve publike gjithnjë e më shumë po pasurohet edhe literatura. Kështu përveç raporteve nga ndërmarrjet publike, raporteve nga Njësia për Politika dhe Monitorim të NP-ve, raporteve nga zyrat rregullatore, raporteve nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), raporteve të auditimit të jashtëm të pasqyrave financiare të vet ndërmarrjeve publike, gjithnjë e më shumë po publikohen raporte të organizatave joqeveritare, të odave ekonomike (kosovare, amerikane, gjermane, britanike etj.) dhe të instituteve të ndryshme të cilat po merren me çështje nga fushëveprimi i ndërmarrjeve publike.

Kështu në diskutimet dhe shkrimet lidhur me ndërmarrjet publike, sot hasim në kërkime hulumtuese lidhur me qeverisjen korporative dhe mbikëqyrjen e ndërmarrjeve publike, vlerësimin e performances dhe efektivitetit të Bordeve të Drejtorëve, me legjislacionin dhe bashkëpunimin me institucionet tjera zyrtare, me përzgjedhjen e anëtarëve për borde të drejtorëve, me ndikimin e nivelit të shërbimeve publike (energjisë elektrike dhe ujit) në bizneset private.

Po ashtu janë shtuar analizat, vështrimet kritike, shkrimet hulumtuese kërkimore për nivelin e cilësisë së shërbimeve publike të furnizimit me energji elektrike, të furnizimit me ujë, largimit dhe deponimit të mbeturinave, të përfshirjes dhe cilësisë së ngrohjes qendrore, të transportit dhe shërbimeve të tjera. Megjithatë, deri me tani nuk kemi hasur në literaturë në

hulumtimin e sfidave financiare të ndërmarrjeve publike në Kosovë me qenë se disa kanë vetëm shtatë vite të funksionimit në këtë formë të organizimit e disa tjera edhe më pak. Prandaj, edhe sa do që ky punim mund të arrijë rezultate modeste ai do të mund të shërbej si pikënisje për hulumtime dhe studime të reja, më të zgjeruara në këtë lami.

1.7 Metodologjia e punimit dhe metodat e hulumtimit

Metodologjia e përdorur në këtë punim është një qasje e kombinuar e të dhënave primare dhe atyre sekondare. Të dhënat primare janë të dhëna të mbledhura nga përgjegjjet në pyetësor dhe të përpunuara me metoda statistikore. Pjesa më e madhe e të dhënave sekondare janë të dhëna të publikuara nga vet ndërmarrjet publike, Njësia për Politika dhe Monitorim të NP-ve, Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Zyrat rregullatore, Odat Ekonomike (e Kosovës, Amerikane, Britanike, Gjermane, etj.), Institutet hulumtuese kërkimore, Raporte nga Banka Botërore, FMN-ja, UNDP-ja, raporte nga kompani të angazhuara për vlerësimin e performances së ndërmarrjeve publike, etj.

Të dhënat në të cilat është mbështetur punimi janë marrë nga ndërmarrjet publike, ato janë: pasqyrat financiare, raportet e auditorëve të jashtëm, raportet vjetore të NP-ve, planet e biznesit, për një periudhë e cila përfshinë vitet 2011, 2012, 2013, 2014 dhe 2015. Nga zyrat rregullatore janë marrë raporte të vlerësimit për qëllime të vlerësimit të performances së ndërmarrjeve publike dhe për qëllime të caktimit të tarifave dhe çmimeve rregullatore për energji, ujë, mbeturina dhe kanalizim.

Të dhënat të cilat janë marrë nga raportet e vlerësuesve të jashtëm të angazhuar nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (NJPM të NP-ve) pastaj nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, raporte hulumtimi nga Instituti “Riinvest”, Odat ekonomike, Agjencioni i Statistikave të Kosovës (ASK), Agjencioni Kosovar i Privatizimit (AKP), Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP), raporte nga institucione të ndryshme ndërkombëtare si Banka Botërore, Agjenci të Kombeve të Bashkuara, etj

1.8 Shpjegim i strukturës së punimit

Punimi përbëhet nga dy pjesë kryesore të cilat janë përfshirë në gjashtë kapituj. Pjesa e parë e punimit paraqet një përmbledhje të kuadrit teorik të analizës së sfidave të identifikuar të ndërmarrjeve publike në Kosovë. Pjesa e dytë e cila është pjesa më e rëndësishme e punimit shqyrton sfidat financiare të ndërmarrjeve publike në Kosovë, faktorët që ndikojnë në paraqitjen e tyre dhe ndikimin që kanë në cilësinë e shërbimeve publike. Pjesa më interesante e punimit është analiza dhe interpretimi i të dhënave të grumbulluara.

Në kapitullin e parë hyrja janë përfshirë parathënja e këtij punimi, shtrimi i problemit, pyetjet kërkimore dhe hipotezat bazë të këtij punimi. Në këtë kapitull janë shtjelluar gjithashtu diskutimet e fundit aktuale për problematiken e ndërmarrjeve publike, qëllimi dhe objektivat e studimit bashkë me përshkrimin e metodologjisë së aplikuar.

Kapitulli i dytë paraqet në mënyrë të përmbledhur përmbajtjen e literatures aktuale në lidhje me problematiken e ndërmarrjeve publike. Në këtë kapitull janë paraqitur në mënyrë kronologjike zhvillimi i ndërmarrjeve të sotme publike nga ish ndërmarrjet shoqërore,

periudha e administrimit të dhunshëm 1989-1999, administrimi nga Shtylla e IV e UNMIK-ut, administrimi nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit, administrimi nga Agjencia Kosovare e Privatizimit dhe funksionimi si ndërmarrje publike.

Kapitulli i tretë shtjellon në mënyrë të detajuar një numër të sfidave financiare të ndërmarrjeve publike. Kryesisht janë shtjelluar sfidat me ndikim më të madh sikurse janë niveli i ulët i arkëtimit të të hyrave, niveli i lartë i shpenzimeve, pamjaftueshmëria e mjeteve financiare për investime kapitale, borxhet e këqija, dhe disa sfida tjera të cilat i kemi konsideruar të rëndësishme për të kuptuar gjendjen aktuale të tyre.

Në kapitullin e katërtë janë dhënë shpjegime në lidhje me burimet e të dhënave, mbledhjen e tyre, mënyren e përgaditjes dhe metoden e përpunimit të tyre. Kapitulli i pestë përfshinë paraqitjen dhe analizën e rezultateve të fituara nga metodat statistikore të aplikuara. Dhe kapitulli i fundit përmban diskutime të rezultateve, përfundime dhe rekomandime.

1.9 Përmbledhje e kapitullit

Në këtë kapitull u diskutua për qëllimin, objektivat, parashtrimin e problematikës së ballafaqimit me sfidat financiare të ndërmarrjeve publike, rëndësinë që kanë ato për qytetarët, ndërmarrjet dhe zhvillimin ekonomik të vendit. Janë prezentuar pyetjet kërkimore dhe hipotezat bazë të cilat shprehin synimet e këtij punimi. Jemi përpjekur të prezentojmë pjesë nga debatet dhe diskutimet aktuale rreth kësaj problematike, në nivel të vendit, regjionit dhe atë ndërkombëtar, një pasqyrim të literatures, të përparësive dhe kufizimeve të

saj si dhe të metodave të kërkimit dhe metodologjisë së punimit bashkë me një shpjegim të strukturës së punimit.

PJESA E PARË: ANALIZË E ZHVILLIMIT TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE NË KOSOVË

KAPITULLI II: SPECIFIKAT E ORGANIZIMIT TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE NË KOSOVË

2.1 Historiku i zhvillimit të ndërmarrjeve publike nga ish ndërmarrjet shoqërore deri më sot

Për të kuptuar më lehtë dinamiken e zhvillimit të ndërmarrjeve publike në vijim do të përshkruajmë zhvillimin e tyre në disa faza më të rëndësishme. Gati të gjitha ndërmarrjet publike (përveç Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës- ish Aeroporti i Prishtinës i cili është administruar nga struktura shtetërore dhe ka shërbyer kryesisht për qëllime ushtarake) të cilat funksionojnë sot në Kosovë kanë ekzistuar dhe funksionuar edhe më heret por kanë qenë të organizuara sipas kërkesave të sistemit socialist të kohës. Ato kanë funksionuar si ndërmarrje shoqërore deri në vitin 1999.

Duhet theksuar se periudha kohore 1989-1999 për shkak të keqeverisjes dhe krizës ekonomike dhe politike në ish-Jugosllavi, ka pasur ndikim negativ në të gjitha ndërmarrjet e asaj kohe. Që nga viti 1999 kur Kosova është administruar nga Misioni i Përkohshëm i Kombeve të Bashkuara (UNMIK), të gjitha ndërmarrjet sikurse edhe ekonomia në përgjithësi janë administruar nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) e themeluar në

bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2002/12 “Mbi Themelimin e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit” e cila ka funksionuar në kuadër të Shtyllës së IV të UNMIK-ut (UNMIK, 2005).

Kjo mënyrë e qeverisjes në mungesë të ligjeve ka vazhduar deri në vitin 2008, kur është formuar Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) si pasardhëse e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit e cila ishte kujdestare e pronës dhe gjatë kësaj periudhe disa nga ndërmarrjet janë përgatitur për transformim në ndërmarrje publike (UNMIK, 2005).

Ndërmarrjet Publike (NP) të sotme në Kosovë janë trashëgimi e ndërmarrjeve të cilat kanë pasur emërtime tjera sipas formës së organizimit të atëhershme e cila ka ekzistuar dhe veprimtarisë të cilën e kanë kryer. Disa nga këto ndërmarrje të cilat kanë funksionuar edhe më heret kanë vazhduar me veprimtarinë e njejtë por me emërtim tjetër apo nga një ish ndërmarrje shoqërore pas riorganizimit-ndarjes janë krijuar dy ndërmarrje (sikurse është rasti i KEK-ut dhe Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut-KOSTT apo rasti i Hekurudhave të Kosovës prej së cilës janë krijuar dy ndërmarrje publike që sot funksionojnë si NP “Trainkos” dhe NP “Infrakos”) (Rinvest & CIPE, 2012).

Pra, ato kanë pasur formën e organizimit dhe formën e qeverisjes të ish ndërmarrjeve shoqërore pasi ato ishin prona shoqërore, të të ashtuquajturave organizatave punuese pastaj të organizatave të punës së bashkuar në sistemin e vetëqeverisjes me ekonominë. Vetëm pas vitit 1999 kur nga Shtylla e Katërtë e UNMIK-ut e cila ishte përgjegjëse për ekonominë

e Kosovës, të gjitha ish Ndërmarrjet Shoqërore u futën nën administrimin e ish Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) kurse prej vitit 2008 nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP) (Riinvest & CIPE, 2012).

Kjo ka qenë periudha e tentimit të konsolidimit të ish ndërmarrjeve shoqërore me qëllim të krijimit e diku kthimit të vazhdimësisë në ofrimin e shërbimeve publike të cilat po ofroheshin në nivel shumë të ultë për qytetarët. Këto ndërmarrje në këtë periudhë ballafaqoheshin me probleme të rënda: pasuria e të cilave ishte dëmtuar nga keqqeverisja, fuqia punëtore-e shpërndarë, e larguar nga vendi, një pjesë e larguar me dhunë nga puna në vitet 90-ta të shekullit të kaluar, e cila kishte humbur hapin me progresin tekniko-teknologjik, tregjet e humbura për shkak të ndërprerjes së funksionimit, furnizues-partnerë afarist të larguar, me kërkesa dhe pretendime nga kreditorë të ndryshëm e shumë probleme tjera nga forma e qeverisjes deri te mungesa e dokumentacionit për shkak të shkatërrimit gjatë kësaj periudhe (GAP, 2015).

Por qëllimi i riorganizimit nga ish AKP-ja ishte që si të kthehen në funksion këto ndërmarrje me qëllim të ofrimit të shërbimeve publike të domosdoshme shumë të nevojshme për qytetarët në atë kohë. Qeverisja e këtyre ndërmarrjeve ka qenë kryesisht nëpërmes bordeve mbikëqyrëse të përbëra nga përfaqësues të shteteve anëtare në kuadër të misionit të UNMIK-ut. Deri në krijimin e kornizës ligjore-ligjeve që rregullonin funksionimin, organizimin dhe qeverisjen e tyre ato kanë qenë të rregulluara vetëm pjesërisht me rregullore të UNMIK-ut të cilat kanë qenë një formë e plotësimit të mungesës së ligjeve. Në këtë periudhë të ekzistimit të tyre ka munguar korniza ligjore që rregullonte

riorganizimin, regjistrimin dhe qeverisjen e tyre pasi që forma e mëhershme e organizimit nuk njihej nga strukturat e misionit të UNMIK-ut.

Dallimet në mes të NP dhe të bizneseve private janë të përcaktuara nga qëllimi. Deri sa rritja e fitimit për pronarin është qëllim i qartë të bizneseve private, para ndërmarrjeve publike paraqitet një numër i gjërë i qëllimeve prej kënaqjes së kërkesave të publikut deri te kërkesat për investime të reja, punësim, kërkesave për zhvillim të qëndrueshëm, ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit ku vepron dhe deri te plotësimi i kërkesave sociale (GAP, 2015).

Akti i parë dhe më i rëndësishmi për rregullimin e organizimit të ndërmarrjeve që ishin nën administrim të AKM-ës ishte hyrja në fuqi e Ligjit për shoqëritë tregtare Nr.02/L-123, në vitin 2007. Vetëm pas hyrjes në fuqi të Ligjit për ndërmarrjet publike në Kosovë (Ligji për ndërmarrjet publike në Kosovë, Nr. 03/L-087), në vitin 2008, ka filluar funksionimi i tyre si NP (Riinvest & CIPE, 2012).

1.2.3 Zhvillimi i NP në botë- në vendet e zhvilluara

Zhvillimi i ndërmarrjeve publike në periudha të ndryshme kohore ka specifikat e veta. Në përgjithësi, në teorinë ekonomike, ndërmarrja publike është kuptuar si një organizatë biznesi tërësisht ose pjesërisht në pronësi të shtetit dhe e kontrolluar përmes autoriteteve publike. Për arsye sociale, disa ndërmarrje publike janë vendosur nën pronësinë publike sepse është menduar se produkti ose shërbimi duhet të ofrohet nga një monopol shtetëror. Shembuj të ndërmarrjeve të tilla publike janë ndërmarrjet publike për furnizim me energji,

ujë, shërbimet postare, të telekomunikimit, të transportit të udhëtarëve, hekurudhor, etj. (Millward, 2011).

Në vendet e zhvilluara evropiane është praktikuar që ndërmarrjet publike të merren me shërbime publike deri sa në SHBA edhe kompanitë private janë lejuar të ofrojnë këto lloj shërbimesh, veprimtaria dhe fushëveprimi i të cilave është rregulluar në mënyrë të rreptë me ligj. Në disa vende për shkaqe ideologjike hekurudhat, minierat e thëngjillit, prodhimi i çelikut, sektori bankar dhe i sigurimeve janë nacionalizuar deri sa grupi tjetër janë futur në sektorin publik për arsye strategjike sikurse janë prodhimi i armatimit, aeroplanëve (Millward, 2011).

Në ish shtetet komuniste, sipas ndikimit që kishte gati të gjitha format e prodhimtarisë, tregtisë dhe financave i takonin shtetit. Në shtete të reja të pavarura dhe vendet më pak të zhvilluara sektori i ndërmarrjeve publike është shumë i madh.

Në Europë, modeli mbizotërues i organizimit ekonomik është ekonomi e përzierë me ndërmarrje publike të cilat funksionojnë krahas me korporatat private. Në Britani të Madhe në vitet e para të shek. XX, zyrat postare, shërbimet komunale, prodhimi i armatimit dhe Porti i Londrës i takonin sektorit publik të cilave më vonë u janë bashkuar forma të ndryshme të transportit publik, e që dukshëm kanë zgjeruar rolin e sektorit shtetëror. Gjatë periudhës 1946-50 nën qeverisjen Laburiste, programi i nacionalizimit masiv ka përfshirë minierat e qymyrit, industrinë e hekurit dhe çelikut, industrinë e gasit, hekurudhat dhe transportin rrugor në distanca të gjata, deri sa në periudhen 1979-90, gjatë regjimit

Konzervativ të Kryeministres Margaret Thatcher, shumë ndërmarrje publike janë privatizuar (Millward, 2011).

Pothuaj se e njëjta rrjedhë e ngjarjeve si në Britani ka ndodhur në Francë ku pas Luftës së Dytë Botërore, qeveria franceze kishte ndërmarrë program të njëjtë të nacionalizimit (që përfshinte bankat, shërbimet e sigurimit, shtëpitë financiare dhe forma të prodhimit), të cilat më vonë u privatizuan. SHBA-të kanë pak ndërmarrje publike (Millward, 2011).

Ndërmarrjet publike veprojnë me qëllim të plotësimit të kërkesave për shërbime publike. Ato ofrojnë ato shërbime publike të cilat i kanë në fushën e veprimtarisë së tyre. Kjo mënyrë e veprimit i shpalos para studiuesve shumë çështje të natyrës organizative dhe komerciale. Një çështje e cila gjithmonë ka ndjekur qeverisjen e ndërmarrjeve publike por që ende po e përcjellë është se si të ndahet nevoja për kontroll të afërt me ndikim politik me kërkesën për pavarësi të mjaftueshme të Drejtimit. Kjo çështje sigurisht është më e theksuar në vendet më pak të zhvilluara. Forma e korporatave publike e përdorur në mënyrë të gjërë në Britani të Madhe dhe e kopjuar tërësisht nga pjesët tjera të botës, është krijuar me një akt të veçantë të Parlamentit i cili definon fuqitë e saj, strukturën drejtuese dhe raportet me organet qeveritare (Millward, 2011).

2.2 NP gjatë administrimit të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM-ës)

Mandati i Misionit të Përkohshëm të Kombeve të Bashkuara (UNMIK) ishte caktuar në vitin 1999 nga Rezoluta 1244 e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara. Agjencia

ishite themeluar për të ruajtur ose shtuar vlerën, qëndrueshmërinë afariste dhe qeverisjen e përbashkët të ndërmarrjeve shoqërore dhe publike në Kosovë. Rregullorja sipas të cilës është themeluar Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) është nxjerrë me 13 qershor 2002 (Rregullorja 2002/12 e ndryshuar me Rregulloren 2005/18 e vitit 2005) kurse mbledhja inauguruese e Bordit të Drejtorëve është mbajtur me 25 korrik 2002 (GIZ & MIE, 2012).

Bordi i Drejtorëve ishte i përbërë nga katër drejtorë ndërkombëtarë dhe katër kosovarë. Agjencia ka zhvilluar dy forma të transformimit të ndërmarrjeve të atëhershme: privatizimin dhe korporatizimin. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit ka pasur për detyrë për të privatizuar Ndërmarrjet Shoqërore në Kosovë përmes metodës së privatizimit spin-off dhe likuidimit. Korporatizimi në Kosovë është zhvilluar në dy faza: Faza e parë është transformimi i entiteteve ekzistuese (NP-ve) në Holding SH.A. (Kompania Amë). Faza e dytë është “Spin-off”, që do të thotë krijimi i Ndërmarrjes së re (Kompania Operuese) në formë të shoqërisë aksionare. Në vitin 2005 janë korporatizuar tetë (8) ndërmarrje të cilat nga AKM-ja emërtoheshin si ndërmarrje publike për shkak të veprimtarisë që e kryenin. Këto ndërmarrje të korporatizuara ishin: PTK-ja, ANP, Hekurudhat e Kosovës, Ngrohtorja Qendrore “Termokos”, Ngrohtorja Qendrore Gjakovë, OSTT, KEK dhe Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës (KMDK) (GIZ & MIE, 2012).

Pas vendosjes së administratës së Misionit të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) në vitin 1999, ka filluar një formë e re e riorganizimit e quajtur komercializim i pazbatuar

më parë si një prej fazave të para në procesin e transformimit të ish Ndërmarrjeve Shoqërore në Kosovë (GIZ & MIE, 2012).

Kjo ishte një formë e qiradhënies 10 vjeçare (e njohur si komercializim) për disa Ndërmarrje Shoqërore të rëndësishme nga aspekti strategjik. Deri tani, nga 18 marrëveshje për komercializim, mbetet vetëm një, që është ish ndërmarrja shoqërore “Fapoli” në Podujevë, për deri sa marrëveshjet tjera të komercializimit janë zgjidhur apo ato ish Ndërmarrje Shoqërore dhe asetet e tyre iu janë nënshtruar privatizimit. Një shembull i aplikimit të komercializimit i përfunduar gjatë kësaj periudhe të qeverisjes është rasti i ish ndërmarrjes shoqërore “Sharrcem” (prodhues i çimentos), e cila i është nënshtruar privatizimit që është realizuar me sukses në dhjetor të vitit 2010 (SHARRCEM, 2013).

Marrëveshja për komercializim i ka dhënë qiramarrësit të drejtën për të blerë fabrikën me çmim të tregut dhe kjo ka obliguar Agjencinë të hyjë në negociata të drejtpërdrejta me qiramarrësin Titan Group. Agjencia ka caktuar këshilltarë ndërkombëtarë për transaksion për të ndihmuar në negociata dhe çmimi i arritur prej 30.1 milion eurove (€) ishte më i larti sipas vlerësimit të këshilltarëve për transaksion. Si shtesë, blerësi është zotuar për investime kapitale shtesë që arrijnë shumën prej 35 milion Eurove (€) për 5 vite dhe ka garantuar punën e të gjithë punëtorëve aktual për 3 vitet e ardhshme (AKP, 2009).

2.3 NP gjatë administrimit të AKP-ës

Pas shpalljes së pavarësisë së Kosovës me 17 Shkurt 2008, Agjencia Kosovare e Privatizimit themelohet si një organ i pavarur publik (sipas Nenit 142 të Kushtetutës së

Republikës së Kosovës) i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur, në bazë Ligjit të Kuvendit të Kosovës Nr. 04/L-034, mbi AKP-në. Veprimtaria e Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit është ndryshuar prej ish Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit duke vazhduar vetëm me privatizimin dhe likuidimin e ish Ndërmarrjeve Shoqërore (NSH-ve) (GLPS & BIRN, 2016).

Me këtë ndryshim, transformim të Agjencisë në njëren anë dhe me hyrjen në fuqi të Ligjit për ndërmarrjet publike në anën tjetër, përfundimisht ndërmarrjet të cilat kryenin veprimtari publike fillimisht janë korporatizuar dhe pastaj janë organizuar si ndërmarrje publike, shoqëri aksionare ku Qeveria e Kosovës ka kompetencen ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të akcionarit të Republikës së Kosovës në NP Qendrore. Procesi i riorganizimit me ish ndërmarrjet shoqërore dhe të ish Kombinatit Xehetaro Metalurgjik Kimik “Trepça” ende nuk ka përfunduar. Rasti i “Trepçës” është i veçantë ndërsa për ndërmarrjet tjera janë duke u zhvilluar procedurat e riorganizimit të tyre nëpër mes proceseve të privatizimit dhe likuidimit (GLPS & BIRN, 2016).

Me Ligjin për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre (Ligji Nr.04/-L-035) dhe pastaj Ligjin Nr. 05/L-008 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/-L-035 për riorganizimin e ndërmarrjeve të caktuara dhe pasurisë së tyre janë ndryshuar afatet lidhur me planin alternativ për organizim dhe për afatin e fillimit të procedurave të likuidimit të cilat kanë për qëllim riorganizimin e kësaj ndërmarrje e cila është me rëndësi të veçantë për ekonominë e Kosovës (GLPS & BIRN, 2016).

Për shkak të skadimit të mandatit të ish drejtorëve të bordit të Agjencisë Kosovare të Privatizimit dhe moszgjedhjes së anëtarëve të rinj në mungesë të zgjedhjes - konstituimit të Qeverisë së Kosovës dhe organeve tjera të dala nga procesi zgjedhor (vakumi institucional gjashtë mujor gjatë vitit 2014), funksionimi i saj ka ngecur dhe nuk ka mund të merret asnjë vendim për riorganizimin e mëtejshëm të ish ndërmarrjeve shoqërore (GLPS & BIRN, 2016).

2.4 Disa karakteristika të përbashkëta dhe të veçanta të NP

Jo vetëm për nga mënyra e themelimit dhe funksionimit por ndërmarrjet publike dallohen edhe me disa karakteristika të cilat në disa raste janë të përbashkëta por edhe të veçanta në varësi të asaj se çka merret për analizë. Në vijim ne po i përmendim disa nga këto karakteristika:

- Karakteristika kryesore e NP është se ato themelohen me qëllim të prodhimit të të mirave dhe ofrimit të shërbimeve publike me rëndësi jetësore për një shoqëri si dhe funksionimi i tyre është për interes të gjërë publik;
- Kanë pozitë të privilegjuar të cilën ju siguron shteti që reflektohet si pozitë monopoliste me cilësi natyrore;
- Kanë rregullativë të veçantë ligjore, për shkak të rëndësisë së veçantë për shtetin dhe pozitës monopoliste që kanë;
- Për shkak të kësaj pozite, kufizimit të konkurrencës dhe tregut roli dhe ndikimi i zyrave rregullatore është i madh, Zyra Rregullatore e Energjisë (ZRRE) dhe Zyra Rregullatore e Ujit dhe Kanalizimeve (ZRRUK);

- Shpenzimet e larta fillestare për investime kapitale në mjete themelore dhe pajisje (aktive afatgjata) të cilat mund të sigurohen dhe financohen vetëm nga shteti janë pengesa për bizneset nga sektori privat që të merren me disa nga këto veprimtari;
- Monitorimi i NP nëpërmes të Njesisë për Politika dhe Monitorim të NP;
- Kanë një akcionar të vetëm dhe të përbashkët për të gjitha ndërmarrjet publike qendrore dhe regjionale të ujitjes dhe ujësjellësve-Qeveria e Kosovës e cila ka kompetencen ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të akcionarit të Republikës së Kosovës në NP Qendrore;
- Të gjitha NP janë të organizuara si shoqëri akcionare në përputhje me ligjin në fuqi për shoqëritë tregëtare;
- Roli dhe ndikimi i shtetit është i madh për shkak të mundësisë së intervenimit, mbështetjes financiare dhe subvencionimit të NP;
- Ushtrjnë veprimtari e cila është e vetme në Kosovë, prandaj krahasimi dhe performanca mund të bëhet vetëm me ndërmarrjet e veprimtarive të njejta në vende tjera;
- Raportimi dhe llogaridhënja para Qeverisë dhe në Kuvendin e Kosovës si dhe para komisioneve parlamentare.

Kosova është bërë anëtare e FMN-së në qershor të vitit 2009. Pas përfundimit të suksesshëm të Programit të Monitorimit të Stafit në vitin 2011, bordi i FMN-ës miratoi në prill të vitit 2012 një Marrëveshje Stand by me vlerë prej 107 milion euro për Kosovën. Ky program ka për qëllim të adresojë sfidat makroekonomike të Kosovës dhe të ruajë stabilitetin financiar. Deri më tani janë përfunduar dy shqyrtime të këtij programi. Banka do

të vazhdojë të bashkëpunojë ngushtë me FMN dhe do të shkëmbejë informacionin lidhur me çështjet makroekonomike dhe ato të reformës strukturore. BE është e angazhuar në mënyrë aktive në zhvillimin e infrastrukturës së transportit dhe asaj komunale, përmirësimin e faktorëve kyç në mjedisin afarist të vendit siç është sistemi gjyqësor, administrata, edukimi dhe qasja në financa si dhe avancimi i përfshirjes sociale (EBRD, 2013).

Kosova tani ka hyrë në procesin e stabilizim asociimit dhe BE ofron mbështetje përmes Instrumentit të Para Anëtarësimit (IPA). Programi i fundit përfshinte shumë fusha në tri kategori kryesore: kriteret politike, ekonomike dhe standardet Evropiane. Fondet nga ky program janë përdorur pjesërisht për mbështetjen e programeve të Mbështetjes së Bizneseve të Vogla nga BERZH-i. Sipas këtij dokumenti strategjia e BERZH-it në të ardhmen do të orientohet në mbështetjen e procesit të privatizimit dhe në zhvillimin e sektorit privat, rritjen e komercializimit, konkurrencës dhe të futjes së sektorit privat dhe promovimin dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm të energjisë dhe sektorëve minerar (EBRD, 2013).

Përmes këtij punimi deshirojmë të japim një pasqyrë të gjendjes dhe të zhvillimit të deri tanishëm të NP-ve që nga formimi i tyre. Gjithashtu kemi hulumtuar disa nga sfidat me të cilat ballafqohet organizimi aktual deri te riorganizimi i tyre. Duke e parë të nevojshëm riorganizimin e NP-ve në Kosovë janë aprovuar edhe tri ligje pa të cilat nuk kishte me qenë e mundur që NP-ët të riorganizohen. Kështu tani në fuqi janë: Ligji për dhënjën me koncesion, Ligji për patneritet publiko privat dhe Ligji për riorganizimin. Kështu mund të

themi se ekziston një infrastrukturë ligjore e cila mundëson riorganizimin nga forma e tanishme e organizimit.

Deri më tani kanë ndodhur dy raste të riorganizimit të NP-ve ndryshe nga forma fillestare e organizimit të tyre. Në njërin rast është përdorur forma e dhënjes me koncesion të NP "Aerportit Ndërkombëtar të Prishtinës" (ANP) konzorciumit turko-francez "Limak&Lyon" kurse në rastin tjetër është përdorur forma e privatizimit të pjesës së distribuimit të KEK-ut (KFOS & RIINVEST, 2015).

Poashtu ka pasur tentime të privatizimit të 75% të aksioneve të NP "Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës" të cilat pas disa përpjekjeve kanë dështuar dhe me 31 dhjetor 2013 Komisioni Qeveritar për Privatizim (KQP) ka njoftuar opinionin publik se ka vendosur të përmbyll procesin e privatizimit të 75% të aksioneve të PTK-ës (Komisioni Evropian, 2014).

Duhet theksuar se ka pasur një rezistencë dhe kundërshtim të madh nga të punësuaritë, partitë politike dhe shoqëria civile për gjithë procesin e privatizimit të PTK-ës por edhe të Distribuimit të KEK-ut. Kundërshtimet të cilat vijnë nga të punësuarit dhe shoqëria civile theksojnë faktet se nuk duhet të privatizohet ndërmarrja (PTK) e cila sipas rezultateve të afarizmit vlerësohet si një ndër ndërmarrjet më profitabile në Kosovë e cila ka qenë burim i të hyrave buxhetore përmes pagesës së dividendes. Apo vlerësimet për privatizimin e rrjetit të distribuimit të KEK-ut se shitja është bërë me një çmim shumë të ulët. Pra, procesi i riorganizimit është përcjellë me protesta, kundërshtime dhe rezerva lidhur me të ardhmen e

ndërmarrjeve të riorganizuara. E tërë kjo mund të jetë si pasojë e procesit të riorganizimit të ish ndërmarrjeve shoqërore nën administrim të Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM) sipas Rregullores 2005/48 e cila ka përjashtuar nga ky proces ndërmarrjet publike (neni 1, pika 1.1.) (KFOS & RIINVEST, 2015).

Nga ky proces i riorganizimit ka pasur pak raste të cilat janë transformuar në mënyrë të suksesshme. Dështimet me procesin e privatizimit të ish ndërmarrjes “Llamkos” por edhe të disa ndërmarrjeve tjera kanë arësytuar ngritjen e zërave kundër mënyrës së tillë të privatizimit.

Disa nga këto privatizime janë objekt i hetimeve dhe i procedurave gjyqësore të cilat do të shpenzojnë shumë kohë ndërsa në anën tjetër ndërmarrjet po shkatërrohen si pasojë e mosfunksionimit dhe mosushtrimit të veprimtarisë së tyre. Mungesa e një përvojë praktike për riorganizimin e ndërmarrjeve nga stafi lokal por edhe nga ai ndërkombëtar i angazhuar në Kosovë ka ndikuar negativisht në ndërmarrjen e veprimeve për një riorganizim të suksesshëm dhe të qëndrueshëm të NP-ve.

Objektiv i Qeverisë së Kosovës si ushtrues i së drejtës së aksionarit të NP-ve është ngritja e nivelit të cilësisë së shërbimeve publike të cilat ofrohen nga NP-ët. Për këtë arsye gjetja e një forme të re dhe më të avancuar të organizimit dhe qeverisjes së NP-ve mbetet një nga prioritetet në të ardhmen. Prandaj, riorganizimi i NP-ve në Kosovë do të jetë një sfidë e vështirë, tejkalimi i suksesshëm i së cilës do të jetë përcaktues i shumë zhvillimeve ekonomike, politike dhe sociale në Kosovë.

2.5 Funksionimi i NP-ve sot

NP-të në Kosovë sot funksionojnë në bazë të një kornize ligjore e cila është në fuqi dhe që përbëhet nga disa ligje themelore. Këto janë ligjet të cilat e përbëjnë kornizen e infrastrukturës ligjore të aplikueshme në ndërmarrjet publike:

- Ligji për shoqëritë tregtare Nr.02/L-123, i cili ka hyrë në fuqi në vitin 2007 dhe që paraqet bazën dhe pikënisjen e organizimit të kornizës ligjore jonetëm për ndërmarrjet publike por edhe për të gjitha format e organizimit të shoqërive tregtare.
- Ligji për ndërmarrjet publike në Kosovë Nr. 03/L-087, i cili ka hyrë në fuqi në muajin qershor të vitit 2008, ka pasur për qëllim themelimin e kornizës ligjore për rregullimin e ushtrimit të të drejtave pronësore, të qeverisjes korporative të ndërmarrjeve në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare për qeverisjen korporative të ndërmarrjeve publike dhe për krijimin e strukturave efikase të raportimit dhe përgjegjësisë për të lejuar mbikëqyrjen e duhur të aktiviteteve të ndërmarrjeve publike.

Pra ky ligj së bashku me Ligjin për shoqëritë tregtare kanë qenë ligjet bazike të organizimit dhe funksionimit të ndërmarrjeve publike. Këto dy ligje bazike janë plotësuar nga dy ligje tjera Ligji për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë dhe Ligjin për prokurim publik në Kosovë, të cilat kanë rregulluar dy lami tjera po aq të rëndësishme siç janë financat publike dhe prokurimi publik. Edhe këto dy ligje janë ndryshuar dhe plotësuar në çështje të caktuara gjatë kësaj periudhe 2008-2015. Ligji për ndërmarrjet publike në vitin

2012 është plotësuar me Ligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për ndërmarrjet publike në Kosovë -Ligji Nr.04/L-111.

Ndryshimet janë trajtuar si të nevojshme në rregullimin e disa çështjeve të cilat ligji në fazën fillestare të funksionimit të ndërmarrjeve publike nuk i kishte parashikuar. Janë bërë ndryshime me qëllim të përmirësimit të komunikimit, raportimit, përbërjes së bordeve të drejtorëve- struktura gjinore dhe nacionale e bordeve të drejtorëve, kufizimi i stimulimit të efektshmërisë për performancën vjetore të bordeve të drejtorëve, si dhe është riformuluar Lista 1 për Ndërmarrjet Publike Qendrore dhe Lista 2 për Ndërmarrjet Publike Lokale (sepse ndërkohë janë formuar edhe pesë (5) Ndërmarrje Publike Lokale dhe gjashtëmbdhjetë (16) Stacionet e autobusëve. Dhe ky proces i formimit të ndërmarrjeve të reja publike lokale në Kosovë ka vazhduar edhe më tutje pasi në ndërkohë janë formuar edhe disa ndërmarrje publike të reja.

Përveç të këtyre ligjeve bazike nga Njësia për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike janë publikuar edhe dy dokumente ndihmëse të kornizës rregullatore të cilat është kërkuar nga ndërmarrjet publike të i zbatojnë në praktikë. Këto janë Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative të Ndërmarrjeve Publike dhe Udhëzuesi i Auditimit të Brendshëm. Kodi është ndryshuar dy herë nga verzioni fillestar i tij duke tentuar kështu të bëhet sa më i aplikueshëm dhe të harmonizohet me ndryshimet ligjore si dhe të plotësojë mungesat e publikimeve paraprake deri sa Udhëzuesi për Auditim të Brendshëm është publikuar për herë të parë dhe Drejtimit e ndërmarrjeve publike e kanë pasur në disponim vetëm nga mesi i vitit 2014.

Që të dy këto dokumente kanë ndihmuar shumë akterët në plotësimin e zbrastësirave ligjore, në shpjegimin më të detajuar të kërkesave që parashtrihen nga ligjet tjera, në përcaktimin e një metodologjie të punës e cila ishte shumë e nevojshme, që shërbente si ndihmesë dhe udhërrëfyes për të gjithë anëtarët e Bordeve të Drejtorëve, të Komisioneve të Auditimit, Komiteteve tjera të Bordit të Drejtorëve (Komiteti i financave, Komiteti për staf dhe shpërblime dhe Komiteti për hulumtime dhe teknologji), Zyrtarët e NP-ve (Kryeshefin Ekzekutiv, Zyrtarin Kryesor Financiar dhe të Thesarit, Këshilltarin e Përgjithshëm/Sekretarin Korporativ, Zyrtarin për Auditim të Brendshëm), të cilët deri sa nuk kanë qenë në këto pozita nuk kishin ose në raste individuale kishin pak përvojë në qeverisjen korporative.

Duke e shpjeguar ndërhyrjen e qeverive në ekonomi, J.E.Stiglitz dhe C.E.Walsh në librin e tyre “Economics” e kanë shprehur këtë në mënyrë shumë të qartë se “*Qeveritë influencojnë ekonominë jovetëm nëpërmes të taksave dhe shpenzimeve por gjithashtu përmes rregulloreve të shumta të cilat prekin çdo aspekt të jetës ekonomike*” (Stiglitz & Walsh, 2006: 375).

2.5.1 Bordet e Drejtorëve

Në sistemin e qeverisjes korporative pamarrë parasysh modelin e qeverisjes, Bordet e Drejtorëve janë vendimmarrësitë kryesorë. Prandaj roli dhe ndikimi i tyre është shumë i madh për funksionimin e suksesshëm të ndërmarrjeve publike. Sot në vende të ndryshme të

botës zbatohen modele të ndryshme të organizimit të bordeve të drejtorëve. Në secilin vend, struktura e qeverisjes korporative ka disa karakteristika ose elemente përbërëse të cilat e dallojnë atë nga strukturat e vendeve tjera.

Një karakteristikë e BD të NP është se nga qeveria e cila ka bërë përzgjedhjen e anëtarëve të BD të NP nuk është respektuar një dispozitë e Ligjit për NP e cila kërkon që anëtarët e BD të cilët do të përzgjedhen në këto pozita, 36 muaj para se të aplikojnë nuk janë ose nuk kanë qenë zyrtarë të zgjedhur publik, të emëruar politik ose bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike. Kjo ka ndikuar që në pozita të BD të NP të emërohen aktivistë partiak të partive politike të cilat kanë qenë në pushtet dhe të cilat kanë formuar qeverinë me qenë se çdo herë ka pasur koalicion qeverisës (KDI & TIK, 2015).

Prandaj, pavarësia e proklamuar e bordeve të drejtorëve nuk ka ekzistuar pasi që interesat partiake dhe personale kanë qenë mbi interesat publike të cilat së paku ka qenë obligim të përfaqësohen. Në mënyrë zinxhirore nga anëtarët e BD ndikohet përzgjedhja e kryeshefit ekzekutiv (drejtorit ekzekutiv ose drejtorit menaxhues) i cili i përzgjedhur në këtë mënyrë ka humbur pavarësinë personale për të rezistuar në plotësimin e kërkesave të njerëzve nga politika. Ndërhyrjet politike dhe patronazhi janë disa nga shkaqet e performances së varfër të anëtarëve të BD në NP (KDI & TIK, 2015).

Privatizimi i NP shpesh nuk konsiderohet vetëm një proces ekonomik por si një alternativë e rishpërndarjes së fuqisë politike në mes të palëve të përfshira e sidomos të ndërmarrjeve publike dhe të ministrive përkatëse të qeverisë të cilat duke u nxitur nga orekset e tyre

byrokratike dhe nga frika e humbjes së privilegjeve që ju ofrojnë NP preferojnë politiken e status quo-s, të mosndryshimit të gjendjes ekzistuese. Prandaj, qasja byrokratike e BD dhe Drejtimit të NP paraqitet pengesë për ndryshime dhe riorganizime nga forma e organizimit aktual megjithë performancën e dobët të tyre (KDI & TIK, 2015).


Secili model i qeverisjes korporative identifikon këto elemente përbërëse: bartësit kyç të qeverisjes korporative, modelin e pronësisë së atij vendi, përbërjen e bordit të drejtorëve, kornizën rregullatore, shpalosjen e kërkesave për kompanitë e listuara, aktivitetet korporative të cilat kërkojnë lejen e pronarit dhe ndërveprimi në mes të bartësve të qeverisjes korporative. Megjithatë në praktikën e qeverisjes korporative kryesisht janë të njohura dhe zbatohen në praktikë dy modele kryesore të organizimit të bordeve të drejtorëve:

- Modeli Anglo-Amerikan dhe
- Modeli Gjerman

Në vendet e OECD-së aplikohen njëra nga këto dy modelet e lartpërmendura. Modeli Anglo-Amerikan i qeverisjes korporative apo modeli njënivelësh (njëshkallësh) dallon nga modeli gjerman sepse në strukturën e tij ka vetëm një Bord të Drejtorëve i cili është organ vendimmarrës dhe është përgjegjës ndaj aksionarëve kurse Drejtimi (Menaxhmenti) është zbatues i politikave dhe vendimeve të bordit. Bordi i Drejtorëve ka kompetenca në përzgjedhjen e Drejtimit dhe zyrtarëve tjerë (Ungureanu, 2012).

Në NP në Kosovë aplikohet modeli anglo-amerikan me një Bord të Drejtorëve të cilët kanë kompetenca që të zgjedhin edhe kryeshefin ekzekutiv (drejtorin ekzekutiv ose drejtori menaxhues), zyrtarin për auditim të brendshëm, zyrtarin kryesor financiar dhe të thesarit dhe sekretarin e ndërmarrjes/këshilltarin e përgjithshëm. Kryeshefi ekzekutiv pastaj sipas funksionit njëkohësisht është edhe anëtar i Bordit të Drejtorëve. Në vijim mund të shihet një skemë e organizimit aktual të një ndërmarrjeje publike dhe organogrami i saj:

Figura Nr. 1 - Organogrami i Ndërmarrjes Publike "Ibër Lepenci"



Burimi: Plani i Biznesit të NH "Ibër-Lepenci", sh.a., 2015.

Modeli Gjerman është model dynivelësh (dyshkallësh) i qeverisjes korporative i cili përveç Bordit të Drejtorëve ka edhe një bord tjetër i cili quhet Bordi Mbikëqyrës. Nga vet emri i tij mund të kuptohet se ky bord ka kompetenca që të mbikëqyrë punën e Bordit të Drejtorëve. Duhet theksuar se këto parime synohen të zbatohen edhe nga vende të cilat nuk janë anëtare të OECD por të cilat bëjnë përpjekje që të ngritin nivelin e qeverisjes por edhe të llogaridhënjes dhe transparences ndaj publikut dhe pjesëmarrësve tjerë (Ungureanu, 2012).

Në ndërmarrjet publike në Kosovë, që nga përzgjedhja dhe emërimi i tyre në pozitën e anëtarëve të bordeve të drejtorëve të ndërmarrjeve publike në vitin 2008, personat e njejtë kanë qenë në pozita të njejtë deri në shtator të vitit 2015 edhe pse fillimisht ishin emëruar me një mandat tre (3) vjeçar. Sipas një vlerësimi të kryer nga MZHE, bordet e drejtorëve të disa NP kanë mungesa në përmbushjen e detyrave fiduciare ndaj aksionarit dhe një grup tjetër i bordeve të NP është ende në vijim të përmbushjes së tyre edhe pas disa viteve të veprimit (MZhE, 2013).

Duhet theksuar se vetëm në dy NP, KEK dhe PTK në fund të vitit 2013 janë bërë ndryshime gjegjësisht emërimet e reja të anëtarëve të bordeve të drejtorëve. Gjithashtu duhet theksuar se me një vendim nga Qeveria e Kosovës pas skadimit të afatit të parë kur janë emëruar ju është zgjat afati të gjithë anëtarëve të bordeve të drejtorëve deri në një vendim tjetër. Në qeverisjen e kaluar dy herë janë shpallur konkurset për anëtarë të bordeve të drejtorëve të NP dhe dy herë pas një kohe të gjatë të mosveprimit, konkurset janë anuluar pa kurrëfarë shpjegimi për pjesëmarrësitë. Shpresojmë që konkursi i shpallur këtë vit (dmth i treti) cili është mbyllur me 18 Shkurt 2015 do të përfundojë me sukses. Megjithë të metat

procedurale në përzgjedhjen e drejtorëve të bordeve, konsiderojmë se shumë më e rëndësishme është zgjedhja e drejtorëve me kualifikime profesionale ashtu siç janë specifikuar me Ligjin për ndërmarrjet publike. Personat e kualifikuar do të mund të japin kontribut shumë më të rëndësishëm në marrjen e vendimeve për NP (MZhE, 2013).

Një nga gabimet i cili shpresojmë të mos përsëritet është përzgjedhja e personave të cilët kanë mbajtur edhe pozita tjera e të cilat nga Agjencia Antikorrupcion e Kosovës janë trajtuar si pozita me konflikt interesi. Kjo ka ndikuar që në disa NP (“Ibër-Lepenci”, KRU “Prishtina”, etj.) që bordet e drejtorëve për një kohë të gjatë të mbesin pa disa anëtarë pasi që disa prej tyre kanë dhënë dorëheqje dhe nuk janë plotësuar me anëtarë të rinj. Veprimi i BD pa disa anëtarë-borde të pakompletuara, nuk ka arritur që të jap maksimumin gjë që ka pasur ndikim negativ në vendimmarrjen për ndërmarrjet (MZhE, 2013).

Një sfidë tjetër e cila nuk është më pak e rëndësishme është përzgjedhja e personave në bazë të përkatësisë politike ose nga këto pozita kanë pasur pjesëmarrje në aktivitete politike-kandidime për zgjedhje në pozita të cilat janë politike e që nuk është e lejuar me Ligjin për NP sipas të cilit të gjithë drejtorët duhet të jenë të pavarur. Sipas nenit 17.2 pika k, një drejtor nuk mund të plotësojë kriterin e pavarësisë nëse ai “është ose në çfarëdo kohe gjatë periudhës 36 muajshe para datës së aplikimit ka qenë: (i) zyrtar i zgjedhur publik, (ii) i emëruar politik ose (iii) bartës i një posti udhëheqës ose vendimmarrës në një parti politike”. Një faktor shumë i rëndësishëm në punën e bordeve të drejtorëve të NP ka qenë papërvoja e tyre në qeverisjen korporative para se të bëhen anëtarë të bordeve të drejtorëve të ndërmarrjeve publike. Duke e pasur të njohur papërvojen paraprake të anëtarëve të

bordeve të drejtorëve nga NJPM të NP-ve janë organizuar trajnime dhe është publikuar një manual “Si të bëhem drejtor i ndërmarrjes” (MZhE, 2013).

Si do të përdoret kjo qeverisje, si do të zbatohet në praktikë, para shumë viteve ka shfaqur dilemat e tij një përfaqësues i teorisë ekonomike liberale monetaristi Milton Friedman i cili në librin e tij “Kapitalizmi dhe liria”, thekson: *“Problemi është si të ndërtojmë struktura institucionale që do t’i japin përgjegjësi qeverisë për paratë dhe në të njejten kohë, ta kufizojë këtë pushtet që i jepet qeverisë dhe të pengojnë që ky pushtet të përdoret në mënyra që kanë për ta dobësuar, në vend që ta forcojnë shoqërinë e lirë”* (Friedman, 1962: 44-45).

Duke hulumtuar në praktiken e deritanishme të ndërmarrjeve publike në Kosovë, vlerësojmë se ky konstatim ende nuk është plotësuar e që janë qëllime edhe të Ligjit për ndërmarrjet publike në Kosovë (Ligji Nr.03/L-087) të shprehura nga miratuesi i këtij ligji Kuvendi i Republikës së Kosovës.

2.5.2 Zyrtarët e NP-ve

Sipas nenit 21.3 Ligjit për ndërmarrjet publike në Kosovë (Ligji Nr.03/L-087), secila NP duhet të ketë këta katër zyrtarë si në vijim: Kryeshefin Ekzekutiv, Zyrtarin Kryesor Financiar dhe të Thesarit, Këshilltarin e Përgjithshëm/Sekretarin Korporativ, dhe një Zyrtar për Auditim të Brendshëm.

Zyrtarët e ndërmarrjeve publike në sistemin e qeverisjes korporative paraqesin një hallkë lidhëse në mes të Bordeve të Drejtorëve si vendimmarrës dhe Drejtimit të ndërmarrjeve si implementues të këtyre vendimeve. Këta zyrtarë emërohen nga Bordi i Drejtorëve, shërbejnë për Bordin dhe mund të shkarkohen nga Bordi me ose pa deklarin e arsyes me përjashtim të Zyrtarit për Auditim të Brendshëm për të cilin kompetencën ekskluzive për emërimin dhe shkarkimin e tij e ka Komisioni i Auditimit, i cili mundet në çdo kohë dhe me shumicë votash të i ndërprejë kontratën ketij zyrtari me ose pa deklarin e arsyes. Para se të bëjë emërimin e këtyre zyrtarëve, Bordi i Drejtorëve duhet të kryej një procedurë të hapur e cila do të jetë konkurruese dhe transparente me qëllim që të gjitha emërimet të bëhen ekskluzivisht në bazë të meritës.

Përmes kësaj procedure, Bordi i Drejtorëve do të sigurohet se personat që do të emërojnë në pozitat e zyrtarëve janë persona me integritet personal të cilët i plotësojnë:

- Kushtet e kualifikimit sipas nenit 17.1 të Ligjit për NP;
- Kriteret e pavarisë sipas nenit 17.2, pikat d, f, j, k dhe l të Ligjit për NP; dhe
- Kanë përvojën e nevojshme profesionale dhe shkollimin e duhur për poziten në fjalë, me kusht që:
- Zyrtari Kryesor Financiar dhe i Thesarit të posedojë diplomë universitare dhe përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e financave dhe/ose kontabilitetit;
- Këshilltari i Përgjithshëm/Sekretari i Korporatës të posedojë diplomë universitare në ligj dhe përvojë të konsiderueshme profesionale nga fusha e qeverisjes korporative ose të drejtes së shoqërive tregëtare; dhe
- Zyrtari për Auditim të Brendshëm të jetë person ekspert në kontabilitet.

Për zyrtarët e ndërmarrjeve publike kompensimet dhe përfitimet përcaktohen nga Bordi i Drejtorëve të bazuara në deklaratën mbi politikën e kompensimit në ndërmarrje publike të aprovuara nga Komisioni i Auditimit.

2.6 Organizimi i tyre sipas Ligjit për NP

Nga ish ndërmarrjet shoqërore të cilat administroheshin nga Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit (AKM) me hyrjen në fuqi të Ligjit për ndërmarrjet publike në Kosovë (Ligji Nr.03/L-087) në vitin 2008 janë formuar ndërmarrjet publike. Qëllimi i këtij ligji ka qenë:

- Themelimi i kornizës ligjore për rregullimin e ushtrimit të të drejtave pronësore,
- Të qeverisjes korporative të ndërmarrjeve në përputhje me parimet e njohura ndërkombëtare për qeverisjen korporative të ndërmarrjeve publike, dhe
- Për krijimin e strukturave efikase të raportimit dhe përgjegjësisë për të lejuar mbikëqyrjen e duhur të aktiviteteve të ndërmarrjeve publike.

Të gjitha ndërmarrjet publike sipas këtij ligji do të organizohen si shoqëri aksionare në përputhje me Ligjin për shoqëritë tregëtare (Ligji Nr.02/L-123). Sipas veprimtarisë dhe shtrirjes gjeografike në ofrimin e shërbimeve të gjitha ndërmarrjet sipas Ligjit për NP në Kosovë janë grupuar në NP Qendrore, NP Rajonale dhe NP Lokale. Kështu ndërmarrja e cila ka veprimtari një shërbim publik të vetëm por edhe të përbashkët për qytetarët e Kosovës dhe ka kryer shërbime duke përfshirë gati gjithë territorin e Kosovës është kategorizuar si Ndërmarrje Publike Qendrore (GAP, 2015). Në këtë kategorizim bëjnë pjesë:

- Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), sh.a.
- Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK), sh.a.
- Posta e Kosovës (PK), sh.a.
- Operator Sistemi, Transmisioni dhe Tregu (OSTT), sh.a.
- Hekurudhat e Kosovës-Trainkos, sh.a.
- Hekurudhat e Kosovës-Infrakos, sh.a.
- Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (ANP), sh.a.
- Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK), sh.a.
- NPH Ibër-Lepenci, sh.a.

Me qenë se kryejnë veprimtarinë e njejtë dhe shtrihen në disa komuna janë kategorizuar si Ndërmarrje Publike Rajonale të Ujitjes dhe Ujësjetjes (GAP, 2015). Në këtë kategorizim përfshihen:

- Kompania e Ujësjetjes Rajonal Prishtina, sh.a., Prishtinë,
- Kompania e Ujitjes Drini i Bardhë, sh.a., Pejë
- Kompania e Ujitjes Radoniqi-Dukagjini, sh.a. ,Gjakovë
- Kompania Rajonale e Ujësjetjes Hidrodrini, sh.a., Pejë
- Kompania Rajonale e Ujësjetjes Hidroregjioni Jugor, sh.a. , Prizren
- Kompania Rajonale e Ujësjetjes Mitrovica, sh.a. , Mitrovicë
- Kompania Rajonale e Ujësjetjes Hidromorava, sh.a. , Gjilan
- Kompania Rajonale e Ujësjetjes Radoniqi, sh.a., Gjakovë .

Sipas këtij ligji ndërmarrjet publike qendrore janë në pronësi të Republikës së Kosovës kurse Qeveria ka kompetencën ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës deri sa të drejtat e aksionarit në një ndërmarrje publike lokale ku komuna është aksionare i ushtron një Komision Komunal i Aksionarëve. Në përputhje me kërkesat e ligjit për ndërmarrjet publike është organizuar dhe implementohet qeverisja korporatave (GAP, 2015).

2.6.1 Kodi i Etikës dhe Qeverisjes Korporative në Ndërmarrjet Publike

Si obligim i cili del nga neni 35.4 i Ligjit për Ndërmarrjet Publike për të shpallur një model të Kodit për shfrytëzim nga NP-të, në vitin 2010 Njësia për Politika dhe Monitorim të NP-ve ka publikuar për herë të parë Kodin e Etikës dhe Qeverisjes Korporative të Ndërmarrjeve Publike.

Sipas nenit 35.1 të këtij ligji, të gjitha NP duhet të përgatisin, miratojnë dhe zbatojnë një kod të detyrueshëm të etikës dhe qeverisjes korporative. Me qëllim të përmirësimit të sistemit të qeverisjes korporative, rritjes së transparencës dhe llogaridhënjes në përputhje me Parimet e OECD-së për Qeverisje Korporative (Njësia për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, 2010). Njësia (NJPM të NP) ka ribotuar për herë të dytë në vitin 2014 Kodin me disa ndryshime dhe plotësime.

Përmes këtij kodi janë përcaktuar kornizat e raportimit, është lehtësuar monitorimi dhe vlerësimi i performancës së ndërmarrjeve publike. Kodi është mbështetje dhe udhëzues i

punës së bordeve të drejtorëve, Drejtimeve të ndërmarrjeve dhe të të punësuarëve dhe kërkohet që të nënshkruhet zotimi për respektimin dhe zbatimin e tij.

Kodi përveç pjesës që ka të bëjë me librat dhe dosjet e korporates, konfidencialitetin, komunikimet, konflikteve të interesit, mitosjes dhe korrupsionit, standardeve për të drejtat e njeriut, sjelljes ndaj pronës dhe politikat pronësore, ka përshkruar në mënyrë më të detajuar se sa Ligji për Ndërmarrjet Publike, funksionet e bordit të drejtorëve, të komisionit të auditimit, të komiteteve tjera të bordit (Komitetit për financa, Komitetit për hulumtim dhe teknologji dhe Komitetit për staf dhe shpërblime), mënyren dhe nivelin e shpërblimit të anëtarëve të bordit (drejtorëve jo-ekzekutiv), zyrtarëve të lartë dhe të punësuarëve. Në pjesën e fundit janë dhënë në formë shpjeguese afatet për aprovimin e planit të biznesit dhe buxhetit vjetor, për aprovimin e pasqyrave financiare, datës së mbajtjes së takimit të përgjithshëm vjetor (TPV), si dhe afatet e raportimit në Njësinë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike (Njësia për Politikat dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike, 2014).

Sipas nenit 31 të Ligjit për NP, kërkohet nga çdo ndërmarrje publike, që brenda afatit prej 75 ditëve pasi të përfundojë viti fiskal të përgatis një raport vjetor gjithëpërfshirës të cilin pasi të miratohet nga Bordi i Drejtorëve do të i dorëzoj raportin vjetor Njësisë për Politika dhe Monitorim të Ndërmarrjeve Publike e cila të njejtin do të e publikojë në faqen e saj zyrtare në internet. Duke marrë parasysh këtë kërkesë në shtojcë të Kodit është dhënë një Udhëzues për përpilimin e Raportit Vjetor të Ndërmarrjeve Publike me qëllim që:

- Të ndihmojë ndërmarrjet të përpilojnë raporte konstruktive dhe me informata të dobishme për lexuesit, dhe
- Të përmirësojë standardet e përgjithshme të raportimeve vjetore.

Sipas Ligjit për NP 03/L-87, raporti vjetor duhet të përfshijë:

- Të dhëna të nevojshme të cilat mundësojnë vlerësimin e performances së ndërmarrjes, duke përfshirë krahasimet me arritjen e caqeve të planit të biznesit dhe krahasimet me realizimet e vitit paraprak.
- Raportime të cilat parashihen me ligjin për ndërmarrjet publike dhe statute të ndërmarrjeve aty ku aplikohet.

Duke pasur parasysh mungesën e përvojës e me qëllim që të shërbej si udhërrëfyes në përpilimin e këtyre raporteve në fund të Kodit është dhënë një model praktik i strukturuar duke e specifikuar përmbajtjen e tij sipas seksioneve.

2.6.2 Udhëzuesi i Auditimit të Brendshëm

Auditimi i brendshëm definohet si shërbim profesional, objektiv dhe i pavarur, ndihmesë për Drejtimin e ndërmarrjes i dizajnuar për të shtuar vlera dhe për të përmirësuar operacionet e ndërmarrjes. Ai mund të japë një kontribut të vlefshëm në arritjen e objektivave të ndërmarrjeve publike dhe në menaxhimin e risqeve si dhe duke propozuar mundësi të reja që do të ndikonin në rritjen e performances së ndërmarrjeve publike. Qasja bashkëkohore e auditimit të brendshëm tejkalon rolin tradicional të kuptimit të auditimit të

brendshëm si “kontroll e brendshme” apo “të policit të ndërmarrjes”. Auditimi i brendshëm gjithnjë e më shumë po trajtohet si shtylla e katërtë e qeverisjes korporative në nivel të ndërmarrjeve publike së bashku me Bordin e Drejtorëve, Komisionin e Auditimit dhe Kryeshefin Ekzekutiv.

Po ashtu në rrethanat e sotme të afarizmit, shumë më e rëndësishme po bëhet qasja parandaluese (preventive) e auditimit të brendshëm, sipas të cilës aktivitetet e saja kanë për qëllim të ofrojnë mbështetje dhe ndihmë Drejtimit në parashikimin e rreziqeve të ardhshme dhe propozimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm të cilat do të i eliminojnë me kohë. Objekti i testimit të audituesit të brendshëm po bëhet afarizmi i gjithëmbarshtëm i ndërmarrjes i orientuar kah e ardhmja (Tušek & Sever, 2008).

Në rrethana të këtylla raportimi i audituesit të brendshëm po bëhet mjet komunikimi në mes të auditimit të brendshëm dhe Drejtimit përmes të cilit audituesi i brendshëm paraqet rezultatet dhe vlerësimet e afarizmit të lamive të cilat i ka audituar bashkë me propozimin e aktiviteteve të nevojshme korrigjuese, por që në të ardhmen do të bëhen analiza të detajuara me propozimet për zvogëlimin, zbutjen ose eliminimin e rrezikut dhe vlerësimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm (Tušek & Sever, 2008).

Roli dhe rëndësia e funksionimit të Komisioneve të Auditimit dhe të auditimit të brendshëm në qeverisjen korporative është pothuaj se vendimtare në funksionimin e ndërmarrjeve publike. Udhëzuesi i Auditimit të Brendshëm për Ndërmarrje Publike është rezultat i punës së përbashkët të konsulencës ndërkombëtare të angazhuar dhe drejtorit të

NJPM të NP-ve. Pas miratimit nga Aksionari, respektivisht Ministri i MZHE-së, është botuar i njëjti me qëllim të shpërndarjes tek Komisionet e Auditimit dhe auditorët e brendshëm të NP-ve. Udhëzuesi ka përmbajtje prej dy pjesësh dhe shtatë kapitujsh të përmbledhura në nëntëdhjetë (90) faqe (MzhE, 2014).

Udhëzuesi ka pasur për qëllim të shërbej si një udhërrëfyes dhe të ju ndihmojë në punën e tyre Komisioneve të Auditimit dhe Zyrtarëve për auditim të brendshëm (auditorët e brendshëm) në ndërmarrjet publike *“për të kuptuar rolin modern dhe përgjegjësitë, proceset dhe politikat e funksionit të auditimit të brendshëm, si dhe terminologjinë që duhet të përdoret”*. Për Zyrtarët për Auditim të Brendshëm ky Udhëzues shërben si bazë për krijimin e manualeve të auditimit të brendshëm në ndërmarrjet publike duke i marrë parasysh gjatë përpilimit specifikat e veprimtarive të ndërmarrjeve ku punojnë. *“Objektivi kryesor i Udhëzuesit të Auditimit të Brendshëm është të paraqesë kuadrin bazë konceptual mbështetës të politikave dhe proceseve të auditimit të brendshëm si dhe të ju jap audituesve njohuri mbi praktikat më të mira globale të auditimit të brendshëm”* (MzhE, 2014: 9).

Përmbajtja e tij është e ndarë në dy pjesë:

- Në pjesën e parë janë përfshirë praktikat më të mira në profesionin e auditimit që kanë të bëjnë me përcaktimin e pozicionit më të përshtatshëm që duhet të ketë auditimi i brendshëm në NP dhe të praktikave në përpilimin e Manualit të Auditimit të Brendshëm.

- Në pjesen e dytë përfshinë përkufizimin e auditimit të brendshëm, Kodin e Etikës dhe Standardet Ndërkombëtare për Praktikën Profesionale të Auditimit sipas Institutit Ndërkombëtar të Audituesve të Brendshëm.

2.7 Mbikëqyrja e ndërmarrjeve publike

Sipas Ligjit për ndërmarrjet publike, neni 7 është theksuar mbikëqyrja nga aksionari (ët) dhe Njësia për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike (NJPM të NP). Në emër të aksionarit ushtron mbikëqyrje të vazhdueshme dhe rigoroze të veprimitarisë së Bordit të Drejtorëve dhe Komisioneve të Auditimit të ndërmarrjes publike respektive. Po ashtu nëse performanca e NP-ës devijon nga caqet e përcaktuara me Planin e Biznesit të miratuar nga Bordi i Drejtorëve, Aksionarët do të kërkojnë nga Bordi i Drejtorëve që të përgatisë dhe të ju dorëzojë atyre një raport i cili i shpjegon arësyet për performancën e dobët, dhe Aksionari(ët) do të marrin të gjitha masat e duhura korrigjuese.

Mëtutje në nenin 7.3 janë caktuar veprimet nëse një NP dështon në arritjen e caqeve të saj të performancës për dy vite financiare radhazi, personi(at) përgjegjës për ushtrimin e të drejtave përkatëse të aksionarit është i detyruar që të marrë parasysh shkarkimin dhe zëvendësimin e Bordit të Drejtorëve ose shumicës së anëtarëve të tij. Një veprim i këtillë mund të ndërmerret edhe në mungesë të provave bindëse, të neglizhencës nga Bordi ose anëtarët përkatës të bordit, përveç nëse Aksionari(ët) konstatojnë se performanca e dobët ka ndodhur kryesisht për shkak të rrethanave ose ngjarjeve negative të paparashikueshme. Personat përgjegjës për ushtrimin e të drejtave përkatëse të Aksionarit do t'ia raportojnë

çdo vendim të marrë në bazë të këtij neni 7.3, dhe arësyet për marrjen e këtij vendimi: (i) Kuvendit, për NP-të Qendrore, ose (ii) Kuvendit përkatës Komunal, për NP-të Lokale.

Po ashtu sipas nenit 7.4 të ligjit të lartpërmendur NJPM të NP ka për obligim të shqyrtojë procesverbalet e secilës mbledhje të Bordeve të Drejtorëve dhe Komisioneve të Auditimit të NP-ve si dhe të gjitha dokumentet e dorëzuara nga ana e tyre. Sa herë që vlerësohet se është e nevojshme, NJPM të NP do të kërkojë dorëzimin e të dhënave më specifike dhe po ashtu mund të kërkojë takim me Bordin e Drejtorëve. Në qoftë se këto procesverbale, dokumente ose të dhëna shfaqin shmangje nga plani i biznesit, indikatorë negativ lidhur me performancën e Bordit të Drejtorëve, menaxhmentit të NP-së ose vetë NP-së, NJPM të NP-ve do ta njoftojë Aksionarin (ët) përkatës mbi këto shqetësime.

Në paragrafet tjera të këtij neni është përcaktuar mënyra e komunikimit ndërmjet Aksionarëve ose Njesisë dhe Bordit të Drejtorëve ose Komisionit të Auditimit, pastaj që roli mbikëqyrës të mos ndërhyjë në pavarësinë e Bordit të Drejtorëve ose Komisionit të Auditimit si dhe obligohet Njësia që të mbaj sekret dhe të mos i bëj publike të dhënat të cilat më parë Bordi i Drejtorëve i ka përcaktuar si të dhëna sekrete.

Poashtu me nenin 28.3 të Ligjit për ndërmarrjet publike, Njësia në baza vjetore vlerëson efektshmërinë e drejtorëve të secilës ndërmarrje publike dhe poashtu është e saktësuar se drejtorët janë të obliguar të bashkëpunojnë me rastin e kryerjes së këtij vlerësimi. Njesisë i lejohej që duke respektuar dispozitat e ligjit për prokurim publik të angazhojë një ose më

shumë këshilltarë ose kompani që të ndihmoj në kryerjen e këtij vlerësimi të cilin Njësia e ka obligim ligjor të e publikoj në web faqen e saj zyrtare (MCI, 2015).


Njësia duke u bazuar në burimet njerëzore, të cilat konsiderojmë se janë të pamjaftueshme ka caktuar nga një analistë për përcjelljen, komunikimin dhe mbikëqyrjen e disa ndërmarrjeve publike. Analistët nga Njësia duke përfaqësuar aksionarin marrin pjesë në takimet e Bordeve të Drejtorëve të ndërmarrjeve publike dhe të Komisioneve të Auditimit në cilësinë e vëzhguesit. Vet fakti se ata kanë pasur për detyrë të mbikëqyrin disa ndërmarrje i ka vënë ata para vështirësive rreth komunikimit me ndërmarrjet publike. Pastaj specifikat e ndërmarrjeve kanë qenë të ndryshme që i ka vënë analistët para vështirësive të reja shtesë (MCI, 2015).

Përcjellja në mënyrë aktive e të gjitha ndërmarrjeve publike kërkon burime njerëzore me kapacitete profesionale më të mëdha dhe me më shumë përvojë se sa që disponon Njësia. Së paku deri më tani, Njësia nuk ka mundur të kryejë funksionin e saj në aspekt të veprimit parandalues (preventiv) por më tepër ka shërbyer si funksion korrigjues (korrektiv), këshillëdhënës me kërkesa të theksuara, të përsëritura për zbatimin e ligjeve. Njësia nuk ka arritur që NP-ve të ju imponojë një dinamikë të cilën do ta zbatonin NP-të kurse Njësia do të monitoronte implementimin e saj. Konsiderojmë se rritja e kapaciteteve monitoruese në aspektin e plotësimit të kërkesave ligjore dhe ngritja graduale e kapaciteteve profesionale do të ndihmonte në ballafaqimin me sfidat për një qeverisje korporative më cilësore (MCI, 2015). Prandaj, është obligim i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik që të fuqizoj rolin e Njesisë që të rritë mbikëqyrjen e NP-ve.

2.7.1 Njësia për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike

Njësia për Politikën dhe Monitorimin të NP funksionon në nivel të departamentit në kuadër të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Qeverisë së Republikës së Kosovës. Ajo funksionon si departament i veçantë që merret me çështjet e ndërmarrjeve publike dhe e mbështetë Ministrinë dhe Qeverinë në ushtrimin e përgjegjësisë së tyre e sidomos të ndërmarrjeve publike qendrore (Rinvest & CIPE, 2012). Rangimi i saj në kuadër të MZHE-së mund të shihet në organogramin në vijim:

Figura Nr. 2 - Organogrami i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik



Burimi: Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (2016)

Në vijim do të specifikojmë disa nga detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë për Politikat dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike. Detyrat dhe përgjegjësitë e Njesisë për Politikat dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike janë: mbështet Ministrinë dhe Qeverinë në ushtrimin e përgjegjësiave për ndërmarrjet publike, përgatitë dhe i dorëzon Ministrit, për transmetim në Qeveri, analiza dhe rekomandime lidhur me çështjet e ndërmarrjeve publike qendrore që janë në kompetencën e Ministrit dhe /ose Qeverisë, përgatitë dhe i dorëzon Ministrit propozim-procedurat për mbikëqyrjen e ndërmarrjeve publike qendrore dhe monitoron përputhjen e tyre me Ligjin për Ndërmarrjet Publike dhe legjislacionin përkatës në fuqi, mbledh të dhënat përkatëse mbi ndërmarrjet publike dhe ofron përkrahje sipas nevojës për Divizionin për Buxhet dhe Financa lidhur me të gjitha aspektet e Buxhetit të Kosovës që ndërlidhen me ndërmarrjet publike, merr pjesë në takimet e bordit të ndërmarrjeve publike, në cilësinë e vëzhguesit, në emër të aksionarit, si dhe detyra dhe përgjegjësi tjera të përcaktuara me Ligjin për Ndërmarrjet Publike, Ligjin për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Ndërmarrjet Publike dhe legjislacionin përkatës në fuqi, ndërsa udhëheqësi i Njesisë për Politikat dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike raporton tek Ministri i Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik .

Njësia për Politikat dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike është strukturë në nivel të njëjtë me Departamentet e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Numri i të punësuarve në Njësinë për Politikat dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike është aktualisht dymbëdhjetë (12).

2.7.2 Disa ndryshime që kanë ndodhur në periudhën 2008-2015

Gjatë kësaj periudhe të zhvillimit të tyre në periudhën 2008-2015 kanë ndodhur disa ndryshime në NP nga formimi i tyre. Ndryshimet që kanë ndodhur me rastin e ndarjes së PTK-ës në dy ndërmarrje publike Posta e Kosovës dhe Telekom. Posta e Kosovës është themeluar si ndërmarrje e re publike me 21 dhjetor 2011 me vendim të Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 16/53.

Fillimisht si ndërmarrje publike kanë funksionuar Hekurudhat e Kosovës, por me vendimin Nr. 05/110 të datës 26.02.2010 janë ndarë në dy ndërmarrje publike: Hekurudhat e Kosovës-Trainkos dhe Hekurudhat e Kosovës-Infrakos. Me këtë ndarje janë përcaktuar edhe veprimtaritë e mëtejshme të këtyre dy ndërmarrjeve:

- Hekurudhat e Kosovës-Operimet me Trena të Hekurudhave të Kosovës, Sh.A. - Trainkos-Menaxhimin, mirëmbajtjen e mjeteve lëvizëse dhe ofrimin e shërbimeve të transportit të udhëtarëve dhe atij të mallrave me hekurudhë dhe me mjete tjera të transportit (Transporti Multi Modal), dhe
- Hekurudhat e Kosovës-Infrastruktura e Hekurudhave të Kosovës, Sh.A.-Infrakos-Menaxhimin, mirëmbajtjen, përmirësimin, renovimin dhe ndërtimin e infrastruktures hekurudhore.

Me Vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës numër 05/68 të dates 12.06.2009 është miratuar rekomandimi i propozuar nga Komiteti Drejtues Ndërministror për zbatimin e Partneritetit Publiko-Privat (Dizajno-Ndërto-Financo-Opero-Transfero) në Aeroportin

Ndërkombëtar të Prishtinës. Në pikën dy të këtij vendimi është kërkuar nga Komiteti Drejtues Ndërministror të filloj me zbatimin e Partneritetit Publiko-Privat bazuar në legjislacionin në fuqi përmes një procesi të prokurimit publik ndërkombëtar (KFOS & RIINVEST, 2015).

Kontrata për partneritet publiko privat Nr. PPP-09-001-611e nënshkruar me 12.08.2010 në mes të Komitetit Drejtues Ndërministrorë të Qeverisë së Kosovës dhe Limak Kosovo J.S.C. në thelb përmban transferimin e kompetencave në menaxhimin dhe operimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës tek konsorciumi “Limak Kosovo”, i përbërë nga operator francez të aeroportit, “Aéroports de Lyon” dhe kompania turke e ndërtimit, “Limak Construction”.

Po ashtu në bazë të kësaj kontrate kërkohet që konsorciumi “Limak Kosovo” të bëjë investime për të modernizuar dhe zgjeruar Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës, duke investuar mbi 100 milionë euro në infrastrukturë të re, përfshirë edhe ndërtimin e një terminali të ri dhe 39,42 për qind të të ardhurave bruto në këmbim me të drejtën për koncesion. Kontrata e partneritetit publiko-privat (e ashtuquajtura "tri P"-PPP) është në fuqi nga data 04 Prill 2011, gjë që paraqet edhe ndryshime në strukturën organizative të ANP-së (KFOS & RIINVEST, 2015).

2.7.3. Procesi i privatizimit të Distribuimit

Privatizimi si formë e re e organizimit dhe funksionimit të NP, të cilen më parë e kishin aplikuar vendet e zhvilluara duke ndjekur modelin britanik të privatizimit, është vlerësuar si proces i cili mund të jap rezultate më të mira, të ngris performancën dhe vlerën e tanishme dhe të zvogëlojë kostot e joefikasitetit të qeverisjes së mëparshme si NP.

Privatizimi i parë pas formimit të ndërmarrjeve publike në Kosovë ka filluar me privatizimin e vetëm pjesës së shpërndarjes së energjisë si njësi organizative brenda NP "Korporata Energjetike e Kosovës",sh.a. e quajtur Distribuimi. Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji, në seancën e mbajtur me datë 01 mars 2013, mbështetur në vendimet e qeverisë për fillimin e procesit të privatizimit të KEK-ut, në dispozita të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr. 03/L-185) ka marrë vendim që të aprovohet transferimi i Licencës së Furnizuesit Publik me Energji Elektrike nga Korporata Energjetike e Kosovës Sh.A – Divizioni i Furnizimit, me numër të regjistrimit ZRRE/Li_07/12 në Kompaninë Kosovare për Distribuim dhe Furnizim me Energji Elektrike (KKDFE) dhe të aprovohet transferimi (tjetërsimi) i asetëve nga KEK SH.A. - Divizioni i furnizimit në KKDFE SH. A.-Divizioni i Furnizimit, si dhe Transferimi i licencës dhe asetëve nga pika I dhe II të dispozitivit të këtij Vendimi do të hyjë në fuqi nga data e nënshkrimit të Marrëveshjes për Transferim mes KEK SH.A dhe KKDFE SH.A që do të bëhet me 03.05.2013 (KFOS & RIINVEST, 2015).

Më 2 tetor 2008 Qeveria e Kosovës mori vendim për privatizimin e distribuimit dhe furnizimit të Korporatës Energjetike të Kosovës (KEK). Gjashtë ditë më vonë qeveria mori vendim për formimin e grupit punues ndërqeveritar i cili do të bartte procesin e privatizimit. Vendimi i qeverisë Nr.03/38 për privatizimin e KEDS, 02.10.2008, Vendimi i qeverisë Nr.08/39 për privatizimin e KEDS, 08.10.2008, ndërsa më 12 dhjetor të të njëjtit vit, ky vendim i qeverisë mori edhe mbështetjen në parim nga Kuvendi i Kosovës.

Projekti i privatizimit të distribuimit dhe furnizimit menaxhohet nga Njësia për Zbatimin e Projektit-NjZP (PIU-Project Implementation Unit), e cila raporton direkt tek grupi punues për privatizim. NjZP është njësi teknike e projektit të privatizimit e cila është e ngarkuar për ekzekutimin, menaxhimin, dhe mbikëqyrjen e zhvillimit të projektit. Për aspektin energjetik kjo njësi këshillohet më tutje nga Deloitte, kompani e kontraktuar nga USAID, dhe për aspektin e transaksionit nga Korporata Ndërkombëtare Financiare (IFC), anëtare e Bankës Botërore (KFOS & RIINVEST, 2015).

Pas përfundimit të afatit për dorëzimin e aplikacioneve për parakualifikim, me datën 6 prill 2011 shpallen katër kompanitë të cilat kishin aplikuar. Këto ishin Calik Holding dhe Limak Holding të regjistruara në Turqi, Elsewedy Electric e regjistruar në Egjipt, dhe Konkorsiumi TAIB – Yildizlar e regjistruar në Turqi dhe Bahrein. Të katër kompanitë e kaluan fazën e para-kualifikimit. Ndërsa pas një afati prej 8 muajsh, gjatë të cilës kompanitë kishin qasje në Dhomën e të Dhënave dhe po përgatitnin ofertat, kompanitë kërkuan nga komiteti për privatizim t'i lejojë të krijojnë konzorciume. Kështu u formuan konzorciumet Limak-Calik dhe Elsewedy. Me datën 9 qershor 2012 konzorciumi Limak-Calik shpallet fitues për

privatizimin e KEDS pasi kishte ofruar shumën më të madhe, 26.3 milion euro. Kjo ofertë ishte 3.5 milion euro më e madhe se sa oferta e konsorciumit Elsewedy (KFOS & RIINVEST, 2015).

Me të shpallur fituesin për privatizim të KEDS fillon faza e fundit e këtij procesi: negociatat e fundit në mes të fituesit dhe Qeverisë së Kosovës, e cila në fund vendos për shpalljen përfundimtare të fituesit apo të kthej procesin serish nga e para. Divizioni i shpërndarjes së rrymës është i organizuar në shtatë distrikte që mbulon tërë territorin e Kosovës, ndërsa distriktet janë të organizuara në bazë regjionale. Divizion i Shpërndarjes është përgjegjës për mirëmbajtjen e stabilimenteve elektro-energjetike nga niveli 110 kV (nga transformatori) e deri tek konsumatori i fundit. Gjithashtu bën planifikimin, zhvillimin, operimin, matjen, leximin dhe llogaritjen e energjisë dhe të humbjeve teknike për të gjithë infrastrukturën e rrjetit të KEK-ut (KFOS & RIINVEST, 2015).

Divizioni i shpërndarjes ka në pronësi 675 km të rrjetit 35 kV. Rrjeti 10(20) kV është në gjatësi prej rreth 445 km, 10 kV në gjatësi prej rreth 5863 km, 6 kV në gjatësi prej rreth 46 km dhe rrjeti 0.4 kV është në gjatësi prej rreth 11.870 km. Ky Divizion ka në pronësi të vet 6.200 trafo stacione të nivelit nga 220 kV (nga transformatori) deri në 10(20)/0.4 kV. Ndërsa mbetet e paqartë nëse objektet e KEK-ut dhe cilat objekte mbeten në pronësi të divizionit të shpërndarjes dhe furnizimit (GAP, 2012).

2.7.4 Procesi i privatizimit të PTK-së.

Komisioni Qeveritar për Privatizimin (KQP) e PTK-së, pasi ka analizuar situatën e krijuar në lidhje me procesin e privatizimit të PTK-së, pas mungesës së kuorumit në Kuvendin e Kosovës, në seancën e datës 26 dhjetor 2013, për të shqyrtuar raportin e procesit të privatizimit të 75% të aksioneve të kësaj ndërmarrje publike ka njoftuar opinionin publik se, në bazë të dokumenteve të tenderit për privatizimin e PTK-së, të cilat kanë përbërë bazën për aplikim të pjesëmarrësve në këtë tender, data 30 dhjetor 2013 ka qenë data e fundit e mundshme për nënshkrim të kësaj kontrate. Në bazë të opinionit ligjor të marrë nga këshilltari i transaksionit, KQP nuk ka bazë ligjore për shtyrje të mëtutjeshme të kësaj date (QPZH & FES, 2015).

Të gjendur në këtë situatë dhe në pamundësi të procedoj me nënshkrim të kontratës për shitje të aksioneve të PTK-së, KQP ka vendosur që me 31.12.2013 ta përmbyll procesin e mëtejshëm të privatizimit të 75% të aksioneve të PTK-së. Edhe këtë proces e kanë përcjellë një kohë të gjatë kundërshtime të shumta nga partitë politike opozitare, organizata joqeveritare, shoqëria civile dhe grupe të interesit. Megjithë përmbylljen e procesit të shitjes-privatizimit të 75% të aksioneve pasukses, nuk kanë përfunduar procedurat e ankimimit të pjesëmarrësve (dy kompani ndërkombëtare M1 International dhe Axos GMBH në konsorcium me Najafi Companies) e cila mund të rezultojnë me ndonjë detyrim kontigjent në të ardhmen si pasojë e procedurave të zhvilluara në të kaluarën e që do të komplikonte edhe më shumë gjithë procesin (QPZH & FES, 2015).

Nga shtetet e krijuara nga shkatërrimi i ish Jugosllavisë, Kroacia ka inicuar një proces konkurrues të vlerësimit fillestar dhe të pavarur të portfolios së 54 shoqërive tregëtare të cilat janë në pronësi të Republikës së Kroacisë para fillimit të procesit të privatizimit. Një hap i tillë i qeverisë kroate ka nxitur përkrahësit e procesit të privatizimit të ndërmarrjeve publike të vlerësojnë këtë iniciativë si gjëja më e mirë që kishte me i ndodhë ekonomisë kroate nëse ky proces do të zhvillohej deri në fund dhe hap i parë dhe i drejtë prej trashëgimisë socialiste nga e cila nuk po mund të largohemi edhe pas njëzetë e pesë viteve nga rënja e perdes së hekurtë (Popov, 2016).

Kurse për guximin e ndërmarrë kryeministri kroat Oreshkoviq është krahasuar me kryeministren e Britanisë së Madhe, baroneshën Margaret Thatcher, e njohur për reformimin e sektorit publik. Duhet theksuar se edhe pse ekonomia kroate është shumë më përpara megjithatë e shohin këtë proces si një hap përpara edhe si fillim të një procesi të mundimshëm i cili do të ballafaqohet me presione për mosndryshime nga ana e atyre të cilët kanë interesa të natyrës ekonomike apo të asaj politike (Popov, 2016).

Prandaj, nuk duhet të na befasojnë vështirësitë dhe kundërshtimet e këtij procesi nga një pjesë e shoqërisë në Kosovë por edhe në vendet tjera si në Serbi dhe Shqipëri të cilët po kundërshtojnë mënyren e privatizimit nga strukturat politike që janë në pushtet. Megjithatë mësimet nga përvojat e privatizimit në Kosovë por edhe në vende tjera mund të shërbejnë në të ardhmen për proceset e privatizimit në vendet tjera.

2.8 Parimet e qeverisjes korporative

Me rastin e 60 vjetorit të Programit të Kombeve të Bashkuara për Administratë Publike, Financa dhe Zhvillim, Departamenti për Çështje Ekonomike dhe Sociale i Kombeve të Bashkuara në publikimin “Kontributi i Kombeve të Bashkuara në ngritjen e administrates publike - 60 Vjet histori” në parathënjën e tij është nënvizuar se *“ky Program që nga fillimi i tij në vitin 1948 në mënyrë konsistente ka promovuar rëndësinë e administrates publike të shëndoshë për zhvillimin politik, ekonomik dhe social të të gjitha kombeve”* (United Nations, 2008:3). Ndryshimi i rolit të shtetit në periudha kohore ka lënë gjurmë në zhvillimin ekonomik dhe social të vendeve. Ky ndryshim gjatë kohës ka evoluar nga aplikimi i teknikave të reja të menaxhimit publik deri te një koncept i gjërë i kuptimit të qeverisjes (United Nations, 2008). Kjo ngritje e rolit të shtetit është ndarë në tri periudha kohore si në vijim:

2.8.1 Fillimi i administrates publike: 1948-1970

Kjo periudhë është koha kur shteti është konsideruar si motor i domosdoshëm i zhvillimit ekonomik kurse një administrate efektive ka implementuar në mënyrë të suksesshme planet dhe programet zhvillimore të shtetit. Sidomos pas vitit 1950 shumë shtete ishin bërë të pavarura nga kolonializmi i atëhershëm dhe u orientuan për sistemin socialist të qeverisjes ku shteti shihej si i vetmi mjet për shpërndarjen e përfitimeve nga liria politike dhe ekonomike për popullin e vetë (United Nations, 2008).

Zhvillimi i administrates publike ishte nënkuptuar si synim, pretendim i shtetit në përshejtimin e çështjeve zhvillimore të orientuara në arritjen e rezultateve duke mos përfillur zvogëlimin e shpenzimeve për arritjen e efikasitetit. Për eliminimin e disproporcionit në mes të implementimit të aktiviteteve të planifikuara dhe të arriturave janë aplikuar disa teknika sikurse janë: reforma administrative, programe të trajnimit, sisteme të trajnimit dhe monitorimit dhe programe të vlerësimit të cilat ishin ndërmarrë për zhvillimin dhe ngritjen e kapaciteteve të administrimit publik, zakonisht me ndihmën teknike dhe mbështetjen e donatorëve dhe agjencive ndërkombëtare të zhvillimit. Mbizotëronte ideja se ngritja e kapaciteteve të administrative të aparatit të shtetit mund të jetë forcë shtytëse e zhvillimit në një ekonomi me kornizë të centralizuar të planifikimit dhe politika të zhvillimit industrial (United Nations, 2008).

2.8.2 Periudha prej administrimit publik deri në menaxhimin publik 1970-1990

Viteve të '70-ta të shekullit të kaluar gjithnjë e më shumë po theksoheshin dobësitë e qeverisjes në të cilën shteti shihej si force kryesore e zhvillimit të shoqërisë në çdo pikëpamje. Shteti i cili për njëzetë vite ishte shikuar pozitivisht tani po kritikohet për ndërhyrje në mekanizmat e tregut. Fillimisht kishte nisur në demokracitë e zhvilluara industriale në të cilat sistemi i administrimit publik kishte filluar të ballafaqohet me joefikasitetin e një sektori publik tani më shumë të zgjeruar (United Nations, 2008).

Gjithnjë e më shumë po futeshin në përdorim parimet dhe praktikrat e sektorit privat dhe të korporatave. Po favorizoheshin politikat e privatizimit, derregullimit, decentralizimit dhe

debyokratizimit ndërsa disa nga demokracitë e zhvilluara perëndimore në vitet e '80-ta kishin filluar reduktimet sistematike të administrates publike e cila më vonë ju shërbeu vendeve tjera në zhvillim si pjesë e programeve të tyre të rregullimeve strukturale. Pra, administrimi publik po riorientohej nëpërmjet ngritjes së qasjes së drejtimit dhe rritjes së bashkëpunimit me sektorin privat (United Nations, 2008).

2.8.3 Periudha prej drejtimit (menaxhimit) publik deri në qeverisje 1990-2008

Shteti i vlerësuar dikur si forcë e vetme e zhvillimit ekonomik dhe shoqëror, në fund të viteve të '80-ta kishte filluar të shihej si një pengesë për zhvillimin e shoqërisë. Pra, ishte koha e zhvillimeve të hovshme demokratike në shumë vende kur joefikasiteti i sektorit publik, krizat fiskale dhe futja e masave të ndryshme të rregullimit struktural po impononte nevojën e aplikimit të mekanizmave të tregut të cilët po vlerësoheshin si vegël e vetme për zgjidhjen e problemeve të zhvillimit. Në përgjithësi është pranuar qasja se roli i shtetit në zhvillimin ekonomik dhe shoqëror duhet të redukohet dhe qeveria duhet të veprojë sipas mekanizmave të tregut sa herë që kjo është e mundshme (United Nations, 2008).

Mirëpo qeverisja korporative është zhvilluar shumë më përpara në vendet tjera por debatet në mes të ekonomistëve dhe ekspertëve financiar pas skandaleve financiare të viteve tridhjeta nga shekulli i kaluar gjeneruan qeverisjen korporative si një formë të re të qeverisjes e cila për herë të parë kishte ndarë funksionin e pronsisë nga funksioni i qeverisjes pasi që vlerësohej se një prej shkaktarëve të skandaleve financiare të asaj kohe ishte kryerja e këtyre dy funksioneve nga i njëjti person.

Në vitin 1999 OECD duke reaguar në kërkesat e aksionarëve dhe investitorëve ka publikuar Parimet e Qeverisjes Korporative, një grumbull rregullash vullnetare për kompanitë aksionare private të listuara në bursë por që mund të shërbej edhe për ndërmarrje publike. Mbi bazën e këtyre Parimeve janë ndërtuar dhe më vonë janë zgjeruar parimet e qeverisjes korporative nga organizata si Rrjeti Ndërkombëtar për Qeverisje Korporative (The International Corporate Governance Network), Shoqata Evropiane e Tregëtarve të Letrave me Vlerë (The European Association of Securities Dealers) dhe Grupi i Aksionarëve Evropian (European Shareholders Group) (OECD, 2015).

Parimet e qeverisjes korporative të OECD, për herë të parë janë aprovuar në vitin 1999, fillimisht nga 30 shtete anëtare të kësaj organizate. Ato kanë arritur të bëhen mjet referimi për ekonomitë e vendeve nga gjithë bota. Duke vazhduar një proces të gjërë të rishikimit dhe duke u mbështetur në përvojat e vendeve që kishin aplikuar deri atëherë qeverisjen korporative këto parime janë korrigjuar në vitin 2004. Parimet e qeverisjes korporative të OECD janë një udhërrëfyes i veçantë për politikëbërësit, rregullatorët, pjesëmarrësit tjerë në ngritjen e kornizës ligjore, institucionale dhe rregullatore e cila e mbështet qeverisjen korporative (Jesover & Kirkpatrick, 2015).

Në Takimin e Ministrave të Financave dhe të Guvernatorëve të Bankave Qendrore të G20, të mbajtur në Ankara, më 4-5 Shtator 2015 janë prezentuar si Parimet e Qeverisjes Korporative të G20/OECD. Parimet e prezentuara nga ky takim do të përcjellen për miratim në Samitin e Liderëve të G20 vendeve me ekonomi më të zhvilluar. Në këto Parime të

korrigjuara janë përfshirë shumë nga rekomandimet e dhëna në verzionet e mëhershme si një vazhdimësi e rëndësishme në krijimin e një kornize efektive të qeverisjes korporative. Parimet ofrojnë udhëzime përmes rekomandimeve dhe shënimeve përgjatë secilit nga gjashtë parimet (OECD, 2015).

Tek Parimit i I-rë “Sigurimi i bazës për një kornizë të qeverisjes korporative efektive” theksi i ri është vendosur në cilësinë e mbikëqyrjes dhe zbatimit. Kapitullit i është shtuar një parim i ri mbi rolin e tregjeve të aksioneve në mbështetjen e qeverisjes së mirë korporative (Jesover & Kirkpatrick, 2015).

Te parimi i II-të “Të drejtat dhe trajtim të barabartë të të gjithë aksionarëve dhe funksionet kyçe të pronësisë” çështje të reja në këtë kapitull përfshijnë përdorimin e teknologjisë së informacionit në takimet e aksionerëve, procedurat për aprovimin e transaksioneve me palët e lidhura dhe pjesëmarrja aksionerëve në vendimet për shpërblimin e ekzekutivit (Jesover & Kirkpatrick, 2015).

Parimi i III-të “Investitorët institucionalë, tregjet e aksioneve dhe ndërmjetësve të tjerë” ky është një kapitull i ri i cili adreson nevojën për iniciativa të shëndosha ekonomike përmes zinxhirit të investimeve, me një fokus të veçantë në investitorët institucionalë të cilët veprojnë në cilësinë e të besueshmit (kapacitete fiduciare). Ky kapitull gjithashtu thekson nevojën për të shpallur dhe minimizuar konfliktet e interesit që mund të komprometojnë integritetin e këshilltarëve, analistëve, agjentëve, agjencive të vlerësimit dhe të tjerëve të

cilët ofrojnë analiza dhe këshilla të cilat janë të rëndësishme për investitorët (Jesover & Kirkpatrick, 2015).

Te kapitulli i Parimit IV, “Roli i palëve të interesuara (akterëve tjerë) në qeverisjen korporative” mbështet qasjen palëve të interesuara në informata në një kohë dhe baza të rregullta dhe të drejtat e tyre për të marrë dëmshpërblim për shkelje të të drejtave të tyre (Jesover & Kirkpatrick, 2015).

Në kapitullin e Parimit të V “Shpalosja (bërja publike) dhe transparencë”, janë risi njohja e tendencave të fundit në lidhje me zërat e informacionit jo-financiar që kompanitë në baza vullnetare mund përfshijnë, për shembull në raportet e tyre të menaxhimit (Jesover & Kirkpatrick, 2015).

Dhe në kapitullin e Parimit të VI “Përgjegjësitë e bordeve”, janë përfshirë çështje të reja që përcaktojnë rolin e bordit të drejtorëve në menaxhimin e rrezikut, planifikimin e taksave dhe auditimit të brendshëm. Gjithashtu është edhe një parim i ri i cili rekomandon trajnimin, vlerësimin e bordit të drejtorëve dhe rekomandimi që të merret në konsideratë themelimi i komiteteve të specializuara të bordit në fusha të tilla sikurse janë shpërblimet, auditimi dhe menaxhimi i rrezikut (Jesover & Kirkpatrick, 2015).

Njeriu si qenje shoqërore ka nevojë për energji elektrike, ujë, transport, edukim, strehim, shërbime postare dhe telekomunikim, etj. Disa nga këto shërbime publike edhe individualisht mund të i plotësoj për nevojat e tij. Por kur këto kërkesa duhet të plotësohen

për një shoqëri dhe janë të përmasave të përbashkëta atëherë nevojitet një organizim më i veçantë. Këtë organizim me zhvillimin e shoqërisë njerëzore e ka marrë shteti i cili për të kryer këtë funksion ka themeluar ndërmarrje publike.

Historiku i zhvillimit të ndërmarrjeve publike është i lidhur ngushtë me zhvillimin e shteteve. Ne kemi analizuar disa nga ndërmarrjet publike qendrore dhe dy të ujësjesve regjional për vitin 2010, 2011, 2012, 2103 dhe 2014 me qëllim të verifikimit të implementimit të disa prej kërkesave të qeverisjes korporative, që mund të shihen nga tabela në vijim:

Tabela Nr. 1 - Implementimi i kërkesave të qeverisjes korporative.

Ndërmarrjet Publike	Bordi i drejtorëve	Komisioni i auditimit	Komisionet tjera	Kodi i etikës	Auditimi i jashtëm	Auditimi i brendshëm	Web faqe
PTK	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO
ANP	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO
KOSTT	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO
Hekurudhat e Kosovës	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO
KMDK	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO
Ibër-Lepenci	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO
KRU Prishtina	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO
KRU Mitrovica	PO	PO	PO	PO	PO	PO	PO

Burimi: Autori (2015)

Pra, siç mund të shihet nga tabela e mësipërme te këto NP janë formuar bordet e drejtorëve, komisionet e auditimit, ka pasur edhe komisione tjera të veçanta, kanë miratuar kodin e etikës dhe qeverisjes korporative, auditimi i brendshëm ka funksionuar, kanë kryer

auditimin e jashtëm të pasqyrave financiare dhe kanë krijuar web faqe zyrtare të tyre. Aty kanë publikuar informata për ndërmarrjen si statutin e ndërmarrjes, ligjet që rregullojnë veprimtarinë e tyre, historiku i ndërmarrjes, dokumente, skema organizative, shpallje ose publikime, në tri gjuhë shqip, anglisht dhe serbisht me qëllim të implementimit të parimit të transparencës por edhe të plotësojnë kërkesat nga NJPPM të NP-ve.

Qeverisja korporative si formë e qeverisjes në këto ndërmarrje nuk është aplikuar më heret. Në sektorin publik në Kosovë, qeverisja korporative ka filluar të implementohet praktikisht pas aprovimit të Ligjit për ndërmarrjet publike në Kosovë (Ligji Nr.03/L-087). Prandaj vështirësitë që dalin gjatë qeverisjes janë për shkak të papërvojës së anëtarëve të bordeve të drejtorëve, zyrtarëve tjerë të lartë dhe menaxhmentit në qeverisjen korporative. Mënyra e përzgjedhjes për anëtarë të bordeve e kritikuar për mungesë transparence dhe implikim të politikës, ka ndikuar që mos të përfillen kriteret e përgatitjes profesionale dhe të aftësisë personale prandaj edhe suksesi i tyre në qeverisjen korporative ka qenë i kufizuar (Rinvest & CIPE, 2012).

2.9 Mungesa e përvojës në qeverisjen korporative

Shumë nga këto ndërmarrje në periudha paraprake deri në procesin e korporatizimit të tyre kanë kaluar nëpër forma të qeverisjes të ndryshme nga qeverisja korporative. Në secilen fazë të zhvillimit të ndërmarrjeve forma e qeverisjes ka diktuar edhe nivelin e pavarësisë në vendimmarrje dhe një nivel tjetër të mbikëqyrjes. Pa dashur me hy në krahasimin e anëve të mira dhe të këqija të qeverisjes së mëparshme, që nga viti 2008 qeverisja korporative me

bordin e drejtorëve si organ më i lartë vendimmarrës ka qenë diçka e re dhe për herë të parë e aplikuar në qeverisjen e ndërmarrjeve publike në Kosovë, por edhe nga anëtarët e bordeve të drejtorëve, zyrtarët e lartë dhe të punësuarit (Rinvest & CIPE, 2012).

Kjo formë e qeverisjes kërkon që anëtarët e bordeve të drejtorëve të janë njerëz me përvojë në kontabilitet dhe financa si dhe të plotësojnë kërkesat etike sipas standardeve të kodit të etikës. Mungesa e përvojës sidomos nga kontabiliteti dhe financat ka ndikuar që anëtarët e bordeve të kanë vështirësi në kuptimin e pozicioneve nga pasqyrat financiare pastaj të raporteve të ndryshme operative dhe menaxheriale mbi bazën e të cilave ato do të sjellin vendime të rëndësishme apo aprovime të planeve vjetore, strategjike, etj. Kjo gjithësi paraqet pengesë në zbulimin e hershëm të treguesve pozitiv apo negativ të rrjedhës së aktivitetit dhe rrjedhimisht kufizim në vendimmarrje (Rinvest & CIPE, 2012).

2.10 Përmbledhje e kapitullit

Në këtë kapitull kemi prezentuar një historik të zhvillimit të NP-ve që nga themelimi i tyre si organizata punuese në kushtet socialiste të prodhimit deri në formimin e tyre si NP dhe disa ndryshime të cilat kanë ndodhur edhe pas funksionimit si NP. Gjithashtu janë trajtuar disa karakteristika të përbashkëta dhe të veçanta të tyre, korniza ligjore e veprimit të tyre, organet vendimmarrëse, organizimi dhe funksionimi i tyre sipas Ligjit për ndërmarrjet publike në Kosovë dhe mbikëqyrja nga Njësia për Politika dhe Monitorim të NP-ve.

Gjithashtu, janë trajtuar proceset e privatizimit dhe dhënjes me koncesion të disa ndërmarrjeve publike pastaj të ndarjes së ndërmarrjeve. Po ashtu është trajtuar aplikimi i parimeve të qeverisjes korporative si formë e qeverisjes e cila në formën e tanishme nuk është aplikuar më parë dhe ndikimet e mungesës së përvojes në qeverisjen korporative si formë më e avancuar deri më sot e qeverisjes.

KAPITULLI III: SFIDAT FINANCIARE TË NDËRMARRJEVE PUBLIKE

Në literaturën e kohës së fundit, në përgjithësi mund të gjendet një pajtueshmëri e hulumtuesve nga vendet e ndryshme lidhur me disa nga sfidat me të cilat ballafaqohen ndërmarrjet publike. Megjithatë ndërmarrjet publike në vendet e ndryshme të zhvilluara dhe ato në zhvillim dallojnë për shkak të fushëveprimit të tyre, rrethanave të funksionimit, formës së organizimit, kornizës ligjore, etj. prandaj edhe sfidat janë të ndryshme.

Edhe në mes të ndërmarrjeve publike të të njejtit vend sfidat financiare janë të ndryshme. Për shembull, në Kosovë PTK-ja ballafaqohet me sfida të konkurrencës jolojale për shkak të operatorëve ilegal në fushën e telekomunikimit kurse nuk ballafaqohet me nivelin e ulët të arkëtimit të të hyrave sikurse ballafaqohen disa nga ndërmarrjet publike të cilat kanë veprimtari furnizimin me energji, furnizimin me ujë, etj. Ose p.sh. ujësjellësitë regional nuk ballafaqohen me konkurrencën jolojale por ballafaqohen me nivel të ulët të arkëtimit të të hyrave apo edhe me humbje teknike për shkak të rrjetit të vjetëruar të ujësjellësve, etj.

Disa nga sfidat që do të i përmendim në vijim janë karakteristike për ndërmarrjet publike në Kosovë.

3.1 Niveli i ultë i arkëtimit të të hyrave

Një nga sfidat më të vështira të disa ndërmarrjeve publike, por sidomos të atyre ndërmarrjeve të cilat kryejnë shërbime publike të furnizimit me rrymë, ujë dhe mbledhjes dhe deponimit të mbeturinave ka qenë dhe po vazhdon edhe më tutje të jetë niveli i ulët i arkëtimit të të hyrave në krahasim me faturimin që bëjnë për kryerjen e shërbimeve.

Përqindja e nivelit të arkëtimit ndryshon në mes të veprimtarive të përmendura më lartë. Po ashtu kjo përqindje ndryshon edhe për shfrytëzuesit nga sektori individual që janë popullësia dhe për sektorin publik –shkollat, organizatat e ndryshme, bizneset, komunat, spitalet, gjykatat, etj. Sipas të dhënave nga raportet vjetore të këtyre ndërmarrjeve publike, shkalla e arkëtimit nga shkalla e faturimit të energjisë për shitje e cila në KEK ka qenë: vitin 2011, faturimi 82% - arkëtimi 91.1%, 2012 faturimi 82.1% - arkëtimi 91 % kurse në vitin 2013 faturimi 79% - arkëtimi 89% - të dhënat janë vetëm për katër muaj pasi ka ndodhur privatizimi dhe faturimi dhe arkëtimi i energjisë ka mbetur te ndërmarrja e re KESCO (KKDEF) (KEK, 2015).

Te Kompania Rajonale e Ujësjetësimit “Prishtina” shkallët e arkëtimit kanë qenë: vitin 2011-70%, 2012-73%, 2013-74.87% dhe në vitin 2014-79.34% (KUR, 2015), te Kompania

Rajonale e Ujësjesit “Mitrovica” shkallët e arkëtimit kanë qenë: vitin 2011-57%, 2012-53%, 2013-48% dhe në vitin 2014-48% (KRU Mitrovica, 2015).

Kurse në Kompaninë Regjionale të Mbeturinave “Uniteti” niveli i arkëtimit ka qenë: 2011-61%, 2012-62% dhe 2013-64% dhe në vitin 2014 ka mbetur në nivel të njëjtë me vitin paraprak - 64%. Këto të dhëna janë marrë nga Raportet Vjetore të këtyre ndërmarrjeve për vitet e përmendura më lartë.

Tabela Nr. 2 - Shkallët e arkëtimit të të hyrave në disa sektore dhe ndërmarrje publike.

Sektori	NP	Shkallët e arkëtimit				Trendi
		2011	2012	2013	2014	
Energjisë elektrike	KEK	91.10%	91.00%	89.00%	0.00%*	Negativ
Ujësjesve	KRU "Mitrovicë"	57%	53%	48%	48%	Negativ
Mbeturinave	KRM "Uniteti"	61%	62%	64%	64%	Pa ndryshime
Ujësjesve	KRU "Prishtinë"	70%	73%	74.87%	79.43%	I ndryshueshëm

*Në KEK në vitin 2014 pjesa e distribuimit e cila e ka kryer arkëtimin është privatizuar.

Burimi: Autori (2015)

Duhet theksuar faktin se shkalla e arkëtimit të këto ndërmarrje është llogaritur mbi bazën e faturimit të atij viti, mirëpo faturimi nuk shpreh gjithë sasinë e energjisë elektrike dhe ujit pasi që humbjet nga gjenerimi i energjisë, prodhimi dhe pastrimi i ujit të pijshëm janë ende shumë të larta sidomos të ujit. Këto janë të ashtuquajturat humbje teknike në rrjetin e energjisë, rrjetin e ujësjesve të cilat shkaktohen për shkak të rrjetit të vjetëruar të pajisjeve, humbjeve teknologjike, kyçjeve ilegale në rrjetë, etj.

Me këtë nivel të arkëtimit, ndërmarrjet nuk arrijnë të mbulojnë shpenzimet e nevojshme për zhvillimin e veprimtarisë. Për pasojë ato ballafaqohen me vështirësi në funksionimin e tyre. Këto vështirësi shpesh herë ndikojnë në sasinë por edhe cilësinë e shërbimeve publike të ofruara. Kështu p.sh. ende kemi reduktime të rrymës elektrike, pastaj reduktime në furnizim me ujë, mbledhje dhe largim të mbeturinave sipas orarit të caktuar nga vet ndërmarrja publike. Plotësimi i kësaj mungese i detyron Drejtimin e këtyre ndërmarrjeve të kërkojnë financim shtesë në formë të subvencioneve nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

Ky nivel i ulët i arkëtimeve po shkakton vështirësi financiare të cilat po manifestohen në ushtrimin e veprimtarisë dhe rrjedhimisht në cilësinë e shërbimeve. Ndërmarrjet në pamundësi të arkëtimit të të hyrave po detyrohen të shkurtojnë orarin e ofrimit të shërbimeve për klientët. Kështu p.sh. Korporata Energjetike e Kosovës (KEK) e cila furnizon me energji elektrike ka aplikuar kategorizimin e qytetarëve sipas nivelit të arkëtimit në këto kategori: A+ -klientët të cilët parapaguajnë energjinë elektrike dhe klientët me prioritet (spitalet, policia, posta) furnizohen me rrymë 24 orë pandërprerje, A-kategoria e cila paguan rregullisht sipas afatit dhe nuk ka reduktime, B-kategoria e cila nuk paguajnë rregullisht dhe kanë reduktime të energjisë elektrike sipas orarit 4 orë me rrymë 2 orë pa rrymë gjatë 24 orëve (që kuptohet si 4+2) dhe C-kategoria ku arkëtimet e të hyrave janë rreth 50% të shumës së faturuar por që i nënshtrohet reduktimeve e para dhe më së gjati. Për këtë kategori reduktimet janë sipas orarit 3 orë me rrymë dhe 3 orë pa rrymë gjatë 24 orëve (që kuptohet si 3+3) (KEK, 2014).

Në një anketë të kryer nga Banka Botërore në vitin 2013, një nga pengesat për zhvillimin e veprimtarisë dhe krijimit të kushteve për të bërë biznes pas sektorit joformal (ekonomia e zezë), qasjes në financa dhe korrupsionit është mungesa e energjisë elektrike, deri sa në anketën e njejtë nga viti 2009, mungesa e energjisë ka qenë pengesa më e madhe e deklaruar nga bizneset e anketuara (World Bank & IFC, 2013).

Edhe Kompanitë Rajonale të Ujësjellësve të cilat furnizojnë me ujë aplikojnë forma të reduktimeve të furnizimit me ujë por sipas orareve të selektuara kohore të caktuara sipas ndarjes territoriale, regjionale, etj. Gjithashtu Kompanitë Rajonale të Mbeturinave duke u ballafaquar me vështirësi financiare, pamjaftueshmëri të mjeteve financiare për shkak të nivelit të ulët të arkëtimit kryejnë veprimtarinë e tyre, grumbullojnë dhe deponojnë mbeturinat vetëm njëherë në javë ose vetëm në ditë të caktuara të javës (në regjionin e Mitrovicës) pamarrë parasysh se çfarë janë kërkesat (World Bank & IFC, 2013).

Një problem që ndikon në një pjesë të arkëtimit të të hyrave paraqet kategoria e ashtuquajtur e ndihmës sociale. Një pjesë e popullësisë e cila sipas kriterëve të përcaktuara është e ranguar në kategorinë e cila ndihmohet nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës nëpërmes Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale nuk ka mundësi të paguaj shërbimet publike të cilat i shfrytëzon. Ndërmarrjet publike ofruar të shërbimeve faturojnë për të gjitha shërbimet e kryera. Arkëtimi i këtyre të hyrave nuk arrin të realizohet. Kështu në pasqyrat financiare të ndërmarrjeve publike mund të shihet dallimi në mes të faturimit dhe arkëtimit gjegjësisht kërkesa nga llogaritë e arkëtueshme. Për pasojë ky nivel i arkëtimit ka ndikim edhe në rrjedhën e parasë dhe realisht ndërmarrjet do të arkëtojnë më pak të hyra

dhe nuk do të mund të realizojnë objektivat e tyre të planifikuara me planin e biznesit dhe buxhetin e tyre.

Arkëtimi i të hyrave më pak se sa janë faturuar i detyron ndërmarrjet publike që të drejtohen tek Ministria Zhvillimit Ekonomik dhe Ministria e Ekonomisë dhe Financave për subvencionimin e ndërmarrjeve publike për pjesën e të hyrave të paarkëtuara ose mbulimit të shpenzimeve të krijuara. Të gjitha këto veprime kërkojnë zbatimin e disa procedurave byrokratike të cilat zgjasin shpesh deri në përmbylljen vjetore të buxhetit në nivelin qendror nëse mbeten mjete financiare nga burimet të cilat nuk janë shfrytëzuar deri në mbylljen e vitit buxhetor.

Niveli i ulët i arkëtitimit të të hyrave është i ndikuar edhe nga mosarkëtimi i të hyrave nga pjesët e vendit në të cilën jetojnë komuniteti joshumicë i cili për shkaqe politike ka refuzuar të bëjë pagesën e shërbimeve publike. Kjo situatë vazhdon ende në disa pjesë të vendit. Duhet kuptuar se si në rastin e kategorive sociale ashtu edhe të komuniteteve joshumicë është fjala për shërbime publike të furnizimit me energji elektrike, të furnizimit me ujë të cilat nuk mund të ofrohen individualisht pra nuk mund të ofrohen në mënyrë selektive dhe cilido kufizim bie ndesh me parimet e Deklarates Universale për të Drejtat e Njeriut, neni 21 pika 2 ku thuhet se “secili ka të drejtë për qasje të barabartë në shërbime publike në shtetin e tij” (United Nations, 2015: 44).

Selektimi i shfrytëzuesve të shërbimeve publike (rangimi i qytetarëve) në kategori A+, A, B dhe C, sikur se ka vepruar fillimisht KEK-u e që aktualisht ende përdoret nga Kompania

Kosovare për Distribuim dhe Furnizim të Energjisë (KKDFE) dhe që nga janari i vitit 2015 KESCO-Kompania Kosovare për Furnizim me Energji Elektrike ka ndikuar negativisht në arkëtimin e të hyrave nga furnizimi me energji elektrike.

Ky kategorizim ka demotivuar një pjesë të qytetarëve të përgjegjshëm pasi që edhe pse kanë paguar rregullisht obligimet e veta për shfrytëzimin e shërbimeve publike ata janë ndëshkuar padrejtësishtë me aplikimin e reduktimeve të njëjta sikurse për qytetarët të cilët nuk kanë paguar rregullisht apo nuk kanë paguar fare për shërbimet publike të shfrytëzuara. Pamundësia e selektimit, për shkak të mënyres së funksionimit dhe shpërndarjes së energjisë në rrjet, të përfshirjes masive të atyre që paguajnë rregullisht dhe atyre që nuk paguajnë ka dëmtuar ata që paguajnë të cilët i ka dekurajuar të vazhdojnë të paguajnë pasi u janë ekspozuar reduktimeve njëjtë, por ka ndikuar negativisht që arkëtimi i të hyrave nga furnizimi me energji elektrike të jetë në nivel të ulët.

Niveli i ulët i arkëtimin të të hyrave nga energjia elektrike përveç që ka ndikuar në furnizimin e rregulltë ka ndikuar edhe në kufizimin e importimit të energjisë nga vendet tjera në rastet kur kjo ka qenë zgjidhja e vetme, në rastet e jashtëzakonshme, të defekteve të mëdha të rënjes së blloqeve të termocentraleve nga sistemi i gjenerimit, kur rikyçja në sistemin e gjenerimit të energjisë ka zgjat një, dy ose tri ditë ose edhe në rastet kur prodhimi vendor nuk i ka plotësuar kërkesat në nivel të vendit dhe importimi i energjisë ka qenë zgjidhja e vetme. Mirëpo çmimi i energjisë së importuar gjithnjë ka qenë më i lartë se sa kostoja e prodhimit vendor dhe kjo ka sjellë Korporaten Energjetike të Kosovës (KEK) në vështirësi shtesë për pagesen e energjisë së importuar.

Janë të shpalosura nga ana e Korporates disa raste kur për pagesen e energjisë së importuar është kërkuar ndihma e Qeverisë e cila ka subvencionuar importimin e energjisë. Natyrisht se nuk kanë munguar përpjekjet nga ana e Drejtimit të Korporatës që për shfytëzuesit e energjisë të cilët kanë ngelur mbrapa me pagesë ose të cilët në një periudhë kohore kanë pasur vështirësi të paguajnë për energjinë elektrike të shpenzuar, të gjendet ndonjë zgjidhje e cila do të ju mundësonte klientëve që të paguajnë me këste borxhin e krijuar sipas një skeme të riprogramimit të borxhit por edhe të paguajnë obligimet vijuese për energjinë e shpenzuar. Edhe pse si një iniciativë për gjetjen e një zgjidhjeje është përkrahur mund të konstatojmë se rezultatet kanë qenë modeste sepse te një pjesë e madhe e shfrytëzuesve shumat e borxhit të papaguar ndaj Korporates tani më kishin arritur vlera financiare të papërbalueshme për buxhetet e tyre familjare dhe gjendja ekonomike e ekonomive familjare nuk po shënonte ndonjë rritje të konsiderueshme e cila premtonte përmirësim të gjendjes aktuale.

Një nga masat të cilësuar si jo të popullarizuara dhe e cila është përdorë kur nuk ka pasur zgjidhje tjetër ka qenë shkyçja e konsumatorëve nga rrjeti me ndërprerjen e furnizimit të energjisë. Ky veprim ka pasur për qëllim të ndikojë në eliminimin e shfrytëzuesve ilegal të energjisë dhe detyrimin e tyre që të paguajnë për shpenzimin e deritanishëm.

Veprimi shumë i ngadalshëm apo mosveprimi i gjykatave ka kontribuar në nivelin e ulët të arkëtimit të të hyrave pasi që procedurat e ngadalësuar dhe byrokratike nuk kanë dhënë efektin e pritur nga rastet e dërguara në gjykata. Kjo situatë e sistemit gjyqësorë, me numër

të madh të lëndëve të pazgjidhura, me kohëzgjatje të gjatë nga pranimi deri te vendimi i gjykatës, ka shkuar në favor të atyre që nuk kanë paguar obligimet e tyre për shërbimet publike të shfrytëzuara, pra nuk e ka ndihmuar rritjen e nivelit të arkëtimit të të hyrave.

Me vendosjen e sistemit të përmbartimit në gjyqësi (Ligjit për procedurën përmbartimore Nr. 04/L-139- të përmbartuesve privat) vlerësojmë se ka ndikuar pozitivisht në shpejtësinë e përmbartimit të kontesteve gjyqësore edhe pse nuk kemi analiza të detajuara. Në tabelën në vijim janë pasqyruar shkallët e arkëtimit të të hyrave të dy kompanive më të mëdha rajonale të ujësjellësitë për periudhën që përfshinë vitet 2011-2015.

Tabela Nr. 3 - Shkalla e arkëtimit për periudhën 2011-2015.

Ujësjellësve					
	2011	2012	2013	2014	2015
KRU "Mitrovica"	57%	53%	48%	48%	56%
KRU "Prishtina"	70%	73%	75%	80%	73%
Mesatarja	63.50%	63.00%	61.50%	64.00%	64.50%

Burimi: Autori (2016)

3.2 Niveli i lartë i shpenzimeve (pagat dhe të punësuarit)

Po të analizohen me kujdes pasqyrat financiare të ndërmarrjeve publike, karakteristikë e përbashkët e gati të gjitha ndërmarrjeve publike është rritja e nivelit të shpenzimeve në krahasim me vitin paraprak. Pra, pamarrë parasysh se niveli i të hyrave nuk ka pasur ndonjë rritje domethënëse në anën tjetër është rritur niveli i shpenzimeve. Pozicioni i pagave është një nga pozicionet i cili dallohet me nivelin më të lartë të pjesëmarrjes në shpenzimet e

përgjithshme. Në disa ndërmarrje publike të veprimtarisë shërbyese ky nivel i shpenzimeve për paga arrin deri në 70% të shpenzimeve të përgjithshme.

Kështu prej vitit në vitin tjetër shpenzimet për paga janë rritur, në ndonjë ndërmarrje publike bashkë me numrin e të punësuarëve e në ndonjë ndërmarrje edhe pa rritje të konsiderueshme të të punësuarëve. Kjo rritje e këtyre shpenzimeve është pjesërisht e lidhur me rritjen e numrit të punësuarëve por edhe me rritjen e nivelit të pagave të të punësuarëve. Kjo rritje e shpenzimeve për paga përveç efektit në rezultatin operativ para zhvlerësimit, ka ndikuar në sasinë dhe nivelin e mjeteve financiare të cilat janë të nevojshme për pagesën e obligimeve që rrjedhin nga aktiviteti dhe për financimin e investimeve kapitale nga burimet e veta.

Kosova po ballafaqohet me një nivel të papunësisë i cili ndryshon varësisht se kush e publikon dhe për çfarë qëllimi. Ne këtu po ju referohemi të dhënave të publikuara sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës, sipas të cilës shkalla e papunësisë për vitin 2014 është 35.3%, kurse shkalla e papunësisë tek të rinjtë (prej 15-24 vjeç) është 61.0%, në vitin 2015 shkalla e papunësisë është më e vogël 32.9%, kurse shkalla e papunësisë tek të rinjtë (prej 15-24 vjeç) është 57.7%. Ky fakt tregon se duke marrë parasysh se moshën mesatare e popullatës është e re atëherë është normale që kjo përqindje të jetë më e lartë pasi që numri i të rinjve që kërkojnë punë është më i madh (grupmosha 15-19 vjet-174,932 persona, është grupmosha e dytë për kohë madhësia pas grupmoshës 10-14 vjet-176,926) (World Bank, 2015).

Duke u ballafaquar me presionin e një niveli të lartë të papunësisë në Kosovë e cila në vitin 2014 ka qenë në shkallën prej 35.3%, në vitin 2015 shkalla e papunësisë është më e vogël 32.9%, sipas Agjencisë së Statistikave të Kosovës dhe ka qenë më e larta në vendet e Ballkanit Perëndimor, Bordet e Drejtorëve dhe Drejtimet e ndërmarrjeve publike, te rritja e numrit të të punësuarëve nuk kanë qenë konsistent në zbatimin e planeve të biznesit të cilat vet i kanë miratuar. Planet e biznesit janë dokumente të krijuara nga Drejtimi i ndërmarrjeve por të aprovuara nga Bordet e drejtorëve si dokumente orientuese zhvillimore (World Bank, 2015).

Fatkeqësisht dukuritë si përkatësia politike, nepotizmi dhe lidhjet familjare kanë ndikuar në rritjen e paplanifikuar të numrit të të punësuarëve deri në mbipunësim dhe rrjedhimisht të rritjes së shpenzimeve për paga. *“Për arsye se Bordi është punëdhënësi im, nuk kam fuqi t’i ndaloj presionet nga ana e tyre për punësimet politike”*, kjo parathënjë e Institutit për Studime të Avancuara-“GAP” të një studimi “Menaxhimi i Ndërmarrjeve Publike” tregon shumë për situatën aktuale të punësimit në ndërmarrjet publike në Kosovë dhe të njejtën kohë alarmon për ndryshime të domosdoshme që të evitohen dhe shmangen ndikimet e Bordit të Drejtorëve në Kryeshefin Ekzekutiv (Drejtorin Menaxhues) (GAP, 2015: 4).

Ka pasur opinione që disa anëtarë të Bordeve të Drejtorëve të caktohen nga bota akademike për të ndikuar në përmirësimin e ruajtjes së pavarësisë së Kryeshefit Ekzekutiv dhe Zyrtarëve të NP por kjo ka mbetur vetëm në nivelin e një ideje në letër. Një propozim tjetër i cili diskutohet në mesin e studiuesve dhe hulumtuesve të çështjeve të ndikimeve në Kryeshefin Ekzekutiv është edhe angazhimi i burimeve nga jashtë ose të kompanive të

specializuara në përzgjedhje të Bordeve dhe Kryeshefit Ekzekutiv por për këtë nevojitet të ndryshohet ligji aktual - Ligji për Ndërmarrjet Publike gjë që në një periudhë kohore nuk është e mundur por aktualisht as që ka ndonjë iniciativë as nga shoqëria civile e as nga vendimmarrësitë në nivele të ndryshme politike.

Në vijim ne do të japim disa shembuj të disa ndërmarrjeve publike me veprimtari të ndryshme ku do të mund të vërehet rritja e nivelit të shpenzimeve për paga dhe numri i të punësuarve dhe krahasimi për disa vite:

Tabela Nr. 4 - Niveli i shpenzimeve për paga dhe numri i të punësuarve në KEK.

NP KEK, sh.a.		në (000 Euro)			
Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Shpenzime për paga	51,434 €	56,612 €	57,115 €	44,989 €*	47,127 €
Nr. i të punësuarve	7749	7713	7454	4846	4794

*Zvogëlimi i nr të punëtorëve në vitin 2013 është për shkak të privatizimit të Distribuimit.

Burimi: Autori (2015).

Tabela Nr. 5 - Niveli i shpenzimeve për paga dhe numri i të punësuarve në NP Infracos.

NP Infracos, sh.a.		në (000 Euro)		
Viti	2011	2012	2013	2014
Shpenzime për paga	587	1,691	1,689	1,992
Nr. i të punësuarve	289	296	305	333

Burimi: Autori (2015)

Pra, siç mund të vërehet kemi rritje të vazhdueshme nga viti në vit të shpenzimeve për paga dhe të numrit të punësuarve.

Tabela Nr. 6 - Niveli i shpenzimeve për paga dhe numri i të punësuarve në NP Trainkos.

NP Trainkos, sh.a.		në (000 Euro)			
Viti	2011	2012	2013	2014	
Shpenzime për paga	419	1,382	1,504	1,569	
Nr. i të punësuarve	194	221	220	224	

Burimi: Autori (2015)

Në tabelën në vijim kemi një shembull kur shpenzimet për paga rriten por jo edhe numri i të punësuarëve:

Tabela Nr. 7 - Niveli i shpenzimeve për paga dhe numri i të punësuarve në KRU Mitrovica.

KRU "Mitrovica", sh.a.		në (000 Euro)			
Viti	2011	2012	2013	2014	
Shpenzime për paga	1,030	1,127	1,124	1,207	
Nr. i të punësuarve	229	226	225	222	

Burimi: Autori (2015)

Shpenzimet e larta për paga në shumicën e ndërmarrjeve publike paraqesin barrë për efikasitetin e tyre dhe zvogëlojnë bazën për zhvillim dhe investime kapitale të cilat janë shumë të nevojshme. Prandaj, sot vendimmarrësitë dhe politikëbërësit gjenden në kryqëzim të parimeve ekonomike dhe të situatave të presioneve për punësim më të madh të cilat shpesh herë marrin ngjyrimë sociale me qëllim të prezentimit të gjendjes më të rëndë se sa

ajo që në realitet është. Për përmirësimin e kësaj situatë janë ballafaquar edhe vendet tjera në Ballkan. Rast tipik është ai i Greqisë që beri përpjekje për zvogëlimin e të punësuarve në NP nëpërmjet pensionimit të hershëm (Mylonas & Joumard, 1999). Për shkak të numrit të madh të të punësuarëve në sektorin publik, edhe vendet si Serbia që nga viti 2013 kanë ndaluar me ligj punësimet e reja në sektorin publik deri në fund të vitit 2015.

Në një publikim nga Departamenti i Ekonomisë i OECD për ndërmarrjet publike greke-sfidat për reformë nënvizon se sektori i ndërmarrjeve publike në Greqi është i përbërë prej afër 50 ndërmarrjeve të cilat punësojnë rreth 130,000.00 të punësuar. Ky sektor është i dominuar nga 10 ndërmarrje të cilat përfshijnë ndërmarrjet më të mëdha në Greqi me karakteristika monopoliste të cilat ofrojnë shërbime shumë të rëndësishme për ekonominë sikur që janë telekomi, energjia (elektrike, minierat e linjtit, nafta dhe gazi natyror), dhe transporti (hekurudhor, ajror dhe transporti urban) (Mylonas & Joumard, 1999).

Për të përgaditur ndërmarrjet publike greke, për ballafaqimin me sfidat të cilat i ofron mjedisi konkurrues në nivel të vendeve të BE-së, qeveria kishte vendosur se ato do të duhej të ngrisin kualitetin e shërbimeve, produktivitetin e tyre dhe të nxisin pjesëmarrjen private në financimin e zhvillimit të tyre. Jashtë këtij grupi të ndërmarrjeve publike kanë mbetur disa kompani të rëndësishme industriale të cilat janë kontrolluar nga shteti si ato të ndërtimit, minierat, fabrikat e tekstitit dhe së fundi ato të çimentos. Këto kompani kontrolloheshin nga Organizata për Ristrukturim Industrial - një grup publik holding për kompanitë joprofitabile ose janë kontrolluar nga bankat shtetërore (Mylonas & Joumard, 1999).

Pra sipas shembujve më lartë, në këto vende mbipunësimi në periudha të mëhershme për shkak të ndikimit të tij në efikasitetin e tanishëm të shërbimeve publike është tentuar të rregullohet përmes kufizimit të rritjes së punësimin. Një dukuri tjetër përveç rritjes së numrit të punësuarëve e cila është vërejtur te disa ndërmarrje publike është rritja e pagave për të punësuarit. Kjo rritje e pagave është madje e planifikuar dhe e parashikuar me planin e biznesit i cili aprovohet nga Bordi i Drejtorëve dhe i dërgohet edhe Njësisë për Politika dhe Monitorim të NP-ve. Kjo rritje e mbështetur edhe nga organizatat sindikale arësyetohet me ngritjen e nivelit të çmimeve të konsumit dhe me një shkallë të inflacionit.

Kështu sipas publikimit aktual të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Indikatori i Çmimeve të Konsumit (IÇK) për tremujorin e dytë (TM2) të vitit 2015 në krahasim me periudhen e njëjtë nga viti 2014 ka qenë -0.4% që tregon për një rënje të çmimeve të konsumit në këtë periudhë (MZhE, 2015). Për cilin do sistem të të hyrave paraprakisht nevojitet të krijohen disa shpenzime. Se në çfarë mase të hyrat e krijuara arësyetojnë shpenzimet është çështje debati jo vetëm nga ekonomistët dhe perfaqësues të ndërmarrjeve dhe që mvaret nga shumë faktorë. Pra, një nivel i pranueshëm i shpenzimeve në mënyrë indirekte përcakton fitim bruto, normën e fitimit apo të realizimit të të hyrave më shumë se sa shpenzimet. Zvogëlimi i nivelit të shpenzimeve operative paraqet sfida për secilin Drejtim të ndërmarrjes. Në disa raste mund të jetë si synim i një optimumi i cili siguron funksionim të rregulltë në ushtrimin e veprimtarisë.

Ndërmarrjet publike në planin e biznesit që përgatitin për vitin e ardhshëm, planifikojnë një nivel të shpenzimeve sipas llojit të shpenzimeve, zërave dhe vendeve të shpenzimeve, varësisht se për cilin nivel menaxherial ju duhen informatat për shpenzime. Me këtë plan NP, BD si organ vendimmarrës shpreh qëllimin e NP për një periudhë kohore, një vit në arritjen e objektivave të cilat pashmangshëm kërkojnë edhe nivelin e caktuar të shpenzimeve.

Prandaj edhe rëndësia e shpenzimeve operative qëndron në ndikimin që kanë në përcaktimin e treguesve tjerë të varur nga niveli i tyre. Secili Drejtim financiar tenton që të gjejë mënyra se si të zvogëlojë nivelin e tyre. Por sa arrihet ajo praktikisht na tregon se po thuaj nuk kemi raste të zvogelimit të tyre. Varësisht nga veprimtaria që kryhet prodhim apo shërbime dallojnë edhe trajtimet. Në veprimtari shërbuese i trajtojnë si shpenzime ditore të cilat ndodhin përgjatë shitjes, administrimit, hulumtimit dhe zhvillimit sikur që në veprimtari prodhuese i trajtojnë si kosto prodhimi, kosto e çmimit. Ato mund të jenë: shpenzime të pagave, shpenzime të tarifave të licencave, taksave për rregullatorin, shpenzime të kontabilitetit, mirëmbajtjes dhe riparimeve, shpenzimet e publikimeve, shpenzime të zyres, shpenzime për furnizime të vogla, shpenzimet e taksave, shpenzime për shërbime si telefoni, ngrohja, uji, internet, largimi i mbeturinave, taksat e tatimit në pronë, shpenzimet e automjeteve dhe të udhëtimit, etj.

Në disa raste të prezentuara në pasqyrat financiare ato mund të gjejnë të grupuara si kosto prodhimi apo shpenzime të shitjes, shpenzime administrative dhe shpenzime të përgjithshme. Dihet se qëllimi i organizimit të NP është ofrimi i shërbimeve publike për

qytetarin. Megjithë që ato nuk kanë synim fitimin si kategori ekonomike që paraqitet si ndryshim në mes të të hyrave dhe shpenzimeve nga niveli i shpenzimeve kryesisht operative mvaret në rend të parë plotësimi i nevojave të publikut e pastaj edhe cilësia e shërbimit apo furnizimit. Prandaj nuk është qëllim i jonë që të kërkojmë rezultatet afariste në kuptimin e realizimit të tyre pozitive apo negative.

Qëllimi i punimit tonë është të hulumtojmë nivelin e shpenzimeve operative të ndërmarrjeve publike gjegjësisht sa janë ndërmarrjet në gjendje të mbulojnë shpenzimet operative nga të hyrat që ato i gjenerojnë? Sa është kjo e mjaftueshme për kryerjen e veprimtarisë së tyre apo në disa raste ka nevojë për burime shtesë? Me këtë rast ne kemi marrë shpenzimet operative duke mos përfshirë shpenzimet e zhvlerësimit të aseteve, të cilat për shkak të vlerës së lartë të aseteve janë mjaft të larta. Edhe pse nuk ka ndonjë ndikim monetar, zhvlerësimi i lartë në disa NP e kthen fitimin operativ para zhvlerësimit në humbje operative pas zhvlerësimit. Pra kemi hulumtuar situatat ndaras kur pasqyrohen vetëm shpenzimet operative të cilat gjenerohen përgjatë zhvillimit të veprimtarisë së ndërmarrjeve.

Ne po ashtu kemi analizuar edhe shpenzimet tjera operative të cilat te disa NP marrin pjesë me një përqindje mjaft të lartë. Me qëllim që të sigurohemi se informatat e prezentuara janë të sakta ne gjatë punës tonë jemi mbështetur kryesisht në raportet e pasqyrave financiare të audituara nga një auditor i jashtëm i pavarur. Pra, këto të dhëna janë marrë nga raportet zyrtare të cilat pas pranimit nga NP, Njësia për Politika dhe Monitorim të NP-ve i ka publikuar në web faqen e Ministrisë për Zhvillim Ekonomik të Republikës së Kosovës. Në

rastin tonë ne kemi përfshirë disa NP të nivelit qendror dhe të nivelit regjional por nuk janë përfshirë ndërmarrje të nivelit lokal me qenë se konsiderojmë se niveli i përfaqësimit është më mirë i shfaqur te ndërmarrjet më të mëdha.

Po ashtu kemi hulumtuar dhe analizuar NP nga veprimtaritë e postë-telekomit, furnizimit dhe distribuimit të energjisë, hidroekonomike (gjenerim të energjisë, furnizim me ujë të papërpunuar dhe ujitje të sipërfaqeve bujqësore), ujësjellësve regjionalë, grumbullimit dhe deponimit të mbeturinave dhe ujitjes. Pra, ne jemi mbështetur në metoden e analizës duke grumbulluar të dhënat nga pasqyrat financiare për vitet 2011 si vit raportues dhe 2010 si vit paraprak krahasues dhe pastaj duke i krahasuar të dhënat me vitin paraprak por edhe duke i krahasuar me të dhëna tjera të ndërmarrjeve publike.

Me qenë se të dhënat për vitin 2015 ende nuk janë publikuar zyrtarisht, ne kemi vepruar me këto të dhëna që besojmë se megjithatë tregojnë rrjedhat e disa prej kategorive më të rëndësishme për punimin tonë. Duke mbledhur dhe krahasuar të dhënat ne kemi analizuar strukturën e shpenzimeve operative të NP, pra kemi identifikuar se cilat janë shpenzimet operative të cilat kanë pjesëmarrjen më të madhe në shpenzimet e përgjithshme. Kështu p.sh. kemi konstatuar se pjesëmarrjen më të lartë në shpenzimet operative e përbëjnë shpenzimet e pagave apo siç e quajnë ndryshe si kostoja e stafit. Në krahasimin që kemi bërë mes viteve 2010 dhe 2011 kemi gjetur se përveç në një NP (KR Ujitjes "Radoniqi-Dukagjini") te të gjitha NP ka pasur rritje të pagave në krahasim me vitin e kaluar.

Në tabelën e prezentuar më poshtë ne kemi prezentuar koston e stafit për periudhën 2010-2014 për disa NP kryesisht të nivelit qendror sipas të dhënave nga raportet e auditimit të jashtëm të pasqyrave financiare. Po të krahasohen individualisht këto NP mund të shihet se përveç PTK-ja dhe KEK-u të cilat e para, për shkak të ndarjes së Postës nga Telekomit dhe te dyta për shkak të privatizimit të Distribuimit shpenzimet janë zvogëluar që nga viti 2012 përkatësisht 2013, te të gjitha NP tjera në vazhdimësi nga viti në vit ka pasur rritje të tyre.

Për këtë krahasim duhet cekur se nuk janë marrë të dhënat për dy kompani të cilat kanë pasur transformime pronësore në organizimin e tyre Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës (ANP) i cili pjesërisht është dhënë me koncesion dhe NP Trainkos si NP e re e krijuar pas ndarjes së hekurudhave në dy ndërmarrje - Infrastruktura e Hekurudhave të Kosoves (Infrakos) dhe Operimi me trena në Hekurudhat e Kosoves (Trainkos).

Te shpenzimet për paga pjesëmarrja e pagave në shpenzimet operative të disa NP janë në nivel të lartë. Kjo vjen nga shkakun se disa NP nuk kanë shpenzime tjera apo të themi se janë njëloj i ndërmarrjeve shërbyese të cilat shpenzimin më të madh i kanë pagat pasi që kanë kapacitete të mëdha të aseteve dhe puna e cila kërkohet është vetëm mirëmbajtja e sistemit me qëllim të funksionimit. Prandaj, pjesëmarrja e shpenzimeve tjera operative përveç pagave janë në nivel të ulët, deri sa te disa NP (PTK, KEK, KOSTT) edhe shpenzimet tjera operative kanë pjesëmarrje më të lartë se sa pagat.

Tabela Nr. 8 - Kostoja e stafit në Ndërmarrjet Publike

Kostoja e stafit Ndërmarrjet Publike	në (000) Euro				
	2010	2011	2012	2013	2014
PTK	47,271	48,580	34,497	28,342	27,816
KEK	51,434	56,612	57,115	44,989	47,127
KOSTT	2,736	2,945	3,950	4,458	5,014
Ibër Lepenci	2,462	2,512	2,552	2,698	2,800
KMDK	267	316	375	443	521
KRU "Prishtina"	3,085	3,636	3,931	4,241	4,835
KRU "Mitrovica"	987	1,030	1,127	1,124	1,207
Gjithsej:	108,242	115,631	103,547	86,295	89,320

Burimi: Autori (2015)

Mirëpo te disa NP kemi pjesëmarrje të theksuar edhe të shpenzimeve tjera jovetëm të pagave dhe atë në një nivel të lartë. Si p.sh. te Korporata Energjetike-KEK-u , në shpenzimet operative kemi shpenzimet e energjisë e cila blehet-importohet, furnizohet në mungesë të energjisë vendore e që në shpenzimet operative nga vlera prej 44,782,000 vitin 2010 në vitin 2011 merr pjesë 58,326,000 € që gati është i përafërt me shpenzimin për paga. Te kjo NP po ashtu ka shpenzime tjera operative mjaft të larta nga shlyerja e llogarive të arkëtueshme si rezultat i mosarkëtimit (22,085,000 vitin 2010 dhe 18,358,000 vitin 2011) si dhe shpenzimet furnizimit me materiale tjera të nevojshme (17,336,000 ne vitin 2010 dhe 14,322,000 në vitin 2011), pastaj edhe shpenzime të mirëmbajtjes të cilat po ashtu janë të larta.

Te kjo NP po ashtu është karakteristike niveli i lartë i granteve të pranuar për importimin e energjisë elektrike në rastet e mungesës së energjisë nga burimet vendore ose të avarive,

kështu vitin 2010 janë pranuar grante 39,021,000 € kurse vitin 2011 janë pranuar 27,350,000 € (Grant Thornton, 2014).

Në NP PTK po ashtu kemi shpenzime operative të veprimtarisë që nuk kanë ndryshuar shumë nga viti paraprak (vitin 2010 kanë qenë 26,047,000 kurse në vitin 2011 26,767,000) të cilat përveç pagave dhe shpenzimeve tjera ngarkojnë shpenzimet e përgjithshme operative mirëpo shpenzimet e pagave janë më të lartat. Në rastin e NP KOSTT që kryen transmisionin e energjisë, shpenzimet e përgjithshme operative përfshijnë përveç kostos së stafit dhe zhvlerësimit , shpenzimet e humbjes në transmission të energjisë të cilat marrin pjesë në shpenzimet operative me 32.42%, pastaj shpenzime tjera operacionale si dhe një nivel mjaft të lartë të provizioneve për llogaritë e arkëtueshme apo 21.65%. Pra, këto ishin disa prej rasteve ku shpenzimet e pagave nuk paraqesin pjesen më të madhe të shpenzimeve operative (Grant Thornton, 2014).

Për shkak të rrjetit të shpërndarë por edhe të vjetëruar, NP nga lamia e energjisë dhe ujit vlerësojnë se kanë një shkallë të humbjes teknike nga gjenerimi deri te konsumatori. Për shkak të pajisjeve të rrjetit shpërndarës të vjetëruara NP nuk arrijnë që të gjithë sasinë e prodhuar edhe të faturojnë. Ky problem është i identifikuar nga menaxhmenti i NP dhe ata e trajtojnë si humbje teknike. Këto humbje teknike sipas Raportit vjetor të ZRRE për vitin 2013 janë 16.04% për energji deri sa në vendet me rrjetë stabile dhe të zhvilluar këto humbje janë 5-7%. Në sektorin e ujit këto humbje janë edhe më të larta mirëpo te ky sektor humbjeve teknike i janë shtuar edhe humbjet administrative. Sipas Raportit vjetor për vitin 2013 të KRU “Prishtina” këto humbje janë deri në 50%. Këto humbje janë mjaft të larta

dhe paraqesin sfidë për menaxhmentin për zvogëlimin e tyre dhe ndikojnë në qëndrueshmërinë financiare të këtyre ndërmarrjeve (KUR Prishtina, 2015).

Me qëllim të ngritjes së nivelit të arkëtimeve por edhe të krijimit të evidencës së saktë të shfrytëzuesve të shërbimeve publike, ndërmarrjet publike kanë pranuar vendimin për lirimin e përkohshëm nga pagesa të shtresave të caktuara sociale të cilat shfrytëojnë shërbimet publike e të cilat janë në skemat e ndihmave sociale të përcaktuara nga Ministria e punës dhe mirëqenies sociale. Një problem tjetër paraqesin pjestarët e komuniteteve pakicë sidomos të serbëve në pjesën veriore të Mitrovicës.

Po ashtu ka pasur për qëllim të eliminimit nga faturimi i vendbanimeve të braktisura, të bartjes së obligimeve në shfrytëzues të rinj, në rastet kur vendbanimet janë shfrytëzuar nga qiramarrës, të evidentimit të shfrytëzuesve që për herë të parë janë regjistruar si shfrytëzues të shërbimeve publike. Megjithëse, me ndërhyrjen e qeverisë ka pasur përpjekje për të financuar mungesën e të hyrave nga lirimi i shfrytëzuesve për pagesë, kjo ka ndikuar që rrjedha e parasë-arkëtimi të mos jetë në kohen e duhur dhe po ashtu ka paraqitur një kufizim i cili ka ndikuar negativisht në performancën financiare të ndërmarrjeve publike.

Ndërmarrjet publike megjithë se ushtrojnë veprimtari publike që ofrojnë shërbime për qytetarët, sipas ligjit që është në fuqi për ndërmarrjet publike janë të obliguara të përpilojnë planin e biznesit dhe ky plan të aprovohet nga Bordi i drejtorëve i seciles NP. Me këtë plan parashikohen të hyrat, shpenzimet, fitimi operativ, fitimi neto pas taksave, rrjedha e parasë, si dhe shumë tregues (indikatorë) fizik të sasive. Pastaj ky plan ndahet në periudha mujore

dhe tremujore dhe Drejtimi i ndërmarrjes krahason të dhënat duke bërë krahasimin e rezultateve të realizuara dhe atyre të planifikuara.

Pra, ndërmarrjet kanë një orientim lidhur me rrjedhat e zhvillimit të veprimtarisë së tyre, mirëpo megjithatë disa transaksione sikurse janë arkëtimi i llogarive të arkëtueshme, niveli i disa shpenzimeve nuk mund të parashikohen saktë dhe kjo çon në kufizimin e kryerjes së shërbimeve në sasi dhe cilësi. Kufizimet në sasi p.sh. te furnizimi me energji manifestohen në reduktimin e furnizimit me energji elektrike të qytetarëve, i ashtuquajtur regjim i reduktimit varësishtë nga zona e përcaktuar: zona A tri orë me rrymë dhe një orë pa rrymë, zona B dy orë me rrymë dhe dy orë pa rrymë dhe zona C tri orë me rrymë dhe tri orë pa rrymë kurse kufizimet në cilësi manifestohen në furnizimin me energji por me tension të ulët i cili pamundëson përdorimin e energjisë elektrike për nevoja të anvisërisë.

Po ashtu kemi rastin e furnizimit me ujë, kur ka kufizime në sasi pasi që manifestohen me reduktime të ofrimit të ujit sipas orarit që formojnë ndërmarrjet publike të ujës-jellësve regional dhe kufizim në cilësi që manifestohet me cilësinë e ulët të ujit i cili në shumë raste rekomandohet të mos përdoret për shkak të nivelit të ulët të pastërtisë. Kufizimet e këtilla të cilat i ndërmarrin ndërmarrjet publike vetëm se nuk kanë mundësi që të ofrojnë shërbime më cilësore ndikojnë drejtëpërdrejt në cilësinë e jetës së qytetarëve, madje në disa raste ju krijojnë shpenzime shtesë në tentim të gjetjes së alternativave me të cilat do të mund të zëvendësoheshin këto shërbime. Këtu mund të përmendim blerjet e gjeneratorëve dhe shpenzimet e karburanteve ose blerjen e ujit të pijshëm kurse ndikimet tjera negative si

zhurma e madhe që krijohet nga përdorimi i gjeneratorëve dhe ndotja e ambientit nga djegja e karburateve pothuaj se janë të pashmangshme.

Në analizën e faktorëve që ndikojnë në performancën financiare, ne jemi mbështetur në zërat e pasqyrave financiare të cilët në mënyrë të drejtëpërdrejt japin informata për të hyrat, nivelin e shpenzimeve, llogaritë e arkëtueshme dhe borxhin e keq.

3.3 Investimet kapitale nga burimet e veta

Duke marrë parasysh se shumica e ndërmarrjeve publike janë të themeluara në çerekun e fundit të shekullit të kaluar e ndonjë si KEK-u (Termocentrali “Kosova A”) edhe më heret pastaj periudhen e administrimit të tyre prej vitit 1989 deri më 1999, e karakterizuar me përjashtimin e punëtorëve shqiptarë nga puna për bindje politike deri te sulmet ajrore të forcave të NATO-s ndaj forcave ushtarake serbe dhe e vazhduar me periudhen e administrimit të tyre nga Agjencia Kosovare e Mirëbesimit deri në vitin 2007, mund të kuptohet se ndërmarrjet publike kanë trashëguar mjete themelore dhe pajisje të cilat janë të vjetërsuara.

Të gjendur në situatë ku kërkohet ofrimi i vazhdueshëm i shërbimeve publike dhe vështirësia e funksionimit, kryerjes së veprimtarisë me mjete themelore dhe pajisje të vjetëruara, NP gjenden në pozitë të vështirë. Mirëmbajtja e mjeteve dhe pajisjeve me qëllim të funksionimit dhe të ofrimit të shërbimeve paraqet sfidë për ndërmarrjet publike. Po ashtu një sfidë tjetër jo më pak e rëndësishme janë investimet kapitale të cilat janë të

domosdoshme për investimet e reja kur të merret parasysh vjetërsia e tyre ose edhe vetëm mirëmbajtja investive e mjeteve themelore dhe pajisjeve. Zhvillimi dhe progresi tekniko-teknologjik në vendet tjera të botës ka avansuar teknologjitë e vjetra dhe tani këto teknologji që përdoren në ndërmarrjet publike në Kosovë po hasin në kundërshtim me kërkesat globale për ruajtjen dhe mbrojtjen e ambientit. Një shembull i këtillë sot është termocentrali “Kosova A” i cili përbëhet nga pesë blloqe punuese të njohura si A1, A2, A3, A4 dhe A5, i ndërtuar në vitet e 70-ta të shekullit të kaluar (Blloku A1 ka filluar të punojë në vitin 1962 ndërsa Blloku A5 në vitin 1975).

Për shkak të teknologjisë së vjetëruar dhe ndotjes së madhe të ambientit (ndotja e ajrit, ndotja e ujërave dhe degradimi i tokës), Qeveria e Kosovës është zotuar në takimin Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë së Vjenës dhe Bashkimit Evropian, për zbatimin e standardeve të Bashkimit Evropian në emetimin e gazrave, për respektimin e afatit të mbylljes së termocentralit deri në vitin 2017 megjithë se janë bërë në vazhdimësi investime kapitale për mirëmbajtjen investive në funksion të mbarëvajtjes së gjenerimit të energjisë dhe mbrojtjes së mjedisit.

Mirëpo, disa nga këto ndërmarrje të cilat ballafaqohen me nivelin e ulët të arkëtimit, me shpenzime tjera të larta rrjedhimisht me detyrime ndaj furnitorëve, pastaj me borxhe të këqija nuk ju mbeten mjete financiare të mjaftueshme që të ripërtrijnë apo të mirëmbajnë mjetet themelore dhe pajisjet. Problemi i financimit të investimeve kapitale nga burimet e veta paraqet një ndër problemet më të mëdha për NP.

Nga ndërmarrjet të cilat kanë problem me rrjedhën e parasë dhe nuk arrijnë të paguajnë obligimet operative vijuese nuk mund të pritët që të kryejnë investime kapitale nga burimet e veta. Kjo gjendje do të reflektojë në kryerjen e veprimtarisë gjegjësisht në ofrimin e shërbimeve publike dhe në cilësinë e këtyre shërbimeve. Në këto raste ndërmarrjet si zgjedhje alternative përdorin kërkesen që të ndihmohen nga Qeveria nëpër mes të Buxhetit të Konsoliduar të Kosovës. Kështu projektet për investime kapitale në mungesë të fondeve nga burimet e veta mbesin barrë e buxhetit qendror i cili nga tepricat e pashfrytëzuara buxhetore në fund të vitit i bartë në formë të subvencioneve në llogari të ndërmarrjeve publike për të cilat vlerësohet se janë të arësyeshme. Për shembull, subvencionimi i furnizimit me ujë të komunave të Mitrovicës së Veriut dhe të Zveçanit për të hyrat të cilat nuk arrijnë të arkëtohen nga komunitetet.

Pamjaftueshmëria e mjeteve të nevojshme financiare nga burimet vetanake për investime kapitale zvarrit inicimin e fillimit të realizimit të projekteve të nevojshme por edhe bartjen e tyre nga njëri vit afarist në tjetrin. Qeveria e Kosovës me qëllim të ngritjes së nivelit dhe përmirësimit të cilësisë së shërbimeve publike përveç subvencionimit të shpenzimeve dhe dhënjes së granteve për projekte të caktuara në disa raste edhe ka dhënë hua për ndërmarrjet publike për tejkalimin e sfidave me të cilat janë ballafaquar.

Sipas Raportit Vjetor të KEK-ut për vitin 2013, janë realizuar të hyra nga grantet qeveritare 21.3 milion euro ndërsa në vitin paraprak janë realizuar 46.4 milion euro, ndërsa huaja afatgjatë me interes nga Ministria e Ekonomisë dhe Financave sipas pasqyrave financiare për vitin 2014 të audituara ka qenë në vlerë prej 191.9 milion euro. Ky është vetëm një nga

rastet por sigurisht me vlerë financiare më të madhe në të cilat janë ndihmuar ndërmarrjet publike për tejkalimin e sfidave për ngritjen e nivelit të investimeve kapitale ose edhe në përmirësimin e nivelit të shërbimeve publike në këtë rast për importin e energjisë elektrike atëherë kur prodhimi vendor për shkak të defekteve nuk ka qenë i mundshëm apo edhe kur sistemi elektro-energjetik ka qenë në funksion por nuk ka arritur që të plotësojë kërkesat në nivel të vendit.

Në këtë gjendje të pamjaftueshmërisë së të hyrave dhe mjeteve financiare për investime kapitale, Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK) nuk ka mundur të plotësojë kërkesat e ndërmarrjeve publike të parashtruara përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik për subvencionimin e shpenzimeve operative (të domosdoshme për kryerjen e shërbimeve publike, si p.sh. të subvencionimit të importit të energjisë për KEK-un ose të subvencionimit të shpenzimeve për furnizim të ujit për pjesën veriore të Mitrovicës dhe Zveçanit apo të shpenzimeve të karburanteve për operimin me trena) dhe të plotësojë kërkesat e NP-ve për financimin e investimeve kapitale aq shumë të nevojshme.

Duke analizuar subvencionimet dhe investimet kapitale për disa vite të ndërmarrjeve publike mund të konstatojmë se NP-të janë ndihmuar nga BKK-ja vetëm kur nuk kanë mundur të gjejnë ndonjë zgjidhje tjetër. Kështu sipas Institutit për Studime të Avancuara “GAP”, në periudhën 2009-2013, NP-të kanë përfituar grante nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik në vlerë prej 260 milionë euro prej të cilave 78% janë në formë të subvencioneve të shpenzimeve dhe vetëm 22% në formë të investimeve kapitale (GAP, 2015).

Një raport i këtillë i financimit të subvencioneve dhe investimeve kapitale duhet të shërbejë në radhë të parë për Bordet e Drejtorëve si vendimmarrës por edhe te Qeveria e Kosovës si akcionarë, që të orientojnë politikat e ardhshme të tyre në drejtim të zhvillimit të qëndrueshëm për arritjen e stabilitetit operativ vijues në mënyrë që të lënë vend për ndihmesë në financimin e investimeve kapitale. Përballja me problemet ditore duke mos arritur që të gjejnë burime të vazhdueshme për investimet kapitale për të kryer funksionin e tyre do të mbajë NP-të në pozitë të varsisë financiare dhe edhe një kohë niveli i ultë investimeve kapitale do të ndikojë që edhe niveli i shërbimeve publike të mbetet aty ku është ose edhe të bie në nivel më të ulët.

Duke u ballafaquar me vështirësi në financimin e investimeve kapitale nga burimet e veta, Drejtimet e ndërmarrjeve publike por edhe Qeveria, kërkojnë të gjejnë burime tjera plotësuese në formë të donacioneve ose kredive. Kështu p.sh. Kompania Rajonale e Ujësjellësitë “Mitrovica” gjatë dy viteve të fundit ka pasur donacion nga Komisioni Evropian për rritjen e kapaciteteve përpunuese të Fabrikës për përpunimin e ujit në Mitrovicë nga 500 lit/sec në 700 lit/sec, nga Qeveria e Luksemburgut është financuar faza e parë e Projektit për rehabilitimin e rrjetit të ujësjellësitë në vlerë prej 4.5 milion euro. Me mjetet nga donacioni i Qeverisë së Kosovës është duke u ndërtuar impianti për përpunimin e ujit në komunën e Vushtrrisë me kapacitet prej 350 lit/sec (KRU Mitrovica, 2015).

Po ashtu nga Qeveria e Kosoves në fund të vitit 2014 përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Kompanisë Rajonale të Ujësjellësitë “Mitrovica” i është dhënë subvencion në vlerë prej 649,882.00 euro për pagesen e obligimeve për ujin e furnizuar gjatë dy viteve nga

NH “ Ibër-Lepenci”. Pra, siç mund të vërehet vlera e këtyre investimeve të mbështetura me këto donacione dhe subvencionime të përmendura më lartë nuk do të mund të realizoheshin nga burimet e veta. Fatkeqësishtë me një nivel të ulët të arkëtimit të të hyrave, pa gjetjen ose rritjen e burimeve tjera të të hyrave pastaj me këtë nivel të shpenzimeve operative, ndërmarrjet publike edhe më tutje nuk do të mund të investojnë nga burimet e veta. Prandaj ndihma gjegjësisht mbështetja nga donatorët do të jetë e mirë se ardhur (KRU Mitrovica, 2015).

Një formë e re e investimeve kapitale është një formë e kombinuar e mbështetjes financiare përmes donacioneve dhe marrjes së kredive. Një formë e këtillë e mbështetjes financiare do të aplikohet në një projekt shumë të madh dhe të rëndësishëm për Kosoven siç është Rehabilitimi i Linjës Hekurudhore 10, i cili do të financohet nga tri burime të jashtme: nga granti i BE - 40 milion Euro për fazën e parë, 39.9 milion Euro nga BERZH dhe 42 milion Euro kredi nga Banka Investive Europiane (BIE) që nuk do të mund të arrihej me mjete nga burimet e veta (European Investment Bank, 2015).

3.4 Likuiditeti i ulët

Në literaturën ekonomike në përgjithësi është i pranuar koncepti i likuiditetit si aftësi e pagesës në kohë sipas afatit të maturimit të obligimeve. Pasqyrat financiare siç i ka definuar teoreticienti gjerman Eugen Schmollenbah (1873-1955) “paraqesin vetëm një fotografi statike të një gjendje dinamike” të gjendjes së pasurisë dhe pozitës financiare të ndërmarrjes në një datë dhe kohë të caktuar” (Schmollenbah, 1962; në Mourik & Walton,

2014). Sipas një definicioni të këtillë, ne si përdorues të tyre nga pasqyrat financiare shohim vetëm një moment të gjendjes së likuiditetit në një datë të caktuar. Pra ne nuk mund të shohim gjatë gjithë kohës ciklin e likuiditetit të afarizmit të ndërmarrjes, prandaj edhe nga ky këndvështrim nuk mund të kuptojmë vështirësitë e tyre.

Në teorinë ekonomike por edhe në praktikën ekonomike tani më janë të njohur një numër i konsiderueshëm i koeficientëve (raporteve) të likuiditetit të cilët përdoren me qëllim të analizave financiare të punës së ndërmarrjeve. Me këtë rast po i përmendim disa: koeficienti vijues (korent) (current ratio), koeficienti i shpejtësisë ose testi acid (quick ratio), koeficienti i llogarive të arkëtueshme, koeficienti i qarkullimit të stoqeve, koeficienti i qarkullimit të llogarive të pagueshme, etj (Mourik & Walton, 2014).

Në ekonominë e vendeve të zhvilluara përëndimore për qëllime të analizave financiare sot gjithnjë e më shumë bëhen analiza krahasuese të koeficientëve të likuiditetit për tri vitet e fundit të punës. Po të analizohen me kujdes pasqyrat financiare të ndërmarrjeve publike, mund të konstatohet se përjashtimisht PTK-ës, KOSTT-it, NH "Ibër-Lepencit" të gjitha ndërmarrjet publike tjera sfidohen me likuiditetin në shkallë të ulët. Konsiderojmë se në gjendjen aktuale të afarizmit të ndërmarrjeve pas nivelit të ulët të arkëtimit të të hyrave një nga sfidat me të cilën po ballafaqohen dhe që nuk po arrijnë të eliminojnë është likuiditeti i ulët. Në aspektin dinamik ndërmarrjet nuk arrijnë të respektojnë afatet kohore për pagesën e detyrimeve nga afarizmi i tyre. Kjo gjendje i detyron të futen në kredi të ashtuquajtura mbitërheqje bankare të cilat janë me shkallë më të lartë të interesit e që rrisin shpenzimet. Ky joliquiditet paraqitet si pasojë e nivelit të ulët të arkëtimit, dinamikës së prolonguar në

arkëtimin e kërkesave të tyre në njëren anë dhe arritjes së afateve për pagesë të detyrimeve në anën tjetër.

Për shkak të këtij niveli të ulët të likuiditetit janë rritur obligimet ndaj furnitorëve. Furnitorët duke e vërejtur se kërkesat e tyre ndaj ndërmarrjeve publike po rriten dhe gjasat për arkëtimin e tyre gjithnjë e më shumë po zvogëlohen janë detyruar të kërkojnë realizimin e kërkesave të tyre nëpërmes të gjykatave. Kështu për shembull një ndërmarrje publike lokale e cila merret me mbledhjen dhe deponimin e mbeturinave është paditur në gjykatë për mospagesen e obligimeve për furnizim me derivate.

Kjo situatë ju jap të drejtë furnitorëve të kalkulojnë interes të pagueshëm për vonesen në kryerjen e obligimeve dhe shpenzime gjyqësore që do të krijojnë shpenzime shtesë që shkakton vështirësi të reja pasi në situatën e re ndërmarrja po ngarkohet përveç obligimit për borxhin kryesor edhe me shpenzime për interesin e kalkuluar dhe shpenzimet gjyqësore. Në anën tjetër nga ana e gjykates (ose edhe përmbauesve privat) mund të bllokohen llogaritë bankare që do të jetë shkas për Drejtimit e këtyre ndërmarrjeve të ndërmarrin veprime të shkeljes së disciplines financiare, të procedurave të aprovuara, të pagesave nga arka me të gatshme e që rrjedhimisht shtohet rreziku i gabimeve, mashtrimeve apo keqpërdorimeve duke ju shmangur kështu zbatimit të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF).

Likuiditeti i nivelit të ulët në ndërmarrje publike gjatë aktiviteteve operative i ka shtyrë Drejtimit e tyre në moszbatimin e procedurave të Ligjit për Prokurimin Publik i cili është i obligueshëm edhe për ndërmarrjet publike. Kjo pastaj ka ndikuar në efektivitetin, kufizimin e konkurrencës dhe transparencën e shfrytëzimit të parasë publike. Këto devijime nga respektimi i ligjeve, rregulloreve të brendshme dhe procedurave standarde do të kushtëzojnë shprehjen e një opinioni pozitiv të audituesve të jashtëm. Por ajo që është më e rëndësishme nga aspekti i këtij punimi se të gjitha këto vështirësi janë të shkaktuara nga likuiditeti i nivelit të ulët i cili duke vështirësuar afarizmin e ndërmarrjeve publike ndikon në cilësinë e shërbimeve publike dhe në jetën e qytetarëve.

3.5 Rrjedha e parasë

Po të shikohen pasqyrat financiare të NP-ve mund të vërehet se te disa prej tyre rrjedha e parasë nuk mund të përcjell dinamikën e detyrimeve të arritura për pagesë. Ndërmarrjet publike të cilat ballafaqohen me nivelin e ulët të arkëtimit të të hyrave, me nivel të lartë të borxheve të këqija, me shpenzime të larta operative dhe me nevojën për investime kapitale kanë rrjedhë të ngadalësuar të parasë që shkakton vështirësi të mëdha në funksionimin dhe kryerjen e veprimtarisë dhe paraqet ndër sfidat më të ndërlikuara gjatë afarizmit të tyre.

Shumë nga mangsitë e cekura nga audituesit e jashtëm në raportet e tyre kanë si pasojë fluksin (rrjedhën) e ngadalësuar të parasë e cila sipas drejtuesve të këtyre NP-ve në emër të kryerjes së veprimtarisë dhe ofrimit të shërbimeve për publikun janë të detyruar të kryejnë

blerje me para të gatshme duke ju shmangur procedurave të prokurimit, konkurrencës, dhe pastaj furnizimet, punët dhe shërbimet rezultojnë të janë prokuruar me çmime më të larta.

Prandaj edhe në një farë mënyre fluksi i ngadalësuar i parasë përmes prokurimit po paraqitet si shkaktar i dukurive negative si korrupcioni, nepotizmi, për të cilin shpesh e kanë ngritur zërin organizatat joqeveritare, institutet, shoqëria civile. Duhet theksuar se qeveria e Kosovës po kritikohet ashpër nga BE-ja dhe në kohën e fundit po kushtëzohet edhe me liberalizimin e regjimit të vizave për qytetarët nga Kosova për shkak të nivelit të lartë të korrupcionit. Për rëndësinë që ka rrjedha e parasë për ndërmarrjen shpesh herë krahasohet rëndësinë që ka pasqyra e gjakut për shëndetin e njeriut. Përceptimi negativ për gjendjen e përgjithshme të korrupcionit dhe krimin mund të ndikojë në zvogëlimin e investimeve nga jashtë dhe në rritjen e zhvillimit ekonomik (UNODC, 2013).

Siç u përmend më lartë, ndërmarrjet publike të cilat ballafaqohen me vështirësi në kryerjen e veprimtarisë së tyre, për shkak të pamjaftueshmërisë së mjeteve financiare të shkaktuar nga mosarkëtimi i të hyrave detyrohen të kërkojnë mjete financiare nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës (BKK). Përveç mjeteve financiare në formë të granteve për investime kapitale dhe mjeteve financiare për mbulimin e humbjeve teknike, nga Buxheti i Konsoliduar vetëm njëherë Korporates Elektroenergjetike të Kosovës (KEK) i është lejuar kredi me qëllim të përmirësimit të furnizimit me energji elektrike. Pra, ka pasur raste por më tepër të natyrës intervente të qeverisë përmes NJPM të NP-ve, për përmirësim të nivelit të shërbimeve publike.

Në sektorin e furnizimit me ujë dhe largimit të mbeturinave, për investime kapitale të cilat nuk mund të financohen nga burimet vetanake, për shkak të pamjaftueshmërisë së gjenerimit të të hyrave nga burimet vetanake, burim i vetëm i financimit-subvencionimit të investimeve kapitale dhe të shpenzimeve ka qenë Buxheti i Konsoliduar.

3.6 Borxhet e këqija

Një karakteristikë e përbashkët e shumicës së NP në Kosovë janë borxhet e këqija. Kjo dukuri sidomos është e shprehur te ato ndërmarrje publike të cilat ofrojnë shërbimet e tyre për qytetarët dhe arkëtojnë të hyrat e tyre nga qytetarët. Më konkretisht me këtë sfidë ballafaqohen (para privatizimit të Njesisë së Distribuimit, KEK-u tani KESCO) për mosarkëtimin e të hyrave nga energjia, Kompanitë Rajonale të Ujësjetësve, Kompanitë e Ujitjes si dhe Kompanitë Rajonale të Mbeturinave por edhe Kompanitë Lokale të Mbeturinave.

Në rrethanat e krijuara që nga viti 1999, NP kanë ofruar shërbime publike por nuk kanë arritur që të bëjnë edhe arkëtimin e të hyrave për shërbimet e kryera. Kjo periudhë ka zgjat shumë prandaj me qëllim të përafrimit mes gjendjes sipas evidencës kontabël dhe gjendjes reale, Qeveria e Kosovës ka aprovuar Ligjin për faljen e borxheve publike (Ligji Nr.05/L-043), me të cilin do të rregullohet çështja e borxheve publike së paku deri në vitin 2008 por edhe do të sqarohet gjendja e borxheve publike për periudhen 2009-2014 (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2015).

Ky ligj do të ndikojë në largimin e kërkesave të paarkëtueshme nga evidencat e NP dhe do të krijojë një gjendje reale të evidencës për kërkesat e llogarive të arkëtueshme. Konsiderojmë se zbatimi praktik i këtij ligji do të ketë ndikim pozitiv jovetëm në NP por edhe në raport me qytetarët dhe definimin e saktë të obligimeve të tyre ndaj NP-ve dhe krijimit të një raporti të ri dhe të drejtë të kërkesave dhe obligimeve për NP-ët dhe qytetarët si shfrytëzues të shërbimeve publike dhe klientë.

Sipas Ligjit Nr.03/L-114 për Tatimin mbi vlerën e shtuar borxhi i keq është përkufizuar kështu: *“Borxhi i keq” do të thotë një pagesë që duhet paguar nga një person i tatueshëm që është përfshirë më parë në të ardhurat e këtij personi, por përkundër faktit se janë ndërmarrë të gjithë hapat ligjorë për ta arkëtuar borxhin, ai mbetet i pa arkëtuar”* (Kuvendi i Republikës së Kosovës, 2008).

Ndërsa sipas Ligjit për faljen e borxheve publike (Ligji Nr.05/L-043) dhe Udhëzimit Administrativ për procedurat e faljes së borxheve publike (QRK) – Nr.04/2015, ky borxh nënkupton çdo shumë e papaguar e borxhit, përfshirë ndëshkimet, gjobat, interesin si dhe çdo obligim tjetër që rrjedh nga mos pagesa me kohë e kryegjësë së borxhit, sipas gjendjes me datën e hyrjes në fuqi të këtij ligji, që kanë qenë obligim për pagesë i personave ndaj Institucioneve Shtetërore, në emër të obligimeve tatimore, doganore dhe tatimit në pronë, si dhe të gjitha obligimeve tjera financiare ndaj Ndërmarrjeve Publike që ofrojnë shërbime publike, në emër të shërbimeve të ofruara, për qytetarët në Republikën e Kosovës deri më datën 31 dhjetor 2008.

Sipas Ligjit për tatimin në të ardhurat e korporatave, Ligji Nr.05/L-029, në nenin 12 definoen shpenzimet e borxhit të keq. Në paragrafin 1 të këtij neni janë të cekura kushtet kur një borxh i keq konsiderohet shpenzim:

- Paguesa nuk është marrë plotësisht apo pjesërisht dhe është shpallur si i pambledhshëm duke inicuar procedurat në organet gjyqësore;
- Borxhit i kanë kaluar së paku gjashtë muaj nga afati i obligimit për pagesë;
- Shuma që korrespondon me borxhin më herët është përfshirë në evidenca kontabël si e ardhur;
- Nuk ka kontest mbi vlefshmërinë juridike të borxhit;
- Ka evidencë të mjaftueshme se janë bërë përpjekje substanciale për të vjelë borxhin, përfshirë çdo veprim të aplikueshëm për të maksimalizuar mbledhjen e borxhit sikurse janë: 1.5.1. tatimpaguesi ka balancuar çdo borxh të pakontestueshëm kundrejt borxhit të keq;
- Korrespondenca dhe kontaktet në përpjekje për të vjelë borxhin;
- Kërkesa është dorëzuar mbi mjetet e falimentimit, likuidimit, nëse është e aplikueshme dhe shuma që do të merret është përcaktuar në mënyrë të arsyeshme nga administratori, përmbaruesi. Deri në shkallën sa janë marrë nga falimentimi, janë aplikuar në borxhin e pashlyer.
- Tatimpaguesi duhet të lëshojë një faturë për shumën e paarkëtuar ku duhet të shkruhen fjalët "Borxh i keq" si dhe numri i faturës, me të cilën lidhet ky borxh, faturë, e cila i shërben shitësit për të zvogëluar të ardhurën dhe blerësit për të zvogëluar shpenzimin koston;

- Për shumën deri në pesëqind (500 €) euro të trajtuar si borxh të keq nuk kërkohet inicimi i procedurave në organet gjyqësore.

Dispozitat e këtij ligji i obligojnë NP-të të ndërmarrin veprime lidhur me evidencat e tyre për të përafuar, sqaruar gjendjen apo edhe të bëjnë shlyerjen e borxhit të keq duke i nxitur dhe stimuluar borxhlinjtë që nëse paguajnë obligimet e tyre për periudhen e viteve 2009-2014 do të ju shlyhet borxhi për periudhen deri në fund të vitit 2008. Sipas nenit 5 të Ligjit për faljen e borxheve publike, NP janë të obliguara që në afatin prej tridhjetë (30) ditësh të identifikojnë dhe përgatisin listen e personave të cilët mund të përfitojnë nga falja e borxheve publike deri më 31 dhjetor 2008 (mund të gjenden në web faqet e NP).

Më tutje me qëllim të motivimit të individëve për shlyerjen e borxhit janë ofruar lehtësira në kuptim të faljes së gjobave, ndëshkimeve, të interesit dhe të çdo obligimi tjetër të kalkuluar nga mos pagesa me kohë mbi bazën e borxhit. Një aspekt tjetër i motivimit të shfrytëzuesve të shërbimeve publike është lidhja e marrëveshjes për pagesen me këste të borxhit për periudhen 01 janar 2009 deri me 31 dhjetor 2014 për një afati mjaft të gjatë prej dy (2) vitesh për personat juridikë dhe prej tri (3) vitesh për personat fizikë nga data e lidhjes marrëveshjes për pagesen e borxhit të pranuar.

Gjithashtu me qëllim të njohjes me ligjin dhe përfshirjes sa më të madhe të subjekteve që mund të përfitojnë nga falja e borxheve-borxhlinjve është caktuar afati brenda një (1) viti nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji kur mund të realizojnë këtë të drejtë, që konsiderohet afat i mjaftueshëm për njoftimin e të gjitha palëve të interesuara.

Sipas studiuësve, analistëve është inkurajuar dhe përkrahur ky vendim i Qeverisë së Kosovës që për herë të parë që nga viti 2008 ka pasur një iniciativë që së paku të qartësohet gjendja e borxheve të këqija si për qytetarët si obligues ashtu edhe për ndërmarrjet publike të cilat kërkonin arkëtimin e kërkesave deri tani të paarkëtuara dhe të trajtuara si borxhe të këqija. Ndërmarrjet publike përveç efektit negativ që kanë pasur për mosarkëtimin e të hyrave janë të obliguara të i prezentojnë në pasqyrat e tyre financiare si shpenzime të borxhit të keq. Në vijim janë prezentuar provizionet për borxhe të këqija të disa ndërmarrjeve publike për disa vite si dhe llogaritë e arkëtueshme:

Tabela Nr. 9 - Provizionet për borxhe të këqija dhe llogaritë e arkëtueshme në KEK

NP KEK, sh.a.		në (000 Euro)				
Viti	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Provizione për borxhe të këqija	25,625	22,085	18,358	13,456	23,158	32,147
Llog. e arkëtueshme	80,639	57,688	37,174	41,986	43,375	47,837

Burimi: Autori (2015)

Pra, siç mund të shihet nga tabela më lartë niveli i provizionimit të llogarive të arkëtueshme është mjaft i lartë që ka ndikim në rritjen e shpenzimeve, në performancën financiare të prezentuar në pasqyren e të ardhurave gjithëpërfshirëse por edhe në zvogëlimin e dinamikës së fluksit të parasë.

Tabela Nr. 10 - Provizionet për borxhe të këqia dhe llogaritë e arkëtueshme në Infrakos

NP "Infrakos", sh.a.		në (000 Euro)			
Viti	2011	2012	2013	2014	
Provizione për borxhe të këqia	780	405	493	562	
Llog. e arkëtueshme	1,568	1,465	1,314	1,869	

Burimi: Autori (2015)

Në tabelën në vijim, është karakteristike që nga KRU "Mitrovica", sh.a. për të gjitha vitet është aplikuar një shkallë drejtvizore e përqindjes së aplikuar të provizionimit të kërkesave nga llogaritë e arkëtueshme:

Tabela Nr. 11 - Provizionet për borxhe të këqia dhe llogaritë e arkëtueshme në KRU Mitrovica

KRU "Mitrovica", sh.a.		në (000 Euro)			
Viti	2011	2012	2013	2014	
Provizione për borxhe të këqia	9,574	9,574	9574	9,574	
Llog. e arkëtueshme	18,716	20,809	23,095	25,300	

Burimi: Autori (2015)

Këto shpenzime do të ndikojnë në rritjen e shpenzimeve edhe ashtu të larta të ndërmarrjeve publike dhe drejtpërdrejt do të ndikojnë rezultatin operativ financiar. Duke u ballafaquar me kërkesa ligjore dhe në pamundësi të gjetjes së ndonjë zgjidhje të volitshme, ndërmarrjet publike kanë mbajtur një nivel të lartë të kërkesave për llogari të arkëtueshme duke mos

kryer provizionimin ose kanë kryer pjesërisht provizionimin ose duke ju përshtatur nivelin e provizionimit këtyre kërkesave nevojave të paraqitjes së rezultatit financiar të përshtatshëm që mund të shihet në pasqyrat financiare të audituara të ndërmarrjeve publike.

Kjo sipas vlerësimeve të audituesve të jashtëm të pavarur ka qenë një shmangje e prezentimit të pasqyrave financiare sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) sipas të cilave ndërmarrjet publike janë të obliguara të përpilojnë pasqyrat financiare.

Një shmangje e tillë e prezentimit të pasqyrave financiare sipas kërkesave të standardeve të lartëpërmendura ka ndikuar në shprehjen, dhënjen e një opinionimi më të ulët për pasqyrat financiare të audituara të ndërmarrjeve publike nga ana e audituesve të jashtëm të pavarur. Kjo mund të shihet në Raportet e auditimit të pasqyrave financiare përkatësisht në opinionet e audituesve të jashtëm të pavarur të angazhuar për auditimin e pasqyrave financiare, në të cilat janë theksuar zërat e llogarive të arkëtueshme dhe zërat të provizionimit të kërkesave për llogari të arkëtueshme p.sh. raportet e auditimit të pasqyrave financiare të KEK-ut për vitin 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014 pastaj të Kompanisë Rajonale të Ujësjetësimit “Mitrovica” për vitin 2010, 2011, 2012 dhe 2014 (mungon opinionimi i auditimit të jashtëm për vitin 2013, të Kompanisë Rajonale të Ujësjetësimit “Prishtina” për vitin 2010, 2011, 2012, 2013 dhe 2014.

3.7 Kërkesat ambientale (KEK, Trepça, Sharrcem, dhe kualiteti i ujit)

Disa nga ndërmarrjet publike nga sektori i energjisë, ujit dhe mbeturinave në të ardhmen e afërt do të ballafaqohen me kritere ambientaliste të cilat duhet të plotësohen si rezultat i kërkesave për ruajtjen e ambientit nga ndotja, rritjes së kualitetit-pastërtisë së ujit dhe deponimit të mbeturinave sipas kërkesave të ligjeve dhe standardeve. Kështu për sektorin e energjisë, kërkesat për kufizimin e ndotjes së ajrit dhe kufizimin e prezencës së dioksidit të karbonit në ajër janë një nga sfidat e cila vështirë se mund të implementohet për shkak të nivelit të teknologjisë e cila aplikohet për gjenerimin e energjisë elektrike. Sektori i furnizimit me ujë po ballafaqohet me kërkesat për rritjen e nivelit të kualitetit të ujit të pijshëm ndërsa sektori i mbeturinave po ballafaqohet me kërkesat për ndarjen-selektimin e mbeturinave sipas përbërjes dhe me kërkesat për deponimin e tyre (World Bank, 2013).

Sipas raportit të përgatitur nga Banka Botërore, “Analiza mjedisore e shtetit-Vlerësimi i kostos së degradimit mjedisor, rishikimi institucional dhe rishikimi i shpenzimeve publike për mjedisin”, Kosova ballafaqohet me degradime mjedisore prej 221 milion euro të shpenzimeve në nivel vjetor cilat ndikojnë shumë në çështjet ekonomike dhe sociale për shkak të menaxhimit të dobët të mbrojtjes së ambientit nga ndotja. Prandaj, sfidë e vazhdueshme do të jetë mbrojtja dhe ruajtja e mjedisit nga ndotësitë më të mëdhenj e që janë NP por edhe ndërmarrje tjera të cilat nuk janë NP si rasti i ndërmarrjes “Trepça nën administrim të AKP-ës”, ish ndërmarrjes “Sharrcem” fillimisht e komercializuar tani të privatizuar (World Bank, 2013).

Mjedisi në Kosovë është degraduar nga zhvillimi i veprimtarisë së ndërmarrjeve në të kaluarën. Mbetjet nga proceset teknologjike (hiri dhe ajri – KEK-u, “Sharrcem-i” mbetjet nga përpunimi i xeheve dhe kontaminimi me plumb- “Trepça”) nga e kaluara ndikojnë në rritjen e kostove të tanishme. Sikur të respektoheshin ligjet dhe standardet për emetimet në ajër nga ndotësitë kryesor e sidomos nga burimet e ndotjes stacionare, cilësia e ajrit do të përmirësohej dhe do të zvogëlohej ndikimi në shëndetin e njerëzve. Është vlerësuar se prej 37 deri në 158 miliona € në vit (0.89-3.76% e BPV-së) mund të jetë kostoja e ndotjes së ajrit me ndikim më të madh në shëndetin e viseve urbane. Për çdo vit llogaritet se nga ndotja e ajrit janë shkaktuar raste të vdekjes së parakohshme 835, të sëmurë nga bronkiti kronik 310, të shtruar në spitale 600 dhe që kanë kërkuar vizita në raste emergjente gjithsej 11600. Për kah niveli i ndikimit në mjedis, kontaminimi me plumb është në vendin e dytë i cili shkakton shpenzime vjetore prej 42 deri në 94 miliona € apo .0-2.2% e BPV-së në vitin in 2010 (World Bank, 2013).

Kjo ndotje nga plumbi vjen për shkak të mbetjeve nga procesi teknologjik i nxjerrjes dhe përpunimit të xeheve së plumbit dhe deponive të tyre sidomos në afërsi të minierave Stan Tërg dhe Artanë pastaj të lokacioneve për përpunimin e tyre në Mitrovicë dhe Kizhnicë. Gjithashtu por në masë më të vogël ka ndikuar shfrytëzimi për automjete i benzinës me plumb e cila ka tendencë të zvogëlimit të ndikimit si rezultat i përdorimit të derivateve pa plumb, avansimit të teknologjisë së prodhimit të automjeteve në aspekt të mbrojtjes së ambientit dhe masave administrative të ndërmarra nga autoritetet përkatëse në lidhje me kufizimin e përmbajtjes së benzinës me plumb.

Në ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit ndikimi i gjyqësorit ende është në nivel të ulët që po krijon hapësira për keqpërdorime si hapja e minierave ilegale, prerjes së pyjeve, dëmtimi i shtratit të lumenjve, shkatërrimi i natyrës nga gurthyesitë, etj. Kosova ende nuk ka zhvilluar autoritete rregullative që do të përforcojnë institucionet në zbatimin e kornizës ligjore dhe të shfrytëzimit të stimulimeve të cilat ofrohen për ruajtjen dhe mbrojtjen e mjedisit. Kjo paraqet një pengesë për funksionim efikas të tyre. Janë rekomanduar masa me qëllim të arritjes së pajtueshmërisë të ndotësve më të mëdhenj për përmirësimin e efektivitetit të standardeve për mjedisin të cilat janë aktualisht në fuqi. Megjithë se nga MMPH me udhëzimet administrative janë përcaktuar vlerat kufizuese për standardet e cilësisë së ajrit, të ujit dhe standardet për emetime në ajër, shkarkimet në ujë, për cilësinë e ajrit, të ujit të pijshëm. Kjo kornizë rregullative duhet të mbështetet me forma tjera të monitorimeve, inspektimeve dhe të posedimit të pajisjeve nga ana e inspektoratit për matjen dhe kontrollin e emetimeve dhe shkarkimeve si dhe të cilësisë së ajrit dhe ujit.

Për ngritjen e nivelit të monitorimit nevojiten mbështetje financiare dhe aftësi profesionale të kuadrove të cilat janë të angazhuara. Aplikimi i tarifave pastaj zbatimi i gjobave mund të ndihmojnë edhe si veprim parandalues ndaj ndotësve të mjedisit dhe në anën tjetër përmes tyre të sigurohen burime për mbështetje financiare të domosdoshme për procesin e riparimit të degradimit të mjedisit. Dy shkaktarë tjerë të cilët ndikojnë në nivelin e ndotjes së mjedisit janë ndotja e ujit dhe ndotja nga mbeturinat. Këto shërbime kryhen nga NP të cilat për shkak të gjendjes financiare në të cilën ndodhen nuk arrijnë të ofrojnë shërbime publike në sasi dhe cilësi (USAID, CDF & RIINVEST, 2016).

Megjithë përpjekjet nga ana NP të ujësjellësve niveli i pastërtisë së ujit të pijshëm ende është i ulët sidomos kur ka të reshura të shiut, kryerje të punimeve në rrjetin e ujësjellësve, ndërprerje të punës në stacione pompike si dhe sipas testimeve të kryera për aspektin fiziko-kimik dhe bakteriologjik të analizave të ujit (USAID, CDF & RIINVEST, 2016).

Për shkak të gjendjes financiare, këto ndërmarrje përveç që me vështirësi e kryejnë veprimtarinë e tyre dhe atë duke e kufizuar sasinë p.sh. të furnizimi me ujë lagje të qyteteve më të mëdha ballafaqohen me mungesë të ujit nga disa orë në ditë kurse mbledhja e mbeturinave bëhet vetëm sipas një orari të cilin ndërmarrjet komunale për mbledhjen e mbeturinave e përcaktojnë vet. Në vendet më pak të urbanizuara ky kufizim i kryerjes së veprimtarisë është edhe më i gjatë.

Kërkesat ambientale janë ngarkesë e madhe në kushtet kur veprimtaria themelore nuk mund të zhvillohet. Ato janë barrë shtesë për buxhetin e varfër të tyre. Megjithatë cilësia e shërbimeve publike dhe kërkesat për mbrojtjen dhe ruajtjen e mjedisit kanë shumë pika të përbashkëta sidomos të furnizimi me ujë dhe të mbledhja dhe deponimi i mbeturinave. Si një zgjidhje e mundshme e cila do të mund të ndihmonte NP në gjetjen e burimeve për financimin janë vjelja e tarifave dhe gjobave si dhe në inicimin për ndryshime në ngritjen nivelit të mbrojtjes së ambientit duke krijuar një strategji e cila do të nxisë edhe donatorët e jashtëm në periudha afatgjata sepse pa ndihmën nga jashtë Kosova nuk mund të arrijë standardet e kërkuara (USAID, CDF & RIINVEST, 2016).

Që të arrihet objektivi që 90% e popullsisë të ketë qasje në ujësjellës krahasuar me 40% që nuk është lidhur fare apo kanë lidhje në shërbime të dobëta, mbledhja e ujërave të zeza dhe trajtimi i tyre, vendosja e kanalizimeve, mbledhja e rregulltë e mbeturinave, selektimi dhe përpunimi i tyre janë objektiva të cilat duhet të realizohen në një periudhë afatmesme me prioritet dhe synim arritjen e standardeve të BE-së, zbatimin e ligjeve të BE-së, integrimin në strukturat mjedisore të BE-së dhe rregullimin e shqetësimeve mjedisore (USAID, CDF & RIINVEST, 2016).

Në pikëpamje të aprovimit të kornizës strategjike duhet theksuar se janë aprovuar strategjitë sektoriale sikur se Strategjia e Kosovës për Energji 2009-18, Strategjia industriale e Kosovës 2010-13 Strategjia e bujqësisë dhe e zhvillimit rural 2009-13 dhe Strategjisë për zhvillimin e sektorit të pylltarisë 2010-20 me të cilat synohet që të krijohet baza që çështjet të lidhura me kërkesat për mbrojtjen e ambientit të mbështeten në plane strategjike që do të ndihmojnë përmbushjen e tyre.

Kërkesat ambientale gjithnjë e më të ashpra do të detyrojnë ndërmarrjet publike në parashikimin e detyrimeve kontingjente pasi si pasojë e ngjarjeve të ndodhura në të kaluaren do të paraqiten obligime në të ardhmen. Kjo do të jetë një barrë e rëndë për buxhetin e varfër të tyre dhe nivelin e tanishëm të zhvillimit tekniko-teknologjik të ndërmarrjeve publike pasi standardet e ruajtjes së mjedisit dhe ofrimi i cilësisë së shërbimeve publike janë larg kërkesave të Bashkimit Europian të cilat po synohen të arrihen në të ardhmen.

3.8 Llogaridhënja dhe raportimi financiar

Një nga qëllimet e Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Nr.03/L-087) është edhe krijimi i strukturave efikase të raportimit dhe përgjegjësisë për të lejuar mbikëqyrjen e duhur të aktiviteteve të ndërmarrjeve publike. Po ashtu disa nene të këtij ligji obligojnë NP për raportim dhe publikim të të dhënave.

Sipas këtij ligji, NP janë të obliguara që të publikojnë raportin për kënaqshmërinë e konsumatorëve, planin e biznesit, raportin vjetor, raportin e auditorit të jashtëm të pavarur për pasqyrat financiare, statutin e NP, rregulloret e NP, kodin e etikës dhe qeverisjes korporative, deklaratën mbi kompensimin dhe kushtet e kompensimit për secilin drejtor dhe zyrtar të NP-së, dransaksionet me palë të ndërlidhura, të gjitha kontratat me vlerë të madhe ashtu siç përcaktohen nga Ligji për prokurim publik, të gjitha konfliktet e interesave të deklaruara nga drejtorë dhe zyrtarë të saj, listen e dhjetë furnizuesve më të mëdhenj për nga vlera e furnizimeve, numrin e të punësuarëve dhe një pasqyrë të ndryshimeve mujore.

Njësia për Politikën dhe Monitorimin e NP-ve duhet të mbaj të publikuara të dhënat e lartëpërmendura në faqen e saj në internet për një periudhë pesë (5) vjeçare. Të gjitha të dhënat e lartëpërmendura duhet të vendosen për qasje publike dhe duhet të zbulohen në përputhje me kërkesat e Ligjit për Qasjen në Dokumentet Zyrtare.

Njësia me qëllim të mbështetjes së Ministrisë dhe Qeverisë në ushtrimin e përgjegjësisë për NP-ët të cilave u janë dhënë sipas Ligjit për NP, gjithashtu do të:

- Përgatisë dhe dorëzojë Ministrit, për transmetim në Qeveri, analiza dhe rekomandime lidhur me çështjet e NP Qendrore që janë në kompetencën e Ministrit dhe/ose Qeverisë;
- Përgatisë dhe dorëzojë Ministrit propozim procedura për mbikëqyrjen e NP-ve Qendrore dhe monitorimin e përputhjes së tyre me këtë ligj dhe ligjet e tjera të rëndësishme; dhe
- Mbledhë të dhënat përkatëse mbi NP-të dhe ofron përkrahje, sipas nevojës, për Departamentin e Buxhetit lidhur me të gjitha aspektet e BKK-së që ndërlidhen me NP-të.

Sipas nenit 14.1 të Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Nr.03/L-087, i datës 13 qershor 2008) , ndërmarrja Publike duhet të veprojë në përputhje të plotë me të gjitha kushtet për raportim financiar dhe parimet e kontabilitetit për shoqëritë aksionare të përcaktuara me ligjin për shoqëritë tregtare dhe sipas nenit 14.3 në përputhje me parimet e kontabilitetit të përmendura në nenin 14.1, llogaritë financiare të secilës Ndërmarrje Publike duhet t'i identifikojnë në mënyrë të veçantë të gjitha shpenzimet e bëra dhe të ardhurat e mbledhura gjatë ushtrimit të detyrimeve për shërbimin e publikut.

Nga kjo buron obligimi ligjor i ndërmarrjes që të përpilojë pasqyrat financiare sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF) me qëllim të raportimit financiar për

veprimtarinë e zhvilluar gjatë vitit afarist, që pasqyrat financiare të janë të publikuara, transparente dhe të ofrojë qasje për shfrytëzuesit e informatave financiare në radhë të parë aksionarin, bordin e drejtorëve, të punësuarit, por edhe për shfrytëzuesit tjerë jashtë ndërmarrjes sikurse janë zyrat rregullatore, investitorët e mundshëm, bankat, agjencioni i statistikave, odat ekonomike, organizatat joqeveritare, etj. Sipas Ligjit për kontabilitet, raportim financiar dhe auditim (Ligji Nr. 04/L-014), me këtë ligj rregullohet sistemi i kontabilitetit dhe raportimit financiar të shoqërive tregtare. Në kreun II, me nenin 3 të këtij ligji është përcaktuar obligimi për raportim financiar.

Shoqëritë tregtare sipas paragrafit 2 të këtij neni, që kryejnë aktivitetin e tyre me mjete shoqërore apo publike do të përgatisin pasqyra financiare për qëllime të përgjithshme në pajtim me këtë ligj. Me rastin e përgatitjeve të pasqyrave financiare për qëllime të përgjithshme, aplikojnë standardet e kontabilitetit, rregulloret dhe udhëzimet administrative të lëshuara nga KKRF-ja sipas nenit të 5 të këtij ligji por mund edhe të përgatisin pasqyra financiare plotësisht në pajtim me SNRF-të duke njoftuar KKRF-në.

Sipas këtij ligji është bërë klasifikimi i shoqërive tregtare për qëllim të raportimit financiar.

Për këtë qëllim kategoritë e shoqërive tregtare janë klasifikuar si vijon: shoqëritë tregtare të mëdha janë ato të cilat plotësojnë dy nga tri kriteret në vijim:

- Qarkullim vjetor (neto) më i madh se katër milion (4,000,000) Euro;
- Asetet (pasuritë) bruto në bilancin e gjendjes: më të mëdha se dy milion euro (2,000,000) Euro;

- Numri mesatar i të punësuarve gjatë vitit financiar: më i madh se pesëdhjetë (50).
Shoqëritë tregtare sipas nenit 4, paragrafi 1. nën-paragrafët 1.1., 1.2. dhe 1.3., që janë të regjistruara si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar ose shoqëri aksionare, përgatisin pasqyrat financiare në pajtim me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar, të lëshuara nga Bordi për Standarde Ndërkombëtare të Kontabilitetit, të cilat miratohen nga KKRF-ja. Po ashtu Pasqyrat financiare sipas nenit 4 paragrafit 1. nën-paragrafit 1.1. të këtij ligji do të auditohen nga firmat e auditimit që janë të licencuara për të kryer auditim nga autoritetet kompetente siç janë definuar në këtë ligj.

Një nga qëllimet e Ligjit për Ndërmarrjet Publike (Nr.03/L-087) është edhe krijimi i strukturave efikase të raportimit dhe përgjegjësisë për të lejuar mbikëqyrjen e duhur të aktiviteteve të ndërmarrjeve publike. Në skemën në vijim mund të shihet niveli i llogaridhënjes dhe raportimit nga NP deri te Komisionet parlamentare:

Figura Nr. 3 - Logaridhëna dhe raportimi nga NP te Komisionet parlamentare



Burimi: Autori (2015)

Në këtë kuptim edhe NP kanë ngritur struktura të raportimit por edhe me qëllim të ngritjes së llogaridhënjes kanë angazhuar përmes konkurrencës së hapur kompani të auditimit për

kryerjen e auditimit të jashtëm të pavarur të pasqyrave financiare të ndërmarrjeve të tyre. Kryesisht janë kompani vendore të auditimit të licencuara nga Këshilli Kosovar për Raportim Financiar por janë angazhuar edhe kompani apo njësi të tyre të themeluara në Kosovë nga i ashtuquajtimi "katërshi i madh" siç i quajnë katër kompanitë e mëdha ndërkombëtare të auditimit ("PricewaterhouseCoopers", "Deloitte Touche Tohmatsu", "Ernst&Young" dhe "KPMG"). Siç mund të shihet nga tabela më poshtë opinioni i audituesve të jashtëm për pasqyrat financiare ka pasur një konsistencë të dhënjes së opinionit të pakualifikuar me theksim të çështjes.

Tabela Nr. 12 - Opinioni i auditorit të jashtëm për KEK

NP KEK, sh.a.					
Viti	2010	2011	2012	2013	2014
Opinion i auditorit të jashtëm	Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes	Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes	Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes	Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes	Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes

Burimi: Autori (2015)

Tabela Nr. 13 - Opinioni i auditorit të jashtëm për NP Trainkos

NP Trainkos, sh.a.				
Viti	2011	2012	2013	2014
Opinion i auditorit të jashtëm	Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes	Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes	Opinion i kualifikuar	Opinion i kualifikuar

Burimi: Autori (2015)

Tabela Nr. 14 - Opinioni i auditorit të jashtëm për NP Infrakos

NP Infrakos, sh.a.				
Viti	2011	2012	2013	2014
Opinioni i auditorit të jashtëm	Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes	Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes	Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes	Opinion i pakualifikuar me theksim të çështjes

Burimi: Autori (2015)

Tabela Nr. 15 - Opinioni i auditorit të jashtëm për KRU "Mitrovica"

KRU "Mitrovica", sh.a.				
Viti	2011	2012	2013	2014
Opinioni i auditorit të jashtëm	Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes	Opinion i kualifikuar me theksim të çështjes	Mungon raporti	Opinion i kualifikuar

Burimi: Autori (2015)

Siç mund të shihet nga shqyrtimi dhe miratimi i raporteve në Kuvendin e Kosovës vërehet se disa raporte janë shqyrtuar me vonesë të madhe (p.sh. Raporti i Performancës së NP-ve gjatë vitit 2011 u shqyrtua në seancën e Kuvendit të Kosovës me 29 mars ndërsa pas votimit u miratua nga deputetët e Kuvendit të Kosovës me 04 prill 2013). Kjo ka ndikuar që Qeveria si ushtruese e së drejtës së aksionarit të informohet po ashtu me vonesë dhe ndërmarrja e çfarëdo vendimi nuk do të jetë i harmonizuar në aspektin kohor-dinamik me rrjedhat dhe zhvillimet aktuale.

Po ashtu edhe marrja e vendimeve dhe transparenca mund të mos kishin efekt pasi në ndërkohë ka pasur mundësi dhe mjaft kohë që gjendja nga raportet e fundit të ketë ndryshuar. Nga kjo që u tha mësipër, lehtë mund të vijmë në përfundim se zinxhiri i raportimit nga NP të NJPM të NP-ve dhe grupet parlamentare-Kuvendi duhet të përshpejtohet. Kjo mund të arrihet me zbatimin e kërkesave ligjore të cilat kanë precizuar afatin kohor të raportimit. Duhet theksuar se një paqartësi ka shkaktuar dallimi për disa afate të raportimit në mes të Kodit të Etikës dhe Qeverisjes Korporative për NP dhe Ligjit për NP. Pas ribotimit të Kodit në vitin 2014 janë eliminuar paqartësitë nga Kodi paraprak.

3.9 Politika e çmimeve

Politika e formimit të çmimeve është një sfidë tjetër për këto NP. Politikat e çmimeve do të duhej të ishin të atilla që të mbulonin shpenzimet operative me qëllim që me pjesën e mbetur të arrihen objektivat që do të plotësonin kërkesat financiare për investime kapitale sipas planeve zhvillimore. Me qenë se kemi të bëjmë me sektorin publik si edhe në vendet tjera të rajonit (Shqipëri, Serbi, Kroaci) edhe në Kosovë çmimet e disa shërbimeve publike janë të mbikëqyrura nga zyrat rregullatore të cilat caktojnë çmimet (tarifat) e shërbimeve publike. Këto janë të ashtuquajtura çmime të rregulluara të cilat caktohen sipas një metodologjie të përcaktuar nga zyrat rregullatore. Vet fakti se janë të rregulluara dhe këto çmime drejtëpërdrejtë ndikojnë në çmimin e shërbimeve publike e me këtë në nivelin e shpenzimeve jetësore të qytetarëve, në formimin e këtyre çmimeve mekanizmi i ndikimit të tregut është i modifikuar. Pra, ndërmarrjet publike nuk mund të krijojnë politika të çmimeve pasi zyrat rregullatore ndërhyjnë dhe aprovojnë çmimet e caktuara për periudhat

përkatëse (vite tarifore) duke përshtatur çmimin sipas kërkesave sociale apo të korigjimit-zvogëlimit të çmimit në rastet kur nuk ka konkurrencë, pra kur ekziston pozita monopoliste (Zulić, 2015).

Kështu nga qeveria e Kosovës, si ushtruese e të drejtave të aksionarit, janë formuar zyrat rregullatore të energjisë, të ujit, të mbeturinave dhe kanalizimit të cilat kanë kompetenca të caktojnë çmimet-tarifat e energjisë, të ujit, të mbeturinave dhe caktojnë periudhen kohore kur ato duhet të aplikohen. Sipas autorizimeve që dalin nga ligji Bordi i ZRRE-së miraton rregullen për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike (Rregulla për Çmimet e FPEE-së) me të cilën përcakton metodologjinë për vendosjen e tarifës së rregulluar me pakicë që ngarkohet nga furnizuesi publik i energjisë elektrike për furnizim me pakicë të energjisë elektrike.

Në Kosovë dhe Shqipëri caktimi i tarifave të shërbimit për kompanitë e ujësjellësitë bëhet në bazë të metodologjisë dhe procedurave që lejohen nga korniza ligjore pas shqyrtimit të të dhënave të dorëzuara nga kompanitë-aplikimet për lejimin e tarifave. Duhet theksuar se në Serbi dhe Kroaci nuk funksionojnë zyrat rregullatore të ujit por kjo çështje është rregulluar me ligj për veprimtaritë komunale në të cilat bëjnë pjesë uji, kanalizimi dhe mbeturinat (Filipovic & Krnjeta, 2013).

Në vijim ne po japim disa karakteristika të dy zyrave rregullatore në Kosovë të cilat siç mund të shihet nga kompetencat që ju japin ligjet përkatëse sipas veprimtarisë, kanë ndikim mjaft të madh në ofrimin e shërbimeve publike. Themelimi, organizimi dhe kompetencat e

Zyrës Rregullatore të Energjisë janë përcaktuar në bazë të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Ligji Nr.2004/9). Zyra e Rregullatorit për Energji është organ i pavarur, i cili ka për detyrë të rregullojë aktivitetet në Sektorin e energjisë në Kosovë, përfshirë energjinë elektrike, ngrohjen qendrore dhe gazin, në pajtim me detyrimet që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë (Ky traktat është nënshkruar nga Bashkimi Evropian dhe nëntë partnerë nga Evropa Juglindore në Athinë në muajin tetor 2005 për krijimin e kornizës ligjore për një treg të integruar të energjisë) (ZRRE, 2011).

Bazuar në dispozitat e ligjit të lartpërmendur, është kompetencë e ZRRE-së që të lëshojë licenca dhe të monitorojë ndërmarrjet e energjisë për respektimin e tyre, që për aktivitetet e shërbimeve publike të mratojë tarifën, sipas rastit mund të imponojë detyrime për furnizimin e popullsisë, ndihmon në zgjidhjen e kontesteve dhe në hartimin e legjislacionit sekondar për sektorin e energjisë. Po ashtu, duke zbatuar parimet e tregut të lire, ZRRE është e obliguar për krijimin e kornizës rregullative, e cila siguron funksionim transparent dhe jo-diskriminues të tregut të energjisë (ZRRE, 2011).

Për dhënjen e licencave ndërmarrjeve të energjisë, ZRRE duhet të zbatojë kritere që janë në përputhshmëri me parimet e transparencës dhe të mirëbesimit duke përfshirë mundsinë për të dhënë, ndryshuar, pezulluar, bartur, marrë, mbikëqyrë dhe kontrolluar nëse këto ndërmarrje të energjisë u përmbahen këtyre licencave. ZRRE gjithashtu i ka kompetencat për të caktuar paraprakisht parimet dhe metodat e vënies së çmimit dhe më vonë për të miratuar tarifën për shërbimet e rregulluara të energjisë. Ky funksion përfshin edhe monitorimin e tarifave, zgjidhjen e kontesteve, cilësinë e shërbimeve dhe standardet për

kryerjen e punëve. Gjatë kryerjes së veprimtarisë së saj, ZRRE bashkëpunon me ndërmarrjet e energjisë dhe ministritë, sidomos me Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik (ZRRE, 2011).

Financimi i veprimtarisë së ZRRE-së bëhet nga taksat e licencave të lëshuara, të cilat i mundësojnë mbështetje financiare dhe pavarësi në zhvillimin e aktiviteteve të saja. Roli i ZRRE-së është në ofrimin e ndihmës dhe të sigurojë që legjislacioni primar dhe sekondar i Kosovës të jetë në harmoni me kërkesat “acquis communautaire” (përmbledhja e legjislacionit të BE-së) për energjinë.

Gjithashtu Zyra Rregullatore e Ujit dhe Kanalizimit e cila më heret ishte emërtuar Zyra Rregullatore e Ujit dhe Mbeturinave (ZRRUM) është themeluar fillimisht në bazë të Rregullores së UNMIK-ut 2004/49 për Veprimtaritë e Ofruesve të Shërbimeve të Ujës-jellësitë, Kanalizimit dhe Mbeturinave kurse është plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr.05/L-042 dhe tani është emërtuar si Autoriteti Rregullativ për Shërbimet e Ujit (ARRU). Sipas kornizës ligjore të cekur më lartë janë specifikuar autorizimet dhe përgjegjësitë, llogaridhënja dhe financimi i saj.

Për shërbimet e ujës-jellësit dhe kanalizimit në Kosovë Autoriteti Rregullativ për Shërbimet e Ujit (ARRU) është rregullator i pavarur ekonomik. Roli i tij është që të sigurojë ofrimin e shërbimeve cilësore, efikente, dhe të sigurta në baza jo-diskriminuese për tërë konsumatorët në Kosovë, duke pasur parasysh mbrojtjen e mjedisit dhe të shëndetit publik. ARRU-ja është e autorizuar dhe ka përgjegjësi për licencimin e ndërmarrjeve publike që ofrojnë

shërbime nga veprimtaria e ujësjellësit dhe kanalizimit, të ujërave të zeza, për të furnizuar ndërmarrjet e ujësjellësit me ujë me shumicë, të përcaktimit të tarifave të shërbimit për ofruesit e shërbimeve të licencuar nga ARRU-ja, duke u përkujdesur që tarifat të jenë të drejta dhe të arësyeshme dhe të mundësojnë qëndrueshmërinë financiare të ofruesve të shërbimeve (ARRU, 2016).

Gjithashtu ka kompetenca të mbikqyrjes së zbatimit të standardeve të shërbimit që ofrojnë ofruesit e licencuar të shërbimeve-ndërmarrjet publike, aprovon dhe mbikqyrë zbatimin e Kartës së Konsumatorëve që rregullon të drejtat dhe obligimet e ndërsjella ndërmjet konsumatorëve dhe ofruesve të shërbimeve të licencuar nga ARRU, mbikqyrë zbatimin e shkyçjeve të konsumatorëve dhe rregullimit të kyçjeve ilegale në sistemin e ujësjellësit dhe kanalizimit, kordinon formimin dhe mbështetjen e Komisioneve Këshilluese të Konsumatorëve në shtatë regjionet e Kosovës. Duke u bazuar në Ligjin Nr. 03/L-086 dhe Ligjin Nr.05/L-042, për ushtrimin e veprimtarisë ARRU i përgjigjet Kuvendit të Kosovës i cili ka kompetenca për emërimin e drejtorit dhe zëvendësdrejtorit të ARRU-së në bazë të rekomandimeve të Qeverisë së Kosovës. Veprimtaria e ARRU-së mbështetet në financimin nga të hyrat e realizuara nga taksat e licencimit që paguajnë ofruesit e shërbimeve të licencuar nga ARRU (ARRU, 2016).

Duhet theksuar se ka një kundërthënjë në mes të asaj çka kërkohet nga NP dhe të vrojtimit, konsiderimit të tyre si shtylla të mbrojtjes së standardit jetësor të popullsisë. Në njëërën anë kërkohet që këto NP të punojnë me rezultate pozitive (pa humbje) mundësishtë me një shkallë të ulët të akumulimit me qëllim që mos të janë barrë e buxhetit, ndërsa në anën

tjetër llogariten si shtylla të mbrojtjes së standardit jetësor të popullates, që nënkupton aplikim të parimeve joekonomike në përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për shërbimet e tyre. Pozita e këtillë e këtyre NP ndikon në sasinë dhe cilësinë e shërbimeve publike të ofruara, dëmtohen shfrytëzuesit e shërbimeve, krijojnë humbje për shkak të çmimeve-tarifave të rregulluara të cilat prapë janë barrë e qytetarit nëse subvencionohen nga buxheti, dëmtojnë politikat kreative për investime kapitale nga burimet e veta, etj.

3.10 Krizat politike-vakuumi institucional

Një nga sfidat jofinanciare e cila për kah ndikimi që ka në qeverisjen e NP-ve, me të cilën praktikisht janë ballafaquar ndërmarrjet publike në Kosovë është kriza politike gjegjësisht krijimi i vakuimit institucional-mungesa e kompetencave për vendimmarrje. Duke ju referuar Ligjit për ndërmarrjet publike në Kosovë (Ligji Nr.03/L-087), ndërmarrjet publike qendrore janë në pronësi të Republikës së Kosovës kurse Qeveria ka kompetencën ekskluzive për ushtrimin e të drejtave të aksionarit të Republikës së Kosovës deri sa të drejtat e aksionarit në një ndërmarrje publike lokale ku komuna është aksionare i ushtron një Komision Komunal i Aksionarëve (KDI & TIK, 2015).

Në rastet kur pas zgjedhjeve të përgjithshme (qendrore) të mbajtura në vitin 2014 dhe pas kalimit të një periudhe kohore relativisht të gjatë po shtyhej zgjedhja e qeverisë, marrja e vendimeve që kanë të bëjnë me veprimtarinë ose rregullimin nga ndonjë lami tjetër e NP-ve ka qenë e kufizuar. Është e njohur situata kur bordet e drejtorëve të pjesës më të madhe të ndërmarrjeve publike nuk kanë qenë complete pasi disa anëtarë të bordeve të drejtorëve

kanë qenë të detyruar të japin dorëheqje nga pozita e drejtorit të bordit sipas kërkesës të Agjencionit Kundër Korrupsion (AKK) për shkak të konfliktit të interesit dhe në këto pozita nuk janë plotësuar apo rizgjedhur anëtarë tjerë për shkak të papajtueshmërisë të partive politike për formimin e qeverisë. Dhe ndoshta një rast edhe më i rëndë kur Bordi Agjencisë së Privatizimit të Kosovës për arësyen e lartëpërmendur nuk ka mundur të kompletohet me anëtarë të tjerë dhe ka qenë një kohë të gjatë jofunksional. Kjo ka pamundësuar marrjen e cilit do vendim në lidhje me procedurat e privatizimit, likuidimit dhe riorganizimit të ndërmarrjeve të cilat qeverisen nga AKP-ja (KDI & TIK, 2015).

3.11 Perspektiva e NP-ve dhe e ardhmja e tyre

Ekzistimi i mëtejshëm i NP do të jetë i lidhur me ofrimin e shërbimeve publike. Për sa kohë që shteti do të ofrojë shërbime publike përmes NP për qytetarët edhe funksionimi i tyre do të vazhdojë. Në shtetet me ekonomi të zhvilluar forma e organizimit të këtyre ndërmarrjeve ka ndryshuar prandaj procesi i transformimit, riorganizimit të tyre është i vazhdueshëm.

Edhe në disa NP në Kosovë deri më tani kanë ndodhur disa ndryshime. Në Kosovë dy ish ndërmarrje publike janë transformuar dhe tani funksionojnë në parime tjera. Kështu ish NP Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës “Adem Jashari” tani qeveriset nga konzorciumi “Limak&Lyon” pra kemi pasur një proces të dhënjes me koncesion dhe që nga 08 Maji i vitit 2013 një pjesë e NP të Korporates Elektroenergjetike të Kosovës (KEK)-Distribucioni-sektori i shpërndarjes dhe furnizimit me energji, që ka funksionuar si njësi e veçantë është shitur pra i është nënshtruar procesit të privatizimit. Sfidat e transformimit do të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

Tani disa nga ish ndërmarrjet shoqërore të administruara nga AKM-ja dhe AKP-ja janë në proces të organizimit, riorganizimit dhe disa edhe në proces të likuidimit pasi që më parë kanë kaluar procesin e falimentimit. Për disa prej tyre ka kërkesa të organizohen si NP, kurse për ish Kombinatin "Trepça" në ndërmarrje me rëndësi strategjike për shtetin. Ballafaqimi me forma të reja të organizimit do të jetë i pashmangshëm. Sikurse edhe në shtetet më të zhvilluara ku nxitja e zhvillimit të mëtejshëm është bërë duke futur konkurrencën në sektore të caktuara si p.sh. në komunikacionin ajror. Transformimet e mundshme në të ardhmen do të bëhen përmes formave të koncesionimit, privatizimit dhe partneritetit publiko privat.

3.12 Përmbledhje e kapitullit

Në këtë kapitull, në vazhdim të shtjellimit të kuadrit teorik, kemi shpalosur një analizë të disa prej sfidave financiare me të cilat ballafaqohen NP në Kosovë të cilat ndikojnë në veprimtarinë e tyre, në sasinë dhe në cilësinë e shërbimeve publike. Duke ndjekur nivelin e ndikimit të tyre janë trajtuar disa nga sfidat në disa NP duke i krahasuar të dhënat për disa NP dhe për disa vite si dhe reflektimin e tyre në gjendjen aktuale të tyre. Kemi analizuar nivelin e ulët të arkëtimit të të hyrave, nivelin e lartë të shpenzimeve për paga dhe lidhja me rritjen e numrit të të punësuarve në NP, investimet kapitale nga burimet e veta, rrjedhen e parasë, likuiditetin e ulët, politikat e çmimeve, llogaridhënjen dhe raportimin financiar, kërkesat ambientale dhe sfidat e së ardhmes të NP.

PJESA E DYTË: STUDIMI EMPIRIK

KAPITULLI IV: METODOLOGJIA E KËRKIMIT

4.1 Përdorimi i kuadrit teorik në funksion të studimit empirik

Në pjesën e kuadrit teorik kemi shtjelluar zhvillimin e vazhdueshëm me ndryshime dhe organizimin e ndërmarrjeve në disa forma të qeverisjes të cilat janë rrethana të cilat kanë ndihmuar në kuptimin e gjendjes momentale dhe funksionimit të tanishëm të ndërmarrjeve publike dhe sfidave të ndryshme me të cilat ballafaqohen. Në këtë kontekst vlerësojmë se në Kosovë organizimi i tyre dallon nga vendet tjera pasi NP në Kosovë janë ndërmarrjet e vetme që ofrojnë shërbime publike deri sa në vendet tjera si p.sh. Kroacia përveç ndërmarrjeve publike funksionojnë edhe ndërmarrjet shtetërore dhe ndërmarrjet me rëndësi strategjike për shtetin apo siç i quajnë ndërmarrjet strategjike. Konsiderojmë se çështjet në vijim të dhëna në kuadrin teorik në kapitujt paraprak kanë ndihmuar në përpunimin e të dhënave duke pasur synim pyetjet kërkimore dhe hipotezat e parashtruara:

Së pari, forma e qeverisjes korporative si e përbashkëta e modelit të qeverisjes për shumicën e ndërmarrjeve publike në vende të botës. Së dyti, forma e organizimit të NP e kushtëzuar nga korniza ligjore vendore brenda së cilës veprojnë nuk ka pësuar ndryshime të mëdha. Së treti, shtjellimi i disa prej sfidave financiare me ndikim më të madh dhe mundësitë e reflektimit të tyre në nivelin e cilësisë së shërbimeve publike, në zhvillimin e qëndrueshëm të NP dhe zhvillimin ekonomik të vendit.

Dhe në fund treguesit e pranisë së sfidave financiare do të janë pjesë e pandarë e këtij punimi për të analizuar korrelacionin pozitiv që kanë sfidat financiare me cilësinë e shërbimeve publike dhe do të janë në funksion të analizës empirike dhe të pjesës përfundimtare që ndërlidhet me rekomandimet.

4.2 Burimet e informacionit

Duke pasur parasysh pyetjet kërkimore dhe hipotezat e përshkruara në kapitullin e parë, burimet kryesore të informacionit që janë përdorur për testimin e hipotezave janë: burimet parësore dhe burimet dytësore.

Burimet parësore përfshijnë të dhënat e mbledhura drejtëpërdrejt nga ndërmarrjet publike në Kosovë nëpërmes pyetësorit të përgatitur për nevojat e këtij studimi ndërsa burimet dytësore përfshijnë të dhënat e mbledhura nga literatura ekzistuese për ndërmarrjet publike të vendeve të ndryshme në botë, raporte vjetore të ndërmarrjeve publike, pasqyra vjetore financiare, plane të afarizmit (planet e biznesit), raporte të auditimit të jashtëm, raporte të monitorimit, të dhëna nga citimet e raporteve të agjencive, instituteve kërkimore, organizatave hulumtuese-kërkimore të nivelit vendor dhe ndërkombëtar.

4.3 Popullata dhe kampioni (mostra)

Popullata e këtij punimi janë të gjithë anëtarët e bordeve të drejtorëve dhe zyrtarë të ndërmarrjeve publike në Kosovë, qendrore dhe rajonale pa marrë parasysh se cilën

veprimtari e ushtrojnë, klasifikimin e tyre apo sa është madhësia e tyre, etj. Ne nuk kemi bërë ndonjë ndarje pasi ato janë klasifikuar-kategorizuar nga ligji. Megjithatë, në gjatë punës i kemi grupuar tri sektoret e veprimit të ndërmarrjeve publike: sektorin e energjisë elektrike, sektorin e ujësjellësve dhe ujit dhe sektorin e mbeturinave. Një kufizim kohor në këtë studim paraqet fakti se popullata është e kufizuar pasi që kjo formë e organizimit të ndërmarrjeve publike nuk ka funksionuar para vitit 2008.

Formula e madhësisë së mostrës:

$$Ss = \frac{z^2 \cdot (p) \cdot (1-p)}{c^2} = \frac{1.96^2 \cdot (0.5 \cdot 0.5)}{0.05^2} = \frac{3.8413 \cdot 0.25}{0.0025} = \frac{0.960325}{0.0025} = 384.13$$

ku:

- Ss – madhësia e mostrës;
- Niveli i besimit merret prej 95 për qind dhe paraqet rezultatin e Z^2 prej 1.96;
- p – përqindja e shpërndarjes së mostrës, ku zakonisht merret 0.5, që do të thotë shpërndarje prej 50 për qind;
- c – paraqet intervalin e besimit, i shprehur si përqindje, në këtë rast 0.05, që do të thotë se margjina e gabimit është +/- 5%
- pop – numri i njësive të popullacionit, në këtë rast anëtarëve të bordeve drejtorëve dhe zyrtarë tjerë të ndërmarrjeve publike në Kosovë të anketuara = 143

$$Ss \text{ e saktë} = \frac{ss}{1 + \frac{ss-1}{pop}} = \frac{384.13}{1 + \frac{384.13-1}{143}} = \frac{384.13}{1 + \frac{383.13}{143}} = \frac{384.13}{1+2.679} = \frac{384.13}{3.679} = 104.41$$

4.4 Metodologjia, metodat dhe instrumentet bazë të hulumtimit

Siç është shpjeguar në kapitullin e parë, ky punim është një rezultat i kombinimit të të dhënave parësore dhe dytësore. Punimi është një analizë e sfidave financiare të NP nëpërmjet metodave të matjes së korrelacionit në mes të variablave të paraqitura në tabelat e kryqëzuara dhe testit "Chi-Square" i cili teston varësinë në mes të variablave të testuara. Pjesa më e madhe paraqet analizën e matjes së korrelacionit të varësisë përmes tabelave të kryqëzuara të variablave të cilat janë vlerësuar më të rëndësishme për testimin e hipotezave si dhe pjesa shumë e rëndësishme e analizës së regresionit linear të ndikimit të variablave në performancën operative dhe financiare të NP.

Të dhënat sasiore të marra nga pasqyrat financiare, raportet vjetore, raporte të organizatave të tjera kërkimore, raporte të organeve mbikëqyrëse dhe raporte statistikore, raporte tjera të ndryshme janë krahasuar me të dhëna cilësore të mbledhura përmes përgjegjeve në pyetësor të anëtarëve të bordeve të drejtorëve dhe zyrtarë të ndërmarrjeve publike në Kosovë, me qëllim të testimit të hipotezave të parashtruara. Pas grumbullimit të të dhënave, përpunimi i tyre është bërë nëpërmjet programit SPSS. Për qëllime të përpunimit të mëtejshëm statistikor kodimi i përgjigjeve është bërë me numra nga 1 deri në 5. Pyetësoni dhe të dhënat nga pasqyrat financiare të publikuara dhe audituara të NP janë instrumente bazë i mbledhjes së të dhënave të punimit empirik.

4.5 Mbledhja e të dhënave dhe përpunimi i tyre

Qëllimi i mbledhjes së të dhënave ka qenë të marrim vlerësimet e vendimmarrësve dhe drejtuesve të NP për sfidat financiare me të cilat ballafaqohen ndërmarrjet ku ata punojnë. Në anën tjetër, rezultatet e përpunimit dhe analiza e këtyre të dhënave ka për qëllim të analizojë sa sfidat financiare janë në vëmendje të tyre, sa ato janë në funksion të situates financiare në të cilën ato kalojnë dhe të vlerësojmë se sa ato kanë korrelacion pozitiv me cilësinë e shërbimeve publike që ofrojnë. Gjithashtu mbledhja e të dhënave nga pasqyrat financiare të NP ka ofruar bazën e nevojshme për analizën e faktorëve që kanë ndikim domethënës në performancën financiare të NP. Dhe në fund, qëllimi përfundimtar që në bazë të analizës tonë të kryer të japim rekomandimet të cilat i konsiderojmë më të rëndësishme.

Përveç këtyre të dhënave për këtë kërkim kemi ndërmarrë edhe disa intervista të pastrukturuara ose gjysëm të strukturuara me anëtarë të Njësisë për Politika dhe Monitorim të NP, auditues nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm, zyrtar ligjor të NP, hulumtues shkencor nga bota akademike, grupe të shoqërisë civile dhe grupe të interesit të sektorit publik në Kosovë, qytetarë në cilësi të përdoruesit të shërbimeve publike. Këto të dhëna pastaj janë kryqëzuar dhe krahasuar me të dhënat e përfituara nga pyetësorët. Njësi anketuese për mbledhjen e të dhënave kanë qenë drejtues të niveleve të ndryshme të ndërmarrjeve publike si: anëtar bordi, kryeshef/drejtor ekzekutiv, zëvendëskryeshef ekzekutiv, zyrtar kryesor financiar, zyrtar për auditim të brendshëm.

4.5.1 Pyetësi

Pyetësi në formë elektronike është dërguar tek njëqind e dyzetë e tre (143) persona të tillë në shtatëmbdhjetë (17) ndërmarrje publike qendrore dhe ndërmarrje publike rajonale të ujitjes dhe ujësjellësit të Kosovës të cilat ju ofrojnë shërbime publike qytetarëve, institucioneve publike, shkollave, spitaleve, administrates, subjekteve ekonomike-bizneseve, etj. Prej të gjithë numrit të anketuarëve janë përgjigjur me plotësim të pyetësit njëqind e shtatë (107) veta që shprehur në përqindje është 74.83%. Edhe sipas formulës për llogaritjen e madhësisë së mostrës nga Taro Yamane madhësia e mostrës së testuar është e mjaftueshme pasi del se madhësia del të jetë 105. Por edhe sipas formulës tjetër rezultati del përafërsisht e njëjtë, madhësia e mjaftueshme e mostrës del të jetë 104.

Pyetësi është dërguar në formë elektronike sepse është konsideruar se të anketuarit e kuptojnë pyetësin, kanë qasje në internet (e-mail adresat elektronike) dhe kanë mundësi të përgjigjen. Në pyetësor janë parashtruar tridhjetë e katër (34) pyetje të cilat janë të renditura në atë mënyrë që një grup i pyetjeve përmban pyetje të përgjithshme që kanë të bëjnë me karakteristikat personale të anketuesit, pastaj disa pyetje të përgjithshme për ndërmarrjen ku punojnë dhe qeverisjen korporative, pjesa qendrore e pyetjeve që kanë të bëjnë me sfidat financiare dhe ndikimin e tyre në ofrimin e shërbimeve publike, si dhe në pjesën e fundit pyetjet lidhur me performancën financiare të ndërmarrjes.

Të dhënat i përkasin periudhës kohore 2013-2015. Një pjesë e pyetjeve kanë një ose disa nënseksione. Përgjigjet e pyetjeve janë të shkallëzuara sipas Likertit, pesë shkallë nga

“aspak dakord” në “plotësisht dakord”. Përgjigjet e të anketuarve shprehin bindje, perceptione dhe opinione të tyre në pyetjet e parashtruara dhe nuk janë të dhëna objektive të marra nga pasqyrat financiare apo dokumentacioni zyrtar i ndërmarrjeve.

4.5.2 Pyetësi pilot

Pyetësit kryesor i ka paraprirë një “pilot pyetësor” të cilin e kam realizuar përmes një ankete të ashtuquajtur ballë për ballë me dy ish anëtarë të bordit të drejtorëve të një ndërmarrjeje publike të cilët kanë pasur përvojë të mjaftueshme për qëllimin për të testuar pyetësin. Kam synuar të marrë informata në lidhje me qartësinë apo kuptueshmërinë e pyetjeve, për nivelin e ndëlikueshmërisë së pyetjeve, për përgjegjjet e mundshme që mund të kthehen (merren), kohëgjatësinë e nevojshme për të dhënë përgjegjeje në pyetësor dhe eventualisht mundësitë për të ndryshuar apo plotësuar dhe përmirësuar pyetësin.

4.5.3 Futja e të dhënave në databazë dhe kodimi i tyre

Pas mbledhjes së të dhënave nga terreni është bërë futja e të dhënave në databazën e krijuar në programin Excel. Databaza në excel është bërë duke paraqitur pyetjet nëpër kolonat e faqes së excelit. Përgjigjet e marra janë koduar me numra. Pyetjet me përgjigje ordinale apo shkallë të Likertit janë koduar me numra prej 1 deri në 5, shumica e tyre kanë qenë të këtij lloji. Ka pasur edhe pyetje me përgjigje nominale, siç janë pozita në ndërmarrje e të anketuarit, gjinia, veprimataria që e zhvillon ndërmarrja, etj.

Gjatë procesit të përpunimit të të dhënave disa pyetje është dashur të rikodohen, psh. kur është dashur të testohet hipoteza e parë përmes analizës së korelacionit, është dashur që për përgjigjet e marra për sfidat që kanë qenë të koduara me shumë rrallë = 1, rrallë = 2, mesatarisht = 3, shpesh=4 dhe gjithnjë=5, është dashur të rikodohen në mënyrë inverse (të kundërt), prej gjithnjë = 1 deri te shumë rrallë = 5, sepse pyetja tjetër, niveli i arkëtimit të të hyrave, që është koreluar me këtë ka pasur këtë kodim: 55-65% të hyrave = 1, 66-75% =2, 76-85% = 3, deri 90%= 4 dhe deri 100% të hyrave = 5, do të thotë trendi pozitiv është koduar duke shkuar prej numrit më të vogël kah numri më i madh, prandaj edhe te përgjigjet e sfidave është dashur që numri më i madh të paraqes situatë më pozitive, në mënyrë që korelacioni i tyre të jetë logjik.

4.5.4 Përpunimi i të dhënave

Pas futjes së të dhënave në databazën e programit excel është bërë bartja e të dhënave në programin SPSS duke ua përshtatur të dhënat dhe emërtimin e tyre këtij programi. Pastaj përpunimi i të dhënave është bërë në këtë program përmes disa analizave.

Analiza e thjeshtë e të dhënave, nëpërmes së cilës kemi bërë nxjerrjen e rezultateve të thjeshta në formë të frekuencave dhe të përqindjeve sipas strukturës së përgjigjeve dhe gjithashtu përqindjet kumulative të tyre. Me këtë metodë janë nxjerrë rezultatet e të gjitha përgjigjeve të marra dhe pas komentimit të tyre janë prezentuar grafikisht.

Analiza e tabelave të kryqëzuara, përmes kësaj analize është bërë krahasimi i varësisë në mes të dy variablave përmes testit `Chi Square`, e cila tregon nëse dy variabla kanë marrëdhënie statistikisht të rëndësishme në dallimet e përgjigjeve të dhëna.

Duke përdorur analizën e tabelave të kryqëzuara, përmes testit të korelacionit të Pearson-it është bërë testimi i korelacionit në mes të disa variablave të caktuara, i cili tregon nëse dy variabla kanë lidhje statistikisht të rëndësishme në mes vete, dhe nëse ajo lidhje është pozitive apo negative dhe nëse është lidhje e fortë apo e butë. Përmes kësaj metode është testuar Hipoteza 1.

Analiza e regresionit linear është përdorur për të matur ndikimin e disa faktorëve financiarë dhe sektorialë në performancën financiare të ndërmarrjeve publike. Esenca e kësaj metode bazohet nëse faktorë të caktuar kanë ndikim statistikisht të rëndësishëm në performancën financiare të ndërmarrjeve. Faktorët janë variabla të pavarura, të cilët pritet të ndikojnë në variablen e varur në këtë rast performancën financiare të ndërmarrjes. Konsiderohet se një faktor ka ndikim në variablen e varur kur vlera p e tij është $p < 0.05$, apo deri në nivelin 5% të rëndësisë statistikore. Përmes kësaj metode është testuar Hipoteza 2.

4.6 Vështirësitë gjatë mbledhjes së të dhënave

Procesi i mbledhjes së të dhënave është ballafaquar me disa vështirësi të cilat kanë zvogëluar dinamikën e përfundimit më të hershëm të këtij studimi. Në radhë të parë ngadalësia e kthimit të përgjegjeve nga pyetësi që kushtëzonte punën në vijim. Kjo

vonesë impononte për thirrje për rikujtim që në disa raste kthehej përgjegjja me arësytim se për mungesë të kohës dhe ngarkesave ditore është lënë për më vonë.

Pastaj nga disa të anketuar ka pasur rezerva për shkak të trajtimit të përgjegjjeve si të natyrës konfidenciale të të dhënave edhe pse gjatë formulimit të pyetësorit jemi kujdesur që të ruhet konfidencialiteti i të anketuarit por edhe përgjegjjet në pyetjet e parashtruara nuk kanë pasur mundësi të japin ndonjë të dhënë e cila do të ishte sekret i afarizmit të ndërmarrjes.

Gjithashtu, niveli i vetëdijes të njerëzve të cilët nuk vijnë nga bota akademike ndikon në kuptimin e studimeve hulumtuese dhe kërkimore për qëllime akademike. Nga disa prej tyre ky studim trajtohet si tentativë për qëllim të ngritjes personale të studjuesit pasi që nuk ka ndonjë efekt dhe rezultati i këtij studimi nuk mund të ndryshojë gjendjen momentale pasi ajo është e ndikuar nga partitë politike. Megjithë vështirësitë e përmendura konsiderojmë se ne kemi arritur të marrim një numër të mjaftueshëm të përgjegjjeve të cilat kanë qenë të rëndësishme për këtë studim.

4.7. Përmbledhje e kapitullit


Në këtë kapitull në fillim të tij kemi trajtuar kuadrin teorik të këtij studimi, metodologjinë, metodat dhe instrumentet bazë. Janë shpjeguar burimet e marrjes së informatave, mënyra e mbledhjes së të dhënave dhe përpunimi i tyre.

Gjithashtu është trajtuar mënyra e përgatitjes së pyetësorit pilot dhe pyetësorit kryesor, futja e të dhënave në databazë dhe kodimi i tyre. Në pjesën tjetër është shpjeguar popullacioni dhe kampioni, si dhe janë shpjeguar llojet e analizave të përdorura për përpunimin e të dhënave. Në fund të kapitullit janë trajtuar vështirësitë gjatë mbledhjes së të dhënave. Në vazhdim të kapitullit vijues janë shtjelluar analiza e të dhënave empirike dhe testimi i hipotezave të këtij studimi.

KAPITULLI V: ANALIZA E TË DHËNAVE

Grafiku Nr. 1 - Pozita punës e të anketuarve në ndërmarrjen ku punojnë


Përmes kësaj pyetjeje kemi pasur qëllim të kuptojmë pozitën e të anketuarve në ndërmarrje publike sepse ka qenë me rëndësi se nga cila pozitë e nivelit të qeverisjes janë përgjigjur të anketuarit. Sipas përgjegjjeve të pranura ka rezultuar se 72% e të anketuarve janë anëtarë të bordeve të drejtorëve, 10% janë në detyrën e kryeshefave ekzekutiv, 9% janë zyrtarë financiar dhe 9% pozita tjera si zëvendës i kryeshefit ekzekutiv.



Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 2 - Numri i të punësuarve ne ndërmarrjet publike

Me qenë se ndërmarrjet publike në Kosovë kanë numër të ndryshëm të të punësuarve, përmes kësaj pyetjeje kemi pasur qëllim që të njohetemi me faktet se sa të punësuar kanë ndërmarrjet aty ku të anketuarit janë anëtarë të bordeve të drejtorëve. Siç mund të shihet nga rezultatet 49% të tyre janë anëtarë të bordeve të drejtorëve të ndërmarrjeve publike ku të punësuar janë 51-250 të punësuar, 36% janë anëtarë të bordeve të drejtorëve të ndërmarrjeve publike ku të punësuar janë 251-1000 të punësuar deri sa vetëm 12% janë anëtarë të bordeve të drejtorëve të ndërmarrjeve publike ku të punësuar janë mbi 1000 të punësuar. Kjo tregon se ndërmarrje publike me numër të madh të punësuarve ka pak kurse pjesa më e madhe e tyre janë me numër të punësuarve nga 51-1000.




Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 3 - Veprimtaria e ndërmarrjeve publike në Kosovë


Ka qenë e rëndësishme të kuptojmë se cilën veprimtari e ushtron ndërmarrja publike në të cilën i anketuari është i punësuar. Siç mund të shihet pjesëmarrja më e madhe është nga veprimtaria e furnizimit me ujë ose ujësjellësve me 38%, 12% e të anketuarve punojnë në ndërmarrjet që kanë për veprimtari ujitjen, 6% nga grumbullimi i mbeturinave, 6% transporti hekurudhor, 6% hidroekonomike, 6% infrastruktura hekurudhore, 6% transmissioni dhe tregu i energjisë, 5% energjia, 5% telekomunikacioni, 5% shërbime postare, 4% shërbimet e navigimit dhe transportit ajror, dhe 1% tjetër.

Burimi: Autori (2015)



Grafiku Nr. 4 - Shfrytëzuesit e shërbimeve publike


Për hulumtimin tonë ka qenë me rëndësi të kuptojmë se ndërmarrjet publike kujt i ofrojnë shërbime publike, me qenë se kryesisht problemet e mos arkëtimit të hyrave janë ngushtë të lidhura me faktin se për kë ofrohen shërbimet publike. Ndërmarrjet publike të cilat ofrojnë shërbime për persona fizik pjesa e shërbimeve që i ofrohen drejtpërdrejt qytetarit (energji elektrike, uji, mbeturinat, ngrohja, transporti, etj.) një pjesë e tyre arkëtohet me vështirësi apo nuk arkëtohet fare dhe kjo ka ndikim domethënës në zhvillimin e veprimtarisë. Bazuar ne rezultatet e hulumtimit 68% e ndërmarrjeve publike ju ofrojnë shërbime ndërmarrjeve publike, bizneseve private dhe personave fizik, 19% bizneseve private dhe personave fizik, 11% ndërmarrjeve publike, 4% kompanive të huaja, 3% ndërmarrjeve publike dhe personave fizik, ndërsa 1% e ndërmarrjeve publike ju ofrojnë shërbime vetëm personave fizik.



Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 5 - Ndërmarrjet publike si ofrues të vetëm të shërbimit


Kemi dashur të kuptojmë se si e shohin ndërmarrjen e tyre si operator i vetëm i këtij lloj shërbimi në kushtet e kufizimit të tregut, mungesës së konkurrencës dhe të caktimit të çmimeve nga autoriteti rregullativ. Kështu, 51% e mendojnë si pozitë të favorshme, 22% janë neutral, 14% si shumë të favorshme, 10% të disfavorshme, deri sa 3% e shohin si të disfavorshme situatën kur ndërmarrja publike është operator i vetëm i shërbimit.



Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 6 - Tarifat e shërbimeve të NP-ve të caktuara nga Zyra Rregullatore


Nga këndvështrimi i tyre se çka mendojnë për çmimet e caktuara nga rregullatori pjesa më e madhe apo 70% mendojnë se ato çmime janë mesatare, 27% mendojnë se janë të ulëta, 2% shumë të ulëta, dhe 1% shumë të larta.



Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 7 - Përvoja në qeverisjen korporative para se të themelohen NP


Përvoja paraprake e anëtarëve të Bordeve të Drejtorëve në qeverisjen korporative ka qenë një informatë e rëndësishme për ne që të kemi një pasqyrë në lidhje me plotësimin e kërkesave ligjore për përvojën e nevojshme të anëtarëve të cilët janë zgjedhur anëtarë të bordeve të drejtorëve si dhe përvoja e tyre në dhënjën e përgjegjjeve për pyetësor. Siç mund të shihet më poshtë nga paraqitja grafike pjesa më e madhe e tyre apo 57% nuk kanë pasur përvojë të mëparshme në qeverisjen korporative para themelimit të ndërmarrjeve publike, 16% kanë pasur përvojë paraprake, 15% kanë pasur përvojë paraprake por jo në NP, dhe 12% kanë pasur pak.



Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 8 - Përvoja si anëtar i Bordit të Drejtorëve të NP-ve

Në vazhdimësi të përgjegjjes paraprake kemi informata se 80% e tyre asnjëherë më parë nuk kanë qenë anëtar të Bordit të Drejtorëve në ndonjë ndërmarrje publike, 16% e të anketuarve kanë qenë anëtarë të Bordit të Drejtorëve në ndonjë ndërmarrje publike, dhe 4% nuk kanë qenë anëtar të Bordit të Drejtorëve por jo në NP.




Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 9 - Njohuri për NP para emërimit si anëtarë i Bordit të Drejtorëve

Me qenë se NP kanë vepruar në formën e tanishme organizative vetëm pas aprovimit të Ligjit për ndërmarrjet publike, kemi pasur qëllim që të kuptojmë se sa anëtarët e bordeve të drejtorëve kanë pasur njohuri për ndërmarrjet publike para se ata të emërohen në këto pozita. Prandaj, 30% janë përgjigjur se kanë pasur njohuri për veprimtarinë e tyre, 29% kanë pasur njohuri të përgjithshme dhe 26% prej tyre kanë theksuar se e kanë ditur se ato ndodhen para shumë sfidave, 6% e të anketuarve kanë deklaruar se nuk i kanë ditur


vështirësitë, 5% kanë deklaruar që kanë pasur njohuri fillestare, kurse 4% kanë deklaruar kam menduar se nuk është aq e ndërlikuar.



Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 10 - Ndryshimet ligjore për funksionim më të mirë të NP-ve


Në pyetjen se a mendoni se duhet të bëhen ndryshime ligjore për funksionim më të mirë të NP-ve, 54% janë përgjigjur se duhet të bëhen ndryshime, 20% se ligji duhet të ndryshohet vetëm për kompetencat e Bordit të Drejtorëve, 17% se duhet të zbatohet ligji, dhe 9% se ligji duhet të ndryshohet vetëm te kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv (Kryeshefit Ekzekutiv).



Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 11 - Ndryshime ligjore për zgjedhjen e drejtorit ekzekutiv që të ruhet pavarësia e tij

Me qëllim që të ruhet pavarësia e Drejtorit Ekzekutiv (Kryeshefit Ekzekutiv) nga Bordi, 29% prej tyre mendojnë se Drejtorit Ekzekutiv (Kryeshefit Ekzekutiv) duhet të zgjidhet nga kompania e jashtme e specializuar për këto punë, 25% të zgjidhet nga paneli i ekspertëve nga bota akademike, 20% pajtohen se duhet bërë ndryshime, 17% janë kundër ndryshimeve, deri sa vetëm 9% përkrahin qëndrimin që Drejtori Ekzekutiv (Kryeshefi Ekzekutiv) të mos zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve.




Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 12 - Format më efikase të organizimit të NP-ve në ofrimin e shërbimeve publike

Si formë më efikase të organizimit të NP-ve për ofrimin e shërbimeve publike respondentët kanë dhënë këto përgjegje: 38% mendojnë që të vazhdojë si NP, 36% përkrahin


organizimin si partneritet publiko-privat, 12% mendojnë se duhet të riorganizohen, 8% e shohin privatizimin e tyre si zgjidhje, 4% mendojnë se dhënia me koncesion është zgjidhja deri sa 2% përkrahin ndonjë formë tjetër e ndryshme nga këto të përmendura më lartë.



Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 13 - Arkëtimi i të hyrave në NP për periudhën 2013-2015

Se cili është niveli i arkëtimit të hyrave të faturuara më parë në NP kemi marrë përgjegjje si vijon: 35% prej të anketuarve kanë dhënë nivelin prej 65-75%, 28% janë deklaruar se arkëtimet janë 75-85%, 20% kanë theksuar nivelin prej 55-65%, 14% deri në 90% dhe vetëm 3% kanë deklaruar se 100% arkëtojnë të hyrat e faturuara.



Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 14 - Faktorët që ndikojnë në rritjen e arkëtimit të NP

Në pyetjen drejtuar anketuesve në lidhje me faktorët që ndihmojnë në rritjen e arkëtimit kemi paraparë që të klasifikohet secili faktor bazuar në vlerësimin e anketuesit. Kështu, 11.20 % e të anketuarve pajtohen plotësisht se reklamat televizive ndihmojnë në rritjen e arkëtimit, 24.30% kanë zgjedhur pajtohem, 2.80% kanë zgjedhur asnjëherë, 26.20% janë përcaktuar për pjesërisht pajtohem, dhe 35.50 % nga të anketuarit nuk pajtohen që reklamat televizive mund të ndikojnë në rritjen e arkëtimit.

Në pyetjen se sa ndikojnë këshillimet me qytetare në rritjen e arkëtimit, 9.30% të të anketuarve pajtohen plotësisht se këshillimi me qytetare ndihmon në rritjen e arkëtimit, 30.80% të anketuarve zgjedhën pajtohen që këshillimi me qytetarë ndihmon në rritjen e arkëtimit, 3.70% nga të anketuarit nuk janë të vendosur nëse këshillimi me qytetarë ndihmon në rritjen e arkëtimit, 32.70% të anketuarve pajtohen pjesërisht që këshillimi me qytetarë ndihmon në rritjen e arkëtimit, ndërsa 23.40% nga të anketuarit nuk pajtohen që këshillimi me qytetarë mund të ndihmojë në rritjen e arkëtimit të ndërmarrjet publike.

Ndërmjet këtij pyetësi ishte gjithashtu me rëndësi të kuptojmë nëse ndërrimi i arkëtarëve do të ndihmonte në rritjen e arkëtimit të ndërmarrjeve publike. Kështu, 17.80% e të anketuarve pajtohen plotësisht se ndërrimi arkëtarëve ndihmon rritjen e arkëtimit në ndërmarrje publike, 38.30% të anketuarve pajtohen se ndërrimi i arkëtarëve ndihmon në rritjen e arkëtimit, 20.60% të anketuarve nuk janë të përcaktuar nëse ndërrimi i arkëtarëve ndihmon rritjen e arkëtimit, 15.90% pajtohen pjesërisht që ndërrimi i arkëtarëve ndihmon

në rritjen e arkëtimit, ndërsa 7.50% nuk pajtohen që ndërrimi i arkëtareve ndihmon në rritjen e arkëtimit.

Në pyetjen tjetër drejtuar te anketuarve ishte gjithashtu me rëndësi të kuptojmë më shumë në lidhje me efikasitetin e gjykatave si ndihmesë në rritjen e arkëtimit. Kështu, 2.80% kanë zgjedhur pajtohem plotësisht, 16.80 % pajtohem, 7.50% asnjëherë, 26.20% kanë zgjedhur pjesërisht pajtohem, ndërsa 46.70% te anketuarve nuk pajtohen që efikasiteti i gjykatave mund të ndihmojë rritjen e arkëtimit në ndërmarrje publike.


Në pjesën tjetër të pyetësorit kemi tentuar të kuptojmë nëse ashpërsimi i ligjeve mund të ndihmojë në rritjen e arkëtimit. Në këtë mënyrë, 8.40% e të anketuarve kanë zgjedhur pajtohem plotësisht, 29.90% kanë zgjedhur pajtohem, 10.30% e të anketuarve kanë zgjedhur asnjëherë, 27.10% të anketuarve pajtohen pjesërisht, ndërsa 24.30% të anketuarve nuk pajtohen se ashpërsimi i ligjeve mund të ndihmojë në rritjen e arkëtimit.

Në pyetjen se sa ndihmon bashkëpunimin me policinë në rritjen e arkëtimit, 12.10% të anketuarve pajtohen plotësisht se ky lloj bashkëpunimi mund të ndihmojë rritjen e arkëtimit, 44.90% kanë zgjedhur pajtohem, 8.40% kanë zgjedhur asnjëherë, 20.60% pajtohem pjesërisht, ndërsa 14% nga të anketuarit nuk pajtohen që bashkëpunimi me policinë ndihmon rritjen e arkëtimit.

Angazhimi i kompanisë së jashtme që do të merret vetëm me arkëtimin e të hyrave ishte gjithashtu pjesë e rëndësishme e pyetësorit ku 15.90% nga të anketuarit kanë zgjedhur

pajtohem plotësisht, 29% kanë zgjedhur pajtohem, 4.70% kanë zgjedhur asnjnës, 19.60% pajtohen pjesërisht, ndërsa 30.80% nuk pajtohen se angazhimi i kompanisë së jashtme që do të merret vetëm me arkëtimin e te hyrave do te ndihmonte rritjen e arkëtimit.

Në pyetjen drejtuar të anketuarve se sa pajtohen që rritja e pikave te arkëtimit ndihmon rritjen e arkëtimit, 8.40% e të anketuarve kanë deklaruar se pajtohen plotësisht, 33.60% kanë zgjedhur pajtohem, 1.90% kanë zgjedhur asnjnës, 36.40% janë përcaktuar që pajtohen pjesërisht, ndërsa 19.60% e të anketuarve nuk pajtohen që rritja e pikave të arkëtimit mund të ndihmoj në rritjen e arkëtimit të ndërmarrjeve publike në Kosovë.




Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 15 - Afatet e pagesës së detyrimeve nga NP-të

Në këtë pjesë të pyetësorit ne ishim të interesuar të kuptojmë më shumë në lidhje me afatet e detyrimeve të ndërmarrjeve. Nga përgjegjjet e pranura nga të anketuarit del se 1% e tyre


besojnë se afatet e pagesës së detyrimeve nga ndërmarrjet janë shumë të shkurtëra, 4% të anketuarve mendojnë se afatet e pagesës së detyrimeve nga ndërmarrjet janë të shkurtëra, 43% nga të anketuarit mendojnë se këto afate janë mesatare, 9% besojnë se afatet janë të gjata, dhe 43 % e të anketuarve besojnë që afatet e pagesës së detyrimeve nga ndërmarrjet janë mjaft të gjata.



Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 16 - Flukset monetare (rrjedhat e parasë) në NP


Pjese e rëndësishme e pyetësorit ishte gjithashtu të kuptojmë se cilat janë flukset monetare (rrjedha e parasë) në ndërmarrjet publike. Nga përgjegjjet që kemi marrë nga të anketuarit del se 43% e tyre mendojnë se flukset monetare (rrjedha e parasë) në ndërmarrje publike janë të pavolitshme, 24% e të anketuarve mendojnë se flukset monetare (rrjedha e parasë) në ndërmarrjet publike janë të volitshme, 19% e të anketuarve besojnë se janë mesatare, 11% shumë të pavolitshme, ndërsa vetëm 3% e të anketuarve besojnë se flukset monetare (rrjedha e parasë) në ndërmarrjet publike janë shumë të volitshme.



Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 17 - Ndikimi i partneritetit publiko-privat në NP në Kosovë

Pjesë e këtij pyetësori ishte edhe ndikimi i partneritetit publiko-privat në ndërmarrjet publike në Kosovë. Është me rëndësi të theksohet se 46 % e të anketuarve besojnë se partneriteti publiko-privat do të ndikonte pozitivisht në ndërmarrjet publike, 24% e të anketuarve nuk dijnë nëse partneritetit publiko-privat do të ndikonte te ndërmarrjet publike, 16% e të anketuarve besojnë se ky lloj partneriteti do të kishte efekt negativ në ndërmarrjet publike, 12% e të anketuarve konsiderojnë se partneritetit publiko-privat do të ishte shumë pozitiv për ndërmarrjet publike kurse 2% e të anketuarve ndajnë mendimin që partneriteti publiko-privat do të ishte shumë negativ për ndërmarrjet publike.



Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 18 - Vështirësitë e ndërmarrjeve publike dhe ballafaqimi me këto vështirësi

Pjesë tjetër e rëndësishme e pyetësorit është pjesa e vështirësive që kanë ndërmarrjet publike në pagesën e detyrimeve afatshkurtëra. Kështu, 43.90 % e të anketuarve mendojnë që ndërmarrjet publike kanë shpesh vështirësi në pagesën e detyrimeve afatshkurta, 23.40% e të anketuarve mendojnë që ndërmarrjet publike kanë rrallë vështirësi në pagesën e detyrimeve afatshkurta, 16.80% e të anketuarve mendojnë që mesatarisht kanë vështirësi, 14% e të anketuarve mendojnë që shumë rrallë ndërmarrjet publike kanë vështirësi në pagesën e detyrimeve afatshkurta, ndërsa 1.90% e të anketuarve mendojnë që ndërmarrjet publike kanë gjithnjë vështirësi në pagesën e detyrimeve afatshkurta.


Me anë të këtij pyetësori ishte gjithashtu me rëndësi të kuptojmë nëse ndërmarrjet publike janë paditur nga furnitorët për mospagesë sipas afatit. Kështu, 34.60% e të anketuarve mendojnë që ndërmarrjet publike rrallë janë paditur për mospagesë të furnitorëve sipas afatit, 31.80% e të anketuarve mendojnë që shumë rrallë, 22.40% e të anketuarve mendojnë

që ndërmarrjet publike shpesh janë paditur për mospagesë të furnitorëve sipas afatit, 10.30% mendojnë që mesatarisht, kurse 0.90% besojnë që gjithnjë ndërmarrjet publike janë paditur për mospagesë të furnitorëve sipas afatit.

Në pyetjen se a kanë ndërmarrjet publike vështirësi në pagesën e pagave për të punësuarit, 31.80% e të anketuarve mendojnë që shumë rrallë kanë vështirësi në pagesën e pagave për të punësuarit, 31.80% e të anketuarve mendojnë që rrallë, 26.20% e të anketuarve mendojnë që shpesh, 7.50% mendojnë që mesatarisht kurse 2.80% e të anketuarve mendojnë që ndërmarrjet publike kanë gjithnjë vështirësi në pagesën pagave për të punësuarit.

Në pyetjen se a ju ka ndodhur që te-fshihet!!! mos të arrini të paguani kontributet pensionale për të punësuarit, 87.90% e të anketuarve kanë zgjedhur shumë rrallë, 7.50% e të anketuarve kanë zgjedhur rrallë, 7.50% e të anketuarve kanë zgjedhur mesatarisht, 2.80% e të anketuarve kanë zgjedhur shpesh, kurse 0.90 % e të anketuarve besojnë që ndërmarrjeve publike ju ndodh gjithnjë që të mos arrijnë të i paguajnë kontributet pensionale për të punësuarit.


Pyetja e pestë e paraqitur grafikisht ka për fokus marrjen e kredive nga ndërmarrjet publike nga bankat komerciale. Nga të dhënat e përpunuara del që 51.40% e ndërmarrjeve publike marrin kredi në bankat komerciale, 36.40% marrin kredi rrallë nga bankat komerciale, 7.50% marrin kredi shpesh, 2.80% marrin kredi mesatarisht, ndërsa 1.90% marrin kredi gjithnjë nga bankat komerciale.



Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 19 - Niveli i borxheve të këqija te ndërmarrjet publike


Nga ky pyetësor ishte e rëndësishme të kuptojmë gjithashtu nivelin e borxheve të këqija të ndërmarrjeve publike. Në bazë të rezultateve del që të 49% e ndërmarrjeve publike niveli i borxheve të këqija është i lartë, 22% e ndërmarrjeve publike kanë nivel të ulët të borxheve të këqija, 17% kanë mesatarisht borxhe të këqija, 6% e ndërmarrjeve publike kanë nivel shumë të ulët të borxheve të këqija, dhe 6% kanë nivel shumë të lartë të borxheve të këqija.



Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 20 - Shpenzimet e zhvlerësimit të NP-ve

Shpenzimet e zhvlerësimit bazuar në rezultatet e pyetësorit janë si ne vijim: 69% e ndërmarrjeve publike kanë shpenzime të zhvlerësimit mesatare, 22% kanë shpenzime të larta të zhvlerësimit, 4% kanë shpenzime të ulëta të zhvlerësimit, 3% kanë shpenzime shumë të larta të zhvlerësimit, kurse 2% kanë shpenzime shumë të ulëta të zhvlerësimit.



Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 21 - Likuiditeti te NP-të

Në pyetjen drejtuar të anketuarve ne lidhje me likuiditetin e ndërmarrjeve publike dhe situatat që përballem me to janë ofruar pesë pohime të ndryshme. Në pohimin e parë “ pagat e të punësuarve nuk arrijmë të i paguajmë me kohe”, 43% e të anketuarve besojnë që shumë rrallë ndodh pohimi i lartpërmendur, 30.80% e të anketuarve mendojnë që shpesh ndodh që pagat të mos paguhen me kohë, 18.70% e të anketuarve janë përcaktuar për rrallë, 5.60% e të anketuarve kanë zgjedhur mesatarisht, kurse 1.90% e të anketuarve kanë zgjedhur opcionin gjithnjë.

Në pohimin e dytë “detyrimet vazhdojnë të rriten nga viti në vit”, 41.10% e të anketuarve kanë deklaruar që në ndërmarrjet e tyre gjithnjë obligimet rriten nga viti ne vit, 20.60% mendojnë që mesatarisht ndodhë që obligimet të rriten nga viti në vit në ndërmarrjen ku punojnë, 15.90 e të anketuarve besojnë që shpesh obligimet rriten nga viti në vit në ndërmarrjen ku punojnë, 11.20% e të anketuarve besojnë që rrallë, kurse 11.20% e të anketuarve janë deklaruar që detyrimet rriten shume rrallë nga viti në vit në ndërmarrjen ku punojnë.


Në pohimin e tretë ” Jo, kryesisht detyrimet e arritura i paguajmë sipas afatit për pagesë”, 28% e të anketuarve kanë zgjedhur shumë rrallë, 23.40% e të anketuarve kanë zgjedhur rrallë, 22.40% e të anketuarve kanë zgjedhur shpesh, 15% e të anketuarve kanë zgjedhur mesatarisht, kurse 11.20% e të anketuarve janë përcaktuar për opcionin gjithnjë.

Në pohimin e katërtë “shpesh nuk kemi mjete për pagesën e shpenzimeve operative”, 41.10% e të anketuarve janë deklaruar që ndërmarrja ku punojnë përballet shpesh me situatë të këtillë, 25.20% e të anketuarve janë deklaruar që ndërmarrja ku punojnë shumë rrallë përballet me situatën e cekur në pohimin e mësipërm, 19.60% e të anketuarve janë deklaruar që rrallë ndodh që në ndërmarrjen ku punojnë mos të kenë mjete për pagesën e shpenzimeve operative, 9.30% e të anketuarve janë përcaktuar për opsionin mesatarisht, ndërsa 3.70 e të anketuarve kanë deklaruar që gjithnjë ju ndodh që në ndërmarrjen ku punojnë të mos kenë mjete për pagesën e shpenzimeve operative.

Në pohimin e pestë ”Detyrohemi të kërkojmë mbitërheqje bankare për tejkalimin e situatës”, 30.80% e të anketuarve kanë deklaruar që kjo ndodhë shumë rrallë në ndërmarrjet ku ata punojnë, 27.10% e të anketuarve kanë deklaruar që rrallë detyrohen të kërkojmë mbitërheqje bankare për tejkalimin e situatës, 24.30% e të anketuarve kanë deklaruar që ndodh shpesh të ndodhen në situatë si në pohimin e mësipërm, 13.10% e të anketuarve janë deklaruar që ndodh mesatarisht, ndërsa 4.70 e të anketuarve kanë deklaruar që ndodhë gjithnjë.

Në pohimin e gjashtë ”Kërkojmë subvencione nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik”, 34.60% e të anketuarve kanë deklaruar që ndërmarrjet ku ata punojnë kërkojnë gjithnjë subvencione nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, 20.60% e të anketuarve kanë deklaruar që ndërmarrjet ku ata punojnë kërkojnë shpesh subvencione nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik, 17.80% e të anketuarve kanë deklaruar shumë rrallë, 16.80% e të anketuarve

kanë deklaruar rrallë, ndërsa 10.30% e të anketuarve besojnë që ndërmarrja ku ata punojnë kërkon mesatarisht subvencione nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik.



Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 22 - Kostot e shërbimeve të NP-ve


Pjesë tjetër e rëndësishme e këtij pyetësi janë kostot e shërbimeve të ndërmarrjeve publike. Në pohimin e parë “janë shumë të larta nga se ka shumë shpenzime administrative” 35.50% e të anketuarve pajtohen plotësisht me këtë pohim, 33.60% e të anketuarve kanë zgjedhur opSIONIN shumë, 21.50% e të anketuarve kanë zgjedhur opSIONIN pak, 5.60% e të anketuarve kanë zgjedhur opSIONIN asnjans, ndërsa 3.70% e të anketuarve kanë zgjedhur opSIONIN aspak.

Në pohimin e dytë “mund të ishin të ulëta sikur pagat të ishin me të ulëta”, 38.30% e të anketuarve kanë zgjedhur opSIONIN shumë, 33.60% e të anketuarve kanë zgjedhur opSIONIN

plotësisht, 15.90% e të anketuarve kanë zgjedhur opsionin pak, 6.50% e të anketuarve kanë zgjedhur të jene asnjans, ndërsa 5.60% kanë zgjedhur opsionin aspak.

Në pohimin e tretë “numri i madh i të punësuarve ndikon negativisht”, 38.30% e të anketuarve kanë zgjedhur opsionin plotësisht, 34.60% e të anketuarve kanë zgjedhur opsionin shumë, 10.30% e të anketuarve kanë zgjedhur opsionin pak, 8.40% e të anketuarve janë deklaruar asnjans, ndërsa 8.40% janë deklaruar aspak.

Në pohimin e katërtë “koston e rritin shpenzimet administrative”, 45.80% e të anketuarve kanë deklaruar shumë, 22.60% e të anketuarve kanë zgjedhur opsionin plotësisht, 22.40% e të anketuarve kanë zgjedhur opsionin pak, 7.50% e të anketuarve janë asnjans, ndërsa 3.70% e të anketuarve kanë zgjedhur aspak.



Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 23 - Investimet kapitale te NP-të

Në pohimin e parë “pa investime kapitale nuk mund të rritet niveli i tanishëm i cilësisë së shërbimit”, 70.10% e të anketuarve pajtohen plotësisht, 22.40% e të anketuarve kanë zgjedhur që pajtohen shume, 3.70% kanë janë deklaruar pak, 1.90% asnjë, ndërsa 1.90% e të anketuarve janë përcaktuar për opionin aspak.


Në pohimin e dytë “investimet kapitale janë të domosdoshme për përmirësimin e cilësinë se shërbimeve”, 57.90% e të anketuarve kanë zgjedhur opionin që pajtohen plotësisht, 33.60% kanë zgjedhur pajtohem shumë, 5.60% kanë zgjedhur pajtohem pak, 1.90% janë përcaktuar për asnjë, ndërsa 0.90% e të anketuarve nuk pajtohen aspak.

Në pohimin e tretë “vazhdimisht bëjmë investime kapitale për ngritjen e cilësisë se shërbimeve”, 37.40% e të anketuarve pajtohen shumë me këtë pohim, 29.90% e të anketuarve kanë zgjedhur që pajtohen pak me këtë pohim, 24.30% pajtohen plotësisht, 8.40% e të anketuarve aspak, ndërsa 3.70 janë asnjë.

Në pohimin e katërtë “vetëm investimet kapitale nuk sigurojnë ngritjen e nivelit të cilësisë se shërbimeve”, 34.60% e të anketuarve pajtohen plotësisht me këtë pohim, 28% pajtohen pak, 20.60% pajtohen shume, 11.20% janë asnjë, ndërsa 5.60% nuk pajtohen aspak me këtë pohim.

Në pohimin e pestë “me këto të hyra mezi bëjmë mirëmbajtjen operative”, 39.30% e të anketuarve pajtohen shume me këtë pohim, 22.40% pajtohen pak me këtë pohim, 18.70% pajtohen plotësisht, 14% nuk pajtohen aspak, dhe 5.60% janë asnjans.

Në pohimin e gjashtë “niveli i lartë i shpenzimeve ndikon negativisht në cilësinë e shërbimeve”, 57% e të anketuarve pajtohen plotësisht, 24.30 e të anketuarve pajtohen shumë me këtë pohim, 10.30% janë asnjans, 5.60% pajtohen pak, kurse 2.80% e të anketuarve aspak nuk pajtohen me pohimin e cekur më lartë.



Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 24 - Planifikimi i investimeve kapitale

Në pyetjen drejtuar të anketuarve në lidhur me planifikimin e investimeve kapitale janë ofruar gjashtë pohime të ndryshme. Në pohimin e parë “planifikohen gjatë përpilimit të planit të biznesit”, 76.60% e të anketuarve janë përgjigjur që pajtohen plotësisht, 15.90%

pajtohen shumë, 3.70% asnjëherë, 3.70% pak, ndërsa për opsionin aspak nuk është përcaktuar ndonjë anketues.


Në pohimin e dytë “me qene se nuk kemi burime të sigurta të financimit nuk i planifikojmë”, 29.90 e të anketuarve kanë zgjedhur që pajtohen shumë, 26.20% pajtohen pak, 25.20% aspak, 12.10% pajtohen plotësisht, ndërsa 6.50% e të anketuarve janë asnjëherë.

Në pohimit e tretë “i planifikojmë por mbështetemi në subvencione ose grante”, 32.70% e të anketuarve pajtohen plotësisht me këtë pohim, 32.70% kanë zgjedhur që pajtohen shumë, 16.80% pajtohen pak, 5.60% janë deklaruar asnjëherë, ndërsa 3.70% e të anketuarve aspak nuk pajtohen me këtë pohim.

Në pohimin e katërtë “i planifikojmë por e dimë se nuk mund të financohen vetëm nga burimet e veta”, 44.90% e të anketuarve pajtohen plotësisht me këtë pohim, 37.40% janë deklaruar që pajtohen shumë, 5.60% janë asnjëherë, 1.90% pajtohen pak me këtë pohim, ndërsa 1.90% e të anketuarve aspak nuk pajtohen me pohimin e katërtë.

Në pohimin e pestë “në mungesë të burimeve të financimit nuk kemi ndonjë strategji të veprimit”, 35.50% e të anketuarve pajtohen plotësisht me këtë pohim, 24.30% janë deklaruar që pajtohen pak, 21.50% pajtohen shumë, 14% e të anketuarve aspak nuk pajtohen me këtë pohim, ndërsa 4.70% e të anketuarve janë deklaruar asnjëherë.

Në pohimin e gjashtë “nëse arrijmë të gjejmë burime të financimit i fusim në plan të biznesit gjatë rishikimit”, 57.90% e të anketuarve pajtohen plotësisht me këtë pohim, 20.60% kanë deklaruar që pajtohen shumë, 12.10% pajtohen pak, 5.60% janë asnjëherë, ndërsa 3.70% e të anketuarve aspak nuk pajtohen me këtë pohim.



Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 25 - Planifikimi i burimeve financiare të NP-të

Pjesë tjetër e rëndësishme e këtij pyetësi është gjithashtu pjesa e planifikimit të burimeve financiare. Në këtë pjesë janë ofruar gjashtë pohime të ndryshme lidhur me planifikimin financiar. Në pohimin e parë “janë marrë parasysh gjatë përpilimit të buxhetit vjetor”, 72% e të anketuarve pajtohen plotësisht me këtë pohim, 24.30% pajtohen shumë, 1.90% janë asnjëherë, 1% pajtohen pak me këtë pohim, ndërsa për optionin aspak nuk është përcaktuar asnjë .

Në pohimin e dytë “nuk kemi ndonjë njësi të veçantë brenda ndërmarrjes”, 38.30% e të anketuarve aspak nuk pajtohen me këtë pohim, 23.40% pajtohen pak, 23.40% janë


asnjanës, 19.60 % e të anketuarve pajtohen shumë me këtë pohim, ndërsa 10.30% e të anketuarve pajtohen plotësisht me këtë pohim.

Në pohimin e tretë “zakonisht i planifikojmë në kuadër të planit të biznesit” 41.10% e të anketuarve pajtohen plotësisht me këtë pohim, 41.10 pajtohen shume, 2.80% pajtohen pak, 1.90% e të anketuarve kanë zgjedhur të deklarohen që nuk pajtohen aspak, ndërsa 0.90% janë deklaruar asnjanës.

Në pohimin e katërtë “janë të specifikuar ne pasqyrën e flukseve monetare”, 56.10% e të anketuarve pajtohen plotësisht me këtë pohim, 34.60% e të anketuarve pajtohen shumë me këtë pohim, 6.50% janë asnjanës, 2.80% janë deklaruar asnjanës, ndërsa për opsionin aspak nuk kemi asnjë anketues të deklaruar.

Në pohimin e pestë “në mungesë të burimeve financiare nuk kemi ndonjë strategji të veprimit” 54.20% e të anketuarve pajtohen plotësisht me këtë pohim, 35.50% e të anketuarve pajtohen shumë, 6.50% pajtohen pak, 3.70% janë asnjanës, ndërsa ne opsionin aspak nuk kemi të deklaruar.


Në pohimin e gjashtë “nuk ka ndonjë strategji afatgjate” , 27.10% e të anketuarve pajtohen plotësisht me këtë pohim, 25.20% pajtohen pak, 23.40% e të anketuarve pajtohen shumë, 15.90% aspak nuk pajtohen me këtë pohim, ndërsa 8.40% e të anketuarve janë deklaruar asnjëherë.



Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 26 - Kthimi në aktive gjatë periudhës 2013-2015 te NP-të


Në pyetjen se sa është kthimi në aktive (Return On Assets-ROA) gjatë periudhës 2013-2015 rezulton se në 56% te ndërmarrjeve publike është deri në 2%, ne 34% të ndërmarrjeve publike është më e madhe se 2% por më e vogël se 5%, ndërsa në 10% të ndërmarrjeve publike është minimalisht 5%.



Burimi: Autori (2015)

Grafiku Nr. 27 - Kthimi në kapitale të veta gjatë periudhës 2013-2015 te NP-të

Në pyetjen se sa është kthimi në kapitale të veta (Return On Equity-ROE) gjatë periudhës 2013-2015 rezulton se në 67% të ndërmarrjeve publike është deri në 10%, në 24% të ndërmarrjeve publike është më e madhe se 10% por më e vogël se 15%, kurse në 9% të ndërmarrjeve publike është minimalisht 15%.



Burimi: Autori (2015)

5.1 Tabelat e kryqëzuara

Tabela Nr. 16 - Veprimtaria dhe pozita e juaj si operator i vetëm i këtij lloj shërbimi

		1=Shumë e disfavorshme, deri 5=shumë e favorshme					Total
		1	2	3	4	5	
1= Energjia,	1	0 .0%	1 .9%	1 .9%	4 3.7%	0 .0%	6 5.6%
2= Transmisioni dhe tregu,	2	1 .9%	0 .0%	0 .0%	2 1.9%	3 2.8%	6 5.6%
3=Telekomunikacioni,	3	0 .0%	1 .9%	3 2.8%	1 .9%	0 .0%	5 4.7%
4=Shërbime të navigimit dhe kontrollit ajror,	4	0 .0%	0 .0%	3 2.8%	1 .9%	0 .0%	4 3.7%
5=Shërbime postare,	5	0 .0%	0 .0%	2 1.9%	2 1.9%	1 .9%	5 4.7%
6=Hidroekonomike,	6	0 .0%	1 .9%	1 .9%	5 4.7%	0 .0%	7 6.5%
7=Infrastruktura hekurudhore,	7	0 .0%	2 1.9%	0 .0%	3 2.8%	1 .9%	6 5.6%
8=Transporti hekurudhor,	8	1 .9%	0 .0%	0 .0%	5 4.7%	0 .0%	6 5.6%
9=Furnizim me ujë - Ujësjiellës,	9	0 .0%	4 3.7%	12 11.2%	17 15.9%	8 7.5%	41 38.3%
10=Grumbullim i mbeturinave,	10	1	2	1	3	0	7

		.9%	1.9%	.9%	2.8%	.0%	6.5%
11=Ujitja,	11	0	0	1	10	2	13
		.0%	.0%	.9%	9.3%	1.9%	12.1%
12 =	12	0	0	0	1	0	1
12=Tjetër		.0%	.0%	.0%	.9%	.0%	.9%
Total		3	11	24	54	15	107
		2.8%	10.3%	22.4%	50.5%	14.0%	100.0%

Burimi: Autori (2015)

Siç mund të shihet nga tabela më lartë 50.5% e të anketuarve e konsiderojnë si të favorshme pozitën e ndërmarrjes së tyre si operator i vetëm i një shërbimi që në fakt shpjegon mungesën e konkurrencës dhe pozitës monopoliste të ndërmarrjeve publike për të cilat shpesh kritikohen nga analistë të mjedisit për të bërë biznes. Megjithatë një pjesë e të anketuarve apo 22.4% e tyre përkundrazi e konsiderojnë si mesatare pozitën e ndërmarrjes së tyre si operator i vetëm i një shërbimi deri sa 14.0% e të anketuarve e vlerësojnë të favorshme këtë pozitë për ndërmarrjen e tyre kurse vetëm 10.3% e të anketuarve e vlerësojnë të disfavorshme dhe vetëm 2.8% shumë të disfavorshme.

Kritikët e pozitive favorizuese me karakteristika monopoliste shpesh herë e theksojnë mospajtimin e tyre me pozita të këtilla të ndërmarrjeve publike duke theksuar të metat sikurse janë sjelljet e Drejtimeve të këtyre ndërmarrjeve, mbipunësimin, pritjet nga shteti

për subvencionime, korrupsionin, mosdhënje të llogarisë për performancë të pasuksesshme dhe defekte tjera të cilat janë të shprehura te NP.

Tabela Nr. 17 - Veprimtaria dhe tarifat e shërbimeve nga Zyra e Rregullatorit

		1=Shumë të ulëta, deri 5=Shumë të larta				Total
		1	2	3	5	
1= Energjia,	Frekuencat	0	1	5	0	6
	% of Total	.0%	.9%	4.7%	.0%	5.6%
2= Transmisioni dhe tregu,	Frekuencat	0	2	4	0	6
	% of Total	.0%	1.9%	3.7%	.0%	5.6%
3=Telekomunikacioni,	Frekuencat	0	1	4	0	5
	% of Total	.0%	.9%	3.7%	.0%	4.7%
4=Shërbime të navigimit dhe kontrollit ajror,	Frekuencat	0	0	4	0	4
	% of Total	.0%	.0%	3.7%	.0%	3.7%
5=Shërbime postare,	Frekuencat	1	1	3	0	5
	% of Total	.9%	.9%	2.8%	.0%	4.7%
6=Hidroekonomike,	Frekuencat	0	2	5	0	7
	% of Total	.0%	1.9%	4.7%	.0%	6.5%
7=Infrastruktura hekurudhore,	Frekuencat	0	1	5	0	6
	% of Total	.0%	.9%	4.7%	.0%	5.6%
8=Transporti hekurudhor,	Frekuencat	0	3	3	0	6
	% of Total	.0%	2.8%	2.8%	.0%	5.6%
9=Furnizim me ujë -	Frekuencat	1	10	29	1	41

Ujësjiellës,	% of Total	.9%	9.3%	27.1%	.9%	38.3%
10=Grumbullim i mbeturinave,	10 Frekuencat	0	3	4	0	7
	% of Total	.0%	2.8%	3.7%	.0%	6.5%
11=Ujitja,	11 Frekuencat	0	5	8	0	13
	% of Total	.0%	4.7%	7.5%	.0%	12.1%
12=Tjetër	12 Frekuencat	0	0	1	0	1
	% of Total	.0%	.0%	.9%	.0%	.9%
Total	Frekuencat	2	29	75	1	107
	% of Total	1.9%	27.1%	70.1%	.9%	100.0%

Burimi: Autori (2015)

Lidhur me tarifatat e shërbimeve të cilat janë të caktuara nga zyrtat rregullatore për veprimtari të ndryshme (energji, ujë, mbeturina, etj.) dhe niveli i tyre mund të ketë ndikim në shpenzimet e ndërmarrjes dhe në nivelin e cilësisë por edhe sasisë së shërbimeve, 70.1% e të anketuarve janë deklaruar se ato janë mesatare kurse 27.1% e tyre kanë vlerësuar se janë të ulëta. Duke krahasuar veprimtaritë vërejmë se vetëm nga veprimtaria e furnizimit me ujë-ujësjiellësve ka pasur deklarime prej 2.4% se tarifatat e shërbimeve të caktuara nga zyrtat rregullatore janë shumë të larta e që në nivelin e përgjithshëm të ndërmarrjeve del të jetë 0.9%. Në anën tjetër vetëm 1.9% e të anketuarve janë deklaruar se ato janë shumë të ulëta.

Tabela Nr. 18 - Veprimtaria dhe cila formë e organizimit të NP-ve është më efektive

		1=Privatizimi, 2=Riorganizimi, 3=Koncesionimi. 4=Te vazhdoj si NP, 5=Partneritet PP, 6=Forme tjeter						Total
		1	2	3	4	5	6	
		Frekuencat	Frekuencat	Frekuencat	Frekuencat	Frekuencat	Frekuencat	
1= Energjia,	Frekuencat	0	1	0	4	1	0	6
	%	.0%	16.7%	.0%	66.7%	16.7%	.0%	100.0%
2= Transmisioni dhe tregu,	Frekuencat	0	0	0	4	1	1	6
	%	.0%	.0%	.0%	66.7%	16.7%	16.7%	100.0%
3=Telekomunikacioni,	Frekuencat	1	1	2	0	1	0	5
	%	20.0%	20.0%	40.0%	.0%	20.0%	.0%	100.0%
4=Shërbime të navigimit dhe kontrollit ajror,	Frekuencat	2	0	2	0	0	0	4
	%	50.0%	.0%	50.0%	.0%	.0%	.0%	100.0%
5=Shërbime postare,	Frekuencat	0	1	0	1	3	0	5
	%	.0%	20.0%	.0%	20.0%	60.0%	.0%	100.0%
6=Hidroekonomike,	Frekuencat	1	2	0	4	0	0	7
	%	14.3%	28.6%	.0%	57.1%	.0%	.0%	100.0%
7=Infrastruktura hekurudhore,	Frekuencat	0	0	0	5	1	0	6
	%	.0%	.0%	.0%	83.3%	16.7%	.0%	100.0%
8=Transporti hekurudhor,	Frekuencat	0	1	0	3	2	0	6
	%	.0%	16.7%	.0%	50.0%	33.3%	.0%	100.0%
9=Furnizim me ujë - Ujësjiellës,	Frekuencat	3	5	0	11	21	1	41
	%	7.3%	12.2%	.0%	26.8%	51.2%	2.4%	100.0%
10=Grumbullim i mbeturinave,	Frekuencat	1	2	0	1	3	0	7
	%	14.3%	28.6%	.0%	14.3%	42.9%	.0%	100.0%

11=Ujitja,	Frekuencat	0	0	0	8	5	0	13
	%	.0%	.0%	.0%	61.5%	38.5%	.0%	100.0%
12=Tjetër	Frekuencat	0	0	0	0	1	0	1
	%	.0%	.0%	.0%	.0%	100.0%	.0%	100.0%
Total	Frekuencat	8	13	4	41	39	2	107
	%	7.5%	12.1%	3.7%	38.3%	36.4%	1.9%	100.0%

Burimi: Autori (2015)

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	100.503 ^a	55	.000
Likelihood Ratio	79.372	55	.017
Linear-by-Linear Association	3.164	1	.075
N of Valid Cases	107		

a. 70 cells (97.2%) have expected Frekuenca less than 5. The minimum expected Frekuenca is .02.

Burimi: Autori (2015)

Nga të dhënat e tabelave të kryqëzuara mund të vërehet se pjesa më e madhe e të anketuarve pajtohen se dy forma të organizimit janë më efikase për funksionimin e NP-ve: të vazhdoj me formën e organizimit si NP për të cilën janë deklaruar 38.3% e të anketuarve dhe për formën e organizimit si partneritet publiko-privat janë deklaruar 36.4% e të anketuarve, pavarësisht prej veprimtarisë së ndërmarrjes. Ndërsa 7.5% e të anketuarve pajtohen se si formë e përshtatshme o organizimit do të ishte privatizimi, 12.1% mendojnë se do të ishte më mirë të riorganizohen, ndërsa koncesionimin si mundësi të organizimit të

NP e deklarojnë vetëm 3.7% deri sa për ndonjë formë tjetër të mundshme të organizimit të NP-ve janë deklaruar vetëm 1.9% e të anketuarve.

Megjithatë, analiza 'Chi-Square' vërteton se ka dëshmi të fuqishme të marrëdhënieve në mes të llojit të veprimtarisë së ndërmarrjes publike dhe qëndrimit se cilën formë të organizimit drejtimi i kompanisë e vlerëson më efektive, pasi që vlera e provës statistikore e 'Pearson-Chi-square' është në nivelin shumë të lartë = 100.503, me shkallën e lirisë 'df'=55, dhe vlera $p < 0.05$ (0.000) apo rëndësi absolute statistikore. Prandaj, meqenëse vlera e p është më e vogël se 0.05 analiza tregon se ka marrëdhënie të rëndësishme statistikore (varësi) në mes llojit të veprimtarisë dhe formës së preferuar të organizimit.

Rezultatet e përgjigjeve japin një pasqyrë të veprimtarive të cilat ballafaqohen me nivelin e ulët të arkëtimit pasi që siç mund të shihet pjesa më e madhe e përgjegjeve nga të anketuarit që janë nga këto veprimtari të cilat kanë preferuar që ndërmarrja të vazhdojë të funksionojë si NP, p.sh. energjia 66.7%, hidroekonomike 57.1%, infrastruktura hekurudhore 81.3%, transporti hekurudhor 50% dhe ujitja 61.5%. Është interesante se vetëm nga veprimtaria e telekomunikacionit 50.0% dhe shërbimet e navigimit dhe kontrollit ajror 40.0% janë deklaruar se përkrahin dhënjën në shfrytëzim me koncesion si formë e organizimit më efektive. Pothuaj se situatë e njëjtë është edhe sa i përket privatizimit vetëm se kemi më shumë veprimtari pasi që përveç dy veprimtarive të lartëpërmendura telekomunikacioni 20.0% dhe shërbimet e navigimit dhe kontrollit ajror 50.0% kemi edhe

përgjigje të anketuarve nga veprimtaria hidroekonomike 14.35%, furnizimi me ujë 7.3% dhe grumbullimi i mbeturinave 14.3%.

Tabela Nr. 19 - Veprimtaria dhe arkëtimi i të hyrave në NP në periudhën 2013-15

		1=55-65, 2=66-75, 3=76-85, 4=deri 90%, 5=100 e te hyrave					Total
		1	2	3	4	5	
1= Energjia,	Frekuenca	0	1	4	1	0	6
	%	.0%	16.7%	66.7%	16.7%	.0%	100.0%
2= Transmisioni dhe tregu,	Frekuenca	0	0	1	3	2	6
	%	.0%	.0%	16.7%	50.0%	33.3%	100.0%
3=Telekomunikacioni,	Frekuenca	0	0	3	2	0	5
	%	.0%	.0%	60.0%	40.0%	.0%	100.0%
4=Shërbime të navigimit dhe kontrollit ajror,	Frekuenca	0	0	2	1	1	4
	%	.0%	.0%	50.0%	25.0%	25.0%	100.0%
5=Shërbime postare,	Frekuenca	0	0	3	2	0	5
	%	.0%	.0%	60.0%	40.0%	.0%	100.0%
6=Hidroekonomike,	Frekuenca	0	1	4	2	0	7
	%	.0%	14.3%	57.1%	28.6%	.0%	100.0%
7=Infrastruktura hekurudhore,	Frekuenca	0	3	3	0	0	6
	%	.0%	50.0%	50.0%	.0%	.0%	100.0%
8=Transporti hekurudhor,	Frekuenca	1	2	3	0	0	6
	%	16.7%	33.3%	50.0%	.0%	.0%	100.0%
9=Furnizim me ujë - Ujësjellës,	Frekuenca	13	18	7	3	0	41
	%	31.7%	43.9%	17.1%	7.3%	.0%	100.0%

10=Grumbullim i mbeturinave,	Frekuenca	1	6	0	0	0	7
	%	14.3%	85.7%	.0%	.0%	.0%	100.0%
11=Ujitja,	Frekuenca	7	6	0	0	0	13
	%	53.8%	46.2%	.0%	.0%	.0%	100.0%
12=Tjetër	Frekuenca	0	0	0	1	0	1
	%	.0%	.0%	.0%	100.0%	.0%	100.0%
Total	Frekuenca	22	37	30	15	3	107
	%	20.6%	34.6%	28.0%	14.0%	2.8%	100.0%

Burimi: Autori (2015)

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	105.963 ^a	44	.000
Likelihood Ratio	103.084	44	.000
Linear-by-Linear Association	42.902	1	.000
N of Valid Cases	107		

a. 56 cells (93.3%) have expected Frekuenca less than 5. The minimum expected Frekuenca is .03.

Burimi: Autori (2015)

Nga tabela e kryqëzuar mësipërme, mund të vërehet nga përgjigjet e të anketuarve se arkëtimi i të hyrave për NP-të në përgjithësi është i shpërndarë në mes të tri grupeve të intervaleve të arkëtimeve të të hyrave prej 55-66% për të cilin janë përgjigjur 20.6% e të anketuarve, prej 66 – 76% për të cilin janë përgjigjur 34.6% e të anketuarve dhe 76 – 85% për të cilin janë përgjigjur 28.0% e të anketuarve. Për intervalin e arkëtitimit të të hyrave deri në 90% janë deklaruar vetëm 14% kurse për intervalin 100% e të hyrave të faturuara janë

deklaruar vetëm 2.8%. Që të dy intervalet shpjegojnë shumë qartë se nivelet e larta të arkëtimit deri në 90% dhe 100% e të hyrave të faturuara janë vështirë të arritshme.

Mirëpo, analiza 'Chi-Square' vërteton se ka dhënë dëshmi të fuqishme të marrëdhënieve në mes të llojit të veprimtarisë së ndërmarrjes publike dhe nivelit të arkëtimit të të hyrave, pasi që vlera e provës statistikore e 'Pearson-Chi-square' është në nivelin shumë të lartë = 105.963, me shkallën e lirisë 'df'=44, dhe vlera $p < 0.05$ (0.000) apo rëndësi absolute statistikore. Prandaj, meqenëse vlera e p është më e vogël se 0.05 analiza tregon se ka marrëdhënie të rëndësishme statistikore në mes llojit të veprimtarisë të cilën e ushtron NP dhe nivelit të arkëtimit të të hyrave.

Pra, dallimi në të hyrat e NP-ve me veprimtari të ndryshme është statistiki i rëndësishëm. Psh. nga tabela vërehet se 85.7% e të anketuarve nga ndërmarrjet e mbledhjes së mbeturinave vlerëson se arkëtimi i të hyrave nga këto ndërmarrje në periudhën 2013-15 është në nivelin 66-75% sikurse që për këtë interval janë deklaruar edhe 50.0% e të anketuarve nga infrastruktura hekurudhore deri sa 66.7% e të anketuarve në sektorin e energjisë vlerësojnë se arkëtimi i të hyrave për periudhën e apostrofuar është në intervalin e 76-85%, ndërsa 60% e të anketuarve në telekomunikacion e vlerësojnë po ashtu intervalin e njëjtë të të hyrave dhe në shkallë të njëjtë vlerësojnë edhe 57.1% e të anketuarve nga veprimtaria e hidroekonomisë.

Rezultatet nga tabela tregojnë për nivel të arkëtimit prej 55-65% të të hyrave në dy veprimtari për të cilat kanë dhënë përgjigje 31.7% e të anketuarve në veprimtarinë e ujësjellësve dhe 53.8% nga veprimtaria e ujitjes së sipërfaqeve bujqësore. Për dallim, veprimtaria e transmisionit dhe tregut intervali i arkëtimit të të hyrave është kryesisht në dy intervale: për intervalin e arkëtimit të të hyrave deri 90% janë përgjigjur 50.0% e të anketuarve kurse për intervalin deri në 100% e të hyrave të faturuara janë përgjigjur 33.3% e të anketuarve. Një karakteristikë e përbashkët për disa veprimtari siç janë infrastruktura hekurudhore, transporti hekurudhor, grumbullimi i mbeturinave ,ujitja është vlerësimi i të anketuarve se arkëtimi nuk kalon intervalin prej 76-85% apo kufiri i epërm i cili vështirë që ndonjëherë arrihet.

Tabela Nr. 20 - Veprimtaria dhe arkëtimi i të hyrave

		1=Shume rralle, 2=Rralle, 3=Mesatarisht, 4=Shpesh, 5=Gjithnje				Total
		2	3	4	5	
1= Energjia,	Frekuenca	1	0	3	2	6
	%	16.7%	.0%	50.0%	33.3%	100.0%
2= Transmisioni dhe tregu,	Frekuenca	4	1	1	0	6
	%	66.7%	16.7%	16.7%	.0%	100.0%
3=Telekomunikacioni,	Frekuenca	2	1	0	2	5
	%	40.0%	20.0%	.0%	40.0%	100.0%
4=Shërbime të navigimit dhe kontrollit ajror,	Frekuenca	0	1	1	2	4
	%	.0%	25.0%	25.0%	50.0%	100.0%
5=Shërbime postare,	Frekuenca	1	2	1	1	5

	%	20.0%	40.0%	20.0%	20.0%	100.0%
6=Hidroekonomike,	Frekuenca	2	1	3	1	7
	%	28.6%	14.3%	42.9%	14.3%	100.0%
7=Infrastruktura hekurudhore,	Frekuenca	0	0	1	5	6
	%	.0%	.0%	16.7%	83.3%	100.0%
8=Transporti hekurudhor,	Frekuenca	2	0	1	3	6
	%	33.3%	.0%	16.7%	50.0%	100.0%
9=Furnizim me ujë - Ujësjiellës,	Frekuenca	3	8	8	22	41
	%	7.3%	19.5%	19.5%	53.7%	100.0%
10=Grumbullim i mbeturinave,	Frekuenca	0	0	1	6	7
	%	.0%	.0%	14.3%	85.7%	100.0%
11=Ujitja,	Frekuenca	0	0	2	11	13
	%	.0%	.0%	15.4%	84.6%	100.0%
12=Tjetër	Frekuenca	0	0	1	0	1
	%	.0%	.0%	100.0%	.0%	100.0%
Total		15	14	23	55	107
		14.0%	13.1%	21.5%	51.4%	100.0%

Burimi: Autori (2015)

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	53.550 ^a	33	.013
Likelihood Ratio	57.375	33	.005
Linear-by-Linear Association	16.070	1	.000
N of Valid Cases	107		

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	53.550 ^a	33	.013
Likelihood Ratio	57.375	33	.005
Linear-by-Linear Association	16.070	1	.000

a. 43 cells (89.6%) have expected Frekuenca less than 5. The minimum expected Frekuenca is .13.

Burimi: Autori (2015)

Nga tabela e kryqëzuar vërehet se mbi gjysma (51.4%) e të anketuarve e konsiderojnë arkëtimin e të hyrave si sfidë që gjithnjë është duke ndikuar në cilësinë e shërbimeve të NP-ve. Sidomos është e theksuar dhe në përqindje të lartë në tri veprimtari si infrastruktura hekurudhore prej 83.3%, ujitja prej 84.6% dhe grumbullimi i mbeturinave 85.7% ndërsa në një nivel më të ulët është në veprimtaritë e transportit hekurudhor prej 50.0% dhe të ujësjellësve prej 53.7%. Gjithashtu 21.5% e të anketuarve e konsiderojnë arkëtimin e të hyrave si sfidë mjaft të shpeshtë që ndikon në cilësinë e shërbimeve publike. Në anën tjetër, 13.1% e të anketuarve janë përgjigjur se në veprimtarinë e tyre arkëtimi ndikon mesatarisht ndërsa 14.0% janë përgjigjur se ndikon rrallë ndërsa me qenë se askush nuk përgjigjur se arkëtimi i të hyrave shumë rrallë ndikon edhe nga programi nuk është gjeneruar kolona me zero.

Megjithatë, analiza 'Chi-Square' vërteton se ka dëshmi të fuqishme të marrëdhënieve në mes të llojit të veprimtarisë së ndërmarrjes publike dhe arkëtimin e të hyrave si sfidë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të NP-ve, pasi që vlera e provës statistikore e 'Pearson-

Chi-square' është në nivel mjaft të lartë = 53.550, me shkallën e lirisë 'df'=33, dhe vlera $p < 0.05$ (0.013). Prandaj, meqenëse vlera e p është më e vogël se 0.05 analiza tregon se ka marrëdhënie të rëndësishme statistikore në mes llojit të veprimtarisë dhe nivelit të arkëtimit të të hyrave si sfidë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Tabela Nr. 21 - Veprimtaria dhe flukset monetare të ndryshueshme

		1=Shume rralle, 2=Rralle, 3=Mesatarisht, 4=Shpesh, 5=Gjithnje					Total
		1	2	3	4	5	
1= Energjia,	Frekuenca	0	1	1	3	1	6
	%	.0%	16.7%	16.7%	50.0%	16.7%	100.0%
2= Transmisioni dhe tregu,	Frekuenca	0	3	2	1	0	6
	%	.0%	50.0%	33.3%	16.7%	.0%	100.0%
3=Telekomunikacioni,	Frekuenca	2	1	0	1	1	5
	%	40.0%	20.0%	.0%	20.0%	20.0%	100.0%
4=Shërbime të navigimit dhe kontrollit ajror,	Frekuenca	0	0	0	4	0	4
	%	.0%	.0%	.0%	100.0%	.0%	100.0%
5=Shërbime postare,	Frekuenca	0	1	3	1	0	5
	%	.0%	20.0%	60.0%	20.0%	.0%	100.0%
6=Hidroekonomike,	Frekuenca	0	2	3	1	1	7
	%	.0%	28.6%	42.9%	14.3%	14.3%	100.0%
7=Infrastruktura hekurudhore,	Frekuenca	0	0	0	5	1	6
	%	.0%	.0%	.0%	83.3%	16.7%	100.0%
8=Transporti hekurudhor,	Frekuenca	0	0	3	1	2	6

	%	.0%	.0%	50.0%	16.7%	33.3%	100.0%
9=Furnizim me ujë - Ujësjiellës,	Frekuenca	4	4	10	17	6	41
	%	9.8%	9.8%	24.4%	41.5%	14.6%	100.0%
10=Grumbullim i mbeturinave,	Frekuenca	0	0	0	4	3	7
	%	.0%	.0%	.0%	57.1%	42.9%	100.0%
11=Ujitja,	Frekuenca	0	0	0	8	5	13
	%	.0%	.0%	.0%	61.5%	38.5%	100.0%
12=Tjetër	Frekuenca	0	0	1	0	0	1
	%	.0%	.0%	100.0%	.0%	.0%	100.0%
Total	Frekuenca	6	12	23	46	20	107
	%	5.6%	11.2%	21.5%	43.0%	18.7%	100.0%

Burimi: Autori (2015)

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	69.175 ^a	44	.009
Likelihood Ratio	71.923	44	.005
Linear-by-Linear Association	7.559	1	.006
N of Valid Cases	107		

a. 56 cells (93.3%) have expected Frekuenca less than 5. The minimum expected Frekuenca is .06.

Burimi: Autori (2015)

Nga tabela e kryqëzuar vërehet se afër gjysma 43.0% e të anketuarve i konsiderojnë flukset monetare të ndryshueshme si sfidë të shpeshtë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të NP-ve, deri sa 21.5% e konsiderojnë si sfidë me të cilën ballafaqohen dhe që ka ndikim mesatar në

cilësinë e shërbimeve kurse 18.7% e të anketuarve kanë vlerësuar se kjo sfidë ndikon gjithnjë në nivelin e ofruar të cilësisë së shërbimeve.

Megjithatë, analiza 'Chi-Square' vërteton se ka dëshmi të fuqishme të marrëdhënieve në mes të llojit të veprimtarisë së ndërmarrjes publike dhe flukseve monetare të ndryshueshme si sfidë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të NP-ve, pasi që vlera e provës statistikore e 'Pearson-Chi-square' është në nivel të lartë = 69.175, me shkallën e lirisë 'df'=44, dhe vlera $p < 0.05$ (0.009). Prandaj, meqenëse vlera e p është më e vogël se 0.05 analiza tregon se ka marrëdhënie të rëndësishme statistikore në mes llojit të veprimtarisë dhe rangimit të flukseve monetare të ndryshueshme si sfidë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të ofruara.

Po të krahasohen veprimtaritë e NP mund të vërehet se ky ndikim i flukseve monetare ndryshon midis tyre, p.sh. deri sa niveli i flukseve i cili ndikon gjithnjë në veprimtaritë si energjia (16.7%), telekomunikacioni (20%), hidroekonomia (14.3%) dhe infrastruktura hekurudhore (16.7%) ky nivel është në shkallë më të lartë në disa veprimtari tjera si transporti hekurudhor (33.3%), mbledhja dhe deponimi i mbeturinave (42.9%), ujitja (38.5%). Por gjithashtu disa nga këto veprimtari sipas deklarimit të anketuarve, flukset monetare kanë ndikim të shpeshtë në cilësinë e shërbimeve infrastruktura hekurudhore (83.3%), ujësjellësitë (41.5%), mbledhja dhe deponimi i mbeturinave (57.1%), ujitja (61.5%).

Tabela Nr. 22 - Veprimtaria dhe likuiditeti

		1=Shume rralle, 2=Rralle, 3=Mesatarisht, 4=Shpesh, 5=Gjithnje					Total
		1	2	3	4	5	
1= Energjia,	Frekuenca	0	1	1	3	1	6
	%	.0%	16.7%	16.7%	50.0%	16.7%	100.0%
2= Transmisioni dhe tregu,	Frekuenca	1	3	1	1	0	6
	%	16.7%	50.0%	16.7%	16.7%	.0%	100.0%
3=Telekomunikacioni,	Frekuenca	0	2	2	0	1	5
	%	.0%	40.0%	40.0%	.0%	20.0%	100.0%
4=Shërbime të navigimit dhe kontrollit ajror,	Frekuenca	0	0	0	2	2	4
	%	.0%	.0%	.0%	50.0%	50.0%	100.0%
5=Shërbime postare,	Frekuenca	0	1	2	1	1	5
	%	.0%	20.0%	40.0%	20.0%	20.0%	100.0%
6=Hidroekonomike,	Frekuenca	0	3	2	2	0	7
	%	.0%	42.9%	28.6%	28.6%	.0%	100.0%
7=Infrastruktura hekurudhore,	Frekuenca	0	0	0	3	3	6
	%	.0%	.0%	.0%	50.0%	50.0%	100.0%
8=Transporti hekurudhor,	Frekuenca	0	0	2	3	1	6
	%	.0%	.0%	33.3%	50.0%	16.7%	100.0%
9=Furnizim me ujë - Ujësjiellës,	Frekuenca	2	9	9	10	11	41
	%	4.9%	22.0%	22.0%	24.4%	26.8%	100.0%
10=Grumbullim i mbeturinave,	Frekuenca	0	0	1	2	4	7
	%	.0%	.0%	14.3%	28.6%	57.1%	100.0%
11=Ujitja,	Frekuenca	0	0	0	6	7	13
	%	.0%	.0%	.0%	46.2%	53.8%	100.0%

12=Tjetër	Frekuenca	0	0	0	1	0	1
	%	.0%	.0%	.0%	100.0%	.0%	100.0%
Total	Frekuenca	3	19	20	34	31	107
	%	2.8%	17.8%	18.7%	31.8%	29.0%	100.0%

Burimi: Autori (2015)

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	47.952 ^a	44	.316
Likelihood Ratio	59.021	44	.065
Linear-by-Linear Association	7.727	1	.005
N of Valid Cases	107		

a. 56 cells (93.3%) have expected Frekuenca less than 5. The minimum expected Frekuenca is .03.

Burimi: Autori (2015)

Nga tabela e kryqëzuar vërehet se ka vlerësim të shpërndarë në mesin e të anketuarve për sa i përket rangimit të likuiditetit si një nga sfidat financiare që ndikon në cilësinë e shërbimeve të NP-ve, 17.8% e vlerësojnë si sfidë të rrallë, 18.7% si mesatare, 31.8% si të shpeshtë dhe 29% si sfidë që gjithnjë atakon cilësinë e shërbimeve të NP-ve. Po të krahasohen përgjegjjet e të anketuarve në lidhje me ndikimin e shkallës së likuiditetit në cilësinë e shërbimeve të NP-ve vërejmë se ka një afërsi të përqindjes në kolonat nëse

shkalla e likuiditetit ndikon shpesh dhe gjithnjë, p.sh. te veprimtaritë e shërbimeve të navigimit dhe kontrollit ajror ajo është (50% me 50%), shërbimet postare (20% me 20%), infrastruktura hekurudhore (50% me 50%), ujësjellësitë (24.4%-26.8%), grumbullimi i mbeturinave (28.6% me 57.1%) dhe ujitja (46.2% me 53.8%).

Analiza ‘Chi-Square’ nuk vërteton se ka dëshmi të fuqishme të marrëdhënieve në mes të llojit të veprimtarisë së ndërmarrjes publike dhe likuiditetit si sfidë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të NP-ve, pasi që vlera $p > 0.05$ (0.316) dhe vlera e ‘Pearson Chi-Square’ është mjaft e ulët.

Tabela Nr. 23 - Veprimtaria dhe borxhet e këqija

	1=Shume rralle, 2=Rralle, 3=Mesatarisht, 4=Shpesh, 5=Gjithnje					Total
	1	2	3	4	5	
1= Energjia,	0 .0%	1 16.7%	1 16.7%	3 50.0%	1 16.7%	6 100.0%
2= Transmisioni dhe tregu,	1 16.7%	4 66.7%	0 .0%	1 16.7%	0 .0%	6 100.0%
3=Telekomunikacioni,	1 20.0%	2 40.0%	0 .0%	1 20.0%	1 20.0%	5 100.0%
4=Shërbime të navigimit dhe kontrollit ajror,	0 .0%	0 .0%	0 .0%	3 75.0%	1 25.0%	4 100.0%
5=Shërbime postare,	2 40.0%	1 20.0%	1 20.0%	1 20.0%	0 .0%	5 100.0%

6=Hidroekonomike,	0	4	1	2	0	7
	.0%	57.1%	14.3%	28.6%	.0%	100.0%
7=Infrastruktura hekurudhore,	0	0	1	3	2	6
	.0%	.0%	16.7%	50.0%	33.3%	100.0%
8=Transporti hekurudhor,	0	2	2	2	0	6
	.0%	33.3%	33.3%	33.3%	.0%	100.0%
9=Furnizim me ujë - Ujësjiellës,	1	4	6	19	11	41
	2.4%	9.8%	14.6%	46.3%	26.8%	100.0%
10=Grumbullim i mbeturinave,	0	0	1	1	5	7
	.0%	.0%	14.3%	14.3%	71.4%	100.0%
11=Ujitja,	0	0	0	6	7	13
	.0%	.0%	.0%	46.2%	53.8%	100.0%
12=Tjetër	0	0	1	0	0	1
	.0%	.0%	100.0%	.0%	.0%	100.0%
Total	5	18	14	42	28	107
	4.7%	16.8%	13.1%	39.3%	26.2%	100.0%

Burimi: Autori (2015)

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	78.912 ^a	44	.001
Likelihood Ratio	73.842	44	.003
Linear-by-Linear Association	17.075	1	.000
N of Valid Cases	107		

a. 55 cells (91.7%) have expected Frekuenca less than 5. The minimum expected Frekuenca is .05.

Burimi: Autori (2015)

Sikur mund të shihet nga tabela më lartë, analiza 'Chi-Square' vërteton se ka dëshmi të fuqishme të marrëdhënieve (varësi) në mes të llojit të veprimtarisë së ndërmarrjes publike dhe borxheve të këqija si sfidë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të NP-ve, pasi që vlera e provës statistikore e 'Pearson-Chi-square' është në nivel të lartë = 78.912, me shkallën e lirisë 'df'=44, dhe vlera **p<0.05 (0.001)**. Prandaj, meqenëse vlera e p është më e vogël se 0.05 analiza tregon se ka marrëdhënie të rëndësishme statistikore në mes llojit të veprimtarisë dhe rangimit të borxheve të këqija si sfidë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të ofruara nga NP-të.

Nga tabela e kryqëzuar vërehet se një pjesë e konsiderueshme prej (39.3%) e të anketuarve i konsiderojnë borxhet e këqija si sfidë të ranguar si shpesh prezente që ndikon në cilësinë e shërbimeve të NP-ve, deri sa (26.2%) konsiderojnë se kjo sfidë është gjithnjë e pranishme. Po të merret mesatarja e këtyre dy përgjegjeve del se më shumë se gjysma e të anketuarve ose shpesh ballafaqohen ose kanë gjithnjë prezente këtë sfidë e cila dëshmon problematiken e vështirësisë së arkëtimit të kërkesave dhe në pamundësi të arkëtimit në kohë, krijimit të borxheve të këqija të cilat ndikojnë në gjendjen financiare të ndërmarrjes dhe drejtpërdrejtë në cilësinë dhe sasinë e shërbimeve publike dhe standardin jetësor të qytetarit.

Nga tabela më lartë mund të vërehet se te disa veprimtari ndikimi i borxheve të këqija është në nivel të lartë pasi sipas përgjegjeve nga të anketuarit me këtë ndikim ballafaqohen gjithnjë në infrastrukturen hekurudhore (33.3%), ujitja (53.8%) dhe grumbullimi i mbeturinave (71.4%). Ndërsa sipas përgjegjeve nga të anketuarit disa veprimtari kanë

ndikim të shpeshtë të borxheve të këqija si p.sh. energjia (50%), transporti hekurudhor (33.3%), furnizimi me ujë-ujësjellësitë (46.3%). Dallimi dhe ndikimi i kësaj sfide sipas veprimtarisë mund të vërehet te këto tri veprimtari të cilat nuk kanë ose kanë më pak borxhe të këqija tek të cilat përgjegjjet e të anketuarve në kolonën rrallë janë në përqindje më të lartë në veprimtarinë e transmisionit dhe tregut (66.7%), telekomunikacioni (40%) dhe hidroekonomike (57.1%).

Tabela Nr. 24 - Veprimtaria dhe afatet e shkurtëra të pagesës së detyrimeve

		1=Shume rralle, 2=Rralle, 3=Mesatarisht, 4=Shpesh, 5=Gjithnje					Total
		1	2	3	4	5	
1= Energjia,	Frekuenca %	0 .0%	4 66.7%	1 16.7%	1 16.7%	0 .0%	6 100.0%
2= Transmisioni dhe tregu,	Frekuenca %	3 50.0%	1 16.7%	2 33.3%	0 .0%	0 .0%	6 100.0%
3=Telekomunikacioni,	Frekuenca %	2 40.0%	0 .0%	2 40.0%	1 20.0%	0 .0%	5 100.0%
4=Shërbime të navigimit dhe kontrollit ajror,	Frekuenca %	0 .0%	0 .0%	3 75.0%	1 25.0%	0 .0%	4 100.0%
5=Shërbime postare,	Frekuenca %	1 20.0%	1 20.0%	2 40.0%	0 .0%	1 20.0%	5 100.0%
6=Hidroekonomike,	Frekuenca %	1 14.3%	3 42.9%	3 42.9%	0 .0%	0 .0%	7 100.0%
7=Infrastruktura hekurudhore,	Frekuenca %	0 .0%	3 50.0%	0 .0%	2 33.3%	1 16.7%	6 100.0%

8=Transporti hekurudhor,	Frekuenca	0	4	1	0	1	6
	%	.0%	66.7%	16.7%	.0%	16.7%	100.0%
9=Furnizim me ujë - Ujësjiellës,	Frekuenca	6	11	16	4	4	41
	%	14.6%	26.8%	39.0%	9.8%	9.8%	100.0%
10=Grumbullim i mbeturinave,	Frekuenca	0	1	1	5	0	7
	%	.0%	14.3%	14.3%	71.4%	.0%	100.0%
11=Ujitja,	Frekuenca	2	4	3	4	0	13
	%	15.4%	30.8%	23.1%	30.8%	.0%	100.0%
12=Tjetër	Frekuenca	0	0	0	1	0	1
	%	.0%	.0%	.0%	100.0%	.0%	100.0%
Total	Frekuenca	15	32	34	19	7	107
	%	14.0%	29.9%	31.8%	17.8%	6.5%	100.0%

Burimi: Autori (2015)

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	60.952 ^a	44	.046
Likelihood Ratio	64.842	44	.022
Linear-by-Linear Association	3.043	1	.081
N of Valid Cases	107		

a. 56 cells (93.3%) have expected Frekuenca less than 5. The minimum expected Frekuenca is .07.

Burimi: Autori (2015)

Nga tabela e kryqëzuar vërehet se vlerësimet e të anketuarve janë të shpërndara sa i përket rangimit të afateve të shkurtëra të pagesës së detyrimeve si sfidë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të NP-ve, dhe atë 14.0% përqind e vlerësojnë si shumë të rrallë, 29.9% si të

rrallë, 31.8% mesatarisht, 17.8% si të shpeshtë dhe 6.5% gjithnjë sfidë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të kryera nga NP-të.

Megjithatë, analiza ‘Chi-Square’ vërteton se ka dëshmi të fuqishme të marrëdhënieve në mes të llojit të veprimtarisë së ndërmarrjes publike dhe afatit të shkurtër të pagesës së detyrimeve si sfidë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të NP-ve, pasi që vlera e provës statistikore e ‘Pearson-Chi-square’ është në nivel mjaftueshëm të lartë = 60.952, me shkallën e lirisë ‘df’=44, dhe vlera **p<0.05 (0.046)**. Prandaj, meqenëse vlera e p është më e vogël se 0.05 analiza tregon se ka marrëdhënie të rëndësishme statistikore në mes llojit të veprimtarisë dhe rangimit të afateve të shkurtëra të pagesës së detyrimeve si sfidë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të ofruara nga NP-të. Kështu disa veprimtari të cilat ndikohen nga afatet e shkurtëra të pagesës së detyrimeve më shpesh sipas përgjigjeve të anketuarve janë ujitja me 30.8%, infrastruktura hekurudhore me 33.3% dhe grumbullimi i mbeturinave me 71.4%.

Tabela Nr. 25 - Veprimtaria dhe shpenzimet e larta

		1=Shume rralle, 2=Rralle, 3=Mesatarisht, 4=Shpesh, 5=Gjithnje					Total
		1	2	3	4	5	
1= Energjia,	Frekuenca	0	0	1	3	2	6
	%	.0%	.0%	16.7%	50.0%	33.3%	100.0%
2= Transmisioni dhe tregu,	Frekuenca	0	0	3	2	1	6
	%	.0%	.0%	50.0%	33.3%	16.7%	100.0%
3=Telekomunikacioni,	Frekuenca	1	0	2	1	1	5

	%	20.0%	.0%	40.0%	20.0%	20.0%	100.0%
4=Shërbime të navigimit dhe kontrollit ajror,	Frekuenca %	0 .0%	0 .0%	1 25.0%	2 50.0%	1 25.0%	4 100.0%
5=Shërbime postare,	Frekuenca %	0 .0%	0 .0%	1 20.0%	1 20.0%	3 60.0%	5 100.0%
6=Hidroekonomike,	Frekuenca %	0 .0%	0 .0%	1 14.3%	4 57.1%	2 28.6%	7 100.0%
7=Infrastruktura hekurudhore,	Frekuenca %	0 .0%	0 .0%	0 .0%	1 16.7%	5 83.3%	6 100.0%
8=Transporti hekurudhor,	Frekuenca %	0 .0%	0 .0%	3 50.0%	2 33.3%	1 16.7%	6 100.0%
9=Furnizim me ujë - Ujësjiellës,	Frekuenca %	0 .0%	2 4.9%	15 36.6%	17 41.5%	7 17.1%	41 100.0%
10=Grumbullim i mbeturinave,	Frekuenca %	0 .0%	0 .0%	2 28.6%	2 28.6%	3 42.9%	7 100.0%
11=Ujitja,	Frekuenca %	0 .0%	0 .0%	1 7.7%	8 61.5%	4 30.8%	13 100.0%
12=Tjetër	Frekuenca %	0 .0%	0 .0%	0 .0%	1 100.0%	0 .0%	1 100.0%
Total	Frekuenca %	1 .9%	2 1.9%	30 28.0%	44 41.1%	30 28.0%	107 100.0%

Burimi: Autori (2015)

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	48.690 ^a	44	.290
Likelihood Ratio	35.361	44	.820
Linear-by-Linear Association	.078	1	.779
N of Valid Cases	107		

a. 56 cells (93.3%) have expected Frekuenca less than 5. The minimum expected Frekuenca is .01.

Burimi: Autori (2015)

Nga tabela e kryqëzuar vërehet se ka vlerësim të shpërndarë në mesin e të anketuarve për sa i përket rangimit të shpenzimeve të larta si sfidë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të NP-ve, 28.8% e vlerësojnë si sfidë që paraqitet mesatarisht, 41.1% të shpeshtë, 28.0% si sfidë që gjithnjë atakon cilësinë e shërbimeve të NP-ve.

Analiza 'Chi-Square' nuk vërteton se ka dëshmi të fuqishme të marrëdhënieve në mes të llojit të veprimtarisë së ndërmarrjes publike dhe shpenzimeve të larta si sfidë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të NP-ve, pasi që vlera $p > 0.05$ (0.290).

Tabela Nr. 26 - Veprimtaria dhe infrastruktura e vjetëruar

		1=Shume rralle, 2=Rralle, 3=Mesatarisht, 4=Shpesh, 5=Gjithnje					Total
		1	2	3	4	5	
1= Energjia,	Frekuenca	1	0	0	2	3	6
	%	16.7%	.0%	.0%	33.3%	50.0%	100.0%
2= Transmisioni dhe tregu,	Frekuenca	0	0	0	5	1	6

	%	.0%	.0%	.0%	83.3%	16.7%	100.0%
3=Telekomunikacioni,	Frekuenca	2	0	0	2	1	5
	%	40.0%	.0%	.0%	40.0%	20.0%	100.0%
4=Shërbime të navigimit dhe kontrollit ajror,	Frekuenca	0	0	2	0	2	4
	%	.0%	.0%	50.0%	.0%	50.0%	100.0%
5=Shërbime postare,	Frekuenca	1	0	0	1	3	5
	%	20.0%	.0%	.0%	20.0%	60.0%	100.0%
6=Hidroekonomike,	Frekuenca	0	1	3	3	0	7
	%	.0%	14.3%	42.9%	42.9%	.0%	100.0%
7=Infrastruktura hekurudhore,	Frekuenca	0	0	1	1	4	6
	%	.0%	.0%	16.7%	16.7%	66.7%	100.0%
8=Transporti hekurudhor,	Frekuenca	2	1	0	0	3	6
	%	33.3%	16.7%	.0%	.0%	50.0%	100.0%
9=Furnizim me ujë - Ujësjiellës,	Frekuenca	1	1	9	8	22	41
	%	2.4%	2.4%	22.0%	19.5%	53.7%	100.0%
10=Grumbullim i mbeturinave,	Frekuenca	0	1	2	3	1	7
	%	.0%	14.3%	28.6%	42.9%	14.3%	100.0%
11=Ujitja,	Frekuenca	0	0	2	6	5	13
	%	.0%	.0%	15.4%	46.2%	38.5%	100.0%
12=Tjetër	Frekuenca	0	0	0	1	0	1
	%	.0%	.0%	.0%	100.0%	.0%	100.0%
Total	Frekuenca	7	4	19	32	45	107
	%	6.5%	3.7%	17.8%	29.9%	42.1%	100.0%

Burimi: Autori (2015)

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	64.507 ^a	44	.024
Likelihood Ratio	65.724	44	.019
Linear-by-Linear Association	.979	1	.322
N of Valid Cases	107		

a. 56 cells (93.3%) have expected Frekuenca less than 5. The minimum expected Frekuenca is .04.

Burimi: Autori (2015)

Nga tabela e kryqëzuar vërehet se ka vlerësim të shpërndarë në mesin e të anketuarve për sa i përket rangimit të infrastrukturës së vjetëruar si sfidë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të NP-ve, 6.5% shumë rrallë, 3.7% rrallë, 17.8% e vlerësojnë si sfidë që paraqitet mesatarisht, 29.9% të shpeshtë dhe 42.1% si sfidë që gjithnjë atakon cilësinë e shërbimeve të NP-ve.

Aanaliza ‘Chi-Square’ nuk vërteton se ka dëshmi të fuqishme të marrëdhënieve në mes të llojit të veprimtarisë së ndërmarrjes publike dhe të infrastrukturës së vjetëruar si sfidë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të NP-ve, pasi që vlera $p > 0.05$ (0.240).

Tabela Nr. 27 - Veprimtaria dhe tarifat/çmimet e larta

		1=Shume rralle, 2=Rralle, 3=Mesatarisht, 4=Shpesh, 5=Gjithnje					Total
		1	2	3	4	5	
1= Energjia,	Frekuenca	0	1	3	1	1	6
	%	.0%	16.7%	50.0%	16.7%	16.7%	100.0%

2= Transmisioni dhe tregu,	Frekuenca	0	0	3	2	1	6
	%	.0%	.0%	50.0%	33.3%	16.7%	100.0%
3=Telekomunikacioni,	Frekuenca	1	1	1	2	0	5
	%	20.0%	20.0%	20.0%	40.0%	.0%	100.0%
4=Shërbime të navigimit dhe kontrollit ajror,	Frekuenca	0	0	2	2	0	4
	%	.0%	.0%	50.0%	50.0%	.0%	100.0%
5=Shërbime postare,	Frekuenca	0	0	3	0	2	5
	%	.0%	.0%	60.0%	.0%	40.0%	100.0%
6=Hidroekonomike,	Frekuenca	0	1	5	1	0	7
	%	.0%	14.3%	71.4%	14.3%	.0%	100.0%
7=Infrastruktura hekurudhore,	Frekuenca	0	1	4	1	0	6
	%	.0%	16.7%	66.7%	16.7%	.0%	100.0%
8=Transporti hekurudhor,	Frekuenca	0	3	3	0	0	6
	%	.0%	50.0%	50.0%	.0%	.0%	100.0%
9=Furnizim me ujë - Ujësjiellës,	Frekuenca	1	11	20	7	2	41
	%	2.4%	26.8%	48.8%	17.1%	4.9%	100.0%
10=Grumbullim i mbeturinave,	Frekuenca	0	1	2	4	0	7
	%	.0%	14.3%	28.6%	57.1%	.0%	100.0%
11=Ujitja,	Frekuenca	2	2	7	2	0	13
	%	15.4%	15.4%	53.8%	15.4%	.0%	100.0%
12=Tjetër	Frekuenca	0	0	1	0	0	1
	%	.0%	.0%	100.0%	.0%	.0%	100.0%
Total		4	21	54	22	6	107
		3.7%	19.6%	50.5%	20.6%	5.6%	100.0%

Burimi: Autori (2015)

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	47.480 ^a	44	.333
Likelihood Ratio	43.765	44	.482
Linear-by-Linear Association	4.592	1	.032
N of Valid Cases	107		

a. 56 cells (93.3%) have expected Frekuenca less than 5. The minimum expected Frekuenca is .04.

Burimi: Autori (2015)

Tabela Nr. 28 - Veprimtaria dhe operatori i vetëm i këtij lloji

		1=Shume rralle, 2=Rralle, 3=Mesatarisht, 4=Shpesh, 5=Gjithnje					Total
		1	2	3	4	5	
1= Energjia,	Frekuenca	1	1	2	1	1	6
	%	16.7%	16.7%	33.3%	16.7%	16.7%	100.0%
2= Transmisioni dhe tregu,	Frekuenca	0	1	4	1	0	6
	%	.0%	16.7%	66.7%	16.7%	.0%	100.0%
3=Telekomunikacioni,	Frekuenca	1	1	2	1	0	5
	%	20.0%	20.0%	40.0%	20.0%	.0%	100.0%
4=Shërbime të navigimit dhe kontrollit ajror,	Frekuenca	0	1	1	2	0	4
	%	.0%	25.0%	25.0%	50.0%	.0%	100.0%
5=Shërbime postare,	Frekuenca	0	1	2	1	1	5
	%	.0%	20.0%	40.0%	20.0%	20.0%	100.0%
6=Hidroekonomike,	Frekuenca	1	2	4	0	0	7
	%	14.3%	28.6%	57.1%	.0%	.0%	100.0%

7=Infrastruktura hekurudhore,	Frekuenca	0	1	4	1	0	6
	%	.0%	16.7%	66.7%	16.7%	.0%	100.0%
8=Transporti hekurudhor,	Frekuenca	0	2	4	0	0	6
	%	.0%	33.3%	66.7%	.0%	.0%	100.0%
9=Furnizim me ujë - Ujësjiellës,	Frekuenca	7	11	18	3	2	41
	%	17.1%	26.8%	43.9%	7.3%	4.9%	100.0%
10=Grumbullim i mbeturinave,	Frekuenca	0	1	3	2	1	7
	%	.0%	14.3%	42.9%	28.6%	14.3%	100.0%
11=Ujitja,	Frekuenca	2	4	7	0	0	13
	%	15.4%	30.8%	53.8%	.0%	.0%	100.0%
12=Tjetër	Frekuenca	0	0	0	1	0	1
	%	.0%	.0%	.0%	100.0%	.0%	100.0%
Total	Frekuenca	12	26	51	13	5	107
	%	11.2%	24.3%	47.7%	12.1%	4.7%	100.0%

Burimi: Autori (2015)

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	35.986 ^a	44	.800
Likelihood Ratio	37.008	44	.763
Linear-by-Linear Association	1.618	1	.203
N of Valid Cases	107		

a. 57 cells (95.0%) have expected Frekuenca less than 5. The minimum expected Frekuenca is .05.

Burimi: Autori (2015)

Tabela Nr. 29 - Veprimtaria dhe shfrytëzuesit e shërbimeve

		1=Shume rralle, 2=Rralle, 3=Mesatarisht, 4=Shpesh, 5=Gjithnje					Total
		1	2	3	4	5	
1= Energjia,	Frekuenca	1	0	0	4	1	6
	%	16.7%	.0%	.0%	66.7%	16.7%	100.0%
2= Transmisioni dhe tregu,	Frekuenca	5	0	1	0	0	6
	%	83.3%	.0%	16.7%	.0%	.0%	100.0%
3=Telekomunikacioni,	Frekuenca	0	1	3	0	1	5
	%	.0%	20.0%	60.0%	.0%	20.0%	100.0%
4=Shërbime të navigimit dhe kontrollit ajror,	Frekuenca	1	2	0	1	0	4
	%	25.0%	50.0%	.0%	25.0%	.0%	100.0%
5=Shërbime postare,	Frekuenca	0	0	0	3	2	5
	%	.0%	.0%	.0%	60.0%	40.0%	100.0%
6=Hidroekonomike,	Frekuenca	1	3	0	3	0	7
	%	14.3%	42.9%	.0%	42.9%	.0%	100.0%
7=Infrastruktura hekurudhore,	Frekuenca	0	2	2	2	0	6
	%	.0%	33.3%	33.3%	33.3%	.0%	100.0%
8=Transporti hekurudhor,	Frekuenca	0	3	1	2	0	6
	%	.0%	50.0%	16.7%	33.3%	.0%	100.0%
9=Furnizim me ujë - Ujësjiellës,	Frekuenca	2	3	13	14	9	41
	%	4.9%	7.3%	31.7%	34.1%	22.0%	100.0%
10=Grumbullim i mbeturinave,	Frekuenca	1	2	2	1	1	7
	%	14.3%	28.6%	28.6%	14.3%	14.3%	100.0%
11=Ujitja,	Frekuenca	0	2	0	7	4	13

	%	.0%	15.4%	.0%	53.8%	30.8%	100.0%
12=Tjetër	Frekuenca	1	0	0	0	0	1
	%	100.0%	.0%	.0%	.0%	.0%	100.0%
Total	Frekuenca	12	18	22	37	18	107
	%	11.2%	16.8%	20.6%	34.6%	16.8%	100.0%

Burimi: Autori (2015)

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	90.031 ^a	44	.000
Likelihood Ratio	86.982	44	.000
Linear-by-Linear Association	5.712	1	.017
N of Valid Cases	107		

a. 56 cells (93.3%) have expected Frekuenca less than 5. The minimum expected Frekuenca is .11.

Burimi: Autori (2015)

Pra, siç mund të shihet nga tabela e kryqëzuar më lartë ka vlerësim të shpërndarë në mesin e të anketuarve për sa i përket rangimit të sfidës nëse shfrytëzues të shërbimeve të NP-ve janë personat fizik si sfidë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të NP-ve. Kështu sipas përgjigjeve të të anketuarve 11.2% vlerësojnë se rrallë ballafaqohen me këtë sfidë, 16.8% shumë rrallë, mesatarisht 20.6%, shpesh 34.6% dhe sfidë që gjithnjë ndikon në cilësinë e shërbimeve publike 16.8%.

Megjithatë, analiza ‘Chi-Square’ vërteton se ka dëshmi të fuqishme të marrëdhënieve në mes të llojit të veprimtarisë së ndërmarrjes publike dhe sfidës nëse shfrytëzues të shërbimeve të NP-ve janë personat fizik si sfidë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të NP-ve, pasi që vlera e provës statistikore e ‘Pearson-Chi-square’ është në nivel mjaftueshëm të lartë = 90.031, me shkallën e lirisë ‘df’=44, dhe vlera **p<0.05 (0.000)**. Prandaj, meqenëse vlera e p është më e vogël se 0.05 analiza tregon se ka marrëdhënie të rëndësishme statistikore në mes llojit të veprimtarisë dhe rangimit të të sfidës nëse shfrytëzues të shërbimeve të NP-ve janë personat fizik si sfidë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të ofruara nga NP-të.

Tabela Nr. 30 - Veprimtaria dhe situata politike/mospagesa e komunitetit pakicë

		1=Shume rralle, 2=Rralle, 3=Mesatarisht, 4=Shpesh, 5=Gjithnje					Total
		1	2	3	4	5	
1= Energjia,	Frekuenca	0	2	2	2	0	6
	%	.0%	33.3%	33.3%	33.3%	.0%	100.0%
2= Transmisioni dhe tregu,	Frekuenca	1	2	1	2	0	6
	%	16.7%	33.3%	16.7%	33.3%	.0%	100.0%
3=Telekomunikacioni,	Frekuenca	0	2	1	1	1	5
	%	.0%	40.0%	20.0%	20.0%	20.0%	100.0%
4=Shërbime të navigimit dhe kontrollit ajror,	Frekuenca	2	1	0	1	0	4
	%	50.0%	25.0%	.0%	25.0%	.0%	100.0%
5=Shërbime postare,	Frekuenca	2	1	0	1	1	5
	%	40.0%	20.0%	.0%	20.0%	20.0%	100.0%

6=Hidroekonomike,	Frekuenca %	2 28.6%	2 28.6%	0 .0%	1 14.3%	2 28.6%	7 100.0%
7=Infrastruktura hekurudhore,	Frekuenca %	0 .0%	4 66.7%	1 16.7%	1 16.7%	0 .0%	6 100.0%
8=Transporti hekurudhor,	Frekuenca %	0 .0%	5 83.3%	0 .0%	1 16.7%	0 .0%	6 100.0%
9=Furnizim me ujë - Ujësjiellës,	Frekuenca %	1 2.4%	7 17.1%	10 24.4%	19 46.3%	4 9.8%	41 100.0%
10=Grumbullim i mbeturinave,	Frekuenca %	3 42.9%	2 28.6%	1 14.3%	0 .0%	1 14.3%	7 100.0%
11=Ujitja,	Frekuenca %	1 7.7%	9 69.2%	0 .0%	2 15.4%	1 7.7%	13 100.0%
12=Tjetër	Frekuenca %	1 100.0%	0 .0%	0 .0%	0 .0%	0 .0%	1 100.0%
Total	Frekuenca %	13 12.1%	37 34.6%	16 15.0%	31 29.0%	10 9.3%	107 100.0%

Burimi: Autori (2015)

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2- sided)
Pearson Chi-Square	67.705 ^a	44	.012
Likelihood Ratio	69.080	44	.009
Linear-by-Linear Association	.016	1	.900
N of Valid Cases	107		

a. 57 cells (95.0%) have expected Frekuenca less than 5. The minimum expected Frekuenca is .09.

Burimi: Autori (2015)

Nga tabela e kryqëzuar vërehet se ka vlerësim të shpërndarë në mesin e të anketuarve për sa i përket rangimit të situatës politike dhe mospagesës për shërbime publike nga ana e komunitetit pakicë në Kosovë si sfidë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të NP-ve, 12.1% janë deklaruar se paraqitet shumë rrallë, 34.6% rrallë, 15.0% e vlerësojnë si sfidë që paraqitet mesatarisht, 29.0% të shpeshtë, 9.3% si sfidë që gjithnjë atakon cilësinë e shërbimeve të NP-ve.

Siç mund të shihet nga përgjigjet e të anketuarve për disa veprimtari të cilat ofrojnë shërbime për të gjithë qytetarët si energjia (33.3%), ujësjellësitë (46.3%), situata politike e cila ndryshon në Kosovë ndikon që të mos kryhet pagesa nga komuniteti pakicë për shërbimet e shfrytëzuara. Kjo pastaj ndikon në nivelin e arkëtimit të të hyrave, në gjendjen e likuiditetit dhe rrjedhimisht në dobësimin e fuqisë financiare që pashmangshëm ndikon në cilësinë por edhe në sasinë e shërbimeve të ofruara.

Analiza 'Chi-Square' nuk vërteton se ka dëshmi të fuqishme të marrëdhënieve në mes të llojit të veprimtarisë së ndërmarrjes publike dhe të situatës politike dhe mospagesës për shërbime publike nga ana e komunitetit pakicë si sfidë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të NP-ve, pasi që vlera $p > 0.05$ (0.120).

Tabela Nr. 31 - Veprimtaria dhe numri i madh i të punësuarve

		1=Shume rralle, 2=Rralle, 3=Mesatarisht, 4=Shpesh, 5=Gjithnje					Total
		1	2	3	4	5	
1= Energjia,	Frekuenca	0	0	0	4	2	6
	%	.0%	.0%	.0%	66.7%	33.3%	100.0%
2= Transmisioni dhe tregu,	Frekuenca	0	0	3	3	0	6
	%	.0%	.0%	50.0%	50.0%	.0%	100.0%
3=Telekomunikacioni,	Frekuenca	0	0	1	3	1	5
	%	.0%	.0%	20.0%	60.0%	20.0%	100.0%
4=Shërbime të navigimit dhe kontrollit ajror,	Frekuenca	0	0	1	1	2	4
	%	.0%	.0%	25.0%	25.0%	50.0%	100.0%
5=Shërbime postare,	Frekuenca	1	0	0	1	3	5
	%	20.0%	.0%	.0%	20.0%	60.0%	100.0%
6=Hidroekonomike,	Frekuenca	0	0	1	1	5	7
	%	.0%	.0%	14.3%	14.3%	71.4%	100.0%
7=Infrastruktura hekurudhore,	Frekuenca	0	0	0	4	2	6
	%	.0%	.0%	.0%	66.7%	33.3%	100.0%
8=Transporti hekurudhor,	Frekuenca	0	0	3	3	0	6
	%	.0%	.0%	50.0%	50.0%	.0%	100.0%
9=Furnizim me ujë - Ujësjiellës,	Frekuenca	4	6	7	18	6	41
	%	9.8%	14.6%	17.1%	43.9%	14.6%	100.0%
10=Grumbullim i mbeturinave,	Frekuenca	0	0	2	5	0	7
	%	.0%	.0%	28.6%	71.4%	.0%	100.0%
11=Ujitja,	Frekuenca	0	2	4	4	3	13

	%	.0%	15.4%	30.8%	30.8%	23.1%	100.0%
12=Tjetër	Frekuenca	0	0	0	1	0	1
	%	.0%	.0%	.0%	100.0%	.0%	100.0%
Total	Frekuenca	5	8	22	48	24	107
	%	4.7%	7.5%	20.6%	44.9%	22.4%	100.0%

Burimi: Autori (2015)

Chi-Square Tests

	Value	df	Asymp. Sig. (2-sided)
Pearson Chi-Square	50.246 ^a	44	.240
Likelihood Ratio	57.405	44	.085
Linear-by-Linear Association	4.634	1	.031
N of Valid Cases	107		

a. 56 cells (93.3%) have expected Frekuenca less than 5. The minimum expected Frekuenca is .05.

Burimi: Autori (2015)

Nga tabela e kryqëzuar vërehet se ka vlerësim të shpërndarë në mesin e të anketuarve për sa i përket rangimit të numrit të madh të punësuarëve si sfidë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të NP-ve, ku 4.7% e të anketuarve e vlerësojnë si sfidë që paraqitet shumë rrallë, 7.5% rrallë, 20.6% e vlerësojnë si sfidë që paraqitet mesatarisht, 44.9% të shpeshtë, 22.4% si sfidë që gjithnjë atakon cilësinë e shërbimev të NP-ve.

Analiza 'Chi-Square' nuk vërteton se ka dëshmi të fuqishme të marrëdhënieve në mes të llojit të veprimtarisë së ndërmarrjes publike dhe të numrit të madh të punësuarëve si sfidë që ndikon në cilësinë e shërbimeve të NP-ve, pasi që vlera $p > 0.05$ (0.240).

Hipoteza Nr. 1: Sfidat financiare kanë korrelacion pozitiv me cilësinë e shërbimeve që ofrohen nga ndërmarrjet publike.

Për të testuar këtë hipotezë është shfrytëzuar metoda e matjes së korelacionit përmes tabelave të kryqëzuara. Janë dy grupe pyetjesh që përmbajnë variablat me emër të njëjtë:

Grupi I: Kategorizoni sfidat e mëposhtme sipas prezencës në ndërmarrjen tuaj;

Grupi II: Kategorizoni sfidat sipas ndikimit që kanë në cilësinë e shërbimeve që ofroni.

Të dy grupet e pyetjeve përmbajnë variablat e njëjta për kontekstin e pyetjes, siç janë :

- Arkëtimi në nivel të ulët,
- Rrjedha e parasë të ndryshueshme,
- Probleme me likuditetin,
- Borxhet e këqija,
- Afatet e shkurtëra për pagesën e detyrimeve,
- Shpenzimet e larta,
- Infrastruktura e vjetëruar,
- Shfrytëzuesit e shërbimeve tuaja janë personat fizikë,
- Situata politike – mospagesa e komunitetit pakicë,
- Numri i madh i të punësuarve.

Matja e korrelacionit është bërë paralelisht për variablën e njëjtë për dy kategorizimet si psh: arkëtimi në nivel të ulët x arkëtimi në nivel të ulët, dhe rrjedha e parasë të ndryshueshme x rrjedha e parasë të ndryshueshme,etj.

Tabela Nr. 32 - Korelacioni i Variablave

Variablat	Numri i rasteve	Koeficienti i korelacionit	Niveli i rendësisë statistikore (Sig.)	Përshkrimi
Arkëtimi në nivel të ulët	107	0.698	0.000	Korrelacion i fortë pozitiv
Rrjedha e parasë e ndryshueshme	107	0.685	0.000	Korrelacion i fortë pozitiv
Probleme me likuiditetin	107	0.760	0.000	Korrelacion i fortë pozitiv
Borxhet e këqija	107	0.753	0.000	Korrelacion i fortë pozitiv
Afatet e shkurtëra për pagesën e detyrimeve	107	0.466	0.000	Korrelacion i fortë pozitiv
Shpenzimet e larta	107	0.528	0.000	Korrelacion i fortë pozitiv

Infrastruktura e vjetëruar	107	0.729	0.000	Korrelacion i fortë pozitiv
Shfrytëzuesit e shërbimeve tuaja janë personat fizikë	107	0.677	0.000	Korrelacion i fortë pozitiv
Situata politike – mospagesa e komunitetit pakicë	107	0.731	0.000	Korrelacion i fortë pozitiv
Numri i madh i të punësuarve	107	0.711	0.000	Korrelacion i fortë pozitiv

Burimi: Autori (2015)

Siç shihet nga tabela sfidat financiare që janë të pranishme në ndërmarrjet publike kanë korrelacion pozitiv me ndikimin që kanë këto sfida në cilësinë e shërbimeve që ofrojnë ato. Prandaj çdo sfidë me të cilat ballafaqohen ndërmarrjet publike ndikon esencialisht në cilësinë e shërbimeve që u ofrojnë qytetarëve dhe bizneseve.

5.2 Analiza e Regresionit

Hipoteza Nr. 2: Sfidat financiare kanë ndikim negativ në performancën operative dhe financiare të ndërmarrjeve publike.

Me qëllim të hulumtimit të disa sfidave financiare me të cilat ballafaqohen NP, jemi mbështetur në të dhënat e pasqyrave financiare të audituara dhe të publikuara (publikimi i

pasqyrave financiare është obligim ligjor i NjPPM të NP-ve). Janë nxjerrë të dhëna për disa zëra të pasqyrave financiare të cilët tregojnë në mënyrë shumë të saktë se me cilat sfida ballafaqohen NP. Kështu ne në kërkimin tonë jemi mbështetur në variabla të pavarura sikur se janë llogaritë e arkëtueshme në raport me totalin e aktives, llogaritë e pagueshme në raport me detyrimet totale, nivelin e shpenzimeve për pagat në raport me totalin e shpenzimeve, pastaj raporti i shpenzimeve operative në krahasim me të të hyrat e përgjithshme si dhe provizionet për borxhet e këqija.

Këto variabla të pavarura janë shumë të rëndësishme sepse edhe si një tregues i vetëm si p.sh. saldoja e lartë e llogarive të arkëtueshme por edhe në raport me variabla tjera japin informata që kanë rëndësi të madhe në të kuptuarit e situatës financiare në të cilën gjendet një NP.

Këto variabla janë marrë nga të gjitha ndërmarrjet publike qendrore dhe ndërmarrjet publike rajonale të ujësjellësve për periudhën 2011-2015 në të cilat ato janë prezente në secilen prej tyre edhe pse dallojnë për nga niveli i lartësisë së tyre.

Secila nga variablat e pavarura të analizuara paraqet një sfidë financiare për ndërmarrjen nga se ndikojnë në afarizmin e tyre prandaj edhe tejkalimi me lehtësi i tyre ndikon pozitivisht në zhvillimin e afarizmit dhe të ofrimit të shërbimeve publike në sasi dhe cilësi të kënaqshme. Në të kundërtën dhe ballafaqimi afatgjatë ka ndikim negativ dhe shërbime publike jokualitative dhe jo të mjaftueshme.

Tabela Nr. 33 - Variablat e përfshira në model

Variablat e pavarura	Përshkrimi i variablave
LLA/AsTot	Pjesëmarrja e llogarive të arkëtueshme në asetet totale (%)
LLP/DefTot	Pjesëmarrja e llogarive të pagueshme në detyrimet totale (%)
Pag/ShpOp	Pjesëmarrja e shpenzimeve të pagave në shpenzimet operative (%)
RapShpOp/TeHyr	Raporti i shpenzimeve operative në të hyrat e përgjithshme (%)
ProvizBorxhKeqija a	Provizioni i borxheve të këqija
Variabla e varur	
Performanca financiare	Variabël e integruar nga tri variabla: vetqëndrueshmëris operative (OSS), Kthimi mbi asetet (ROA) dhe Kthimi mbi ekuitetin (ROE)

Variabël e varur është marrë performanca financiare, e cila është formuar nga integrimi i tre treguesve të rëndësishëm financiar siç janë: vetqëndrueshmëria (OSS), kthimi mbi asetet (ROA) dhe dhe kthimi mbi ekuitetin (ROE).

Formulat e këtyre tre treguesve financiarë janë:

$$OSS = \frac{T\grave{e} \text{ hyrat nga aktivitetet operative}}{Shpenzimet operative}$$

$$ROA = \frac{Fitimi Neto}{Mesatarja e aseteve}$$

$$ROE = \frac{Fitimi Neto}{Ekuiteti}$$

Procedura e integritit të këtyre treguesve është bërë si vijon:

- së pari janë standardizuar në excel secili prej tre treguesve përmes formulës:

$$z = (S - M)/DS^1$$

Për secilën variabël ne vijim përdorem këtë formulë :

$$1. ROAz = (Sroa - Mroa)/DSroa$$

$$2. OSSz = (Soss - Moss)/DSoss$$

$$3. ROEz = (Sroe - Mroe)/DSroe$$

Prej këtyre tre treguesve financiarë të standardizuar është formuar variabla e integruar për Performancën Financiare:

$$\mathbf{PERF = ((ROAz + OSSz + ROEz))/3}$$

Në vijim paraqiten statistikat e përshkrimit të variablave të përfshira në model, si vlera minimale, maksimale, mesatrja dhe devijimi standard. Vlera minimale dhe maksimale tregojnë intervalin e shtrirjes në kuadër të variablës. Siç shihet në tabelë, pjesëmarrja e llogarive të arkëtueshme në asetet totale fillon nga 0.72% (min) deri në 51.09 % (max). Llogaritë e pagueshme kanë një shtrirje më të gjerë në kuadër të detyrimeve të tërësishme (0.33 – 91.96%). Ndërsa, si shihet nga të dhënat, raporti i shpenzimeve operative ndaj të hyrave të përgjithshme shtrihet nga 34.7% që është minimumi deri në 153.3% që është maksimumi, e që mund të konstatohet se ka ndërmarrje publike që nga të hyrat e përgjithshme që realizojnë nuk mund të mbulojnë shpenzimet e tyre operative.

¹ Z- Variabla e standardizuar, S- Vlera e njësisë në vargun e variablës (Rezultati); M- Mesatare; DS- Devijimi standard

Tabela Nr. 34 - Statistikat përshkruese të variablave

	N	Minimum (%)	Maximum (%)	Mesatarja (%)	Devijimi standard
Raporti LLA/Asetet totale	67	0.72	51.09	15.7343	12.45455
Raporti LLP/Detyrimet totale	67	0.33	91.96	26.3585	27.61240
Raporti shpenzime e pagave/ shpenzimet operative	67	28.10	81.90	55.4373	16.15798
Raporti Shpenzimet Operative/ Të Hyrat e përgjithshme	67	34.70	153.30	76.0149	22.61905
ProvizBorxhetKeqija	64	0	9574	855.48	1827.309
Performanca financiare	67	-1.96	2.19	.0000	.87101

Burimi: Autori (2017)

Nga të dhënat e analizuara del se disa NP (si “Posta” dhe “ANP”) nuk gjenerojnë të hyra të mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet nga veprimtaria dhe kanë humbje operative para zhvlerësimit që pastaj reflektohet edhe në raport me shpenzimet operative, provizionet e borxheve të këqija dhe performancën financiare. Te disa NP tjera (si “Ibër-Lepenci”, KRU “Hidrodrini”, KRU “Hidromorava”, KRU “Hidroregjioni”, KRU “Radoniqi”) është karakteristike se për shkak të vlerës së madhe të asetëve dhe proporcionalisht të shumës së lartë të zhvlerësimit të aktiveve të qëndrueshme, ndryshon rezultati financiar dhe fitimi operativ i realizuar shndërrohet në humbje operative pas zhvlerësimit.

Është karakteristike niveli i lartë i zërave të llogarive të arkëtueshme sidomos tek ato NP të cilat ofrojnë shërbime edhe për persona fizik (amvisëri familjare) sidomos NP që merren

me furnizim me energji dhe NP të ujësjellësve. Mosarkëtimi i parasë sipas planit të rrjedhës së parasë dhe mosarkëtimi në nivelin e kontraktuar sjellë NP në vështirësi financiare por edhe redukton ose minimizon shkallën e investimeve kapitale nga burimet e veta.

Gjatë analizës dhe krahasimit të të dhënave sipas zërave të pasqyrave financiare mund të vërehet rritja e aktiveve fikse te dy NP (Telekomi dhe KOSTT) dhe rënje nga viti në vit në pothuaj se të gjitha NP tjera përveç rasteve të investimeve në aktive fikse afatgjata gjatë dy viteve tek KRU "Prishtina" (viti 2014) dhe KRU "Mitrovica" (viti 2013).

Një karakteristikë dalluese dhe e përbashkët e disa NP-ve siç janë marrë nga pasqyrat financiare dhe përgaditur në programin aplikativ në excel si bazë për përgatitjen e analizës së korelacionit janë rënja e të hyrave të përgjithshme por edhe zvogëlimi i shpenzimeve të përgjithshme (te "KEK"-u, "Trainkos", "PTK"). Po ashtu mund të vërehet një trend i rritjes së detyrimeve afatgjata i cili nuk përcjellet me nivelin e rritjes së kapitalit akcionar dhe shkon në drejtim të kundërt me nivelin e aktiveve të qëndrueshme (rasti i KEK-ut, KRU "Prishtina").

Nga tabela e të dhënave gjithëpërfshirëse për të gjitha NP, sipas zërave të pasqyrave financiare për periudhën prej vitit 2012 deri në vitin 2015, konstatohet rritja e nivelit të shpenzimeve për paga e përcjellur me rritjen e numrit të punësuarëve nga viti në vit e përfshirë brenda shpenzimeve të përgjithshme po ashtu është karakteristikë e përbashkët e të gjitha NP-ve. Treguesit e zhvillimit të qëndrueshëm dhe konsistent të NP sikur se janë norma e kthimit në aktive (ROA) dhe norma e kthimit në ekuitet (kapital) (ROE) vetëm në disa raste arrijnë

normat standarde të rritjes kurse pjesën më të madhe të gjitha NP janë nën nivelin standard prej 5% (ROA) dhe 15% (ROE), shembuj janë vitet 2012 dhe 2013 kur KEK-u ka pasur ROA mbi 5% dhe ROE mbi 15%, NP "Trainkos" në vitin 2013 dhe "PTK" në periudhen prej 2012 deri 2014.

Në tabelën në vijim, janë paraqitur koeficientët e korelacionit në të dy kahjet të të gjitha variablave të përfshira në model. Siç shihet në tabelë, performanca financiare ka lidhje të fortë negative me raportin e Llogaritë e Pagueshme / Detyrimet Totale me koeficient - 0.53 dhe me raportin e shpenzimeve operative ndaj të hyrave me koeficient – 0.839, ndërsa ka lidhje të butë pozitive me provizionin për borxhet e këqija. Të tri këto korelacione janë në nivelin e rëndësisë prej 1%. Në të njëjtën kohë këto dy variabla të pavarura (LLP/Det.Totale dhe raporti ShpOp/Të hyr e përgjithshme) kanë lidhje të fortë pozitive në nivelin 1%. Ndërsa performanca financiare si variabël e varur ka lidhje të butë negative me Raportin e shpenzimeve të pagave në shpenzimet totale në nivel 5%, me koeficient – 0.309.

Tabela Nr. 35 - Koeficientët e korrelacionit të Perasonit të variablave të pavarura dhe variablës së varur

	ProvizBorxh Keqija	LLAAsTot	LLPDet Tot	PagShpOp	RapShpOp TeHyr	PERF
ProvizBorxhKeqija	1	0.181	-0.174	-0.103	-0.229	0.346**
LLAAsTot	0.181	1	0.186	-.243*	0.066	-0.198
LLPDetTot	-0.174	0.186	1	.150	0.609**	-0.530**
PagShpOp	-0.103	-0.243*	0.150	1	0.157	-0.309*
RapShpOpTeHyr	-0.229	0.066	0.609**	0.157	1	-0.839**
PERF	0.346**	-0.198	-0.530**	-0.309*	-0.839**	1

*. Korrelacioni është statistikisht i rëndësishëm në nivelin 5 % (në 2-anët).

** . Korrelacioni është statistikisht i rëndësishëm në nivelin 1 % (në 2-anët).

Modeli i regresionit dhe diskutimi i rezultateve

Në vijim të kësaj pjese do të diskutohet mbi rezultatet e modelit ekonometrik për treguesit që e ndikojnë performancën financiare të ndërmarrjeve publike në Kosovë. Analiza e regresionit linear është përdorur për të matur ndikimin e treguesve të përcaktuar në performancën financiare të ndërmarrjeve publike që operojnë në Kosovë. Qëllimi i kësaj metode bazohet nëse treguesit të caktuar (variablat e pavarura) kanë ndikim statistikisht të rëndësishëm në performancën financiare - variablën e varur. Treguesit janë variabla të pavarura, të cilët pritet të ndikojnë në variablën e varur në këtë rast performancën financiare (PERF). Konsiderohet se një tregues ka ndikim në variablën e varur kur vlera p e tij është $p < 0.05$, apo deri në nivelin 5% të rëndësisë statistikore. Analizimi i të dhënave është bërë përmes programit në excel dhe pakos softverike SPSS.

Në vijim është paraqitur testimi i modelit, ku vërehet se e kalon testin e rëndësisë në nivelin 1% (nga tab. ANOVA, sig.=0) . Variabla e pavarura të përfshira e shpjegojnë në masë të lartë modelin me nivel prej $R^2 = 83.1\%$, për më tepër R^2 e rregulluar është 81.6%. Pjesa tjetër janë faktorë të tjerë, jashtë këtij modeli, që ndikojnë në performancën financiare.

Tabela Nr. 36 - Përmbledhje e modelit të regresionit linear

Modeli	R	R katror	R katror i rregulluar	Gabimi standard i vlerësimit	Statistikat e ndryshimit				
					Ndryshimi i R katror	Ndryshimi i F	df1	df2	Rëndësia statistikore e ndryshimit të F
1	0.912 ^a	0.831	0.816	0.37631	0.831	57.047	5	58	0.000

a. Predictors: (Constant), RapShpOpTeHyr, PagShpOp, ProvizBorxhetKeqija, LLAAsTot, LLPDetTot

ANOVA^b

Modeli	Shuma e katrorëve	shkallët e lirisë	Katrori i mesatares	F	Sig.
1 Regresioni	40.391	5	8.078	57.047	.000 ^a
Residual	8.213	58	.142		
Total	48.604	63			

a. Përcaktuesit: (Konstanta), Rap ShpOp/TeHyr, Pag/ShpOp, Proviz/BorxhetKeqija, LLA/AsTot, LLP/DefTot

b. Variabla e varur: PERF

Për të testuar hipotezat e ngritura u përdor regresioni linear duke formuar ekuacionin linear:

$$\text{PERF} = \beta_0 + \beta_1 \text{ Proviz Borxhet Keqija} + \beta_2 \text{ LLA/AsTot} + \beta_3 \text{ LLP/DefTot} + \beta_4 \text{ Pag/ShpOp} + \beta_5 \text{ RapShpOp/TeHyr} + \varepsilon$$

Tabela Nr. 37 - Koeficientët e regresionit linear

Modeli	Koeficientët e pastandardizuar		Koeficientët e standardizuar	t	Rëndësia statistikore (Sig.)	Statistikat e kolinearitetit	
	B	Std. Error	Beta			Toleranca	VIF
(Konstanta)	3.189	.253		12.602	.000		
ProvizBorxhetKeqija	0.000	.000	.227	3.949	.000	0.881	1.135
LLA/AsTot	-0.027	.005	-.330	-5.221	.000	0.731	1.368
LLP/DefTot	0.003	.002	.086	1.223	.226	0.590	1.695
Pag/ShpOp	-0.015	.003	-.291	-4.896	.000	0.825	1.212
RapShpOp/TeHyr	-0.028	.003	-.712	-10.213	.000	0.599	1.669

a. Variabla e varur: PERF

Rezultatet nga analiza e regresionit linear tregojnë se variablat e pavarura në vijim: niveli i llogarive të arkëtueshme, pjesëmarrja e shpenzimeve në paga dhe raporti i shpenzimeve

operative ndaj të hyrave të përgjithshme, si sfida financiare të ndërmarrjeve publike kanë ndikim negativ statistikisht të rëndësishëm në performancën financiare të ndërmarrjeve publike në Kosovë dhe atë në nivelin absolut të rëndësisë $p=0$, që dmth. se $P<0.05$ (tabela nr. 37). Ndikimin negativ të tyre e tregon shenja negative e koeficientëve beta (B) të këtyre variablave në model. Treguesi i provizionit të borxheve të këqija edhe pse është statistikisht i rëndësishëm në model, efekti i tij është $B=0$. Ndërsa, pjesëmarrja e llogarive të pagueshme në detyrimet e përgjithshme nuk është statistikisht e rëndësishme me ndikim në performancën financiare.

Testi për matjen e nivelit të multikolaritetit tregon se në asnjërën nga variablat e përfshira në model nuk ka prezencë të multikolaritetit, pasi që konsiderohet se multikolariteti i variablave është prezent nëse niveli i VIF është 5 e më i lartë dhe niveli i tolerancës është 0.2 e më i vogël.

Bazuar në të dhënat e gjeneruara nga analiza e regresionit linear variablat që dolën të kenë ndikim statistikisht të rëndësishëm mund të përfshihen në model dhe të formohet ekuacioni i regresionit linear:

$$\text{PERF} = 3.189 + 0 * \text{ProvizBorxhetKëqija} - 0.027 * \text{LLA/AsTot} - 0.015 * \text{Pag/ShpOp} - 0.028 * \text{RapShpOp/TeHyr} + \varepsilon \quad (\varepsilon \text{ -gabimi standard i variablave të pavarura}).$$

Bazuar nga gjetjet e modelit ekonometrik mund të konkludohet se hipoteza: sfidat financiare kanë ndikim negativ në performancën financiare të ndërmarrjeve publike konfirmohet e vërtetuar.

KAPITULLI VI: DISKUTIME, KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

6.1 Diskutime të gjetjeve kryesore dhe rekomandime

Siç u shpjegua më lartë përpunimi i të dhënave ka dhënë rezultate varësisht nga të dhënat e krahasuara. Në diskutimin e tyre ne po vazhdojmë ashtu siç ka shkuar rrjedha e përpunimit të tyre. Së pari, do të prezentojmë një përmbledhje të rezultateve statistikore të cilat megjithatë japin disa informata të rëndësishme për NP dhe sfidat me të cilat përballen. Siç mund të shihet pjesa më e madhe e të anketuarve janë në pozita vendimmarrëse apo 72% dhe nga të gjithë të anketuarit del se të grupmohës së re (25-35 vjet) janë vetëm 6.5%.

Në aspektin gjinor raporti është 81.3% meshkuj dhe 18.7% femra kurse numri më i madh i NP apo 48.6% prej tyre kanë prej 51-250 të punësuarë dhe 36.4% e NP-ve kanë prej 251-1000 të punësuarë deri sa NP që kanë mbi 1000 të punësuarë janë vetëm 12.10%. Sa i takon veprimtarisë 38.3% janë nga veprimtaria e furnizimit me ujë-ujësjellësve deri sa pjesa tjetër e veprimtarive nuk dallon shumë nga njëra tjetra në përqindjen e pjesëmarrjes. Të dhënat që mund të kanë ndikim në rezultatin e përgjithshëm janë ato që kanë të bëjnë me përvojën në qeverisjen korporative, si anëtarë të bordeve të drejtorëve dhe njohuritë e tyre për veprimtaritë e NP-ve.

Se sfidat financiare janë preokupim të drejtuesve të NP-ve kemi gjetur se rangimi i sfidave ndryshon. Disa kanë marrëdhënie statistikisht të rëndësishme në mes të pozitës drejtuese dhe sfidave si arkëtimi në nivel të ulët i të hyrave, afateve të shkurtëra për pagesën e detyrimeve, etj. janë konstatuar përmes tabelave të kryqëzuara (crosstabulation).

Kështu p.sh.për shkak të nivelit të ulët në arkëtimin e të hyrave sipas tabelave të kryqëzuara, kjo sfidë është në vëmendje të drejtuesve të NP gjithnjë apo 51.4% (te anëtarët e bordeve 55.8% , kryeshefat ekzekutiv 50.0%, zyrtarët financiar 40% dhe te të tjerët 30.0%), shpesh apo 21.5% derisa për nivelin shumë rrallë nuk është deklaruar askush prandaj mungon ajo kolonë. Kështu kemi përdorur testin "Chi-square" të pavarur i quajtur edhe testi "Chi-square" i Pearsonit, për të zbuluar nëse aty ka ndonjë marrëdhënje statistikore në mes të dy variablave të testuara.

Në këtë rast analiza 'Chi-Square' vërteton se ka dëshmi të marrëdhënieve statistikore në mes të pozitës në ndërmarrjes publike dhe rangimit të nivelit të ulët në arkëtimin e të hyrave pasi që vlera e provës statistikore e 'Pearson-Chi-square' është në nivel të lartë prej 16.557 me shkallën e lirisë "df"=9 dhe dhe vlera $p < 0.05$ (0.051). Sipas kësaj metodologjie duke synuar që të japim përgjigje në pyetjen kërkimore sa ndikojnë sfidat financiare të ndërmarrjeve publike në cilësinë e shërbimeve publike kemi vazhduar të testojmë edhe disa sfida tjera për të cilat të anketuarit kanë treguar se janë në prezente të NP sikurse janë borxhet e këqija $p < 0.05$ (0.065) dhe numri i madh i të punësuarëve $p < 0.05$ (0.015). Në pjesën e dytë të testimit se sa sfidat financiare janë të pranishme në NP janë testuar variablat përmes tabelave të kryqëzuara të pozitës në ndërmarrje, përgjigjeve të pranuar rreth renditjes së sfidave financiare sipas vështirësisë dhe arkëtimin të të hyrave.

Në rastet në vijim analiza 'Chi-Square' vërteton se ka dëshmi të marrëdhënieve statistikore në mes të pozitës në ndërmarrjes publike dhe rangimit të numrit të madh të punësuarve pasi

që vlera e provës statistikore e ‘Pearson-Chi-square’ është në nivel të lartë prej 21.624 me shkallën e lirisë "df"=12 dhe vlera $p < 0.05$ (0.042), afateve të shkurtëra për pagesën e obligimeve pasi që vlera e provës statistikore e ‘Pearson-Chi-square’ është në nivel të lartë prej 20.791 me shkallën e lirisë "df"=12 dhe vlera $p < 0.05$ (0.054).

Pra, këto janë vetëm disa prej sfidave të cilat janë më shumë prezente në NP që nuk do të thotë se tjerat nuk janë por sipas rezultateve ato janë më pak.

Rezultatet e matjes së ndërvarsisë së variablave, nivelit të rëndësisë statistikore dhe koeficienti i korrelacionit Pearson tregojnë për sfidat të cilat janë si rezultat i situatës financiare nëpër të cilën kalojnë NP (arkëtimi i të hyrave, flukset monetare të ndryshueshme, problemet me likuiditetin, borxhet e këqija, shpenzimet e larta, humbjet teknike dhe shfrytëzues të shërbimeve janë personat fizikë).

Po kështu është shumë karakteristike se disa nga sfidat të cilat janë më pak të natyrës financiare si afatet e shkurtëra për pagesën e detyrimeve, infrastruktura e vjetëruar, probleme të natyrës legale me ndikim financiar, situata politike – mospagesa nga ana e komunitetit pakicë dhe numri i madh i të punësuarve sipas rezultateve të matjes së korrelacionit të varsisë kanë dhënë rezultat se ndërvarësia në mes të variablave të matura nuk ekziston prandaj edhe niveli i rëndësisë statistikore është zero.

Po ashtu një sfidë që nuk është e natyrës financiare siç është zhvlerësimi por që ka ndikim në nivelin e shpenzimeve të përgjithshme edhe sipas matjes së ndërvarsisë në mes të variablave ka rezultuar të jetë në funksion të kundërt me situatën financiare nëpër të cilën kalojnë NP.

Se sfidat financiare ndikojnë në cilësinë e shërbimeve publike me prezencën e tyre këtë e kemi analizuar përmes matjes së korelacionit, përmes tabelave të kryqëzuara të cilat siç është prezentuar më lartë kanë treguar se ekziston një korelacion i fortë pozitiv në mes të variablave të njejta sipas dy kategorizimeve (prezencës së tyre dhe ndikimit të tyre).

Pra, mund të konstatojmë se ato NP të cilat ballafaqohen me këto sfida nuk arrijnë të ofrojnë shërbime publike cilësore, në disa sektorë më shumë e në disa të tjerë më pak në varësi të shtrirjes dhe ndikimit që kanë ato sfida. P.sh. niveli i arkëtimit të të hyrave të NP të cilat arkëtojnë të hyra nga disa burime është në nivel më të lartë se sa niveli i arkëtimit të të hyrave nga NP të cilat arkëtojnë të hyrat vetëm nga fermerët për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore. Ose NP të furnizimit me ujë-ujësjellësve ballafaqohen me nivelin e ulët të arkëtimit të të hyrave nga personat fizik-amvisëritë familjare. Megjithatë, ato kanë nivel mjaft të lartë të arkëtimit të të hyrave nga organizatat shtetërore (ministritë, agjencionet qeveritare, policia, gjykatat, spitalet, shkollat, NP si shfrytëzuese të shërbimit, etj.) që ju mundëson të gjenden në pozitë më të favorshme sepse në njëfarë mënyre ato kanë një nivel të arkëtimit të rrjedhshëm për çdo muaj pavarësisht se cili është raporti në mes burimeve të të hyrave gjegjësishtë shfrytëzuesve të shërbimeve të tyre. Ose NP të cilat ofrojnë shërbime edhe për komunitetet të cilat janë pakicë në Kosovë por që për shkak të situatave politike të ndryshueshme, refuzimit të pagesës nuk arrijnë të arkëtojnë të hyrat për shërbimet e ofruara. Ndërprerja apo mosofrimi i shërbimeve adresohet si politikisht e motivuar prandaj këto NP janë në pozitë të pavolitshme, të pafuqishme që të arrijnë të përmirësojnë nivelin e arkëtimit ndërsa krijojnë shpenzime për të cilat duhet paguar.

Edhe pse kërkesat e NP-ve drejtuar qeverisë për subvencionimin e kësaj pjese të të hyrave ose rimbursimit të shpenzimeve bëhen, nga ana e qeverisë ato vonohen ose ndërmerret ndonjë veprim gjatë rishikimit të mbylljeve buxhetore në fund të vitit. Mospagesa e detyrimeve nga ana e NP të ballafaquara me këtë sfidë shpesh herë i vënë në vështirësi financiare NP tjera të cilat kanë ofruar shërbime (p.sh. mospagesa e energjisë elektrike, mospagesa e ujit të papërpunuar nga ana e ujësjellësve, etj.). Kjo ka efekt zinxhiror mes ndërmarrjeve të përfshira në transaksione por që ka ndikim në cilësinë e shërbimeve publike.

Një ndikim tjetër i kushtëzuar nga sfidat financiare të përmendura më lartë, i cili nga aspekti i zhvillimit të mëtejshëm të tyre është shumë i rëndësishëm paraqitet te kthimi në aktive dhe kthimi në kapitale të veta. Ballafaqimi me nivel të ulët të arkëtimit të të hyrave, me numër të madh të punësuarve, borxhe të këqija, flukse të ndryshueshme të parasë dhe sfida tjera, afarizmi me humbje operative nuk ju lejon NP të arrijnë ose të ngrisin normat e kthimit në aktive dhe kapitale të veta që ka ndikim në zhvillimin e qëndrueshëm të tyre por edhe në zhvillimin ekonomik të vendit.

Duke marrë parasysh të gjitha që u analizuan më lartë, konsiderojmë se rekomandimet në vijim janë shumë të dobishme:

Ngritja e nivelit të tanishëm të mbikëqyrjes financiare të NP nga Njësia për Politika dhe Monitorim të NP është e domosdoshme,

Qeveria e Kosovës duhet të krijojë një strategji afatgjate në mbështetje të NP për ngritjen e performances financiare dhe zhvillim të qëndrueshëm të NP,

Me ngritjen e performances financiare do të rritej pjesëmarrja e NP në Bruto Produktin Vendor që do të kishte efekt zinxhiror në minimizimin e sfidave financiare dhe përballjen

më të lehtë nga ana e NP me sfidat financiare, (p.sh.krijimin e mundësive për punësim të rinjve të papunësuar, etj.).

6.2 Kontributet e studimit, kufizimet dhe perspektiva e vazhdimet në të ardhmen

Synim i secilës shoqëri të organizuar është që të ofrohen shërbime sa më cilësore për qytetarin. Roli i NP në ofrimin e shërbimeve publike të një vendi është shumë i rëndësishëm. Duke pasur parasysh këtë, diskutimet lidhur me mënyren e organizimit dhe të qeverisjes së tyre vazhdojnë të janë të shumta. Ato dallojnë nga vendi në vend sipas mënyrës së organizimit të tyre, mënyrës së qeverisjes, sfidave me të cilat ballafaqohen, mjedisit ku veprojnë, etj.

Në Kosovë NP janë themeluar pas vitit 2007 dhe nuk kanë përvojën e vendeve tjera. Kryesisht jemi fokusuar në ndërmarrjet publike qendrore dhe ndërmarrjet publike rajonale të ujitjes dhe ujësjellësit të cilat janë më të mëdha përkahe veprimtaria që kryejnë, territorit që mbulojnë, numrit të punësuarëve, vlerës së pronës dhe pajisjeve, etj. Konsiderojmë se ky punim do të jap një kontribut të rëndësishëm i cili do të ju shërbej jove të vendimmarrësve, drejttimeve të ndërmarrjeve por edhe studjuesve të ardhshëm jove të brenda Kosovës por edhe jashtë vendit. Ky punim është karakteristik për disa arsye:

Së pari, është ndoshta studimi i parë i cili merret me hulumtimin dhe analizën e çështjeve të ndërmarrjeve publike në Kosovë. Deri më tani organizatat joqeveritare, odat ekonomike, e

institucione tjera janë marrë kryesisht me zbatimin e ligjeve përkatëse në segmente të caktuara nga ana e bordeve dhe drejtimeve të NP.

Së dyti, ky punim pasqyron sfidat kryesore dhe më të rëndësishme me të cilat ballafaqohen në këtë periudhë ndërmarrjet publike. Ai jep një pamje të gjendjes aktuale dhe të sfidave të cilat në të ardhmen kërkojnë një zgjidhje sa më të shpejtë. Gjithashtu identifikon vështirësitë kryesore të cilat janë pengesë për ofrimin e shërbimeve cilësore publike dhe zhvillim të mëtejshëm të tyre.

Së treti, mund të shërbejë si ndihmesë ndërmarrjeve publike për një vlerësim të gjendjes në ndërmarrjet tyre duke ju dhënë përparësi dhe forcuar aktivitetet në drejtim të minimizimit të pengesave për zhvillimin e tyre në fazën fillestare. Tejkalimi i gjendjes aktuale ndihmon në forcimin e pozitës financiare që ndikon në rritjen e cilësisë dhe sasisë së shërbimeve.

Së katërti, mund të shërben si një përkujtues për organet vendimmarrëse (bordet e drejtorëve, drejtimet e ndërmarrjeve) por edhe të atyre mbikëqyrëse (grupet parlamentare) dhe monitoruese (Njësia për Politika dhe Monitorim të NP-ve) që të merren me zgjidhjen e tyre. Disa zgjidhje nga vendet tjera të regjionit të cilat kanë përvojë më të madhe në ofrimin e shërbimeve publike mund të shërbejnë si shembull i mirë edhe për ndërmarrjet publike në Kosovë.

Së pesti, me qenë se aktualisht për këtë problematikë ka një mungesë të studimeve, ky studim do të shërbej si bazë për nisje të studimeve tjera më të thella dhe të profilizuara për

studjues të ardhshëm vendor dhe të huaj nga se rasti i transformimit të ish ndërmarrjeve shoqërore, qeverisja-administrimi nga ish AKM-ja (UNMIK) dhe organizimi si ndërmarrje publike është një rast shumë i rrallë në praktiken ekonomike.

Dhe në fund, por jo më pak e rëndësishme, nëse merren parasysh rezultatet e këtij studimi ballafaqimi i ndërmarrjeve publike me sfidat e tanishme do të ndihmojë në sensibilizimin për tejkalimin e lehtë të tyre kurse do të përmirësohej cilësia e shërbimeve publike për qytetarin që është qëllim i organizimit dhe funksionimit të tyre si dhe do të ndikoj në zhvillimin e qëndrueshëm dhe më konsistent të ndërmarrjeve publike.

Megjithë kontributin e përmendur më lartë, ky studim është ballafaquar me disa vështirësi të cilat kanë pasur ndikim në kufizimin e studimit:

Së pari, ky studim ka përfshirë vetëm ndërmarrjet publike qendrore dhe ndërmarrjet publike rajonale të ujit dhe ujësjellësit por nuk ka përfshirë ndërmarrjet publike të nivelit komunal.

Së dyti, bashkëpunimi i vështirësuar për shkak të nivelit të përgatitjes profesionale, përvojës së mangët në qeverisjen korporative dhe natyrës së çështjeve të trajtuara që dëshmohej me disa shmangje nga pyetësi dhe përgjegjjet e pranuar.

Së treti, megjithë se për vendet tjera mund të gjenden studime, për ndërmarrjet publike në Kosovë ne nuk kemi gjetur studime paraprake në këtë lami që ka paraqitur një kufizim të madh në kuptim të krahasimit të analizave dhe rezultateve sipas veprimtarisë, brenda industrisë ku vepron, në nivel të vendit, etj. Pastaj, edhe vet procesi i themelimit - formimit

të NP të reja por edhe i riorganizimit të NP aktuale është duke vazhduar edhe më tutje që mund të kufizojë krahasueshmërinë e tyre.

Dhe në fund, me qenë se objekt i studimit janë NP në Kosovë ky punim mund të jetë i kufizuar për NP nga vendet tjera për shkak të nivelit të zhvillimit të ndryshëm të tyre, formës së organizimit dhe kornizës ligjore rregullative.

Pavarësishtë kufizimeve të lartpërmendura, me një siguri të arësyeshme vlerësojmë që ky studim do të vazhdojë me intensitet shumë më të madh se deri më tani për disa arsye:

Së pari, sigurisht që sfidat financiare do të janë objekt studimi pasi që ato janë të vazhdueshme, nuk janë të njejta dhe nuk përfundojnë brenda një periudhe kohore.

Së dyti, disa nga sfidat me të cilat aktualisht përballen ndërmarrjet publike dhe janë shtjelluar në këtë studim do të ndryshojnë dhe në të ardhmen do të paraqiten sfida tjera të reja.

Së treti, gjithnjë e më shumë po ngritet vetëdija qytetare dhe kërkesat për nivelin më të lartë cilësisë dhe sasisë së shërbimeve publike bashkë me kërkesat e shoqërisë civile për shërbime tjera të reja dhe për rritjen e mbikëqyrjes së shpenzimeve dhe llogaridhënjen për shërbime publike.

Së katërti, disa nga NP që funksionojnë sot do të janë objekt studimi nga perspektiva të ndryshme të zhvillimit (rritja e kapaciteteve të furnizimit të KRU "Prishtina" - impianti në Shkabaj, funksionimi i shërbimeve publike të cilat janë privatizuar-distribuími i energjisë apo janë kërkesat ambientale për gjeneruesit e energjisë nga termocentralet, cilësia e ujit, etj.) .

Dhe në fund, nëse zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm i NP do të jetë prioritet, sfidat financiare do të janë preokupim jovetëm i drejtuesve të NP por edhe të studjuesve të ardhshëm, hulumtuesve të pavarur, shoqërisë civile, etj..

6.3 Konkluzione përfundimtare

Duke qenë të fokusuar në cilësinë e shërbimeve publike që ofrohen dhe vështirësitë me të cilat ballafaqohen NP për ofrimin e këtyre shërbimeve shumë të rëndësishme për qytetarin, në këtë studim kemi analizuar sfidat financiare në nivelin e ndërmarrjeve publike qendrore të Kosovës i cili ka përfshi të gjitha ndërmarrjet publike qendrore dhe ndërmarrjet publike rajonale të ujitjes dhe ujësjellësit sipas kategorizimit të Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik të Kosovës.

Në punim janë parashtruar dy hipoteza:

1. Sfidat financiare kanë korrelacion pozitiv me cilësinë e shërbimeve që ofrohen nga ndërmarrjet publike.
2. Sfidat financiare kanë ndikim negativ në performancën operative dhe financiare të ndërmarrjeve publike.

Me qëllim të testimit të hipotezave të këtij studimi, në punim në dy kapituj është dhënë kuadri teorik në të cilin janë trajtuar në formë kronologjike zhvillimi i ndërmarrjeve publike që nga themelimi i tyre-transformimi i tyre nga ish ndërmarrjet shoqërore deri te formimi dhe funksionimi i tyre si ndërmarrje publike, organizimi, funksionimi i tyre në formën e tanishme, aplikimi i sistemit të qeverisjes korporative, organet drejtuese, struktura organizative dhe mbikëqyrja e tyre.

Në vazhdim, në kapitullin e tretë, janë trajtuar disa nga sfidat financiare me të cilat aktualisht përballen ndërmarrjet publike dhe për të cilat drejtuesit e tyre kërkojnë zgjidhje sepse janë pengesa kryesore për ofrimin e shërbimeve publike cilësore.

Gjithashtu, për testimin e hipotezave janë përdorur metoda statistikore, (analiza e thjeshtë e të dhënave, analiza e tabelave të kryqëzuara-përmes testit “Chi square”, matjes së korrelacionit përmes koeficientit Pearson dhe analiza e regresionit linear) për përpunimin e të dhënave dhe nxjerrjen e rezultateve në lidhje me sfidat financiare të ndërmarrjeve publike dhe ndikimin e tyre në cilësinë e shërbimeve publike dhe në performancën e tyre operative dhe financiare. Sipas rezultateve të analizës të testit “Chi square”, analiza tregon se ka marrëdhënie të rëndësishme statistikore në mes pozitës drejtuese në NP, llojit të veprimtarisë dhe nivelit të arkëtimit të të hyrave si sfida që ndikojnë në cilësinë e shërbimeve të ofruara. Sipas rezultateve të analizës së regresionit linear mund të konstatojmë se sfidat financiare kanë ndikim negativ në performancën financiare të ndërmarrjeve publike.

Rezultatet kryesore të studimit tregojnë se në varësi nga marrësi i shërbimeve apo për kend ofrohen shërbimet (për ndërmarrje publike, biznese apo persona fizik), varësisht nga veprimtaria të cilën e ushtrojnë, edhe sfidat financiare ndryshojnë nga një ndërmarrje në tjetrën. Po ashtu disa nga këto sfida (niveli i ulët i arkëtimit të të hyrave, fluksi i ndryshueshëm - i çrregulluar i parasë, likuiditeti i ulët, borxhet e këqija, etj.) ndikojnë jovetëm në cilësinë e shërbimeve publike por edhe në krijimin e vështirësive tjera financiare të lidhura me të dhe të gjenerimit të sfidave tjera të cilat pastaj kanë ndikim zinxhiror në zhvillimin ekonomik dhe të qëndrueshëm të NP. Përpjekjet për një ekonomi të

hapur dhe konkurruese - liberalizimi i tregut dhe dhënja fund të trajtimit preferencial të ndërmarrjeve publike nga ana e qeverisë, është përvojë nga vendet e zhvilluara e cila mund të ndihmojë vendet si Kosova.

Dhe në fund, në kushtet e zhvillimit të ekonomisë në Kosovë, sfidat financiare nuk janë të përkohshme, ato do të vazhdojnë të janë të pranishme dhe përballja e suksesshme apo jo nga ana e Drejtimit të ndërmarrjeve, do të përcaktojë nivelin e cilësisë së shërbimeve publike, standardin e jetës së qytetarëve, formën e mundshme të organizimit të ardhshëm të tyre dhe nivelin e zhvillimit të shoqërisë në tërësi.

BIBLIOGRAFIA

- AKP. (2009). *Raport i punës 2008-2009*. Prishtine: Agjencia Kosovare e Privatizimit.
- ARRU. (2016). *Rregullore Nr. 07/2016 Për Përcaktimin e Tarifave të Shërbimit të Ujit në Kosovë*. Prishtine: Autoriteti Rregullativ për Shërbimet e Ujit.
- Borzaga, C., & Tortia, E. (2009). Social Enterprises and Local Economic Development. *The Changing Boundaries of Social Enterprises Local Economic and Employment Development (LEED)*, 195-228.
- Burchell, J. (2008). *The corporate social responsibility reader*. Milton Park, Abingdon, Oxon: Routledge.
- Clifton, J., Comín, F. C., & Fuentes, D. D. (2003). *Privatisation in the European Union: Public enterprises and integration*. Dordrecht: Kluwer Academic.
- Clifton, J., Comín, F., & Fuentes, D. D. (2003). The End of Public Enterprises in Europe? *Privatisation in the European Union*, 45-81.
- Dunning, J. H., & Lundan, S. M. (2008). *Multinational enterprises and the global economy*. Cheltenham, UK: Edward Elgar.
- Dyck, I. J. (1999). *Privatization and corporate governance: Principles, evidence and future challenges*. Boston: Division of Research, Harvard Business School.
- EBRD. (2013). *Strategy for Kosovo*. Prishtine: European Bank for Reconstruction and Development.
- EBRD. (2013). *STRATEGY FOR KOSOVO*. Prishtine: European Bank for Reconstruction and Development.
- European Investment Bank. (2015). *EIB and European Commission support railway modernisation with EUR 82 million of initial funding*. Luxembourg: European Investment Bank.
- Filipovic, M., & Krnjeta, L. (2013). *Jedinstvena metodologija za određivanje cena komunalnih usluga*. Beograd: Swiss Agency for Development and Cooperation.
- Friedman, M. (1962). *Capitalism and freedom*. Chicago: University of Chicago Press.
- Friedrich, P., & Wonnemann, H. (2005). Financial Effects of Establishing a Public Office or Public Enterprise. *Papers in Regional Science*, 56(1), 229-247.

- GAP. (2012). *Procesi i privatizimit dhe vlera e asetëve të KEDS*. Prishtine: GAP.
- GAP. (2015). *Menaxhimi Ndërmarrjeve Publike*. Prishtine: Instituti për Studime të Avancuara GAP.
- GIZ & MIE. (2012). *Material diskutues për ndërmarrjet shoqërore dhe publike në Republikën e Kosovës*. Prishtine: Task Forca për Integrim Evropian.
- GLPS & BIRN. (2016). *Shitje në panik: Vlerësim i Sfidave dhe Problemeve Kryesore të Procesit të Privatizimit në Kosovë*. Prishtine: Group for Legal and Political Studies.
- Gonzales, V. (2007). Social Enterprises, Institutional Capacity and Social Inclusion. *Local Economic and Employment Development (LEED) The Social Economy*, 119-153.
- Grant Thornton. (2014). *Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur: Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës*. Prishtine: Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës.
- Grant Thornton. (2014). *Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të Pavarur: Korporata Energjetike e Kosovës*. Prishtine: Korporata Energjetike e Kosovës.
- Gupta, K. R. (2011). *Public enterprises: Economics and management*. New Delhi: Atlantic & Distributors.
- International Finance Corporation. (2008). *A Conflict's Impact on Project Goals and Reputation Risk: Lessons from Kosovo Privatization Program*. Prishtine: International Finance Corporation.
- Jesover, F., & Kirkpatrick, G. (2015). *The Revised OECD Principles of Corporate Governance and their Relevance to Non-OECD Countries*. OECD.
- KDI & TIK. (2015). *National Integrity System Assessment Kosovo*. Prishtine: Kosova Democratic Institute.
- KEK. (2012). *Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të Pavarur për vitin 2011*. Prishtine: Korporata Energjetike e Kosovës.
- KEK. (2012). *Raporti Vjetor 2011*. Prishtine: Korporata Energjetike e Kosovës.
- KEK. (2013). *Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të Pavarur për vitin 2012*. Prishtine: Korporata Energjetike e Kosovës.
- KEK. (2013). *Raporti Vjetor 2012*. Prishtine: Korporata Energjetike e Kosovës.

KEK. (2014). *Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të Pavarur për vitin 2013*. Prishtine: Korporata Energjetike e Kosoves.

KEK. (2014). *Raporti mbi Përmbushjen e Nevojave të Konsumatorëve për vitin 2013*. Prishtine: Korporata Energjetike e Kosoves.

KEK. (2014). *Raporti Vjetor 2013*. Prishtine: Korporata Energjetike e Kosoves.

KEK. (2015). *Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të Pavarur për vitin 2014*. Prishtine: Korporata Energjetike e Kosoves.

KEK. (2015). *Raporti Vjetor 2014*. Prishtine: Korporata Energjetike e Kosoves.

KFOS & RIINVEST. (2015). *Koncesioni i Aeroportit*. Prishtine: Riinvest Institute.

KFOS & RIINVEST. (2015). *Privatizimi në Sektorin e Energjisë*. Prishtine: Riinvest Institute.

Komisioni Evropian. (2014). *Strategjia e zgjerimit dhe sfidat kryesore 2014-2015*. Prishtine: Komisioni Evropian.

KRU Mitrovica. (2012). *Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të Pavarur për vitin 2011*. Mitrovica: Kompania e Ujesjellesit Rajonal Mitrovica.

KRU Mitrovica. (2012). *Raporti Vjetor 2011*. Mitrovica: Kompania Ujesjellesi Rajonal Mitrovica.

KRU Mitrovica. (2013). *Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të Pavarur për vitin 2012*. Mitrovica: Kompania e Ujesjellesit Rajonal Mitrovica.

KRU Mitrovica. (2013). *Raporti Vjetor 2012*. Mitrovica: Kompania Ujesjellesi Rajonal Mitrovica.

KRU Mitrovica. (2014). *Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të Pavarur për vitin 2013*. Mitrovica: Kompania e Ujesjellesit Rajonal Mitrovica.

KRU Mitrovica. (2014). *Raporti Vjetor 2013*. Mitrovica: Kompania Ujesjellesi Rajonal Mitrovica.

KRU Mitrovica. (2015). *Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të Pavarur për vitin 2014*. Mitrovica: Kompania e Ujesjellesit Rajonal Mitrovica.

KRU Mitrovica. (2015). *Raporti Vjetor 2014*. Mitrovica: Kompania Ujesjellesi Rajonal Mitrovica.

KUR Prishtina. (2012). *Raporti Vjetor 2011*. Prishtine: Kompania Ujesjellesit Rajonal Prishtina.

KUR Prishtina. (2013). *Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të Pavarur për vitin 2012*. Prishtine: Kompania Ujesjellesit Rajonal Prishtina.

KUR Prishtina. (2013). *Raporti Vjetor 2012*. Prishtine: Kompania Ujesjellesit Rajonal Prishtina.

KUR Prishtina. (2014). *Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të Pavarur për vitin 2013*. Prishtine: Kompania Ujesjellesit Rajonal Prishtina.

KUR Prishtina. (2014). *Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të Pavarur për vitin 2013*. Prishtine: Kompania Ujesjellesit Rajonal Prishtina.

KUR Prishtina. (2014). *Raporti Vjetor 2013*. Prishtine: Kompania Ujesjellesit Rajonal Prishtina.

KUR Prishtina. (2015). *Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorëve të Pavarur për vitin 2014*. Prishtine: Kompania Ujesjellesit Rajonal Prishtina.

KUR Prishtina. (2015). *Raporti i Pasqurave Financiare te Audituarra: KUR Prishtina*. Prishtine: KUR.

KUR Prishtina. (2015). *Raporti Vjetor 2014*. Prishtine: Kompania Ujesjellesit Rajonal Prishtina.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2008). *Ligji Nr. 03/L-114: Për Tatimin mbi Vleren e Shtuar*. Prishtine: Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Kuvendi i Republikës së Kosovës. (2015). *LIGJI Nr. 05/L -043: Për Faljen e Borxheve Publike*. Prishtine: Kuvendi i Republikës së Kosovës.

Mallin, C. A. (2004). *Corporate governance*. Oxford: Oxford University Press.

MCI. (2015). *Vleresimit te Perfomaces dhe Efektshmerise se Bordeve te Ndermarrjeve Publike*. Prishtine: Management Consulting Institute.

Millward, R. (2011). Public Enterprise In The Modern Western World: An Historical Analysis. *Annals of Public and Cooperative Economics*, 82(4), 375-398.

- Monks, R. A., & Minow, N. (2004). *Corporate governance*. Malden, MA: Blackwell Pub.
- Mourik, C. V., & Walton, P. J. (2014). *The Routledge companion to accounting, reporting and regulation*. London: Routledge Taylor & Francis Group.
- Mylonas, P., & Joumard, I. (1999). *Greek public enterprises: Challenges for reform*. Paris: OECD.
- MZHE. (2013). *Vlerësimi i Efektshmërisë së punës së Bordeve të Drejtorëve të NP-ve Qendrore për vitin 2012*. Prishtine: Ministria e Zhvillimit Ekonomik.
- MZHE. (2014). *Udhëzuesit të Auditimit të brendshëm për Ndërmarrje Publike*. Prishtine: Ministria e Zhvillimit Ekonomik.
- MZHE. (2015). *Indikatori i Çmimeve të Konsumit në Kosovë TM2*. 2015: Ministria e Zhvillimit Ekonomik.
- Narayan, J., & Singh, G. (2014). Public Enterprise Reforms and Financial Performance of Government Commercial Companies of Fiji. *International Journal of Public Administration*, 37(11), 756-772.
- Nations, U. (2008). *Public Enterprises: Unresolved Challenges and New Opportunities*. New York: United Nations.
- Njësia për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike. (2010). *Kodi i Etikës dhe Qeverisja Korporative për Ndërmarrjet Publike*. Prishtine: Ministria e Ekonomisë dhe Financave.
- Njësia për Politikën dhe Monitorimin e Ndërmarrjeve Publike. (2014). *Kodi i Etikës dhe Qeverisja Korporative për Ndërmarrjet Publike*. Prishtine: Ministria e Ekonomisë dhe Financave.
- Park, M., & K. (2013). Privatization of Public Enterprises and Income Smoothing. *Productivity Review Productivityreview*, 27(4), 419-446.
- Popov, L. (2016, April 23). *Privatizacija državnih tvrtki najbolja je stvar koja se može dogoditi hrvatskom gospodarstvu*. *Index.hr*. Retrieved April 27, 2016, from <http://www.index.hr/vijesti/clanak/privatizacija-drzavnih-tvrtki-najbolja-je-stvar-koja-se-moze-dogoditi-hrvatskom-gospodarstvu/888994.aspx>
- QPZH & FES. (2015). *Trendët zhvillimorë të PTK-së dhe përpjekjet e pasuksesshme për privatizimin e saj*. Prishtine: Friedrich Ebert Stiftung.

Riinvest Institute for Development Research & Center for International Private Enterprise. (2012). *Qeverisja Korporative në Ndërmarrjet Publike në Kosovë*. Prishtine: Riinvest Institute.

Slatter, S. S., & Lovett, D. (2004). *Corporate recovery: Managing companies in distress*. Washington, DC: Beard Books.

Stiglitz, J. E. (2012). *The price of inequality*. New York: W.W. Norton &.

Stiglitz, J. E., & Walsh, C. E. (2006). *Economics*. New York, NY: Norton.

SHARRCEM. (2013). *Corporatesocial responsibility and sustainability report 2013*. Hani i Elezit: SHARRCEM.

Task Forca për Integrim Evropian. (2012). *Material diskutues për ndërmarrjet shoqërore dhe publike në Republikën e Kosovës*. Prishtine: Task Forca për Integrim Evropian.

Tušek, B., & Sever, S. (2008). Development and Perspectives of Internal Auditing in the Improvement of Business Quality of Enterprises – Empirical Research in Croatia. *HRCAK*, 21, 82-95.

The Changing Boundaries of Social Enterprises. (2009). *Local Economic and Employment Development (LEED)*.

Thompson, F. (2010). How to Privatize Public Enterprises. *Public Administration Review*, 70(6), 964-967.

Ungureanu, M. (2012). Models and Practices of Corporate Governance Worldwide. *CES*, 625-635.

United Nations. (2008). *Public Enterprises: Unresolved Challenges and New Opportunities. A 60-Year History*. New York: United Nations.

United Nations. (2015). *Universal Declaration of Human Rights*. United Nations.

UNMIK. (2005). *Amending UNMIK Regulation No. 2002/12 ON The Establishment of the Kosovo Trust Agency*. Prishtine: UNMIK.

UNODC. (2013). *Business, corruption and crime in Kosovo the impact of bribery and other crime on private enterprise*. Vienna: United Nations Office on Drugs and Crime.

USAID, CDF & RIINVEST. (2016). *Menaxhimi i Mbeturinave në 16 Komuna: Mundësitë për Bashkëpunim Ndër-Komunal*. Prishtine: Riinvest Institute.

Wixley, T., Everingham, G. K., & Wixley, T. (2005). *Corporate governance*. Claremont, South Africa: Siber Ink.

World Bank & IFC. (2013). *Enterprise Surveys: Republic of Kosovo-Country Profile*. Prishtine: World Bank.

World Bank. (2013). *Kosovo country environmental analysis cost assessment of environmental degradation, institutional review, and public environmental expenditure review*. Washington, D.C.: World Bank.

World Bank. (2015). *Kosovo Overview*. Washington, DC: World Bank.

ZRRE. (2011). *Rregulla për vendosjen e çmimeve të furnizuesit publik të energjisë elektrike*. Prishtine: Zyra e Rregullatorit për Energji.

Zulić, S. (2015). *Studija o Najboljem Načinu Administrativnog Pozicioniranja Regulatornog Tijela u Postupku Utvrđivanja Cijena Komunalnih Usluga Vodosnabdijevanja i Odvodnje i Prečišćavanja Otpadnih Voda*. Sarajevo: UNDP.

SHTOJCA

Pyetësi

1. Cila është pozita juaj e punës në ndërmarrje?

Anëtar i Bordit të Drejtorëve
Kryeshef Ekzekutiv - Drejtor Ekzekutiv
Zyrtar Financiar
Tjetër

2. Sa të punësuar ka ndërmarrja?

Më pak se 50
51-250
251-1000
Mbi 1000

3. Cilen nga këto veprimtari
ushtron ndërmarrja juaj?

Energjia
Transmisioni dhe tregu i
energjisë
Telekomunikacioni

Shërbime të navigimit dhe kontrollit ajror
 Shërbime postare
 Hidroekonomike
 Infrastruktura hekurudhore
 Transporti hekurudhor
 Furnizim me ujë-Ujësjiellës
 Grumbullimi i mbeturinave
 Ujitja
 Tjetër

4. Shfrytëzuesit e shërbimeve tuaja janë...?

Ndërmarrjet publike
 Bizneset private
 Personat fizik
 Ndërmarrjet publike dhe personat fizik
 Ndërmarrjet publike, bizneset private dhe personat fizik
 Bizneset private dhe personat fizik
 Kompanitë e huaja
 Tjetër

5. Pozita juaj si operator i vetëm i këtij lloji shërbimi është...?

Po Jo

Shumë e favorshme
 E favorshme
 Neutrale
 Disfavorshme
 Shumë e disfavorshme

6. Tarifat (Çmimet) e shërbimeve tuaja të caktuara nga Zyra Rregullatore janë ... ?

Po Jo

Shumë të larta
 Të larta
 Mesatare
 Të ulëta
 Shumë të ulëta

7. A keni pasur përvojë në qeverisjen korporative para se të themelohen NP?

Plotësisht pajtohem Pajtohem Asnjanës Pjesërisht pajtohem Nuk pajtohem

Jo nuk kam pasur përvojë paraprake
 Kam pasur pak
 Po kam pasur përvojë paraprake
 Kam pasur por jo në NP

8. A keni qenë më parë anëtarë i Bordit të Drejtorëve të ndonjë NP?

Po Jo

Jo nuk kam qenë asnjëherë
 Kam qenë
 Kam qenë por jo në NP

9. Sa keni pasur njohuri për NP para se të emëroheni anëtarë i Bordit të Drejtorëve?

Plotësisht pajtohem Pajtohem Asnjanës Pjesërisht pajtohem Nuk pajtohem

Të përgjithshme
 Kam pasur njohuri për veprimtarinë
 Nuk i kam ditur vështirësitë
 Kam menduar se nuk është aq e ndërlikuar
 Kam pasur njohuri fillestare
 E kam ditur se ndodhen para shumë sfidave

10. A mendoni se duhet të bëhen ndryshime ligjore për funksionim më të mirë të NP-ve?

Plotësisht pajtohem Pajtohem Asnjanës Pjesërisht pajtohem Nuk pajtohem

Po

Vetëm tek kompetencat e Bordit të Drejtorëve

Vetëm tek kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv (Kryeshefit Ekzekutiv)

Jo

Vetëm të zbatohet ligji për NP ashtu siç kërkohet

	Plotësisht pajtohem	Pajtohem	Asnjanës	Pjesërisht pajtohem	Nuk pajtohem
Po					
Vetëm tek kompetencat e Bordit të Drejtorëve					
Vetëm tek kompetencat e Drejtorit Ekzekutiv (Kryeshefit Ekzekutiv)					
Jo					
Vetëm të zbatohet ligji për NP ashtu siç kërkohet					

11. A mendoni se duhet të bëhen ndryshime ligjore për zgjedhjen e drejtorit ekzekutiv (kryeshefit ekzekutiv) që të ruhet pavarësia e tij?

Plotësisht pajtohem Pajtohem Asnjanës Pjesërisht pajtohem Nuk pajtohem

Po

Drejtori Ekzekutiv (Kryeshefi Ekzekutiv) të mos zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve

Drejtori Ekzekutiv (Kryeshefi Ekzekutiv) të zgjidhet nga paneli i ekspertëve nga bota akademike

Drejtori Ekzekutiv (Kryeshefi Ekzekutiv) të zgjidhet nga kompania e jashtme e specializuar për këto punë

Jo, nuk ka nevojë për ndryshime

	Plotësisht pajtohem	Pajtohem	Asnjanës	Pjesërisht pajtohem	Nuk pajtohem
Po					
Drejtori Ekzekutiv (Kryeshefi Ekzekutiv) të mos zgjidhet nga Bordi i Drejtorëve					
Drejtori Ekzekutiv (Kryeshefi Ekzekutiv) të zgjidhet nga paneli i ekspertëve nga bota akademike					
Drejtori Ekzekutiv (Kryeshefi Ekzekutiv) të zgjidhet nga kompania e jashtme e specializuar për këto punë					
Jo, nuk ka nevojë për ndryshime					

12. Cila formë e organizimit të NP-ve mendoni se është më efikase në ofrimin e shërbimeve publike?

Plotësisht pajtohem Pajtohem Asnjanës Pjesërisht pajtohem Nuk pajtohem

Privatizimi
 Riorganizimi
 Koncesionimi
 Të vazhdoj si NP
 Si partneritet publiko-privat
 Ndonjë formë tjetër

13. Arkëtimi i të hyrave në NP është në nivel deri në..?

Po Jo

100% e të hyrave të faturuara
 Deri në 90%
 Prej 75-85%
 Prej 65-75%
 Prej 55-65%

14. Kush sipas juve mund të ndihmoj në rritjen e arkëtimit?

Plotësisht pajtohem Pajtohem Asnjanës Pjesërisht pajtohem Nuk pajtohem

Reklamat televizive
 Këshillimet me qytetarët në lagjet e tyre
 Ndërrimi i arkatarëve
 Efikasiteti i gjykatave
 Ligji më i ashpër
 Bashkëpunimi me policinë
 Angazhimi i kompanisë së jashtme që do të merret vetëm me arkëtimin e të hyrave
 Rritja e pikave të arkëtimit

15. Afatet e pagesës së detyrimeve nga ndërmarrja juaj janë?

Po Jo

Mjaft të gjatë
Të gjatë
Mesatar
Të shkurtër
Shumë të shkurtër

16. Flukset monetare në ndërmarrjen tuaj janë?

Po Jo

Shumë të volitshme
Të volitshme
Mesatare
Të pavolitshme
Shumë të pavolitshme

17. Si do të ndikonte partneriteti publiko-privat në ndërmarrjen tuaj?

Po Jo

Shumë pozitivisht
Pozitivisht
Nuk e di
Negativisht
Shumë negativisht

18. Me cilën nga këto situata ballafaqoheni?

Shumë rrallë Rrallë Mesatarisht Shpesh Gjithnjë

A keni vështirësi në pagesën e detyrimeve afatshkurtëra
A është paditur ndërmarrja nga furnitorët për mospagesë sipas afatit

A keni vështirësi në pagesen e pagave për të punësuarit

A ju ka ndodhur që mos të arrini të paguani kontributet pensionale për të punësuarit

A merrni kredi nga bankat komerciale

19. Niveli i borxheve të këqija është ... ?

Po Jo

Shumë i lartë

I lartë

Mesatar

I ulët

Shumë i ulët

20. Shpenzimet e zhvlerësimit janë të .. ?

Po Jo

Shumë të larta

Të larta

Mesatare

Normale

Të ulëta

21. Me cilat nga situatat më poshtë ballafaqoheni me likuiditetin?

Shumë rrallë

Rrallë

Mesatarisht

Shpesh

Gjithnjë

Pagat e të punësuarve nuk arrijmë t'i paguajmë me kohë

--	--	--	--	--

Detyrimet vazhdojnë të rriten nga viti në vit

Jo, kryesisht detyrimet e arritura i paguajmë sipas afatit për pagesë

Shpesh nuk kemi mjete për pagesën e shpenzimeve operative

Detyrohemi të kërkojmë mbitërheqje bankare për tejkalim të situatës

Kërkojmë subvencionim nga Ministria e Zhvillimit Ekonomik

22. Sa jeni dakord me pohimet e mëposhtme lidhur me kostot e shërbimeve të ndërmarrjes tuaj?

Aspak Pak Disi Shumë Plotësisht

Janë shumë të larta nga se ka shumë shpenzime operative

Mund të ishin më të ulëta sikur pagat të ishin më të ulëta

Numri i madh i të punësuarëve ndikon negativisht

Koston e rrisin shpenzimet administrative

23. Sa jeni dakord me pohimet e mëposhtme?

Aspak Pak Disi Shumë Plotësisht

Pa investime kapitale nuk mund të ngritet niveli i tanishëm i cilësisë së shërbimit

Investimet kapitale janë të domosdoshme për përmirësimin e cilësisë së shërbimeve

Vazhdimisht bëjmë investime kapitale për ngritjen e cilësisë së shërbimeve

Vetëm investimet kapitale nuk sigurojnë ngritjen e nivelit të cilësisë së shërbimeve

Me këto të hyra mezi bëjmë
mirëmbajtjen operative
Niveli i lartë i shpenzimeve ndikon
negativisht në cilësinë e shërbimeve

24. Renditni sipas vështirësisë sfidat
në ndërmarrjen tuaj?

1 2 3 4 5

Arkëtimi i të hyrave në nivel të ulët
Flukset monetare të ndryshueshme
Probleme me likuiditetin
Borxhet e këqija
Afatet e shkurtëra për pagesen e
detyrimeve
Shpenzimet e larta
Humbjet teknike
Infrastruktura e vjetëruar
Mossubvencionimi nga ana e
qeverisë
Kreditë me interes të lartë
Tarifat-Çmimet e ulëta
Probleme të natyres legale me
ndikim financiar
Shpenzimet e larta të zhvlerësimit
Operator i vetëm i këtij lloj shërbimi
Shfrytëzuesit e shërbimeve tuaja
janë personat fizik
Problemet e pazgjidhura nga e
kaluara
Situata politike-mospagesa nga
komuniteti pakicë
Trajtim ndryshe i taksave nga ATK
Numri i madh i të punësuarëve
Organizimi i brendshëm
Cilësia e shërbimeve

25. Kategorizoni sfidat e mëposhtme sipas prezences së tyre në ndërmarrjen tuaj?

Arkëtimi i të hyrave në nivel të ulët
 Flukset monetare të ndryshueshme
 Probleme me likuiditetin
 Borxhet e këqija
 Afatet e shkurtëra për pagesen e detyrimeve
 Shpenzimet e larta
 Humbjet teknike
 Infrastruktura e vjetëruar
 Mossubvencionimi nga ana e qeverisë
 Kreditë me interes të lartë
 Tarifat-Çmimet e ulëta
 Probleme të natyres legale me ndikim financiar
 Shpenzimet e larta të zhvlerësimit
 Operator i vetëm i këtij lloji shërbimi
 Shfrytëzuesit e shërbimeve tuaja janë personat fizik
 Problemet e pazgjidhura nga e kaluara
 Situata politike-mospagesa nga komuniteti pakicë
 Trajtim ndryshe i taksave nga ATK
 Numri i madh i të punësuarëve
 Organizimi i brendshëm
 Cilësia e shërbimeve

Shumë
rrallë

Rrallë

Mesatarisht

Shpesht

Gjithnjë

26. Kategorizoni sfidat sipas ndikimit që kanë në cilësinë e shërbimeve publike në NP?

Shumë të
madh

Të
madh

Mesatar

Të
ulët

Pa
ndikim

Arkëtimi i të hyrave në nivel të ulët					
Flukset monetare të ndryshueshme					
Probleme me likuiditetin					
Borxhet e këqija					
Afatet e shkurtëra për pagesën e detyrimeve					
Shpenzimet e larta					
Humbjet teknike					
Infrastruktura e vjetëruar					
Mossubvencionimi nga ana e qeverisë					
Kreditë me interes të lartë					
Tarifat-Çmimet e ulëta					
Probleme të natyrës legale me ndikim financiar					
Shpenzimet e larta të zhvlerësimit					
Operator i vetëm i këtij lloji shërbimi					
Shfrytëzuesit e shërbimeve tuaja janë personat fizik					
Problemet e pazgjidhura nga e kaluara					
Situata politike-mospagesa nga komuniteti pakicë					
Numri i madh i të punësuarëve					
Organizimi i brendshëm					

27. Tejkalmimi i cilave nga këto sfida ndikon në zhvillimin e qëndrueshëm të NP-ës tuaj?

Plotësisht pajtohem Pajtohem Asnjanës Pjesërisht pajtohem Nuk pajtohem

Arkëtimi i të hyrave në nivel të ulët					
Ngritja e nivelit të investimeve kapitale					
Probleme me likuiditetin					
Borxhet e këqija					
Shpenzimet e larta operative					
Humbjet teknike					

Infrastruktura e vjetëruar					
Tarifat-Çmimet e ulëta					
Probleme të natyres legale me ndikim financiar					
Shpenzimet e larta të zhvlerësimit					
Operator i vetëm i këtij lloj shërbimi					
Problemet e pazgjidhura nga e kaluara					
Situata politike-mospagesa nga komuniteti pakicë					
Numri i madh i të punësuarëve					
Organizimi i brendshëm					

28. Sa jeni dakord me pohimet e mëposhtme lidhur me planifikimin e investimeve kapitale?

Aspak Pak Disi Shumë Plotësisht

Planifikohen gjatë përpilimit të planit të biznesit

Me qenë se nuk kemi burime të sigurta të financimit nuk i planifikojmë

I planifikojmë por mbështetemi në subvencione ose grante

I planifikojmë, por e dijmë se nuk mund të financohen vetëm nga burimet e veta

Në mungesë të burimeve të financimit nuk kemi ndonjë strategji të veprimit

Nëse arrijmë të gjejmë burime të financimit i fusim në plan të biznesit gjatë rishikimit

29. Sa jeni dakord me pohimet e mëposhtme lidhur me planifikimin e burimeve financiare?

Aspak Pak Disi Shumë Plotësisht

Janë marrë parasysht gjatë përpilimit të buxhetit vjetor

Nuk kemi ndonjë njësi të veçantë brenda ndërmarrjes

Zakonisht i planifikojmë në kuadër të planit të biznesit

Janë të specifikuara në Pasqyren e flukseve monetare

Mbështetemi në burime të sigurta nga veprimtaria

Nuk ka ndonjë strategji afatgjate

	Aspak	Pak	Disi	Shumë	Plotësisht
Janë marrë parasysht gjatë përpilimit të buxhetit vjetor					
Nuk kemi ndonjë njësi të veçantë brenda ndërmarrjes					
Zakonisht i planifikojmë në kuadër të planit të biznesit					
Janë të specifikuara në Pasqyren e flukseve monetare					
Mbështetemi në burime të sigurta nga veprimtaria					
Nuk ka ndonjë strategji afatgjate					

30. Kthimi në aktive (Return On Assets-ROA) është..?

Shumë rrallë Rrallë Mesatarisht Shpesh Gjithnjë

Deri në 2%,

Nën 2%

Më e madhe se 2% por më e vogël se 5%

Minimalisht 5%

	Shumë rrallë	Rrallë	Mesatarisht	Shpesh	Gjithnjë
Deri në 2%,					
Nën 2%					
Më e madhe se 2% por më e vogël se 5%					
Minimalisht 5%					

31. Kthimi në kapitale të veta (Return On Equity-ROE) është..?

Shumë rrallë Rrallë Mesatarisht Shpesh Gjithnjë

Deri në 10%,

Nën 10%

Më e madhe se 10% por më e vogël se 15%

Minimalisht 15%

	Shumë rrallë	Rrallë	Mesatarisht	Shpesh	Gjithnjë
Deri në 10%,					
Nën 10%					
Më e madhe se 10% por më e vogël se 15%					
Minimalisht 15%					